



**UNIVERSITETI I TIRANES
FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHES ANGLEZE**

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TE PERKTHIMIT JURIDIK

Punim për Gradën Doktor në
Shkenca Gjuhësore

KOMISIONI I MBROJTJES

1. Prof.Dr. Viktor Ristani (Kryetar, Oponent)
2. Prof.Dr. Enver Hysa (Anëtar)
3. Prof.As.Dr. Elida Tabaku (Anëtare)
4. Prof.As.Dr. Fatmir Vrapit (Oponent)
5. Prof.As.Dr. Daniela Tamo (Anëtare)

Kandidati
MA. Edlir Ajazi

Udhëheqëse shkencore
Prof.Dr. Klodeta Dibra

Pasqyra e lëndës

Hyrje

0.1 Përligjia e punimit	v
0.2 Objekti dhe hipotezat e studimit	v
0.3 Metodologjia dhe struktura e studimit	vi
0.4 Përmajtja sipas krerëve	vi

KREU I - PËRKTHIMI DHE BARASVLERA: GJENDJA NË TË CILËN NDODHEN

1.1. Hyrje	fq.1
1.2. Barasvlera dhe teoritë e reja të përkthimit	fq.1
1.3. Teoritë funksionaliste të përkthimit	fq.8
1.3.1. <i>Teoria për tipat e teksteve</i>	fq.9
1.3.2. <i>Teoria e Skopos-it</i>	fq.11
1.4. Përkthimi i përcaktuar nga barasvlera	fq.14
1.5. Llojet e ekulivalencës	fq.23
1.5.1. <i>Barasvlera gjuhësore</i>	fq.24
1.5.2. <i>Barasvlera paradigmatiske</i>	fq.25
1.5.3. <i>Barasvlera stilistike</i>	fq.25
1.5.4. <i>Barasvlera semantike</i>	fq.25
1.5.5. <i>Barasvlera formale</i>	fq.26
1.5.6. <i>Barasvlera referenciale</i>	fq.26
1.5.7. <i>Barasvlera pragmatike</i>	fq.26
1.5.8. <i>Barasvlera dinamike</i>	fq.29
1.5.9. <i>Barasvlera funksionale</i>	fq.31
1.6. Pranimi i ekuivalencës funksionale	fq.33
1.7. Modeli Analiza e Gideon Toury	fq.36
1.7.1. <i>Konteksti</i>	fq.36
1.7.2. <i>Përkthimi si veprimtari që udhëhiqet nga norma</i>	fq.37
1.7.2.1. <i>Normat fillestare</i>	fq.40
1.7.2.2. <i>Normat paraprake</i>	fq.41
1.7.2.3. <i>Normat operacionale</i>	fq.41
1.7.3. <i>Përçapje analize</i>	fq.42

KREU II - ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT JURIDIK

2.1. Hyrje	fq.45
2.2. Qasje pragmatike në përkthimin juridik	fq.48
2.3. Baza epistemologjike e përkthimit juridik	fq.50
2.3.1. Karakteri normativ ose detyrues i tekstit juridik	fq.51
2.3.2. Gjuha e së Drejtës	fq.53
2.3.2.1. Karakteristika të përgjithshme	fq.54
2.3.2.2. Karakteristika leksikore	fq.55
2.3.2.3. Karakteristikat stilistikore	fq.57
2.3.2.4. Karakteristikat sintaksore	fq.58
2.3.2.5. Vendi i foljes	fq.58
2.3.2.6. Rendi i fjalive	fq.60
2.3.2.7. Gjatësia e fjalive	fq.60
2.3.2.8. Përdorimi i fjalive në diatezën pësore	fq.60
2.3.2.9. Karakteristikat semantike	fq.60
2.3.3. Diversiteti i sistemeve juridike	fq.62
2.3.3.1. E Drejta civile	fq.65
2.3.3.1.1. Ndarjet dhe konceptet	fq.66
2.3.3.1.2. Nocioni i rregullit të së Drejtës	fq.67
2.3.3.1.3. Burimet e së Drejtës	fq.68
2.3.3.2. Common Law-I	fq.69
2.3.3.2.1. Struktura e Common Law-it	fq.72
2.3.3.2.2. Equity	fq.72
2.3.3.2.3. Burimet e së Drejtës	fq.72
2.3.4. Dokumentacioni mbështetës në përkthim	fq.75
2.3.5. Qasja shumëdisiplinare e përkthimit ligjor	fq.77
2.4. Kultura juridike dhe rëndësia e saj në përkthim	fq.79

KREU III - ANALIZA E TEKSTIT DHE METODAT E PËRKTHIMIT

3.1. Tipologjia e teksteve juridike dhe përgjegjësia e përkthyesit	fq.84
3.2. Formimi i përkthyesit ligjor	fq.86
3.3. Kuptimi nëpërmjet interpretimit të tekstit	fq.92
3.3.1. Analiza semantike	fq.95
3.3.2. Analiza sintaksore	fq.96
3.3.3. Analiza gramatikore	fq.97
3.3.4. Analiza leksikore	fq.97

3.3.5. <i>Analiza stilistikore</i>	fq.97
3.4. Paqartësia (Dykuptimësia) në tekstet ligjorë	fq.98
3.5. Metodatat e përkthimit	fq.102
3.5.1. <i>Huazimi</i>	fq.105
3.5.2. <i>Kalku</i>	fq.105
3.5.3. <i>Përkthimi i fjalëpërfjalshëm</i>	fq.106
3.5.4. <i>Zëvendësimi (transpozicioni)</i>	fq.106
3.5.5. <i>Modulimi</i>	fq.107
3.5.6. <i>Përshatja</i>	fq.110

KREU IV - ANALIZË KRAHASUESE

4.1. Rëndësia e përkthimit ligjor	fq.112
4.2. Pak histori e përkthimit ligjor në Shqipëri	fq.113
4.3. Huazimet	fq.117
4.4. Analizë krahasuese	fq.120

PËRFUNDIME	fq.172
-------------------	--------

BIBLIOGRAFI	fq.177
--------------------	--------

Hyrje

Studimet në fushën e Përkthimologjisë po njohin tashmë zhvillim edhe në Shqipëri. Mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhëve të specialitetit kanë nxjerrë në pah nevojën për thellimin e studimeve në fushën e përkthimit të këtyre gjuhëve. Fusha juridike është, pa dyshim, mjaft e rrahur, pasi në jetën e përditshme kemi të bëjmë shpesh me tekste me karakter juridik, për të mos folur për komunikimin institucional e më gjerë.

0.1 Përligjia e studimit

Në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësen shkencore Prof.Dr. Klodeta Dibra zgjodhëm si fushë studimi Përkthimologjinë duke propozuar si temë për studimin tonë “Aspekte teorike dhe praktike të përkthimit juridik. Propozimi ynë u bazua në argumentet e poshtëshënuara:

➤ *Fusha e përkthimit të gjuhës ligjore është një fushë me mjaft interes, pasi komunikim në këtë fushë është mjaft i gjerë dhe i përditshëm.*

➤ *Shqipëria është anëtare e mjaft organizatave dhe organizmave ndërkombëtare dhe përkthimi i legjislacionit, qoftë atij shqiptar qoftë dhe atij të huaj, është nevojë e domosdoshme e kohës. Sigurisht, mjaft ligje janë përkthyer por, sigurisht, në vazhdimësi, do të kërkohen ligje të tjera që kanë nevojë të sillen në shqipe apo dhe ligjet shqiptare të përkthehen në anglishte.*

➤ *Studimet në fushën e Përkthimit të gjuhës juridike u shërbejnë përkthyesve dhe specialistëve të fushës, juristëve, studentëve që dëshërojnë të merren me përkthimin e literaturës juridike, e cila ngërthen vështirësi jo të vogla, të cilat do mund të kapërcehen hap pas hapi.*

➤ *Studime të këtij lloji janë, gjithashtu, në shërbim edhe të një komuniteti më të gjerë, pasi ëshë e nevojshme kultura jurike, për të kuptuar më mirë komunikimin i cili kërkon specifikisht përdorimin e gjuhës juridike.*

➤ *Ky studim përligjet, gjithashtu, edhe me studimet që kam kryer si për Gjuhën angleze ashtu dhe studimet universitare dhe pasuniversitare në fushën juridike. Puna që kryej prej disa vitesh ngërthen. Pa dyshim, edhe përkthimin juridik me të cilin jamë marrë.*

0.2 Objekti dhe hipotezat e studimit

Objekti i këtij studimi është renditja e disa aspekteve teorike dhe praktike të përkthimit juridik. Duke sjellë disa prej teorive kryesore të përkthimit në përgjithësi dhe atij juridik në veçanti, kemi si objektiv njohjen dhe aplikimin e tyre në praktikën e përkthimit të gjuhës ligjore. Objekti i studimit tonë ngërthen, po ashtu, interpretimin e konceptit të 'barasvlerës', concept aq I diskutuar nga gjuhëtarë dhe specialistë të fushës së përkthimologjisë. Nisur nga kjo, në studimin tonë kemi ngritur disa pyetje-hipoteza, të cilave jemi përpjekur t'u japim përgjigje përgjatë studimit:

- ç'është barasvlera dhe a ka, në të vërtetë, barsvlerë?
- ç'është përkthimi dhe cilat metoda janë më të përshtatshme në përkthimin e gjuhës ligjore?
- ç'nivel suksesi ka arritur përkthimi i gjuhës ligjore?

0.3 Metodologjia dhe struktura e studimit

Në studimin tonë ngërthehen disa lloje metodash, të cilat do të na ndihmojnë të sjellim një trajtesë teorike gjithëpërfshirëse, e parë në aspektin e metodave induktive dhe deduktive, të cilat janë të pashmangshme në studime shkencore.

Duke qenë se studimit tonë duam t'i japim edhe karakter praktik, kemi kombunuar, gjithashtu, metodën e analizës dhe atë të përqasjes, për t'i shërbyer më mirë qëllimit të punimit.

Studimi është menduar të strukturohet në disa krerë, me qëllime dhe objektiva të mirëcaktuara për secilin prej krerëve.

0.4 Përmbajtja sipas krerëve

Kreu I – Në kreun e parë trajtojmë nocionet e 'përkthimit' dhe të 'barasvlerës', duke iu përgjigjur edhe pyetjes: a është e mundur barasvlera dhe a është e mundur të gjendet gjithnjë barasvlera në gjuhën mbërritëse. Për këtë sjellim disa teori, duke i trajtuar në mënyrë të detajuar dhe duke u dhënë hapësirë të gjerë 'barasvlerës' dhe llojeve të ndryshme të barasvlerave. Kështu, në kreun e parë gjejmë vend teoria e Skopos-it dhe modeli i analizës së Gideon Toury-së.

Kreu II – Në kreun e dytë hyjmë në problematikën e përkthimit të gjuhës ligjore, duke bërë më parë dallimin e dy sistemeve kryesore juridike: Common Law dhe Droit Civil. Trajtimin e këtyre dy sistemeve e quajmë të domosdoshëm për t'u sjellë në studim, pasi

edhe sot e kësaj dite janë baza e sistemeve juridike në mbarë botën. Gjithashtu, trajtojmë gjuhën e së drejtës dhe karakteristika e saj, si dhe sfidat e përkthyesit të teksteve ligjore.

Kreu III – *Në kreun e tretë trajtojmë llojet e teksteve juridike si dhe formimin që duhet të ketë përkthyesi ligjor. Gjithashtu, përkthyesi ligjor, përpara se të fillojë të përkthejë tekstin ligjor, duhet ta interpretojë mirë tekstin në gjuhën origjinale në aspektin gramatikor, leksikor, semantik dhe stilistikor. Në këtë kre gjejnë vend edhe metodat e ndryshme që përdoren gjatë përkthimit të teksteve ligjore si: huazimi, kalku, përkthimi i fjalëpërfjalshëm, zëvendësimi, modulimi, përshtatja.*

Kreu IV – *Kreu i katërt i kushtohet analizës dhe përqasjes së teksteve ligjore të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Nëpërmjet analizës, dëshërojmë të vemë në dukje specifikat e sistemeve gramatikore të dy gjuhëve si dhe vështirësitë që hasen gjatë procesit të përkthimit. Gjithashtu, përqasja e tekstit original me atë të përkthyer, na jep mundësi të kuptojmë edhe mënyrat dhe metodat që përdor përkthyesi për realizimin sa më të mirë të përkthimit të tekstit ligjor*

Përfundime- *Studimi i paraqitur synon të japë një trajtesë teorike dhe praktike të përkthimit të teksteve juridike; synon të na japë karakteristikat e tekstit ligjor si dhe formimin dhe kulturën që duhet të ketë përkthyesi ligjor. Analiza përqasëse na lejon të kuptojmë më koncretisht procesin e përkthimit të tekstit ligjor si dhe vështirësitë që hasen gjatë këtij procesi.*

KREU I

PËRKTHIMI DHE BARASVLERA*: GJENDJA NË TË CILËN NDODHEN

1.1. Hyrje

Elementi në thelb të debatit, i cili u ka hapur udhën studimeve krahasuese dhe zhvillimit të shkencës së përkthimit u përket varianteve (*translation shifts*) midis përkthimit dhe origjinalit. Shkalla e barasvlerës së tekstit në gjuhën mbërritëse, në raport me gjuhën burimore, ka shkaktuar debate dhe polemika gjatë viteve 1970-të, dhe kjo gjendje nuk ka ndryshuar ende edhe sot.

Qysh nga vitet 1950-të, shumë prej teoricienëve janë orvatur të hedhin dritë mbi variantet dhe të përcaktojnë kategori të ndryshme. Këtu ia vlen të përmendim Vinay-n, Darbelnet-in dhe Catford-in. Vinay dhe Darbelent-i anojnë për nga shtatë mënyrat e përkthimit, të quajtura sot si taksonimi klasike e varianteve në përkthim. Ndërsa, për sa i përket Catford-it, `re objekt perceptimesh dhe përkufizimesh të ndryshme.

Në studimin tonë kategorizimi, variantet përkthimore janë perceptuar në shumë mënyra. Paragrafët vijues u kushtohen perceptimeve të ndryshme të nocionit ‘variant përkthimor’ dhe atij ‘barasvlerë’.

Ç’është barasvlera? A ka vërtet barasvlerë? Për këto pyetje, ia vlen të bëjmë një pyetje tjetër: ç’është përkthimi? A është përkthimi vërtet i mundshëm? Këto pyetje mund të hutojnë shumë vetë sepse, siç dihet, përkthimi ekziston. Jo vetëm që ekziston, por gjithashtu është praktikuar qysh në kohët më të lashta. Kështu që do t’ia vlente më mirë të merreshim seriozisht me pyetjet e mëposhtme: ç’nivel suksesi ka arritur përkthimi? Ç’rol barasvlerë luan ai në aktualizim? Apo edhe, si duhet matur suksesi, dhe kush e vendos pranueshmërinë e këtij suksesi?

1.2. Barasvlera dhe teoritë e reja të përkthimit

Përpara se të sqarojmë pyetjet e mësipërme, le të përpiqemi ta vendosim përkthimin, si shkencë, në një kontekst historik. Thënë ndryshe, le të analizojmë

shkurtimisht udhët e reja të shfrytëzuara dhe të propozuara gjatë këtyre viteve të fundit nga teoricienë të këtij lëmi. Ky kontekstualizim do të na mundësojë, gjithashtu, të kuptojmë logjikën, e cila nënkupton teorinë e barasvlerës dhe të njohim origjinat e saj. Elementet teorikë dhe konceptualë të një shkence ose të një arti janë të rëndësishëm, madje thelbësorë, që përkthyesi të mund të kapërcejë pengesat që has gjatë udhës. Këto ndikojnë, gjithashtu, për të njohur të kaluarën, çka mundëson, nga ana tjetër, të kuptohen prirjet e së ardhmes.

Shkrimet që kanë të bëjnë me përkthimin janë aq të vjetra sa edhe shekulli që i paraprin epokës kristiane. Punimet e Ciceronit, Horacit dhe të Shën Jeronimit (shek. 4 pas J.K.) kanë ushtruar një ndikim të madh deri në shek. e 20-të. Megjithëse praktika e përkthimit daton kaq herët, studimi i tij si një disiplinë në institucionet e arsimit të lartë nuk shkon më tej se gjysma e dytë e shek. të 20-të¹.

Për një kohë të gjatë, përkthimi ka qenë përdorur si mjet plotësues, gjatë të mësuarit të gjuhëve moderne në shkollat e mesme dhe në universitete. Kjo shpjegon në një masë të madhe statusin e tij si një disiplinë dytësore². Kjo praktikë, na thotë Munday, mori fund, duke u vjetëruar, në SHBA midis viteve 1960-të – 1970-të në saje të metodës komunikative të të nxënimit të anglishtes. Kjo metodë mbështetet në parimin që çdo student ka aftësinë natyrore të mësojë një gjuhë të huaj, në situata reale nxënieje, në një sallë mësimi dhe këtë ta arrijë pa përdorur gjuhën amtare. Kështu, përkthimi shndërrohet në një temë studimi gjatë të mësuarit të gjuhëve të huaja dhe gjatë formimit universitar të përkthyesve.

Përkthimi, ashtu si edhe shkencat e tjera, është në një zhvillim të qëndrueshëm. Ky zhvillim pasqyrohet në krijimin e programeve të formimit në përkthim – dhe në interpretim – si në ciklin e parë, ashtu edhe në të dytin, në universitetet e të gjithë botës. Po kështu, ka edhe një numër të pafundmë konferencash, monografish dhe revistash që lidhen drejtpërdrejt me temat e përkthimit³.

Siç do ta vërejmë në vazhdim, zhvillimi i përkthimit në përgjithësi dhe i përkthimit letrar në veçanti, favorizohet nga punimet e kryera në fushën e letërsisë

¹Po aty, fq. 18-29. (Shih gjithashtu *Les traducteurs dans l'histoire*, nën drejtimin e Jean Delis-it dhe Judith Woodsworth-it, Otava, Presses de l'Université d'Ottawa, 1995).

²Po aty, fq. 5-10.

³Po aty. Shih gjithashtu Anthony Pym-in dhe Monique Trajnim Caminade-in në *Les formations en traduction et interprétation: Essai de recensement mondial*, Paris, Société Française des Traducteurs, 1995. Autorët numërojnë të paktën 250 programe trajnimi në përkthim për një kohëzgjatje 4-vjeçare të ofruara në rreth 60 vende.

krahasuese dhe të analizës krahasuese⁴, si analizë e dy gjuhëve me qëllim identifikimin e dallimeve të përgjithshme dhe atyre specifike.

Megjithate, vlen të theksohet se deri në vitet 1960-të, kishte vetëm dy rrugë që lejonin qasjet e problemeve të ndryshme në këtë lëmë. Për një kohë relativisht të gjatë mungesa e krahasimeve bëri që përkthimi t'i nënshtrohej një debati pak a shumë të mbyllur. Ky debat vinte përballë njëri – tjetrit ithtarët e përkthimit letrar dhe mbrojtësit e përkthimit të lirë. Gjatë viteve 1970-të ndryshimet, e ndodhura në Europë dhe në SHBA, u hapën rrugën jo vetëm qasjeve të reja por, gjithashtu, edhe mundësisë për të hedhur themelet e një disipline që anonte nga tërësia e problemeve të fushës, më tepër se sa me çështje të shkëputura e të izoluara.

Ndër teoricienët, që analizojnë në mënyrë shteruese këto ndryshime, mund të përmendim Edwin Gentzler-in. Në veprën e tij *Contemporary Translation Theories*, e cila është, qysh nga botimi i saj i parë, më 1993 një ndër veprat më të cituara, Gentzler-i regjistron dhe analizon teoricienët dhe rrymat që kanë ndikuar në formimin e një disipline të re përkthimi. Punimet e kohëve të fundit të Jeremy Munday-t⁵ marrin, gjithashtu, parasysh punimin e Gentzler-it.

Në këtë vepër Gentzler-i saktëson se, tradicionalisht, studimet në përkthim kanë të bëjnë me çështje filozofike. Përkthimi perceptohej ose si një veprimtari letrare ose si një dukuri jo-letrare. Praktikisht, kishte vetëm dy mënyra kërkimore: e para lidhej me probleme letrare që hidhte poshtë çdo postulat teorik, çdo normë e çdo zhargon gjuhësor, ndërsa e dyta interesohej për çështjet gjuhësore dhe mëtonte se ndiqte një qasje shkencore⁶, duke hedhur poshtë kësorisoj çdo spekulim dhe çdo zgjidhje që nuk mbështetej te logjika.

Sipas Gentzler-it rezultoi se mbrojtësit e këtyre dy mënyrave kërkimore i kufizojnë tipat e teksteve që përdorin për të vlerësuar metodologjitë e tyre në mënyrën më

⁴Konkretisht J.P. Vinay dhe J. Darbelnet, *Stilistika e krahasuar e frëngjishtes dhe e anglishtes*, 1958; J.C. Catford, *A Linguistic Theory of Translation: an essay in applied linguistics*, London, Oxford University Press, 1965.

⁵Krahaso, *Introducing Translation Studies*, 2001. Jeremy Munday është profesor i studimeve spanjolle në Universitetin e Surrey (University of Surrey), në Mbretërinë e Bashkuar, përkthyes i pavarur dhe leksikograf.

⁶Në Evropë, këto debate u përfaqësuan nga shkolla e Lajpcigut. Mbrojtës kryesorë ishin Otto Kade, Gert Jäger, Albrecht Neubert, Wolfram Wills, Katharina Reiss dhe Werner Koller, ndërsa si frymëzues të krijimit të një teorie të pavarur të përkthimit mund të përmendim amerikanin Andre Lefevere, Holmes, Van den Broeck dhe Catford. Në Shtetet e Bashkuara, ithtarët kryesorë të këtij perceptimi të ri të përkthimit janë, vetëkuptohet, Eugene Nida dhe Taber-i. Shih Mary Snell-Hornby, *Translation Studies: An Integrated Approach*, Amsterdam, John Benjamins, 1988, Rishikuar 1995, fq. 14.

të mirë të mundshme, duke e gjykuar njëri – tjetrin me skepticizmin më të madh: përkthyesit letrarë largonin çdo analizë gjuhësore, të thënë shkencore, dhe gjuhëtarët, nga ana e tyre, hidhnin poshtë çdo analizë letrare jo-shkencore⁷. Terma si *korrekt, jo korrekt, art, shkencë*⁸ që shoqëronin aspekte të ndryshme të përkthimit ishin në rend të ditës, çka përbënte pasqyrimin e një lloj polarizimi që e bën përkthimin një fushë monolite (homogjene).

Gjatë viteve 70-të, shpjegon Gentzler-i, metoda e ndjekur në kërkimet përkthimore pësoi një transformim: në vend që të provohej zgjidhja e problemeve filozofike që kishin të bënin me natyrën e kuptimit, përkthimologjia (traduktologjia) i kushtonte më tepër vëmendje mënyrës se si zhvendosej kuptimi. Ajo u bë një disiplinë e karakterizuar nga një hapje drejt qasjes ndërdisiplinore. Po kështu, specialistë të letërsisë nisën të punonin për projekte të lidhura me logjicienët, gjuhëtarët dhe filozofët. Në këtë mënyrë, terma si *korrekt, jo korrekt, formal, dinamik, literal, i lirë, art, shkencë, teori dhe praktikë* u rralluan së tepërmi. Në këtë mënyrë u vu re një ndryshim toni në tezat dhe në mendimet e shfaqura nga teoricienë të ndryshëm⁹.

Në këtë aspekt, përkthimi nuk është parë si letrar ose jo-letrar, por si letrar dhe jo-letrar njëherazi. Çështjet e analizuara janë më të larmishme, falë së kaluarës dhe interesimi më i madh është për tema shkencore si natyra e procesit të përkthimit ose përshtatja midis tekstit origjinal (burimor) dhe tekstit të përkthyer (mbërritës). Përkthimologjia trajton, gjithashtu, çështje që kanë të bëjnë me dallimin midis autorit dhe përkthyesit. Kuptimi i tekstit fillestar nuk është më bërthama e procesit të përkthimit. Kuptimi dhe funksioni i tekstit të përkthyer tërheqin gjithnjë e më tepër vëmendjen e shkencëtarëve.

⁷Për një historik të hollësishëm të evolucionit në përkthimologji, shih kreun 4 të veprës *Translation Studies* të Gentzler-it. Shih gjithashtu Mary Snell - Hornby, vep. e cit. fq. 2.

⁸Këto fjalë janë huazuar nga Gentzler-i.

⁹Ndryshimi në perceptimin e Nida-s kundrejt ekuivalencës dinamike është një shembull. Në parathënien e veprës *From One Language to Another. Functional Equivalence in Bible Translation*, Nashville, Thomas Nelson Publishers, 1986, Nida tërheq vëmendjen për ndryshim në terminologji. Në këtë libër ai përdor termin *functional equivalence* në vend të *dynamic equivalence*, të cilin e përdor në veprat *Toward a Science of Translating*, Leiden E. H. Brill, 1964 dhe *The Theory and Practice of Translation*, Leiden E. H., Brill, 1969. Ky ndryshim është shkaktuar nga interpretimet e gabuara që i janë bërë termit *dynamic equivalence*.

Sipas Gentzler-it, ky ndryshim i orientimit të studimeve dhe kërkimeve në fushën e përkthimit i atribuohet para së gjithash James Holmes-it¹⁰, i cili futi termin *Translations Studies* (Studime përkthimore ose Përkthimologji) dhe André Lefevere-it¹¹. Punimeve të Holmes-it dhe të Lefevere-it iu kushtua një vëmendje e veçantë, sepse ata janë në themel të teorisë së barasvlerës, ashtu siç e njohim dhe zbatojmë sot. Vlejnë gjithashtu të përmenden edhe punimet e Catford dhe të Toury.

Në veprën "*The Focus of Growth of Literary Knowledge*", Lefevere reagon ndaj gasjeve të ndjekura nga ithtarët e dy mënyrave të kërkimit të sipërmendura, pra ndaj mënyrës së ndjekur nga përkthyesit letrarë, të cilën e cilëson si hermeneutike*, dhe mënyrës së ndjekur nga gjuhëtarë, të cilën e cilëson si neopozitiviste*¹².

Ai qorton mënyrën e parë, të zbatuar nga teoricienë që orvaten të mbërrijnë vetëm në ide universalisht të vlefshme, por kjo mënyrë nuk ka bazë shkencore dhe mbështetet në sistemin nocionor, në hipoteza epistemologjike 300 vjeçare të vjetra dhe kundërshtohet gjithnjë nga zbulime të disiplinave të tjera¹³. Përsa i përket pozitivizmit

¹⁰ Poet dhe përkthyes amerikan, i cili ka dhënë leksione në lëndën e përkthimit në Universitetin e Amsterdamit dhe që ka shkruar disa libra studimorë në lëndën e përkthimit (në përkthimologji), midis të tjerash «*The Name and Nature of Translation Studies*», *The Translation Studies Reader*, botuar nga Lawrence Venuti, London, Routledge, 2000, fq. 172-185. Ky artikull u botua fillimisht në vitin 1972.

¹¹ André Lefevere-i ka qenë profesor në Departamentin e gjuhëve gjermanike në Universitetin e Teksasit në Austin dhe Profesor Nderi në Përkthimologji në Universitetin e Warwick -it. Është autor i shumë librave, ndër të cilët mund të përmendim: *Translation of Poetry: Seven Strategies and a Blue Print*, Assen, Van Gorcum, 1975 dhe *Translation, Rewriting & the Manipulation of Literary Frame*, London, Routledge, 1992, 176 f., kol. « Translation Studies ». Disa nga veprat e tij mund të gjenden vetëm në hollandishte.

* Hermeneutika: arti dhe teknika e interpretimit të teksteve. Në Filozofi, drejtim i filozofisë bshkëkohorë që përgjithëson teorinë e interpretimit të teksteve duke e çuar drejt një kritike të ligjërimit si zbulues i dimensionit përbërës të ekzistencës njerëzore.

* Neopozitivizëm: drejtim i mendimit i lindur në Vjenë në vitet '20 të nëntëqindës i cili, duke mohuar çdo metafizikë, çon praktikën e filozofisë drejt analizës së ligjërimit shkencor, nga e cila nxjerr një logjikë me të cilën formulon rregullat e çdo tipi ligjërimit, përfshirë dhe atë të zakonshëm.

¹² Kujtojmë se doktrinat pozitiviste mëtonin të ishin të bazuara në njohuritë faktike dhe në përvojën shkencore.

¹³ Lefevere, cituar nga Gentzler-i në *Contemporary Translation Theories*, 1993, f.75.

* Monizmi: pikëpamje filozofike ku një shumëllojshmëri gjërash egzistuese mund të shpjegohen me termat e një realiteti ose thelbi të vetëm. Njihet ndryshe si jo-dualizëm ose jo-pluralizëm.

* Reduksionalizmi: (filoz.) nga shekulli XVIII deri më sot, drejtim epistemologjik që përcakton një marrëdhënie hierarkike midis disiplinave të ndryshme shkencore, çdonjëra prej të cilave mund të risillet dhe riformulohet në ligjërimitin e një discipline më të përgjithshme (p.sh. dukuritë psikologjike mund të çohen në nënshtresën e tyre neurofiziologjike)

* Fizikalizmi: konceptimi filozofik i gjysmës së parë të shekullit XX, që synonte të unifikonte të gjitha shkencat (përfshirë dhe ato shoqërore) në shkencën e fizikës, gjuha e së cilës do të merrej e përbashkët dhe universale. Në Filozofi, drejtim i mendimit i gjysmës së parë të shekullit të XX, brenda shkollës së Vjenës, falë Neurath-it, programi i të cilit synonte të eliminonte nga shkenca çdo problem metafizik, të themelonte bashkimin e shkencës mbi gjuhën, të risillte të gjitha shkencat në të njëjtën bazë fizike.

logjik, strategjia kryesore e ndjekur nga strukturalistët e fushës së përkthimit, gramaticienët dhe nga semioticienët, ai qorton reduktimin e studimit të letërsisë në një gjuhë të destinuar për shkencën e fizikës, bazimin e postuleteve të saj tek të dhënat sasiore dhe të rregullat që rrjedhin prej tyre, dhe të propozojë modele shkencore që nxjerrin në pah më tepër teori si monizmin*, reduksionizmin* dhe fizikalizmin*.

Ai paralajmëron, gjithashtu, se teoritë e përkthimit që mbështeten në qasje të tilla nuk kontribuojnë në zhvillimin e njohurive letrare dhe kanë shfaqur interesa që nuk ndihmojnë në formimin e përshtatshëm të një teorie të përshtatshëm të përkthimit¹⁴.

Sipas Lefevre-it, shkenca e përkthimit do të duhej të bëhej me ndihmën e rasteve reale. Diskutimi i këtyre rasteve do të çonte në zhvillimin e një shkence, e cila do të gëzonte konsensusin e teoricienëve kompetentë. Ai propozon, gjithashtu, se kërkimet në fushën e përkthimit do duheshin të largonin teoritë e letërsisë e të gjuhësisë. Madje, ai propozon edhe një përçapje të kundërt me atë të ndjekur deri asokohe, e cila do t'i imponohej zhvillimit të njohurive specifike të përkthimit dhe që, më vonë, do të mund të gjenin zbatim nga teoritë gjuhësore dhe letrare. Shkurt, Lefevre propozon hartimin e një shkence përkthimi, të krijuar nga pjesë, duke u nisur nga konceptet e veta dhe të qasjeve të tyre. Ai propozon realizimin e kërkimeve që mbështeten në koncepte zhvillimore të një metashkence dhe jo të koncepte të një logjike pozitiviste apo hermeneutike.

Kërkimet në lëmin e përkthimit, më herët, bazoheshin në premisa që kishin të bënin me kuptimin origjinal që përkthyesit dhe interpretët duhej ta riprodhonin me korrektësi. Kërkimet shkencore na jepnin rregullat dhe parashkrimet¹⁵ që zbatoheshin për mënyrat e përkthimit. Me ndihmën e këtyre rregullave ose parashkrimeve, çdo përkthim i bërë nisur nga i njëjti tekst duhej të mbërrinte tek i njëjti rezultat.

Holmes-i, ashtu si Lefevre, propozon realizimin e një përkthimi pa ndihmën e parashkrimeve universale që kanë të bëjnë me vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e zgjidhjeve të propozuara. Ai bën një analizë të metodave dhe mënyrave të përkthimit, që janë përdorur në periudha të ndryshme të historisë. Ai nuk kërkon të përjetësojë postulate për natyrën e gjuhës ose të njohjes konceptuale, por përpiqet më tepër të kuptojë tipat e

¹⁴Po aty.

¹⁵Për një përshkrim të këtyre rregullave, shih Edmond Cary-n, *Les grands traducteurs français: Etienne Dolet, Amyot, Mme Dacier, Houdar de la Motte et les traducteurs d'Homère, Galland et les traducteurs des Mille et une nuits, Gérard de Nerval, Valery Larbau.*, Genève, Georg, 1963. Cary paraqet atje kërkesat e propozuara nga Etienne Dolet-i. Për kërkesat e tjera, në gjuhën angleze, shih Mary Snell-Hornby, *Translation Studies: An Integrated Approach*, 1995, fq. 12-13.

ndryshëm të përkthimit. Holmes-i propozon katër tipa (lloje) përkthimi që ruajnë një lidhje të ndryshme me origjinalin për sa i përket formës, funksionit dhe kuptimit.

Tipi i parë i përkthimit ka të bëjë me formën. Përkthimi ruan formën e tekstit zanafillor. Holmes-i mendon se është e pamundur të ruash formën e një poeme origjinale, por është e mundur të gjenden, në kulturën përftuese, forma që i ngjajnë asaj të origjinalit, dhe se është e mundur të rikrijohet struktura themelore e vargjeve.

Tipi i dytë ka të bëjë me funksionin. Në këtë tip përkthimi, përkthyesi përpiqet të zbulojë funksionin që përkthimi do të ketë në kulturën pritëse dhe lejon që përkthimi të realizohet sipas rregullave të gjuhës mbërritëse, që mundësojnë përftimin e këtij funksioni. Përkthimi realizohet sipas një forme analoge, e cila ka si qëllim realizimin e një efekti të ngjashëm; si për shembull versioni anglez i Homerit me anë të vargjeve jo të rimuara.

Tipi i tretë lidhet me kuptimin e tekstit. Për Holmes-in, ky tip përbën një veçanti perceptimi. Përkthimi i një poeme duhet të na çojë te kuptimi i saj; d.m.th. kuptimi i poemës në gjuhën mbërritëse mund të jetë një lloj derivati i origjinalit.

Tipi i katërt ka të bëjë me shmangien formale. Holmes-i propozon një lloj përkthimi që largohet në mënyrë të ndërgjegjshme nga origjinali dhe që ndan vetëm pak tipare të përbashkëta me këtë të fundit¹⁶.

Nga sa më sipër, vëmë re se Holmes-i përqendrohet tek: a) analiza e lidhjes midis tekstit të përkthyer (si tekst dytësor) dhe tekstit origjinal, duke pasur parasysh praktikën e kuptimit në fushën letrare shkencore, dhe b) lidhja midis tekstit të përkthyer (si tekst i parë) dhe traditat e kuptimit të kulturës marrëse (pritëse). Kjo nënkupton pra, që një përkthim mund të analizohet në lidhje me origjinalin dhe me sistemin e domethënies ose me kuptimin e fushës letrare të origjinës, në raport me sistemin e kuptimit të kulturës marrëse.

Sipas Holmes-it, një poemë e përkthyer nuk mund të jetë kurrë e njëjtë me origjinalin dhe aq më pak ekuivalenti i saj. Sipas tij, të kërkuar barasvlerën e saj do të thotë t'i kalosh kufijtë pragmatikë që qarkojnë rrethanën. Për të, përkthimi nuk ka të bëjë me të njëjtin objekt të botës reale të tekstit fillestar por, më tepër, me një formulim

¹⁶Për një përshkrim të hollësishëm të katër llojeve të përkthimit të analizuara nga Holmes-i, shih Gentzler, vep. e cit., f. 92-94.

gjuhësor. Sipas tij, gjuha e përkthimit është e ndryshme nga gjuha letrare zanafillore dhe ai përdor termin “metagjuhë*” për të bërë këtë dallim¹⁷.

Për të kundërshtuar parashkrimet e vjetra, sipas të cilave të gjitha përkthimet e një poeme duhej që të na jepnin rezultate të njëjta, Holmes-i propozon përkthimin e një poeme nga pesë përkthyes të ndryshëm. Ai paralajmëron se shanset për të pasur dy përkthime identike¹⁸ janë shumë të zbehta, edhe nëse bëhet fjalë për një poemë shumë të thjeshtë. Për të, do të ishte gabim që të quheshin këto përkthime të ndryshme ekuivalentë me origjinalin. Holmes-i parapëlqen të flasë për tipare ose forma të ngjashme, për efekte të njëjtë ose për funksione analoge të një teksti. Sipas tij përkthimi, si një proces, është një vazhdimësi vendimesh që përkthyesi ndërmerr për të arritur qëllimin e vet, dhe beson se këto vendime hapin disa rrugë e mbyllin disa të tjera.

Vlen të nënvizohet se kuptimi i termit *barasvlerë* merr këtu një dimension të ri. Ky term, kur përdoret në përkthim, ka të bëjë me një rrethanë ose me një element ekuivalent në planin e ligjërimit dhe jo në atë të gjuhës.

Përkthimi letrar shërben si burim për fusha të tjera përkthimi, përfshi këtu edhe atë juridik. Përkthimi i specializuar ka trashëguar debate për barasvlerën, kur kanë marrë përmasa të mëdha, sipas fushave të ndryshme të specialitetit. Përkthimi ligjor ka parasysh barasvlerën në një mënyrë krejt të veçantë.

1.3. Teoritë funksionaliste të përkthimit

Debatet për përkthimin që përfshijnë vitet 1950-të – 1960-të kishin të bënin kryesisht me kuptimin dhe barasvlerën. Punimet e Nida-s lidhur me ekuivalencën formale dhe ekuivalencën dinamike e ilustronjë mirë këtë prirje. Vitet 1970-të shënojnë një zhvillim të rëndësishëm në përkthimologji, kryesisht në Gjermani.

* Metagjuhë: në Logjikë dhe në Gjuhësi, gjuhë artificiale ose natyrale me të cilën analizohet ose përshkruhet i njëjti ose një tjetër ligjërimit, thënë, pra, *gjuhë objekt*.

¹⁷ Vepra *The Name and Nature of Translation Studies*, 1972 e Holmes-it është konsideruar si një nga veprat themelore në përkthimologji. Në të Holmes-i përdor një terminologji të re të përkthimologjisë si dhe një strukturë të re, e cila drejton studimet në këtë fushë. Ai propozon krijimin e një dege përshkruese që lejon përshkrimin e dukurive të përkthimit ashtu siç manifestohet në botë, një degë teorike që cakton parimet për të shpjeguar këto dukuri, si dhe një degë të zbatuar që mundëson përdorimin e këtyre dukurive.

¹⁸Në këtë shembull, nocioni i ekuivalencës është i vendosur mes përkthimeve të ndryshme të së njëjtës poemë, sesa midis origjinalit dhe përkthimit.

Gjatë këtij dhjetëvjeçari, Gjermania ka qenë skena e zhvillimit të teorive të quajtura funksionaliste, të përqendruara kryesisht te tipat e teksteve dhe te funksionet e tekstit. Këto teori, midis të cilave figurojnë teoria mbi tipat e teksteve e Reiss-it dhe teoria e Skopos-it e Reiss-it dhe Vermer-it, ndërtojnë një tipologji tekstesh për t'u përkthyer sipas nocionit të funksionit, dhe i bashkëngjisin çdo tipi tekstor një metodë përkthimi. Me teorinë e Skopos-it, teksti zanafillor resht së qeni element qendror që përcakton natyrën e tekstit në gjuhën mbërritëse, dhe kjo e fundit shndërrohet në një entitet me të drejtë të plotë, funksioni i së cilës mund të jetë i ndryshëm nga ai i gjuhës nisëse.

1.3.1. Teoria për tipat e teksteve

Në fillim të viteve 1970-të Katarina Reiss, teoriciene gjermane, propozon konceptin e tekstit ekuivalent. Në punimet e saj, Reiss-i analizonte shkallën sipas së cilës përkthimi arrin të vendosë komunikimin dhe pikën tek e cila duhet kërkuar ekuivalenca. Ajo çka ajo kërkonte të ndiqte ishte vendosja e një procesi sistematik për vlerësimin e përkthimit. Për këtë, ajo propozoi një tipologji tekstesh dhe çdo tipi i dha një funksion të veçantë.

Ajo e përcaktoi përkthimin si një proces komunikimi dygjuhësh, i cili synon përgjithësisht të riprodhojë në gjuhën mbërritëse një tekst që është funksionalisht ekuivalent me tekstin zanafillor¹⁹. Ky proces përkthimi përfshin, sipas Reiss-it, mjetin²⁰ ose tekstin burimor dhe tekstin në gjuhën mbërritëse dhe një *medium*, apo ndryshe përkthyesin, i cili shndërrohet në një *dhënë*s të dytë. Gjithashtu, përkthimi shikohet si një komunikim dytësor.

Raiss-i saktëson se përdorimi i dy gjuhëve natyrore dhe i një përkthyesi ndryshon domosdoshmërisht dhe natyrisht mesazhin gjatë procesit të komunikimit. Ajo nënvizon, gjithashtu, se ky parim mbështetet te postulati i teoricienit të komunikimit Otto Haseloff,

¹⁹Shih Katharina Reiss, *Type, Kind and Individuality of Text. Decision Making in Translation*, në *The Translation Studies Reader*, edited by Lawrence Venuti, London, Routledge, 2000, fq. 160-171.

²⁰Termet e specializuara të përdorura në këtë teori janë vendosur me shkronja korsive, sepse janë përkthim i versionit në anglishte. Punimet e Reiss-it janë hartuar në gjuhën gjermane. Tekstet që janë në dispozicion në anglishte, janë përkthime nga gjermanishtja. Në anglishte, termet e përdorura për përcaktimin e tre elementeve të përfshira në procesin e përkthimit janë, sipas Reiss-it, *media* (përkthyer *mjet* këtu), *medium* - ndryshe përkthyes (përkthyer këtu me *parmedium*, në mungesë të një termi më të mirë) dhe *secondary sender*, ndryshe, edhe një herë tjetër, përkthyes (përkthyer me *emetues* (transmetues), meqë bëhet fjalë për teorinë e komunikimit).

sipas të cilit komunikimi ideal është i rrallë edhe brenda së njëjtës gjuhë, për shkak të njohurive dhe të pritshmërive të marrësit të cilat janë në përgjithësi të ndryshme nga ato të dhënësit.

Kjo dukuri njihet me emrin *dallim që favorizon komunikimin (communicative difference)*. Dallimet jo të qëllimshme mund të dalin nga dallimet midis strukturave të gjuhëve ose nga kompetenca përkthimore e përkthyesit. Ndërsa dallimet e qëllimshme mund të shfaqen, kur qëllimi i ndjekur gjatë përkthimit është i ndryshëm nga ai i ndjekur nga teksti origjinal²¹. Siç e saktëson Reiss-i, kur ka ndryshim në funksionin e komunikimit, në vend që të kërkohet barasvlera funksionale midis tekstit fillestar dhe tekstit mbërritës, duhet kërkuar më tepër rishprehja e përshtatshme e tekstit mbërritës sipas funksionit të tekstit burimor.

Reiss-i pohon se është i mundur hartimi një tipologjie tekstesh, sepse gjuhët e ndryshme dhe kulturat përdorin pak a shumë të njëjtët tipa tekstesh. Kështu, bazuar në funksionin e teksteve dhe llojeve të komunikimit identifikohen tekste informuese, shprehëse dhe operacionale.

Ajo saktëson se tekstet informuese përmbajnë fakte të thjeshta: udhëzime, njohuri, opinione, etj., të shkruara në një gjuhë logjike ose referenciale. Tekstet shprehëse u përkasin eseve (sprovave), d.m.th. krijimit letrar tek i cili ndihet fuqishëm prania e autorit. Estetika dhe forma e teksteve përbëjnë elemente që ia vlen të riprodhohen për të garantuar suksesin e përfuturit të barasvlerësisë. Ndërsa tekstet operacionale kërkojnë të na japin një sjellje ose një reagim. Për këtë, autorja praktikon një gjuhë dialogjike. Reiss-i njih edhe një tip të katërt tekstesh, për të cilin ajo nuk vonon të na flasë. Bëhet fjalë për filmat ose për reklamat që shfaqen në shtypin e shkruar, të folur (radio) apo të televizionuara, të cilat zëvendësojnë tre tipat e tjerë të teksteve me ndihmën e imazheve, muzikës, etj²².

Për çdo tip teksti, Reiss- na jep një qasje shkencore përkthimi. Kështu, për tekstin informues, përmbajtja duhet të na jepet në tekstin mbërritës. Ajo propozon një përçapje të drejtuar nga kuptimi i tekstit fillestar që mundëson ruajtjen e pandryshueshmërisë së përmbajtjes. Kjo mund të kërkojë, për shembull, që të mos e shprehësh hapur atë që është e pashfaqshme (e nënkuptuar) dhe anasjelltas, dhe kjo bëhet për shkak të dallimeve midis pragmatikës kolektive të të dy bashkësive gjuhësore që kanë të bëjnë me

²¹Koncepti i *qëllimit* ose i *funksionin* të përkthimit është shpjeguar në pikën vijuese.

²²Shih Jeremy Munday, *Introducing Translation Studies*, 2001, fq. 73-75.

përkthimin. Nëse teksti fillestar ka qenë shkruar me qëllim që të përçojë një përmbajtje artistike, përmbajtja e tekstit në gjuhën mbërritëse duhet të na jepet në një formë artistike analoge. Si metodë përkthimi, Reiss-i na sugjeron përkthimin nëpërmjet *identifikimit*. Kjo do të thotë që përkthyesi duhet të njëjtësohet me qëllimin artistik dhe krijues të autorit për të riprodhuar cilësinë artistike të tekstit.

Pra, në qoftë se teksti fillestar ka një organizim të brendshëm, i cili prodhon një reagim ose një sjellje, përmbajtja e tekstit mbërritës duhet gjithashtu të ketë një përmbajtje të tillë me qëllim që të na japë një reagim ose një sjellje analoge tek lexuesi i tekstit mbërritës. Metoda e përkthimit që na sugjeron Reiss-i është përshtatja. Ajo jep si shembull fjalinë “*black is beautiful*”, e cila do të duhej përshtatur nëse ajo i adresohet një lexuesi të Afrikës së Jugut²³.

Ajo ngulmon në faktin se një ndryshim në funksionin e tekstit zhduk nevojën e vendosjes së një tipologjie të teksteve dhe përdorimin për çdo tip teksti të një metode përkthimi, e cila të mundësojë barasvlershmërinë funksionale të tekstit mbërritës. Në rastin kur funksioni i tekstit mbërritës është i ndryshëm nga ai i tekstit burimor, Reiss-i na sugjeron më tepër vendosjen e një tipologjie tipesh përkthimi e cila do të na jepte kriteret e mënyrës së përkthimit të dëshirueshme për çdo rast. Nëse funksioni i tekstit mbërritës është i ndryshëm nga ai burimor, objektivi i përkthimit (ose i tekstit mbërritës) është që t’i japë këtij të fundit një formë përkatëse të funksionit të nisjes. Çështja që shtrihet këtu nuk është më cilin objektiv dhe cilin publik synon teksti burimor, por më tepër cilin objektiv dhe cilin publik synon teksti mbërritës. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lëmin e përkthimit juridik.

1.3.2. Teoria e Skopos-it

Teoria e *Skopos-it*²⁴ bën pjesë në teorinë e veprimit përkthimor (translatorisches handeln) e propozuar nga Holz-Mänttärri, i cili e shikon përkthimin si një lloj të veçantë

²³Shih: Katharina Reiss, *Type, Kind and Individuality of Text. Decision Making in Translation*, 2000, fq. 168.

²⁴Versioni i plotë i teorisë së *Skopos-it* i Vermeer-it është në gjermanishte . Autori ka botuar një version të shkurtuar në librin e botuar nën përgjegjësinë e Lawrence Venuti-t , *The Translation Studies Readers*, 2000, fq. 221-232. Në të Jeremy Munday bën një analizë mjaft të hollësishme. Shih veprën e tij *Introducing Translation Studies* , 2001, fq.78-81. H. G. Höning . H. G. Honing-u gjithashtu bën një analizë të kësaj teorie në artikullin *Positions, Power and Practice: Functionalist Approaches and Translation Quality Assessment*, në *Translation and Quality*, edited by C. Schäffner, Clevedon, Multilingual Matters, 1998, fq. 6-35.

të veprimit përkthimor të bazuar tek teksti burimor. Termi *Skopos*, me origjinë greke, do të thotë qëllim ose objektiv dhe është përdorur në vitet 1970-të nga teoricieni gjerman Hans J. Vermeer, si një term teknik, që përcakton qëllimin e tekstit mbërritës dhe të veprimit përkthimor. Duke u mbështetur tek parimi, sipas të cilit, çdo tip veprimi përkthimor, dhe si rrjedhim vetë përkthimi, mund të konsiderohet si një veprim, Vermeer-i pohon se çdo veprim ka një qëllim dhe një funksion dhe që, si rrjedhim, përkthimi mund të ketë gjithashtu një qëllim të veçantë. Çdo veprim çon te një rezultat, një situatë e re apo tek një ngjarje dhe, ka të ngjarë, te një objekt i ri. Veprimi përkthimor, nga ana e vet, na jep një tekst mbërritës, të cilin Vermeer-i e quan *translatum*. Është për t'u theksuar që në këtë teori, qëllimi ose *skopos*-i i *translatum*-it mund të jetë i ndryshëm nga ai i tekstit burimor. Vermeer-i saktëson që “teksti burimor dhe teksti i mbërritjes mund të dallojnë shumë nga njëri-tjetri, jo vetëm në formulim dhe në shpërndarjen e përmbajtjes por, gjithashtu, edhe te qëllimet përkatëse, të cilat përcaktojnë mënyrën sipas së cilës shprehet përmbajtja”²⁵.

Teoria e *Skopos*-it përqendrohet, para së gjithash, tek qëllimi i përkthimit, i cili përcakton metodat e përkthimit dhe strategjitë që do të përdoren për të mbërritur tek një rezultat funksionalisht i përshtatshëm. Vermeer-i saktëson se procesi, i cili çon te *translatum*-i, duhet të paraprihet nga një proces marrëveshjeje, sipas të cilit ai që komandon përkthimin i shpjegon përkthyesit qëllimin e përkthimit dhe kushtet në të cilat duhet të kryhet përkthimi, përfshirë këtu afatet e përfundimit dhe honoraret. Përkthyesi është ekspert në veprimin përkthimor; ai është i vetmi përgjegjës i realizimit të punës që i është besuar dhe i rezultatit të pritshëm. Kështu, me ta njohur funksionin e tekstit mbërritës, përkthyesi nis punën me tekstin burimor tek i cili ai vendos një hierarki elementesh të cilët modelojnë tekstin në gjuhën mbërritëse.

Le të vëmë re, këtu, statutin e dhënë tek teksti burimor. Është e sigurt pikënisja te prodhimi i *translatum*-it, por mbërritja varet kryekëput nga funksioni ose nga *Skopos*-i që do të ketë në kulturën pritëse. Po kështu, parimi i teorisë së *Skopos*-it mund të zbatohet në tri mënyra dhe mund të ketë tri përmasa. Ai mund të zbatohet: a) te procesi i përkthimit, dhe si rrjedhim te qëllimi i këtij procesi. B) te rezultati i përkthimit dhe, si rrjedhim, te funksioni i *translatum*-it; dhe c) te mënyra e përkthimit dhe, si rrjedhim, te qëllimi i kësaj mënyre.

Për të kuptuar pikën e fundit të paragrafit të mësipërm, le të kujtojmë se teoria e *Skopos*-it kombinon elemente të teorisë që kishte të bënte me tipat e teksteve sipas Reiss-

²⁵Hans J. Vermeer, *Skopos and Commission in Translational Action*, botuar nga Lawrence Venuti, London, Routledge, 2000, fq. 223.

it. Kjo teori, siç u paraqit në paragrafët e mësipërm, bashkon një mënyrë ose procedurë përkthimi me tipin e tekstit që do të përkthehet.

Vermeer-i saktëson se *Skopos*-i nuk zbatohet vetëm për një veprim të plotë – te i gjithë teksti – por gjithashtu, në masën më të mundshme, te pjesë veprimi, d.m.th. te pjesë të *translatum*-it, të cilat Vermeer-i i quan *sub-skopoi*, nëse kjo do të ishte e nevojshme për pritshmëritë.

Kjo teori, e cila vendos përkthimin në kontekstin e sociolinguistikës pragmatike, u kritikua nga ata që mbështesin idenë se të gjitha veprimet nuk kanë një objektiv. Vermeer-i saktëson se një veprim, që nuk ka një qëllim, nuk mund të quhet si një veprim. Letërsia, shpesh, merret si një shembull teksti që nuk ka qëllim të saktë. Vermeer-i saktëson se një poemë mund të jetë rezultat i një çasti frymëzimi dhe, të themi të vërtetën, nuk ka funksion. Gjithsesi, vazhdon ai, fakti i thjeshtë i shkrimit të një poeme shndërrohet në veprim, sepse krijuesi edhe mund të vendoste të mos e shkruante. A nuk do të ishte e saktë këtu të kërkonim me ngulm funksionin estetik? Nëse këtij do t'i shtonim botimin e një poeme të tillë, vetëkuptohet që aty ka një qëllim, cilido qoftë ai. Siç pohon Louis Jolicoeur, botimi i një vepre ka si qëllim t'i japë lexuesit veprën në fjalë, pra ta bëjë zotërues të saj²⁶.

Vermeer-i i mvesh qëllim edhe lëvizjes *arti për art*, me fjalë të tjera, artit të krijuar për dashurinë për art. Sipas tij, kjo lëvizje dëshironte një reagim kundër idealizmit, i cili i beson një qëllimi të caktuar.

Tipi i dytë i kritikës së teorisë së *Skopos*-it është pak i ngjashëm me të parin. Disa mëtojnë se nuk janë të gjitha përkthimet që kanë një qëllim. Kësaj, Vermeer-i i përgjigjet duke përdorur të njëjtën logjikë: një përkthim, që nuk ka qëllim ose funksion, nuk do të dinte të ishte një përkthim në kuadrin e teorisë së *Skopos*-it. Dikush që ndërmerret një përkthim e bën ose me nismë të vetë, ose ngaqë ia kërkon dikush tjetër. Në të dy rastet bëhet fjalë për një veprim. Kritikë të tjerë të kësaj teorie i mëshojnë faktit se teoria e Reiss-it dhe ajo e Vermeer-it trajtojnë dukuri të ndryshme dhe nuk duhet të lidheshin me të njëjtën teori. Për më tepër, termi *translatum* quhet si një term i cili nuk ndihmon në asgjë për zhvillimin e përkthimologjisë dhe mund të zëvendësohej me terma ekzistues, si tekst mbërritës ose përkthim²⁷.

²⁶Louis Jolicoeur, *La sirène et le pendule*, Kebek, L'instant même, 1995, fq. 26.

²⁷Shih Jeremy Munday, *Introducing Translation Studies*, 2001, fq. 80- 81.

Qasja funksionaliste, dhe sidomos teoria e *Skopos-it*, i ka mundësuar përkthimologjisë të fitojë një dimension të ri. Sot janë kaluar parashkrimet e vjetra të cilat e shikonin tekstin burimor si normë që përcakton funksionin e tekstit mbërritës. Kjo teori ia njuh tekstit të përkthyer identitetin e vet dhe rrethanat e veta. Siç pohon Munday, ajo njuh mundësinë për të pasur përkthime të ndryshme të të njëjtit tekst sipas funksionit të tekstit mbërritës. Në praktikë, ndodh shpesh që të përkthehen tekste për qëllime të ndryshme nga ato që kanë motivuar krijimin e tekstit burimor. Kjo është e vërtetë, para së gjithash, në botën e biznesit dhe në fushën juridike.

1.4. Përkthimi i përcaktuar nga barasvlera

Teoritë që qarkullonin gjatë viteve 1970-të u hapën udhën mënyrave të reja për të trajtuar problemet e përkthimit. Teoritë funksionaliste revolucionarizuan përkthimologjinë duke e analizuar përkthimin si një proces komunikimi pragmatik, tek i cili tekstet burimore dhe ato në gjuhën e përkthyer mund të kenë qëllime ose funksione të ndryshme. Kështu, përkthyesi, ndërmjetësi i komunikimit ndërgjuhësor dhe ndërkulturor, duhet të kërkojë një barasvlerë, e cila ta kthejë tekstin mbërritës funksional në kulturën pritëse.

Sot, gjuhësia bashkëkohore largohet nga debati i përkthyesve të vjetër, të cilët e shikonin përkthimin si një veprimtari ose gjithnjë të mundshme, ose të pamundur, ose të plotë, ose të paplotë. Duke u mbështetur te qasjet e komunikimit pragmatik, gjuhësia bashkëkohore njuh relativitetin e rezultateve të veprimtarisë përkthimore duke e përcaktuar si “një operacion, relativ në suksesin e tij, të ndryshueshëm në nivelet e komunikimit që arrin”²⁸. Megjithëse ky përcaktim nuk përfshin qartë termin barasvlerë, prapëseprapë tregon qartë ndryshimin e perceptimit të asaj çka është përkthimi.

Teoricienët që përcaktojnë përkthimin me ndihmën e nocionit të barasvlerësisë janë të shumtë. Për shembull, Anthony G. Aettinger e quan përkthimin si “*zëvendësim të elementeve të një gjuhe... nga elementë ekuivalentë të një gjuhe tjetër*”. John Cunnison Catford pohon se përkthimi do të mund të përcaktohej si “*zëvendësimi i materialeve tekstuale të një gjuhe me materiale barasvlerëse në një gjuhë tjetër*”. Ndërsa Nida propozon që “*përkthimi ka të bëjë me prodhimin në gjuhën mbërritëse të barasvlerësisë më të afërt të mesazhit të gjuhës burimore, fillimisht të përmbajtjes, pastaj të stilit.*”²⁹

²⁸Georges Mounin, *Les problèmes théoriques de la traduction*, Paris, Gallimard, 1986, fq. 278.

²⁹Përkthimi i përkufizimeve të dhëna në anglishte nga Anthony Pym-i, në veprën e tij *Translation and Text Transfer*, New York, Peter Lang, 1992, fq.38.

Kjo qasje e re, sigurisht, që ka hapur një debat, i cili ka vazhduar dhjetëvjeçarët e fundit dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Debati në fjalë ka të bëjë me përkthimin dhe barasvlerësin si element përcaktues i këtij të fundit.

Vlen të theksohet se barasvlera është një koncept që i përket lëmit të përkthimologjisë. Gjuhësia kontrastive e njeh *konceptin e gjegjësisë*, por ky koncept është një dukuri e ndryshme nga barasvlera. Gjuhësia kontrastive, qëllimi kryesor i së cilës është analizimi i dy gjuhëve, për të identifikuar dallimet e tyre të përgjithshme dhe specifike, ka si fushë zbatimi të mësuarit e gjuhëve të dyta. Kjo do të thotë se ajo lidhet me gjuhën si sistem. Gjegjësi është një koncept i përdorur për të përshkruar fjali dhe struktura që u përgjigjen në gjuhën zanofillore dhe në atë mbërritëse.

Gjuhësia kontrastive ka favorizuar zhvillimin e përkthimit letrar i cili, nga ana e tij, përbën një burim ku kanë shkuar për të mbushur ujë format e tjera të përkthimit të specializuar. Barasvlera, nga ana e saj, ka të bëjë më tepër me shkallën me të cilën një fjalë, një fjali, madje një tekst mund të quhet në gjuhën dhe në kulturën pritëse si barasvlerësi i tekstit nistor. Barasvlera ka të bëjë me ligjërimin ose të folurin, dhe lidhet me përkthimin.

Përcaktimi i përkthimit nëpërmjet barasvlerës shpesh kundërshtohet, sepse kjo duket sikur çon në tautologji: nëse përkthimi shikohet si veprimtari që çon tek barasvlerësi, do të ishte e drejtë të arrihej në përfundimin se barasvlera është një element, i cili përcakton përkthimin. Kështu, përkthimi do ta përcaktonte barasvlerën dhe barasvlera do të përcaktonte përkthimin. Problemi kryesor, siç nënvizon Anthony Pym, nuk është aq shumë nocioni i barasvlerës në vetvete sa ç'mund të jenë atributet që u japin disa teoricienë. Të kuptosh barasvlerën dhe përkthimin e përcaktuar nga barasvlera kërkon, siç pohon Pym-i në veprën *Translation and Text transfer*, që disa ide të sqarohen mirë, madje të ndahen qartë.

Një nga këto ide është nocioni i simetrisë që ekziston në vlerën e elementeve të gjuhëve të ndryshme. Pym-i pohon se simetria ishte njëra nga parimet e Saussur-it në veprën *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*. Gjuhëtarët strukturalistë hidhnin poshtë çdo mundësi përkthimi ndër-gjuhësore, duke u mbështetur te parimi, sipas të cilit, vlera e

elementeve (formale, semantike etj.) e gjuhëve të ndryshme nuk paraqet lidhje simetrike me një gjuhë tjetër. Sipas këtij postulati, barasvlera do të ekzistonte me kusht që të kishte të njëjtën vlerë si origjinali. Në veprën e tij, Pym-i rimerr argumentet që Saussur përdorte në lidhje me pamundësinë për të pasur elemente vlere të barabarta midis dy gjuhëve. Ja pra, argumente shpesh të huazuara nga ithtarët e të papërkthyeshmes. Pym-i saktëson se Saussur e lidh nocionin e vlerës së potencialit semantik të dhënë me një element nëpërmjet pranisë ose mungesës së termave të afërta dhe domethënien me përdorimin që ka gjetur zbatim në një situatë të veçantë.

Për të shpjeguar këto dy nocione Saussur vendosi një paralele midis lojës së shahut dhe gjuhës. Për gurët e lojës, vlera e kalorësit përcaktohet nëpërmjet aftësisë për të kryer disa lëvizje të kufizuara nga rregullat e vendosur. Domethënia do të ishte largësia e çdo lëvizjeje. Nocioni i vlerës sipas Saussur-it, saktëson Pym-i, lidhet me pozicionin relativ të elementeve brenda një gjuhe në tërësinë e vet. Fakti që çdo gjuhë organizon hapësirën e vet semantike në mënyrë të ndryshme mohon, teorikisht, çdo mundësi vlere të barabartë midis elementeve të gjuhëve të ndryshme.

Në veprën e sipërcituar, dhe më vonë në një dorëshkrim të pabotuar³⁰, Pym-i merr një shembull tjetër nga Saussur për jo-gjegjësinë e vlerës së elementeve midis gjuhëve. Kësaj radhe, Pym-i ilustron, me ndihmën e një shembulli, si kuptohet nocioni i vlerës në përkthimologji. Shembulli që merr është termi frëng *mouton* (dele) dhe termat në gjuhën angleze *sheep* (dele) dhe *mutton* (mish dele).

Pym-i pohon se dallimi i vlerës midis dy termave në frëngjishte dhe anglisht ka të bëjë me faktin që anglishtja ka një term për të përcaktuar kafshën dhe një term për të përcaktuar mishin e saj, ndërkohë që frëngjishtja ka vetëm një për t'i përcaktuar të dyja nocionet. Ai thekson se dallimi midis *sheep* dhe *mutton* është me origjinë historike dhe jo medoemos semantike, d.m.th. anglo - saksonët u shërbenin zotërinjve të tyre normanë atë çka këta të fundit e quanin *moton*, gjellë që ata vetë e quanin *sceap*.

Për termin *signification* (kuptim) të një elementi të përdorur nga Saussur, Pym-i parapëlqen termin *funksion*. Gjithashtu, në lojën e shahut, kalorësi ka një numër të caktuar funksionesh: të zhvendoset nga para, prapa dhe anash; ai mund të vendoset gjithashtu në mënyrë strategjike për sulm ose për t'u flijuar. Pym-i propozon se jo-gjegjësia midis vlerës dhe kuptimit-funksioni i një termi varet nga përmasat e hapësirës

³⁰Pym-i nisi të rishkruajë veprën *Translation and Text Transfer*. Atje ai zhvilloi disa koncepte dhe futi të reja. Dorëshkrimi i përmendur, i titulluar *Équivalence, malgré tout* është një ekstrakt nga projekti i tij i rishkruar.

në të cilën mund të shfaqen termat, vetëkuptohet, sipas normave të përcaktuara në çdo gjuhë.

Ai sugjeron që në sistemet artificiale të kontrolluara mirë, termat dëftejnë vetëm çka është përshkruar e asgjë tjetër. Kjo të bën të mendosh për sisteme që kryejnë përkthimin automatik të parashikimeve meteorologjike, vlera e të cilave si dhe kuptimi i termave nuk paraqet probleme. Ato janë vendosur në një hapësirë shumë të kufizuar me një numër funksionesh shumë të kufizuar.

Në sistemet natyrore, funksionet e termave sa vijnë e bëhen më të kërleshura për shkak të hapësirës në të cilën mund të shfaqen termat, sigurisht në emër të rregullave ose normave të secilës gjuhë. Pym-i vëren se termi *mouton* (dele) mund të përkthehet në anglishte me *mutton* ose *lamb* (gjithnjë duke pasur parasysh dallimet) dhe frëngjishtja lejon shprehje të formuar me termin *mouton* si *être un mouton*, për të cilësuar dikë që është leshko, flitet gjithashtu për praninë e *moutons* (dallgë, kreshta shkume) në një det të trazuar nga era. Ndërsa anglishtja mundëson shprehje të tilla si *to feel lost like a sheep*, që ka kuptimin e të ndjerit të syrgjynosur, pa atdhe, ose edhe *make sheep's eyes* për të përshkruar dikë që hedh vështrime dashurore.

Nëse vlera e termave kuptohet në funksion të një numri kuptimesh të mundshme, duket qartë se kjo vlerë është e ndryshme në anglisht dhe në frëngjisht. Gjithsesi, Pym-i saktëson se kjo nuk do të thotë që barasvlera përkthimore³¹ nuk ekziston.

Pym-i është i mendimit se barasvlera përkthimore është një krijim dhe se ky krijim kërkon që vlera e elementeve të ngarkohet në hapësirën semantike të gjuhëve. Ja, pra, shpjegon Pym-i, se ç'kanë bërë anglosaksonët kur afronin mishin në tryezën e zotërinjve të tyre normanë. Duke e quajtur *mouton* atë çka ata e quanin *sceap*, anglo – saksonët ia dolën të vendosnin një komunikim ndërkulturor. Ky shembull përshkruan dukurinë e transferimit historik³², i cili, sipas Pym-it, përlligj rastet kur dy gjuhë kanë terma me vlerë të barabartë. Kështu, duke rimarrë termin *mouton*, Pym-i sinjalizon se barazia e vlerës midis shprehjeve *être le mouton noir de la famille* (të jesh delja e zezë ose tersi i familjes) dhe *to be the black sheep of the family*. Ja, pra, sipas Pym-it, një dukuri të cilën Saussur-i e ka hequr në postulatën e tij të jo-korrespondencës së vlerës të termave.

³¹Me këtë duhet kuptuar ekuivalenca si ndihmës ose si mjet përkthimi, dhe jo një kategori apo lloj barasvlerësi.

³²Ky është një koncept i ri, të cilin Pym-i e paraqet në planin për të rishkruar veprën *Translation and Text Transfer*.

Siç u theksua në paragrafin e mësipërm, Pym-i nënvizon se barasvlera është një krijim i domosdoshëm për të vendosur një komunikim ndërkulturor. Dimensionin kulturor i komunikimit përbën boshtin qendror të krahasimit. Pym-i pohon se jo vetëm që barasvlera është një krijim që vendoset në rrafshin e ligjërit, por ai shkon më tej, duke shtuar se barasvlera është rezultat i një procesi negocimi midis përkthyesit dhe klientit.

Për të treguar relativitetin e termave, Pym-i³³ i referohet parimit të Marksit, që përdor për vendosjen e vlerës së mallrave ose produkteve. Sipas këtij parimi, një sasi X e prodhimit A është e barabartë me një sasi Y e prodhimit B. Duke huazuar shembullin e rrobaqepësve hebrenj që fiksuan vlerën 20 jard për lirin, të barabartë për prodhimin e një xhakete, Pym-i vëren se liri shpreh vlerën përmes xhaketes; dmth. kjo e fundit luan rol aktiv, ndërkohë që liri luan rol pasiv. Vlera e mallit të parë (e lirit), shfaqet nën një formë relative, ndërsa malli i dytë (xhaketa) vepron si barasvlerës ose shfaqet nën një formë ekuivalente të së parës. Sipas parimit ekonomik të Marksit, shpjegon Pym-i, asnjë mall ose asnjë produkt nuk mund të luajë format relative dhe ekuivalente të vlerës në të njëjtën kohë, sepse vlera e lirit njihet vetëm kur ai hyn në lidhje me xhaketen. Nuk bëhet aspak fjalë për lidhje identiteti. Edhe natyra e materialeve në fjalë nuk ka rëndësi në shprehjen e vlerës. Kjo e fundit varet nga lidhja midis produkteve dhe rrethanës ose kontekstit në të cilën lidhja është e mundshme.

Vlera e xhaketes mund të përcaktohet me ndihmën e produkteve të tjera, të pranishme në sasi të ndryshme. Xhaketa mund të kombinohet, gjithashtu, me produkte të tjera dhe të veprojë si ekuivalent, pa parë kurrë natyrën e zvogëluar në atë të një produkti tjetër. Sipas këtij parimi, barasvlera varet vetëm nga ajo çka është ofruar, e negociuar dhe e pranuar në një situatë shkëmbimi të veçantë. Sipas këtij parimi, çdo lidhje ekuivalence është një bindje, një vend i përkohshëm i një marrëveshjeje pa fund. Në rast të një përkthimi, shkalla e barasvlerës përcaktohet në funksion të përdorimit që porositi ose lexuesit do t'i bëjnë përkthimit.

Për sa i përket përkufizimit të përkthimit nëpërmjet ekuivalences, Pym-i vëren se duhet bazuar në çka është thënë por që nuk nënkuptohet. Në qoftë se barasvlera përcakton idealin e përkthimit duhet, si rrjedhim, që të përcaktohet ose ripërcaktohet ekuivalenca ideale. Kjo do të thotë që shkalla e pritjes dhe e pranimit të barasvlerës mund të ndryshojë sipas kontekstit.

³³Anthony Pym, *Translation and Text Transfer*, 1992, fq. 44-46.

Pym-i vëren, gjithashtu, se përkufizimet e përkthimit që mbështeten te barasvlerësia lidhen me rezultatin e operimit të përkthimit më tepër se te vetë ky proces. Por, në këto përcaktime, duhet kuptuar se është përkthyesi, i cili *riprodhon* barasvlerën më të afërt, zëvendëson elementet ose materialet tekstuale të një gjuhe me elemente ose materiale tekstuale ekuivalente, edhe pse këto përcaktime duket sikur nuk i japin asnjë rëndësi autorit të këtyre veprimeve. Në përkthimin pragmatik, dhe kjo kalon shpesh pa u përmendur në shkrimet e teoricienëve, përkthyesi duhet të ketë udhëzime të ndryshme në punën që i është besuar. Ja pra, seç quan Pym-i negociim.

Në këtë negociim, përkthyesi kërkon t'i japë porositesit një tekst që t'i pëlqejë këtij të fundit. Pym-i propozon që ky proces negociimi të kryhet sipas parimit të ekonomisë së shkëmbimit, sipas të cilit kostoja e transaksionit duhet të jetë proporcionale me atë të përfitimit. Kështu, porositesi nuk do të duhej të paguante për një shërbim që do të ishte jashtë pritshmërive të tij, dhe përkthyesi nuk do të rropatej duke investuar kohë dhe mund për të fituar një barasvlerë që nuk i bindet përveçse kritereve të tij.

Koncepti i një barasvlere, që gjendet në planin e ligjërimit, ka hapur shumë çështje tek ata që vazhdojnë të kapen pas gjuhësisë dhe parimeve të saj. Snell Hornby, profesoreshë e përkthimit në Universitetin e Vjenës, e përcakton barasvlerën si një nocion të vagullt dhe të errët, i cili i reziston çdo vlerësimi gjuhësor. Sipas saj, për një nocion kyç të përkthimologjisë ekuivalenca është më tepër e papërshtatshme. Snell Hornby nuk e njeh vlefshmërinë e ekuivalencës përveçse në fusha shumë të sakta, si për shembull në terminologjinë teknike. Përveç këtij përjashimi, ajo hedh poshtë paradigmën e barasvlerësisë në krejt tërësinë e saj. Ajo e hodhi poshtë në 1986³⁴ dhe vazhdon ta hedhë në versionin e ripunuar të veprës *Translation Studies: An Intergrated Approach*, botuar në 1995.

I gjithë ky debat i ngjan, çuditërisht, debatit të vjetër midis strukturalistëve, të cilët mëtonin, teorikisht, që përkthimi ishte i pamundur për shkak të mos-përkimit midis strukturave të gjuhëve të ndryshme, dhe teoricienëve të shkencës së re të përkthimit, që kërkonin të pajisnin përkthimologjinë me aparatit teorik dhe praktik. Kjo të kujton, në një farë mënyre, debatet që kanë të bëjnë me ekzistencën e Zotit, ku asgjë nuk është e re, edhe nëse vazhdohet të flitet.

³⁴Shih shënimet të cilat ka bërë Anthony Pym-i për këtë pikë në artikullin *European Translation Studies, Une Science qui dérange, and why Equivalence Needn't Be a Dirty Word*, 1995, fq. 162-164.

Nocioni i ekuivalencës diskutohet thekshëm midis gjuhëtarëve dhe teorianëve të përkthimit. Gjuhëtarët e lidhin me gjuhën si sistem dhe studiojnë strukturat dhe funksionet e ndryshme të saj. Ndërsa, teorianët e përkthimit e vendosin ekuivalencën në planin e ligjëritimit dhe e perceptojnë si frutin e ndërveprimit midis përkthyesit dhe tekstit. Në këtë mënyrë, veprimi përkthimor konsiderohet si një proces dinamik prodhimi dhe jo si një proces i thjeshtë zëvendësimi strukturash ose njësisht paraekzistuese në një gjuhë. Ekuivalenca ideale do të ishte, pra, ajo, që në një situatë asimetrie, të mund të lejonte që teksti në gjuhën mbërritëse të funksiononte ose të kishte një përdorim, një qëllim praktik në një kulturë përfutuese të përkthimit.

Për të prishur rrethin vicioz të debateve që kundërvënë gjuhëtarët strukturalistë me ithtarët e ekuivalencës si nocion përcaktues të përkthimit, do të ishte mirë që të shmangej një shkëputje e plotë marrëdhëniesh midis gjuhësisë dhe përkthimologjisë. Kjo e fundit do të ishte shkencë e gjuhësisë vetëm nëse do të mbështetej te parimet e gjuhësisë. Me fjalë të tjera, përkthyesi nuk do të mund t'i hidhte poshtë shërbimet që i plotëson gjuha dhe zgjidhjet që ajo i ofron. Po kështu, përkthyesi duhet të njohë, për shembull, ekuivalencat formale, apo termat të cilat ai mund t'i përkthejë fjalë për fjalë, sepse ato janë të leksikalizuara në gjuhën mbërritëse. Por, siç do ta shohim më tej, duhet që përkthyesi të njoftohet për të shmangur gabimet e “*miqve të rremë*” që i nxjerr ekuivalenca formale.

Ekuivalenca, siç del këtu, nuk duhet konsideruar si njësi pa asnjë lidhje me tekstin burimor. Ajo mbështetet, në fakt, në parimin sipas të cilit duhet të ketë një lidhje barasvlerësie midis dy teksteve, ku njëri është përkthim i tjetrit. Teoritë funksionaliste, ashtu si edhe metodat e komunikimit ndërkulturor i njohin tekstit të mbërritjes (translatum ose ç’lloj emri që mund t’i vihet tekstit të përkthyer) të drejtën që të ketë një funksion ose një qëllim në kulturën përfutuese. Në një perspektivë pragmatike dhe praktike, nga teksti në gjuhën mbërritëse pritet që ai të përmbajë elemente që të na japin një komunikim ndërkulturor. Fjalët e Ubaldo Stecconi-t e përmbledhin shumë mirë mënyrën sipas së cilësohet kuptuar ekuivalenca:

"Equivalence is crucial to translation because it is the unique intertextual relation that only translations, among all conceivable text types, are expected to show". [...] Such "expectation" is certainly an affair of social convention rather than empirical certainty, but it has consequences to the actual work of the Translator. [...] "B had never been

equivalent to A before it appeared in a translation: using inferences of the abductive kind, the translator makes the two elements equivalent^{35}*."

Debati që kundërvë përkrahësit e përkufizimeve të bazuara te gjuhësia dhe te mbrojtësit e postulateve të përkthimologjisë ka si qëllim të përjetësojë kontradiktën që këto dy palë nuk njohin përveçse tezën e tyre në dy plane të ndryshme. Teoricienët dhe prakticienët e përkthimit kërkojnë të bëjnë, prej disiplinës së tyre, një shkencë, e cila të ketë aparatën e saj teorik dhe didaktik.

Megjithëse gjuhësia është baza, e cila nënkupton këtë disiplinë, përkthimologjia është një shkencë e zbatuar e cila ka një qëllim të përcaktuar mirë: të mbetet prapa problemeve që pengojnë rrugën e komunikimit midis dy bashkësive që flasin gjuhë të ndryshme. Sakaq, përkthimi ndihmëson në futjen në kulturën përftuese të elementeve të huaj që mund të favorizojnë zhvillimin e tij. Sa më e qenësishme të jetë kjo orvatje për të marrë drejtimet më të ndryshme, aq më e vërtetë bëhet ajo. Le të saktësojmë vetëm komunikimin, i cili perceptohet këtu si një proces i cili mundëson të ndërkuptuarit e nevojshëm në shoqëri.

Kur ky ndërkuptim kryhet në një mjedis ndërkulturor dhe ndërgjuhësor, midis individësh që flasin vetëm një gjuhë, duhet të na vijë në ndihmë përkthimi dhe përkthyesi. Shkurt, përkthimologjia shfaqet si një disiplinë pragmatike e komunikimit ndërgjuhësor dhe ndërkulturor.

Siç e përmend Pym-i në projektin e rishkruar, përkthimi është bërë një veprimtari e nxitur nga tregu. Me ardhjen e dukurisë në rritje të globalizimit, komunikimi ndërkulturor do të bëhet më i shpeshtë dhe do të ketë sfida gjithnjë e më të shumta. Tregu i ri i përkthimit sheh kërkesa për lokalizimin e përmbajtjes, duke përfshirë edhe përmbajtjen me mbështetje elektronike, të cilat janë rritur në mënyrë të frikshme. Pym-i hedh bazat për atë që mund të gjenerojë një debat të ri në përkthimologji dhe një sfidë të re në përkthim. Ku është kufiri midis përkthimit dhe lokalizimit? A nuk mund të ketë një kthim të nocionit të ekuivalencës në realizimin e punëve? Ja, pra, një çështje që potencialisht i jep dimensione të reja përkthimit.

³⁵Po aty, fq. 166.

*"Ekuivalenca është e rëndësishme për përkthimin sepse është lidhja e vetme ndërtekstuale të cilën vetëm përkthyesi mund ta demonstrojnë. Kjo pritshmëri është me siguri një çështje shoqërore sesa sigurie empirike por që natyrisht ka pasoja në punën aktuale të përkthyesit... [...] "B asnjëherë nuk ka qënë ekuivalente e A-së para se të shfaqej në përkthim: duke përdorur metoda parashikuese, përkthyesi i bën këto dy element ekuivalente".

Pranojmë faktin se ekuivalenca nuk bie nga qielli dhe as nuk lind nga toka. Ekuivalenca është një krijesë, një iluzion që nuk ka lidhje natyrore përtej rrethanës së komunikimit. Megjithatë, ajo është mjet për të futur elemente të reja në një kulturë, qofshin këto të natyrës gjuhësore, kulturore apo të tjera. Me t'u bërë prezantimi, i takon kulturës pritëse për të filluar një proces të përshtatjes dhe normalizimit të elementeve të pranuar. Për ta bërë këtë, duhet, sigurisht, vullnet politik për të vënë në vend mekanizmat për zhvillimin e strukturave dhe normat që u japin këtyre elementeve një karakter në kulturën pritëse.

Qasja funksionaliste në përgjithësi dhe, në veçanti ekuivalenca, e liron përkthyesin nga çështja e dyfishtë për përkthimin e frymës apo të përmbajtjes së tekstit? Pasi ai e di funksionin e tekstit të synuar dhe pritjet e konsumatorëve, përkthyesi nuk duhet të shqetësohet për çështjen e përkthimit të fjalëpërfjalshëm, përveç se kur porositi i kërkon që ai të bëjë një përkthim fjalë për fjalë. Për më tepër, pa u shkëputur tërësisht nga teksti origjinal, vëmendja e përkthyesit është e drejtuar tek një tekst mbërritës, i cili mund të jetë funksional në kulturën pritëse. Ose, siç thotë Höning-u, « *the source text should no longer be seen as a 'sacred original', and the purpose of the translation can no longer be deducted from the source text but depends on the expectations and needs of the target readers*»^{36*}

Le të shtojmë, për të përfunduar, se citimi i sipërpërmendur i Stecconi-t na jep, gjithashtu, një ide të rolit të duhur të përkthyesit në vendosjen e ekuivalencës. Kur kuptimi i tekstit origjinal nuk del paralelisht me leximin e këtij të fundit dhe, kur burimi, qoftë ky edhe teksti origjinal, nuk mund të konsultohet, duhet që përkthyesi të angazhohet në një qasje interpretuese të tekstit. Për të arritur ekuivalencën ideale, përkthyesi duhet të njohë burimet që ka në dispozicion si dhe vështirësitë të cilave duhet t'u bëjë ballë në procesin e përkthimit. Për ta bërë këtë, ai duhet të zotërojë përvojën e nevojshme për të kryer projektin e tij në afat. Të përftuarit e ekuivalencës, gjithashtu, mund të ndikohet nga kushtet (gjuhësore, kohore, hapësinore, materiale, etj), në të cilat përkthyesi ushtron veprimtarinë e tij.

³⁶H. G. Höning, *Positions, Power and Practice: Functionalist Approaches and Translation Quality Assessment and Translation and Quality*, 1998, fq. 9.

“Teksti burimor nuk duhet të konsiderohet më si “origjinali i shenjtë”, dhe qëllimi i përkthimit nuk mund të jetë më rezultat i tekstit burimor por varet tashmë nga pritshmëritë dhe nevojat e lexuesit në gjuhën mbërritëse”.

1.5. Llojet e ekuivalencës³⁷

Para kryerjes së analizës së llojeve të ndryshme të ekuivalencës, është e nevojshme të krijohen lidhje mes këtyre të fundit dhe mënyrave të përkthimit të përshkruara në sythin 2.9. Metodatat teknike të përkthimit kanë të bëjnë me operacionin e kryer nga përkthyesi gjatë procesit të kapjes së kuptimit të tekstit origjinal dhe përfthimit të tekstit të mbërritjes. Në përshkrimin e këtyre teknikave nuk përmendet drejtpërdrejtë lloji i ekuivalencës që arrihet midis tyre. Teknikat e përkthimit janë, pra, ekuivalenca të analizuara nën prizmin e operacionit të kryer nga përkthyesi gjatë procesit të përkthimit. Ekuivalencat e përshkruara në vijim i referohen më tepër rezultatit të operacionit të kryer nga përkthyesi.

Origjina e nocionit të ekuivalencës është mjaft e vështirë për t'u përcaktuar, edhe pse ne e dimë që Jakobson-i foli për të qysh në vitin 1959³⁸. Disa teoricienë³⁹ pohojnë se termi është futur në fushën e përkthimologjisë, pasi u shfaq në studimet matematikore. Kjo hipotezë mund të përlligjet me faktin se në këtë fushë, termi *ekuivalencë* do të thotë një marrëdhënie simetrike mes të dhënave që mund të zëvendësohen me njëra-tjetrën, pa shkaktuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm. Teoricienë të tjerë, si Mary Snell-Hornby, mohojnë këtë mundësi duke treguar ekzistencën e më shumë se pesëdhjetë e shtatë llojeve të ekuivalencës në përkthimin gjerman⁴⁰.

Është e pamohueshme se termi *ekuivalencë* nënkupton një marrëdhënie me vlerë të barabartë, i cili justifikon përdorimin e saj në matematikë. Megjithatë, ai duhet të analizojë rëndësinë e këtij termi në gjuhësi dhe në përkthimologji.

Debatet e para rreth ekuivalencës në përkthimologji kërkonin të kuptonin atë çka duhej të ishte ekuivalente: fjalë, fraza, pjesë të tekstit apo teksti në tërësi. Le të kujtojmë se para zhvillimeve të kryera në vitet 1970-të në fushën e përkthimit, teksti ishte parë si një sekuencë lineare e njësive dhe përkthimi si një operacion deshifrimi, gjatë të cilit

³⁷Llojet e ekuivalencës të analizuara në paragrafët e mëposhtëm janë ndër më të njohurit nga teoricienët e ndryshëm. Shih , në mes tjerash, Virginia Cano Mora, e tj. . «¿Qué hace exactamente, el traductor jurídico?, Livius, 1994, fq. 25-27; Susan Bassnett, *Translation Studies*, London, Routledge 1991, fq. 23-39; et Susan Šar evi , Në *Approaches to Legal Translation*, The Hague, Kluwer Law International 1997, fq. 233-237.

³⁸Jakobsoni pohonte hapur se nuk ka asnjë ekuivalencë të plotë mes të gjuhëve të ndryshme dhe madje edhe sinonimet e të njëjtit kod nuk janë sinonime të përsosur ose të plotë. Shih Roman Jakobson, *On Linguistic Aspects of Translation*, The Translation Studies Reader, botuar nga Lawrence Venuti, Routledge, London, 2000, fq.113-118.

³⁹Krahaso Wills Wolfran, cituar nga Anthony Pym në *Translation and Text Transfer*, 1992, fq. 37.

⁴⁰Po aty.

përkthyesi zëvendëson *njësitë e tekstit* origjinal me njësi ekuivalente në gjuhën mbërritëse. Sot, koncepti "njësi ekuivalente" mund t'i referohet, sipas teoricienëve të ndryshëm, një fjale ose një teksti në tërësinë e tij⁴¹.

Qëllimi i përkthyesit është të krijojë një lloj ekuivalence që i përshtatet më mirë kontekstit në të cilin duhet të kryhet përkthimi dhe sipas funksionit që ai do të ketë të publiku i synuar. Një nga vështirësitë që përkthyesi duhet të kapërcejë në realizimin e punës së tij prek mënyrat e ndryshme në të cilat është përcaktuar dhe klasifikuar ekuivalenca në dokumentacionin e gjerë të mbledhur.

Disa lloje ekuivalencash mbivendosen, domethënë, ato marrin një emër të ndryshëm sipas teoricienëve, por shpesh ato i referohen të njëjtin koncept ose koncepteve me ndonjë ndryshim të vogël. Ndosht, gjithashtu, që teoricienë të ndryshëm, më konkretisht gjermani Werner Koller njohin një bashkësi disi të ndryshme të ekuivalencës⁴².

Edhe pse teoricienë, si për shembull Snell-Hornby, pohojnë se kanë identifikuar më shumë se pesëdhjetë e shtatë ekuivalenca, paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë vetëm ekuivalencat gjuhësore, paradigmatiche, stilistike, semantike, formale, referenciale, pragmatike, dinamike dhe, natyrisht, ekuivalencën funksionale. Këto janë llojet e ekuivalencës që analizohen më shpesh⁴³. Duhet theksuar se këto ekuivalenca janë vendosur në rrafsh të ndryshme. Ekuivalenca gjuhësore, për shembull, është vendosur në rrafshin e semantikës, ekuivalenca paradigmatiche vendoset në rrafshin gramatikor dhe ekuivalenca pragmatike në rrafshin jashtëgjuhësor.

1.5.1. Barasvlera gjuhësore

⁴¹Shih lidhur me këtë temë Mary Snell-Hornby, *Translation Studies: An Integrated Approach*, 1995, fq. 16.

⁴²Shih: Jeremy Munday, *Introducing Translation Studies*, 2001, fq. 46-47.

⁴³ Shih, krahas të tjerëve, Susan Bassnett, *Translation Studies*, 1991; Virginia Cano Mora, Leo Hickey e tj., «¿Qué hace, exactamente, el traductor jurídico?», Livius, 1994; Edwin Gentzler, *Contemporary Translation Theories*, 1993; Leo Hickey, «Equivalencia pragmática y traducción jurídica, Perspectivas Pragmáticas en Lingüística Aplicada», 1998; Peter Newmark, *A Textbook of Translation*, New York, Prentice Hall 1988; Louis-Philippe Pigeon, *La traduction juridique: L'équivalence fonctionnelle, Langage du droit et traduction: Essais de jurilinguistique*, punim kolektiv, realizuar nën drejtimin e Jean-Claude Gémar, Montréal, Linguatex, 1982; fq. 271-281; Susan Šar evi, *Bilingual and Multilingual Legal Dictionaries: New Standards for the Future*, Revue générale de droit, nr. 19, 1988, fq. 961-978; dhe Susan Šar evi, *New Approach to Legal Translation*, 1997.

Quajmë të tillë llojin e ekuivalencës që shfaq një homogjeneitet në aspektin e gjuhës, midis tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer. Ekuivalenca gjuhësore quhet, gjithashtu, edhe ekuivalencë formale, që përftohet nga një përkthim fjalë për fjalë. Sythi 3.5. përmban një analizë të shkurtër të kësaj ekuivalence.

1.5.2. Barasvlera paradigmatiche

Kjo lloj ekuivalence karakterizohet nga imponimi i njëfarë korrespondence në rrafshin gramatikor midis tekstit të përkthyer dhe tekstit origjinal. Bëhet fjalë për elemente gramatikore që mund të jenë të zëvendësueshëm, pa ndryshuar kuptimin e asaj çka duhet shprehur. Në frëngjishte, në italishte, në spanjishte, për shembull, koha foljore e ligjeve në përgjithësi është e tashmja e dëftores. Kjo kohë mund të zëvendësohet nga një tjetër nëse e kërkojnë doket dhe zakonet e sistemit juridik në kulturën marrëse. Ekuivalenca paradigmatiche përcakton marrëdhënie të quajtura vertikale, në krahasim me marrëdhëniet sintagmatike, të cilësuar më tepër si marrëdhënie horizontale. Në përgjithësi, përkthyesi e fiton këtë ekuivalencë nëpërmjet anasjelljes.

1.5.3. Barasvlera stilistike

Barasvlera stilistike i referohet një marrëdhënieje funksionale midis elementeve stilistikë të tekstit burimor dhe tekstit të synuar, në mënyrë që të marrë një identitet shprehës apo emocional midis origjinalit dhe tekstit të përkthyer, pa ndryshuar kuptimin e asaj çka dëshirojmë të shprehim. Stili, që i jepet përkthimit, mund të ndryshojë në varësi të tekstit të përkthyer, qoftë ky tekst letrar apo tekst pragmatik. Në përkthimin juridik, për shembull, stili i tekstit mbërritës duhet të jetë në përputhje me zakonet e sistemit juridik të kulturës pritëse.

1.5.4. Barasvlera semantike

Flasim për barasvlerë semantike, kur origjinali dhe përkthimi i tij kanë të njëjtën përmbajtje semantike ose semiotike. Barasvlera semantike përqendrohet te fjalët dhe jo te paragrafi apo teksti në tërësi. Ajo supozon që termi i fillimit dhe ekuivalenti i tij në gjuhën e synuar të ndajnë të njëjtën fushë semantike. Në këto raste, përkthim i fjalëpërfjalshëm shfaqet si një proces përkthimi i përshtatshëm.

1.5.5. Barasvlera formale

E njohur gjithashtu me emrin barasvlerë tekstuale, barasvlerë sintagmatike apo edhe barasvlerë strukturore, barasvlera formale është përdorur për të riprodhuar sa më shumë që të jetë e mundur fjalë për fjalë formën dhe përmbajtjen e tekstit origjinal, në mënyrë që përfituesit e përkthimit të marrin të njëjtin mesazhi si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Kjo ndihmon për të identifikuar sa më shumë të jetë e mundur personin apo objektin në fjalë në tekstin origjinal, për të kuptuar sa më mirë të jetë e mundur veçoritë kulturore: zakonet, mënyrën e të menduarit, mjetet e tij të shprehjes, etj. Barasvlera formale është gjë tjetër nga përkthimi fjalë për fjalë.

Përkthimi nëpërmjet barasvlerës formale ka karakteristikën e të qenit një përkthim i orientuar drejt tekstit burimor. Në fakt, është ky i fundit që shërben si referencë në përcaktimin e normave të besnikërisë. Përkthimi i komentuar apo i interpretuar është shembull i përkryer i një përkthim të bërë nga barasvlera formale.

1.5.6. Barasvlera referenciale

Në këtë lloj barasvlere, duhet pasur kujdes që origjinali dhe përkthimi i tij t'i referohen të njëjtës temë dhe të njëjtit realitetit.

1.5.7. Barasvlera pragmatike

Barasvlera pragmatike është shumë afër barasvlerës dinamike. Me këtë barasvlerë, dhe sidomos me barasvlerën pragmatike, e cila shkakton një efekt psikologjike te përftuesi, përkthyesi synon të prodhojë tek lexuesi i tekstit të përkthyer të njëjtat efekte dhe të njëjtat reagime praktike që shkakton teksti origjinal te lexuesi i vet. Me efekt psikologjik nënkuptohet çdo përgjigje apo pasojë ose çdo rezultat që teksti shkakton tek lexuesi, nga të kuptuarit e thjeshtë të tekstit te reagimet e brendshme, të tilla si gëzim ose dhimbje psikologjike, përmes reagimeve të jashtme, si dëshira për të kryer një vrasje. Pragmatika i studion këto efekte përmes analizës së akteve të të folurit.

Ajo që vlen të theksohet këtu është lidhja e ngushtë ndërmjet aktit të të folurit dhe efektit. Nëse një akt të foluri synon të kërkoj falje, për shembull, duhet që gjatë

përkthimit të përdoren fjalë që të prodhojnë efekte të njëjta në gjuhën mbërritëse, ashtu siç ndjesa prodhon efekte te lexuesi i tekstit origjinal.

Leo Hickey vë në dukje se, në qoftë se barasvlera pragmatike zë një vend të rëndësishëm në përkthimin letrar, zbatimi i tij është i kufizuar në përkthimin ligjor.⁴⁴ Ai vë në pah se efektet psikologjike që teksti synon të prodhojë te lexuesi nuk janë efektet reale, por të mundshme. Përndryshe, thotë ai, do të ishim në fushën e psikologjisë. Për t'u "përkthyer" në gjuhën mbërritëse, këto efekte të mundshme duhet të zbulohen në tekstin origjinal. Kështu, përkthyesi duhet të analizojë qëllimet subjektive të autorit, vetëm në atë masë sa janë të pranishme objektivisht në tekst.

Vështirësia më e madhe për t'u kapërcyer gjatë procesit të përfutimit të barasvlerës pragmatike, siç vëren Hickey, vjen nga fakti se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë ose automatike mes tekstit dhe efektit që shkakton. Kjo nuk është e lehtë të parashikohet, aq më pak të njihet pa u gabuar në efektet që shkakton teksti te lexuesi. Përveç kësaj, në qoftë se marrësi i tekstit origjinal është një jurist, teksti i përkthyer nuk do të ketë medoemos lexues analog. Nëse marrësi i tekstit të përkthyer është një jurist i shkolluar sipas një tradite të ndryshme juridike nga ajo e lexuesit të tekstit origjinal, efekti që do të shkaktojë teksti i mbërritjes mund të rezultojë të jetë i ndryshëm nga efekti mbi lexuesin e tekstit origjinal. Barasvlera pragmatike ose perlokutive (me efekt psikologjik) do të duhej kërkuar midis efekteve të shkaktuara te lexuesit e pakualifikuar të tekstit origjinal, domethënë te lexuesi jo-jurist, i cili është mjaft i rrallë në praktikë, dhe te çdo lexues i tekstit mbërritës.

Siç u vu në dukje në fillim të këtij sythi, përkufizimet dhe klasifikimi i barasvlerës të çon shpesh në pështjellim. Leo Hickey, për shembull, përshkruan barasvlerën pragmatike si barasvlerë që përkthyesi shfrytëzon për t'i ofruar lexuesit një efekt të ngjashëm me efektin që teksti origjinal ka krijuar në mesin e lexuesve të tij. Megjithatë, problemet dhe zgjidhjet që ai propozon lidhen më tepër me rastet e mospërputhjes së realiteteve apo koncepteve mes dy sistemeve juridike të prekura nga përkthimi. Lloji i përkimit në fjalë, në kësi raste, është barasvlera funksionale. Mungesa e termave për të shprehur nocione jo-ekzistuese në një gjuhë, me siguri mund të krijojnë efekte psikologjike te lexuesit e gjuhës në të cilën përkthehet, sidomos në qoftë se përkthyesi fillon e sajton terma leksikore të panjohura nga të gjithë, por ky efekt do të jetë jo-

⁴⁴Shih Leo Hickey, *Equivalencia pragmática y traducción jurídica*, 1998, fq. 493-500.

ekzistent për lexuesin e tekstit origjinal. Si mund të prodhojë përkthyesi të njëjtat efekte dhe reagime si ato të tekstit origjinal, që ka prodhuar të lexuesi i tij?

Përkthimi letrar është efekti i tekstit të përkthyer, që përcakton raportin e barasvlerës që ai ka me origjinalin. Për shembull, për Louis Jolicoeur-in, barasvlera fitohet në atë masë që përkthyesi ia del për të riprodhuar efektin e tekstit, i cili përcaktohet nga "zgjedhja leksikore, ekuilibri, muzikaliteti, toni, lëvizja, poezia, atmosfera e vendeve dhe e epokave, nivelet e leximit"⁴⁵, elemente të cilat ndihmësojnë në estetikën e veprës letrare.

Në përkthimin ligjor, ndryshe nga përkthimi letrar, efekti nuk është rezultat i një shqetësimi estetik, sepse ky zë një vend mjaft të kufizuar. Megjithatë, shkenca juridike ka treguar kujdes të madh për të zhvilluar një gjuhë e cila, ashtu si ajo e poezisë, për shembull, të ndryshojë nga gjuha e përditshme. Efekti i kërkuar në fushën ligjore është krijimi i një gjuhe ligjore, si një entitet që është jashtë fushëveprimit të qytetarëve të zakonshëm, e cila (kjo gjuhë) duhet, nga ana e saj, të përmbushë standardet dhe kërkesat. Për ta bërë këtë, ligji ka paraqitur standardet e veta gjuhësore të veçanta që nuk lë hapësirë për përdorime të shprehjeve familjare. Karakteristikat e gjuhës ligjore do të trajtohen në vazhdim.

Këtu, është e përshtatshme të diskutohet shkurtimisht një tjetër element që mund të hyjë në kategorinë e dykuptimësisë së barasvlerës pragmatike. Vëmendja që i është dhënë dykuptimësisë është e lidhur, zakonisht, me interpretimin e saj dhe me paradoksin, para të cilit ajo vë përkthyesin, i cili duhet të vendosë nëse duhet ta mbajë apo jo në përkthimin e tij.⁴⁶

A prodhon dykuptimësia ndonjë efekt pragmatik? Sigurisht që po. Për më tepër, analiza e gjuhës ligjore paraqet debate që mund të shfaqen mes juristëve. Në të vërtetë, ajo shpesh e gjen veten mes rasteve të rëndësishme, që do të thotë se juristët e interpretojnë shumë herë legjislacionin në një mënyrë atillë që t'i përshtatet kauzës së tyre, që mbrojnë ose denoncojnë. Sigurisht, këto interpretime ose shmangie nuk kufizohen te tekstet e paqarta, por këta të fundit përbëjnë, pa dyshim, një rrugë të shkelur.

⁴⁵Louis Jolicoeur, *La sirène et le pendule*, 1995, fq. 25.

⁴⁶Dykuptimësia analizohet në sythin 2.8.

Është e vërtetë se dykuptimësia krijon një efekt psikologjik, dhe një nga këto efekte i shërben lexuesit për të interpretuar tekstin e paqartë, në mënyrën që i përshtatet më mirë qëllimit dhe objektivave të tij. Në çdo situatë gjyqësore përfshihen, përgjithësisht, dy palë dhe efekti psikologjik më i madh kërkon që të gjenden argumente për të mbrojtur veten, në rast procesi gjyqësor. Megjithatë, është e vështirë për të përcaktuar nëse lexuesit e tekstit origjinal dhe ata të tekstit të përkthyer e kanë përjetuar këtë në të njëjtën mënyrë. Kjo është e vërtetë, jo vetëm në lidhje me dykuptimësinë, por edhe në lidhje me parimin e efektit të barasvlerës dinamike në përgjithësi.

1.5.8. Barasvlera dinamike

Siç u vu në dukje më parë, një nga vështirësitë që rrethojnë barasvlerën është përcaktimi dhe klasifikimi, i cili është objekti i saj. Barasvlera dinamike, si edhe ajo funksionale, ka tërhequr vëmendjen e shumë teoricienëve dhe, kjo vëmendje e hallakatur, ka lënë shteg për përcaktime disi të kundërta apo dhe të turbullta.

Barasvlera dinamike është e bazuar në parimin e efektit ekuivalent, i quajtur edhe parimi i përgjigjes ekuivalente. Megjithatë, nuk duhet ngatërruar me parimin që nënkupton barasvlerën pragmatike. Me *efekt ekuivalent* duhet kuptuar qëllimi që i jepet tekstit origjinal dhe që teksti i synuar duhet të riprodhojë sa më besnikërisht që të jetë e mundur. Le të theksojmë se këtu nuk bëhet fjalë domosdoshmërisht për efekte në planin emocional, por më tepër në atë fizik, si të thuash, autori i tekstit origjinal inkurajon marrësin të kryejë disa veprime (gjeste) të caktuara.

Një tekst publicitar, për shembull, është shkruar zakonisht me qëllim të veçantë për të inkurajuar konsumatorët të blejnë një produkt të veçantë. Reklama '*Ndalohet duhan*'i vendoset për të ndaluar pirjen e duhanit, në mjedisin ku ajo shfaqet. Sipas këtij parimi, përkthimi duhet të prodhojë tek ata, të cilëve u adresohet, një efekt që të jetë sa më afër e mundur me atë që prodhon, në mesin e përfituesve të tekstit origjinal. Një shembull që ilustron qartë konceptin e efektit ekuivalent është përkthimi i pajisjeve të llojeve të ndryshme. Manuallet janë shkruar për t'u lejuar përdoruesve ta montojnë dhe ta përdorin pajisjen që ka në dorë. Kur lexuesi i tekstit të përkthyer duhet t'i referohet origjinalit për të pasur të njëjtin efekt të tekstit origjinal (ta përdorë pajisjen në fjalë), ne mund të themi se përkthyesi ka dështuar në punën e tij.

Përkthimi i manualeve ilustron rëndësinë për të riprodhuar të njëjtin efekt në përkthimin e teksteve thirrëse, të cilët përfshijnë, sipas klasifikimit të Newmark-ut,

lajmërime, udhëzime, reklama dhe tekste propagandistike, tekste bindëse ose debate dhe tekstet e trillimeve popullore.

Klasifikimin e dokumenteve sipas tipave dhe funksioneve, si dhe lloje të ndryshme të përkthimit⁴⁷ të propozuara në përkthimologji, bëjnë të mundur krijimin e një lloj tipologjie tekstesh, të cilët arrijta e të njëjtit efekt është e mundur ose e dëshirueshme në shkallë të ndryshme. Këtu vlen të përmendet ajo çka Newmark-u⁴⁸ propozon në lidhje me të.

Duke e konsideruar si një koncept të rëndësishëm në përkthim, Newmark-u fokusohet në parimin e efektit ekuivalent për të treguar shkallën e zbatimit të tij në çdo tekst dhe shkallën e rëndësisë së tij në varësi të llojit të tekstit.

Ndryshe nga teoricienë të tjerë si Leo Hickey, për shembull, Newmark-u propozon se efekti ekuivalent është një rezultat i dëshirueshëm, por jo qëllimi parësor i përkthimit. Ai, gjithashtu, thekson se nuk është e mundur të mirret i njëjti efekt kur funksioni i tekstit origjinal është i ndryshëm nga ai mbërritës (dhe anasjelltas), ose kur ekziston një dallim i madh ndërmjet kulturës së tekstit burimor dhe asaj të tekstit të synuar. Agjensitë e reklamave, për shembull, e kuptuan se efekti i reklamave të tyre nuk u arrit shpesh kur reklamat e tyre u përkthyen thjesht në kulturën pritëse. Siç do ta shohim në vijim, gjuha dhe kultura ruajnë një marrëdhënie shumë të ngushtë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e sistemeve juridike dhe në gjuhën ligjore.

Sipas Newmark-ut, në përkthimin semantik, qoftë ky përkthim me anë të të cilit përkthyesi synon të rikrijojë aspektet estetike përkthimore të tekstit origjinal, të përfuturuarit e efektit ekuivalent, ai (përkthyesi) ndeshet me dy vështirësi të mëdha. Së pari, ndodh që teksti i përkthyer nuk është menduar për lexuesit në përgjithësi (pra, për atë që quhet *readership* (lexues publik), por për lexuesin si individ. Përkthyesi përkthen, vë në dukje Newmark-u, tekstin, i cili shkakton efekt mbi të (përkthyesin) dhe jo mbi një lexues rastësor. Jolicoeur-i, nënvizon se të përkthesh, do të thotë fillimisht të tërhiqesh, të joshesh nga vepra që përkthen dhe kjo joshje buron nga bukuria e tekstit, dhe efekti që riprodhohet në tekstin e synuar lidhet, midis të tjerash, me estetikën e tekstit⁴⁹. Le të kujtojmë se dallimi mes kulturës së tekstit burimor dhe tekstit të synuar luan një rol të rëndësishëm në riprodhimin e efektit ekuivalent.

⁴⁷Shih sythin 2.5.

⁴⁸Krahaso Peter Newmark, *A Textbook of Translation*, 1988, fq. 48-49.

⁴⁹Louis Jolicoeur, *La sirène et le pendule*, vepër e cituar, fq. 7.

Efekti ekuivalent ka shkaktuar, sigurisht, probleme të ndryshme. Kështu, si në rastin e ekuivalencës pragmatike, është e nevojshme të pyetet nëse efekti i fituar në gjuhën e synuar është me të vërtetë i njëjtë me atë të gjuhës origjinale.

Po kështu, këtu ia vlen të përmendim punën e rëndësishme të Nida-s në këtë fushë. Nida është një nga teoricienët më me ndikim, që ka përcaktuar përkthimin me barasvlerës dhe që ka propozuar ekuivalencën dinamike, si një mjet për të krijuar një marrëdhënie, mes tekstit dhe lexuesit. Ky raport duhej të ishte i njëjtë mes lexuesit të tekstit origjinal dhe atij të tekstit të synuar.

Sipas Nida-s, një përkthim, që bazohet në ekuivalencën dinamike, kërkon një shprehje natyrore në gjuhën mbërritëse dhe synon t'i ofrojë marrësit mundësinë për t'u identifikuar me modelet e sjelljes, në përputhje me kulturën e vet. Ndryshe nga ekuivalenca formale, ekuivalenca dinamike nuk ka për qëllim të informojë lexuesin në gjuhën mbërritëse për zakonet dhe doket e kulturës së gjuhës nga e cila përkthehet. Në këtë qasje të orientuar nga lexuesi i tekstit mbërritës, përkthyesi duhet të marrë parasysh përshtatjen gramatikore dhe leksikore dhe madje edhe referencat kulturore. Përkthimi duhet të jetë i zhveshur nga ndërhyrjet e jashtme.⁵⁰ Kjo është ajo që Nida nënkupton me ekuivalencën natyrore më të afërt, në përcaktimin që i bën përkthimit⁵¹.

Megjithëse perceptimi i Nida-s mund të konsiderohet disi i vjetëruar, punimet e kryera kanë një rëndësi të madhe, pasi hapën rrugën për forma të reja të përkthimit; format që shmangen nga përkthimi fjalë për fjalë. Për më tepër, punimet e tij me përkthimin e Biblës, duke përfshirë ato në nocionet e ekuivalencës formale dhe dinamike, kanë qenë thelbësore për zhvillimin e një teorie të përkthimit.

1.5.9. Barasvlera funksionale

Barasvlera funksionale, siç kuptohet sot, është procesi nëpërmjet të cilit përkthyesi hulumton në gjuhën mbërritëse, elemente gjuhësore, kulturore dhe kontekstuale duke e lejuar atë për të prodhuar një tekst që mund të jetë funksional në kulturën pritëse. Termi *funksional(e)* duhet të kuptohet këtu në kuptimin pragmatik. Kjo do të thotë se qëllimi i përkthyesit është që të prodhohë një tekst, i cili mund të kryejë të njëjtat akte si në tekstin origjinal. Për të arritur këtë, përkthyesi përdor nganjëherë mënyra të diskutueshme.

⁵⁰Eugene A. Nida, *Toward a Science of Translating*, 1964, fq. 159-168.

⁵¹Ky përkufizim gjendet në sythin 1.4.

Të përkthesh, sipas ekuivalencës funksionale, do të thotë të pranosh që përkthimi është një aktivitet që mund të cilësohet si analog, në kuptimin që ai nuk është një shkencë me terma të qarta e të kuptueshme, por me terma tepër të përafërta, sipas rastit të përafërta dhe të pabarabarta në shumicën e rasteve. Fjalët e urta dhe idiomat japin shembuj të mirë të ekuivalencës funksionale. Ekuivalenca nuk duhet të kërkohet në elementet gjuhësore të fjalës së urtë apo të shprehjes idiomatike, as te vetë fjalë, as te imazhet e përfshira në këtë të fundit, por te funksioni i fjalës së urtë apo i shprehjes idiomatike. Proverbi apo shprehja idiomatike, në gjuhën origjinale, është zëvendësuar nga një shprehje në gjuhën e përkthyer me të njëjtat funksione në kulturën pritëse. Procesi i përdorur në këtë rast është zëvendësimi i një shenje të gjuhës origjinale me një shenjë të gjuhës mbërritëse.

Përkthimi i metaforave, nga ana tjetër, ka një vështirësi të veçantë. Siç vë në dukje Susan Bassnett-i në veprën *Translation Studies*⁵², kjo vështirësi vjen nga fakti se, sipas përkufizimit, një metaforë është një risi në gjuhën origjinale, pra, nuk ka ekuivalent të menjëhershëm në gjuhë të tjera. Në këtë rast, kompetenca dygjuhëshe e përkthyesit i shërben si një tregues i asaj që ekziston apo jo në gjuhën e tyre. Përkthyesi duhet të vendosë nëse metafora mund të përkthehet e pandryshuar, apo vetëm mund të riprodhohet pjesërisht.

Përkthimi është një proces që shkon përtej zëvendësimit të thjeshtë të elementeve leksikore dhe gramatikore të gjuhës me ato të një gjuhe tjetër. Arritja e barazisë mund, në fakt, të nënkuptojnë "humbje" të elementeve themelore gjuhësore të pranishëm në tekstin origjinal, të cilat zëvendësohen me elemente gjuhësore në gjuhën mbërritëse, duke pasur një funksion ekuivalent. Kjo do të thotë se në kërkimin e tij për ekuivalencë funksionale, përkthyesi largohet nga ekuivalenca gjuhësore, domethënë nga përkthimi fjalë për fjalë.

Në shembullin e mëposhtëm, huazuar nga Susan Bassnett-i, përkthimi i një betimi - apo blasfemie – nga italishtja ose nga spanjishtja kasteliane në gjuhën angleze kërkon që përkthyesi të gjejë në gjuhën e vet një shprehje që të përmbajë elemente që trondisin lexuesin anglofon. Elemente që mund të shkaktojnë një efekt të tillë janë ata që mbajnë një ngjyrim seksual. Kështu, Bassnett-i sugjeron të përkthejmë në anglisht shprehjen italiane '*Porca Madonna!*' me shprehjen '*Fucking hell!*'. Elementet e shprehjes në gjuhën e përkthyer nuk kanë të përbashkët, në këtë rast të veçantë, përveç strukturës gramatikore mbiemër + emër. Ajo çka është tronditëse në formën e parë është mbiemri

⁵²Susan Bassnett, *Translation Studies*, 1991, fq. 24.

porca, si cilësor i një emri me përdorim fetar, ndërsa në rastin e dytë është përdorimi i mbiemrit *fucking* që, pavarësisht, trondit emrin që cilëson⁵³.

Si përfundim, duke huazuar nga fjalët e Bassnett-it, ekuivalenca në përgjithësi, dhe ajo funksionale në veçanti, këtu është parë si rezultat i marrëdhënieve ndërmjet: a) shenjave gjuhësore, b) shenjave gjuhësore dhe kuptimit të tyre, c) shenjave, kuptimit të tyre dhe atyre që i përdorin ato. Këto janë elementet kryesore të çdo përkthimi të mirë të bërë nga qasje funksionale. Ky përkufizim përfshin edhe elementin që përbën objektin kryesor të studimeve që lidhen me pragmatikën: përdorimin që njerëzit i bëjnë gjuhës.

Vlen, gjithashtu, të theksohet në përkufizimin e mësipërm, se në një situatë përkthimi, ai që përdor shenjat gjuhësore, së pari, është përkthyesi dhe si ndërmjetës i komunikimit, ai duhet të mbajë parasysh raportet e përmendura në këtë përkufizim me qëllim që të riprodhojë një frazë, një paragraf ose një tekst të plotë, i cili të mundë të përmbushë një funksion të njëjtë (ekuivalent) në kulturën pritëse sipas burimeve gjuhësore, dokeve dhe zakoneve të kësaj të fundit.

1.6. Pranimi i ekuivalencës funksionale

Në kërkimin e ekuivalencës funksionale përkthyesi, ndonjëherë, mund të gjejë zgjidhje të gatshme. I tillë është rasti i përkthimit të një numri të madh të proverbave dhe shprehjeve. Këto ekuivalente janë regjistruar shpesh në fjalorët dygjuhësh ose burime të tjera të ngjashme.

Në raste të tjera, përkthyesi do të duhet të përdorë mënyra përkthimi më të ndërlikuara. Me mënyra të ndërlikuara të përkthimit, duhen nënkuptuar mënyra që kërkojnë një analizë më të thellë semantike të tekstit burimor dhe të mënyrës sesi mund të kalohet kuptimi në gjuhën pritëse, apo një analizë e opsioneve në dispozicion të përkthyesit, dhe së fundi, përdorimi i burimeve njerëzore që mund të zgjidhin problemin e përkthimit në fjalë.

Edhe pse metodat e ndryshme të përkthimit do të analizohen në vijim, le të saktësojmë se një nga vështirësitë kryesore të ekuivalencës funksionale, në përkthimin në përgjithësi dhe në përkthimin ligjor në veçanti, është shkalla e ekuivalencës, e cila përcakton pranimin e saj. Siç Gémar-i shprehet qartë në vijim se një nga vështirësitë

⁵³Po aty, fq. 27.

kryesore në përkthimin ligjor vjen nga diversiteti i sistemeve ligjore. Gémar-i arrin deri atje sa të thotë që *vështirësia e vetme e vërtetë e madhe* në përkthimin ligjor është prania e diversitetit të sistemeve juridike.⁵⁴

Konceptet dhe terminologjia e ligjit, në dallim nga disiplinat e tjera si kimia dhe fizika, të cilat janë ekuivalente pak a shumë të të gjitha bashkësitë sipas nivelit të njohurive lëndore, janë vetëm pjesërisht të ngjashme nga një vend në tjetrin.

Kështu, siç pohon *Cano et al.*⁵⁵, përkthyesi spanjoll që do të përkthejë fjalë si *hipoteca*, *arrendador*, *arrendatario* dhe *alquiler* si barasvlerës funksionalë të termave anglezë *mortgage* (hipotekë), *lessor* (qiradhënës), *lessee* (qiramarrës) dhe *rent* (qira) duhet ta dijë se shkalla e ekuivalencës prej këtyre termave është vetëm e pjesshme. Këta autorë na paralajmërojnë se çfarë është e rëndësishme për të kuptuar një koncept ligjor: është aftësia e atij që duhet të dijë pasojat ligjore të drejtpërdrejta ose kryesore të këtij koncepti.

Në shembullin e mësipërm, është e rëndësishme të dihen hollësitë juridike që vlejné për një *lessor* në gjuhën angleze, të cilat nuk përputhen domosdoshmërisht me ato që do të zbatohet për një *arrendador* në gjuhën spanjolle. Hickey saktëson se, edhe pse termat mund të jenë ekuivalente, kjo nuk do të thotë se të dy sistemet juridike e trajtojnë në mënyrë të njëjtë *lessor*-in dhe *arrendador*-in. Këto terma janë konsideruar ekuivalente në gjuhën angleze dhe spanjolle - në Angli dhe në Spanjë më saktësisht - edhe në qoftë se ligji i jep të drejta dhe imponon detyrime të ndryshme. Në këto raste, shënojnë autorët, thuhet se janë pasojat që janë të ndryshme, jo konceptet.

Studime në të drejtën e krahasuar tregojné se, për arsye historike, gjuhësore, sociale dhe kulturore, konceptet dhe nocionet e sistemeve të ndryshme juridike, si dhe rëndësia e tyre juridike, janë përgjithësisht të ndryshme. Në kontekstin e veçantë të përkthimit ligjor, pranueshmëria e ekuivalencës ligjore duhet të marrë parasysh llojin e tekstit që duhet përkthyer dhe funksionin e tij në kulturën pritëse.

Sot, nëse do i përmbaheshim parimit të së papërkthyeshmës do të thoshte të injoroje ose të hidhje poshtë, me një të rënë të lapsit, kërkimet dhe diskutimet që u zhvilluan në fushën e përkthimit nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar. Dihet se edhe gjuhësia bashkëkohore e sheh përkthim si "një operacion relativ në suksesin e arritur, të

⁵⁴Shih 2.3.3.

⁵⁵Virgina Cano Mora et al., « *¿Qué hace exactamente el traductor jurídico?* », Livius, 1994, fq. 29-30.

ndryshueshëm në nivelet e komunikimit që kanë arritur"⁵⁶. Tipi i tekstit që përkthehet përcakton, në masë të madhe, pranimin e ekuivalencës funksionale dhe përgjegjësinë e përkthyesit për t'u përballur me tekstin. Siç do paraqitet në vijim, përgjegjësia e përkthyesit, sidomos ajo e përkthyesit ligjor, dhe pasojat e përkthimit të gabuar, ndryshojnë sipas rastit, nëse bëhet fjalë për një legjislacion, për një kontratë, një marrëveshje ndërkombëtare apo për një tekst të doktrinës në drejtësi.

Gjatë kërkimit për ekuivalencë funksionale, përkthyesi shpesh përdor fjalorë njëgjuhësh, dygjuhësh ose shumëgjuhësh. Ne do të shohim në kreun e dytë që fjalorët, ndër të tjera, paraqisin problemin e besueshmërisë së zgjidhjeve të propozuara.

Në një artikull të titulluar *Bilingual and Multilingual Legal Dictionaries: New Standards for the Future*, Susan Šar evi -i fokusohet në besueshmëritë e ekuivalencës funksionale që janë regjistruar. Ajo njeh ekuivalencën funksionale si një koncept në sistemin juridik të gjuhës mbërritëse, duke e afruar sa më shumë me gjuhën dhe sistemin juridik të gjuhës nga e cila përkthehet; çka do të thotë që një koncept në gjuhën pritëse të përdoret për të shënuar një koncept ose institucion, funksioni i të cilit ose përdorimi të jetë i njëjtë me termin e gjuhës nga e cila përkthehet⁵⁷.

Šar evi -i vë në dukje se pranueshmëria e ekuivalencës funksionale nuk është vetëm një çështje juridike, ajo përfshin edhe parime të leksikografisë, duke përfshirë qëllimin e fjalorit dhe përdoruesit e tij. Ajo pohon se ekuivalenca e pjesëshme është përgjithësisht e mjaftueshme të fjalorët përshkruar, të cilat janë bërë për qëllime informative dhe janë menduar për lexues që u përkasin sistemeve të ndryshme juridike. Ajo, gjithashtu, vë në dukje ekzistencën e fjalorëve udhëzues, qëllimi i vetëm të cilëve është standardizimi i terminologjisë. Këta janë, në përgjithësi, fjalorë të hartuar për një legjislacion të veçantë dygjuhësh.

Le të shtojmë, si përfundim, se ekuivalenca funksionale është një nga mjetet e përkthimit më të përdorura, veçanërisht në përkthimin ligjor. Në Kanada, është dëshmuar rruga e përsosur për të krijuar një *common law* në frëngjishte dhe një të drejtë civile në anglishte.

Përdorimi më i dukshëm i ekuivalencës funksionale mbetet Japonia, ku sistemi juridik është kryesisht me frymëzim perëndimor. Për Ichiro Kitamura-n, profesor në

⁵⁶Shih sythin 1.4.

⁵⁷Susan Šar evi , *Bilingual and Multilingual Legal Dictionaries: New Standards for the Future*, Revue générale de droit, 1988, fq. 964.

Fakultetin e Drejtësisë në Tokio, për të asimiluar një koncept të huaj, mjafton të gjendet një qëllim pak a shumë praktik, çka do të thotë ky koncept në gjuhë të huaj dhe pastaj i plotëson kushtet ose koncepte në gjuhën e tyre⁵⁸. Le të vëmë re se pranueshmëria e ekuivalencës funksionale në kontekstin e krijimit leksikor, duhet të pasohet nga një proces i strukturuar i perfeksionimit të gjuhëve kombëtare, ose të paktën në gjuhën ligjore.

1.7. Model Analiza e Gideon Toury⁵⁹

1.7.1. Konteksti

I bindur se përkthimologjia do të ankohej se ka mbetur prapa në zhvillimin dhe përdorimin e metodave, për të vëzhguar dukuri tipike në këtë lëmë dhe t'i shpjegojë ato, Toury ka propozuar kushtet për një qasje sistematike për kërkime që janë unike për shkencën e përkthimit. Sipas Toury-së, studimeve në fushën e përkthimit u mungon një degë e studimeve përshkruese që do t'i lejonte për t'u vendosur në nivelin e shkencës empirike të plotë dhe të pavarur. Për të, çdo shkencë empirike duhet të ketë një degë teorike, një praktike dhe një përshkruese.

Toury, nisur nga e shkuara, vëren se, për të kryer studime, teoricienët e përkthimit huazonin elemente teorike nga shkenca të tilla si gjuhësia krahasuese, letërsia dhe stilistika krahasuese, pragmatika dhe psikolinguistika. Edhe pse këto studime kanë tematika që lidhen me përkthimin, kuadri i tyre teorik dhe metodologjik nuk ishte shumë i përshatshëm për këtë të fundit. Përveç kësaj, prirja në mesin e teoricienëve ishte për të treguar supozimet e tyre me shembuj jashtë kontekstit, madje edhe të sajuar. Këta shembuj, shton Toury, u përzgjedhën duke u bazuar në kompetencat e tyre të bindjes dhe jo në përfaqësueshmërinë e tyre për një problem apo dukuri të dhënë.

Toury propozon krijimin e një dege sistematike përshkruese, duke u bazuar në postulatet dhe hipotezat e veta të pajisura me një metodologji dhe teknika kërkimore, të zhvilluara në mënyrë të qartë në dritën e studimeve në përkthimologji. Për të, krijimi i një dege të tillë dhe zhvillimi i një metodë analize do të lejonte testimin e rezultatëve dhe e studimeve individuale, për t'i krahasuar dhe riprodhuar, të paktën në parim, duke lehtësuar kështu grumbullimin e rregullt të njohurive.

⁵⁸Ichiro Kitamura, *La traduction juridique: Un point de vue japonais*, Les Cahiers de Droit, vol. 28, nr. 4, dhjetor 1987, fq. 747-792.

⁵⁹Ky syth përshkruan dhe përmbledh modelin e analizës krahasuese që Gideon Toury propozon në veprën *Descriptive Translation Studies and Beyond*, 1995.

Toury frymëzohet nga parimet e teorisë së polisistemeve (*polysystems theory*). Termi "*polysysteme*" u përdor për herë të parë në 1970 nga izraeliti Itamar Even-Zohar, teksa punonte për një model analitik të letërsisë hebraike⁶⁰. Toury është një nga profesorët e shumtë në Universitetin e Tel Avivit, i cili ka marrë pjesë në disa studime të zbatuara për të provuar, gjatë viteve 1970-të, hipotezën e Even-Zohar-it. Teoria e polisistemeve i përmbahet parimit, sipas të cilit një tekst letrar nuk mund të studiohet në mënyrë të izoluar, sepse ai është pjesë e një sistemi dinamik dhe kompleks letrar i cili, nga ana e tij, është i lidhur me sisteme të tjerë. Sipas kësaj teorie, janë normat e tekstit të kulturës pritëse që përcaktojnë elementet gjuhësore dhe tekstuale të përfshira në përkthim. Ky është një postulat në kundërshtim me metodat e orientuara të analizës së tekstit origjinal.

Ai pranon se kufizimet gjuhësore, tekstuale dhe të tjera, kushtëzojnë natyrën e produktit të përfutur nga procesi i përkthimit dhe propozon një teori me një seri normash që do të përligjinin zgjedhjet e bëra nga përkthyesi. Normat e identifikuar nga Toury burojnë nga të dhëna sasiore të regjistruara dhe të analizuar për pesëmbëdhjetë vjet, që kanë të bëjnë me përkthimin e romaneve të huaja. Romanet e analizuar janë përkthyer kryesisht nga anglishtja, rusishtja, frëngjishtja ose nga jidishtja në gjuhën hebraishte. Parametrat e analizuar ishin, për shembull, numri i autorëve të përkthyer, numri i librave të shkruar nga çdo autor i përkthyer dhe numri i botuesve dhe përkthyesve⁶¹.

Punimet e Toury-t janë një tjetër dëshmi e kontributeve të përkthimit letrar në zhvillimin e studimeve të përkthimologjisë.

1.7.2. Përkthimi si veprimtari që udhëhiqet nga norma

Disiplina të tilla, si pragmatika, e shikojnë përkthimin si një veprimtari social-kulturore. Roli i përkthimit, i produkteve të tij dhe i praktikuesve është ai që u ka ngarkuar shoqëria. Përkthyesi nuk është konsideruar si një gjenerator i thjeshtë i deklaratave nga një gjuhë në një tjetër. Si anëtar i një shoqërie të caktuar, përkthyesi është menduar se e njeh kornizën e referencës të vendosur nga shoqëria ku ai bën pjesë.

⁶⁰Shih Edwin Gentzler-in, *Contemporary Translation Theories*, 1993, fq. 104. Në librin e tij, Toury nuk i referohet teorisë së polisistemeve edhe pse shumë prej parimeve të kësaj teorie të fundit gjenden në bazë të teorisë së tij.

⁶¹Po aty, fq. 126.

Toury pohon me forcë se përkthimi, si veprimtari social-kulturore, është kushtëzuar nga kufizime të llojeve të ndryshme, në shkallë të ndryshme. Sipas tij, këto kufizime janë përtej tekstit origjinal, përtej dallimeve sistematike të gjuhëve dhe të teksteve që merren me përkthimin dhe përtej edhe aftësive dhe kufizimeve të përkthyesit, si ndërmjetës i nevojshëm. Toury ofron një klasifikim të këtyre kufizimeve në shkallën e tyre të intensitetit dhe sipas sjelljes së tyre në kohë.

Lidhur me intensitetin e kufizimeve në përkthim, Toury ofron një gamë të gjerë të kufizimeve të rregullave që nisin nga kundërshtitë deri te rregullat, duke kaluar nëpërmjet normave. Toury pranon kufizimet që vendosen në dy pole: në njërin anë, idiosinkrazitë (në lidhje me individët ose veprimtaritë)⁶², dhe nga ana tjetër, rregullat e përgjithshme ose relativisht absolute. Pastaj, në mes të dy poleve, ai njeht një situatë të ndërmjetme, ku gjenden elemente të tjerë shtrëngues që ai e quan "norma". Secila nga këto norma paraqet një rëndësi të ndryshme, disa janë të forta dhe u ngjajnë rregullave, dhe të tjerat, më të dobëta, u ngjajnë idiosinkrazive.

Kufijtë midis pengesave të ndryshme nuk janë të qarta dhe të pastra. Çdo koncept, duke përfshirë edhe rendin e normave është disi relativ. Për më tepër, ajo që mund të konsiderohet një mënyrë sjelljeje e parapëlqyer nga një grup heterogjen ka gjasa të bëhet e detyrueshme për një grup homogjen, qoftë në lidhje me individët, për shembull, nga përkthyesit apo njerëzit që punojnë në fushën e krijimit të teksteve, ose në lidhje me veprimtaritë, për shembull të përkthimit ligjor. Përkthimi ligjor është, në fakt, një nga fushat e përkthimit më të më prekura nga kufizimet dhe rregullat. Kapitulli i dytë i këtij punimi do të përqendrohet kryesisht në aspektet teorike dhe praktike të përkthimit ligjor dhe, në veçanti, te nocioni i kufizimit në këtë lëmë.

Lidhur me dimensionin kohor, Toury saktëson se kufizimet kanë periudhat e ngritjes dhe rënies. Kështu, prirjet thjesht kryeneçe në një çast të caktuar mund të fitojnë një karakter gjithnjë e më shumë normativ. Normat, nga ana tjetër, mund të marrin një vlefshmëri në rritje dhe të bëhen, në praktikë, forcat e detyrueshme ose anasjelltas.

Duke u frymëzuar nga fushat e sociologjisë dhe të psikologjisë, Toury i përcakton normat si « *the translation of general values or ideas shared by a community - as to what is right and wrong, adequate and inadequate - into performance instructions appropriate*

⁶²Këto norma do të zbatoheshin për studimet krahasuese diakronike. Korpusi i analizës do të përfshinte përkthimet e bëra nga i njëjti përkthyes në kohë të ndryshme. Qëllimi është për të identifikuar prirjet nga ana e përkthyesit në lidhje me zgjedhjen e strategjive të përkthimit. Kjo është ajo që Toury e quan sjellje e përkthyesit.

*for and applicable to particular situations, specifying what is prescribed and forbidden as well as what is tolerated and permitted in a certain behavioural dimension »**⁶³. Konstatohet se në këtë citat termi *normë* nuk ka të bëjë me ligjet si të tilla, por me përdorimin dhe sjelljet e përbashkëta të anëtarëve të një komuniteti.

Shembulli i Jean Delisle-it, për të treguar orën në frëngjishte dhe anglishte, ilustron bukur fjalët e Toury-y. Delisle-i thotë se, kur tregon orën, frankofoni thotë spontanisht: « *il est huit heures dix* » dhe jo « *il est dix après huit* » (Ora është tetë (e) dhjetë" dhe jo "Ora është dhjetë pas tetës"). Nga ana tjetër anglofoni thotë: « *A quarter past eight o'clock* », apo ndoshta « *Eight fifteen* », më tepër se « *Fifteen minutes after eight o'clock* », edhe pse formulimi fundit është gramatikisht i saktë⁶⁴.

Normat, sipas Toury, janë përfutur nga individë, përmes procesit të edukimit dhe shoqërizimit, dhe ato përmbajnë, gjithmonë, nocionin e sanksionit, të vërtetë ose të mundshëm. Në një komunitet, normat përbëjnë, gjithashtu, edhe kriteret nëpërmejt të cilave sjellja gjykohet ose vlerësohet. Normat janë konceptet kyç dhe pikë qendrore në çdo përpjekje për të përcaktuar marrëdhënien dhe rëndësinë e veprimtarive shoqërore. Ato janë, në fakt, elementet kryesore që shërbejnë për të vendosur dhe mirëmbajtur rendin shoqëror.

Përkthimi, thotë Toury, lidhet pashmangërisht së paku me dy gjuhë dhe dy kultura, dhe natyrisht, me dy grupe normash. Këto norma janë të ndryshme, sipas përcaktimit dhe, prandaj, edhe të papajtueshme. Toury pohon se përkthimi, në një kulturë të caktuar, mund të jetë i lidhur me prirje të caktuara specifike për këtë kulturë. Edhe pse çdo shmangie nga këto prirje nuk mund të shpjegohet në mënyrë të qartë, anëtarët e kulturës në fjalë mund të vënë re dallimet nga përkthimi i praktikave të pranuar gjerësisht. Toury njih tri lloje normash, të cilat, sipas tij janë: norma fillestare, norma paraprake dhe norma operacionale⁶⁵.

⁶³Gideon Toury, *Descriptive Translation Studies and Beyond*, 1995, fq. 55.

*"Përkthimi i vlerave dhe ideve të përgjithshme të përdorura në një komunitet – për të përcaktuar se çfarë është e drejtë dhe e gabuar, e përshtatshme dhe e papërshtatshme – në formën e udhëzimeve të përshtatshme dhe të aplikueshme në situata të veçanta, duke theksuar çfarë është e lejueshme dhe e ndaluar si edhe çfarë është e tolerueshme në një situatë të caktuar".

⁶⁴*Terminologie de la traduction*, nën drejtimin e Jean Delisle et al., Amsterdam, John Benjamins 1999, fq. 164.

⁶⁵Gideon Toury, vepër e cituar, fq. 56-61.

1.7.2.1 . *Normat fillestare*

Toury e shpjegon normën fillestare si një mjet për të identifikuar drejtimin e përkthimit. A është fjala për një përkthim të orientuar drejt tekstit dhe gjuhës burimore (*source-oriented*) apo drejt tekstit dhe gjuhës së synuar (*target-oriented*)? Le të kujtojmë se bëhet fjalë për një vendim relativisht i pavetëdijshëm nga ana e përkthyesit dhe se ky drejtim mund të ndryshojë gjatë përkthimit. Megjithatë, teksti zakonisht ka disa veçori që lejojnë për të përcaktuar drejtimin.

Nëse përkthyesi ka përshtatur një qasje të orientuar drejt tekstit origjinal, përkthimi pasqyron standardet ose elemente të gjuhës origjinale, të cilat janë shpesh të papajtueshme me gjuhën. Në këtë rast bëhet fjalë, në fakt, për një tekst të hartuar në gjuhën mbërritëse, që ruan marrëdhëniet me tekstin origjinal, me fjalë të tjera, për një tekst që nuk është shkëputur krejtësisht me sistemin gjuhësor të origjinës. Për më tepër, nëse qasja është e orientuar drejt tekstit të synuar, përkthimi pasqyron normat dhe elementet gjuhësore që janë specifike për gjuhën dhe tekstin e synuar.

Norma fillestare, vë në dijeni kërkuesi shkencor lidhur me elementet gjuhësore dhe tekstuale, mund të jetë e pranishme në përkthime që përbëjnë objektin e krahasimit: elementet e tekstit dhe të gjuhës origjinale ose të tekstit dhe të gjuhës pritëse. Përveç kësaj, orientimi i një përkthimi ka efekt mbi atë se si është i perceptuar. Meqë ka dy orientime të mundshme, mund të krijohen dy efekte të përgjithshme. Orientimi drejt tekstit burimor, pohon Toury, përcakton shkallën e përshtatshmërisë midis përkthimit dhe tekstit origjinal, ndërsa orientimi drejt tekstit të gjuhës mbërritëse përcakton shkallën e pranueshmërisë së përkthimit në kulturën pritëse.

Toury thekson se nocioni i normës fillestare përbën një mjet shpjegues, i cili nuk nënkupton një kronologji zbatimi, por më tepër një nivel më të përgjithshëm, në krahasim me normat e tjera më specifike. Normat, përveç atyre që gjenden në polet e skajshme, duhet të merren gjithmonë me një shkallë të caktuar përkulshmërie. Në rastin e normës fillestare, për shembull, edhe në qoftë se një orientim është qartësisht i pranishëm në një përkthim, kjo nuk do të thotë se të gjitha vendimet e marra, në procesin e përkthimit, janë marrë në funksion të këtij orientimi.

Vendimet e marra në procesin e përkthimit, rezultati i të cilave bëhet objekt i analizës së kërkuesit shkencor, përfshijnë pra një kombinim të të dy orientimeve të tekstit të përkthyer, ose të kompromiseve që janë bërë kundër njërit apo tjetrit të këtyre orientimeve. Toury sugjeron zbatimin e këtij parimi orientimi për arsye teorike dhe

metodologjike. Dallimi mes këtyre dy orientimeve nënkupton njohjen e themeleve të ndryshme teorike që mundësojnë dallimin dhe përligjjen e natyrës dhe shkallën e kompromisit që shfaqet në tekstin e përkthyer. Me fjalë të tjera, është ky orientim që mund të dallojë dhe të justifikojë ngjashmëritë dhe dallimet midis përkthimeve dhe origjinalit.

1.7.2.2. Normat paraprake

Toury propozon, si norma paraprake, analizën e dy faktorëve që janë shpesh të ndërlydhur: ekzistencën dhe natyrën e një politike relative në përkthim dhe pranimin e përkthimeve jo të drejtpërdrejta (*translation policy dhe directness of translation*)⁶⁶ . Me politikë relative në përkthim, ai nënkupton elementet që rregullojnë zgjedhjen e teksteve për t'i paraqitur nëpërmjet rrugës së përkthimit, në një kulturë apo në një gjuhë në një kohë të caktuar. Mund të thuhet se kjo politikë ekziston për aq sa zgjedhja e tekstit nuk është lënë në dorë të fatit. Kjo politikë, thotë Toury, mund të ndryshojë sipas grupeve apo nëngrupeve, përta i përket llojit të tekstit që duhet përkthyer (letrar ose jo letrar), apo edhe sipas faktorëve të tjerë si shtëpitë botuese, për shembull. Kujtojmë përsëri se puna, që çoi në zhvillimin e kësaj metode të analizës, fokusohet në përkthimin letrar, i cili nuk do të ndikojë në rezultatin optimal të konsideratave të përdorura në përkthimin ligjor.

Me *directness of translation*, Toury nënkupton mundësisë, në kontekstin e origjinës së përkthimeve që përbëjnë objektin e analizës, përkthimin nga një gjuhë që nuk është gjuha burimore. Ai sugjeron të marrim në konsideratë, nëse në kontekstin e zgjedhur është e lejuar, e ndaluar, ose e toleruar apo e parapëlqyer për të përkthyer një gjuhë ndërmjetëse, që do të thotë të bësh përkthimin e një përkthimi. Cilat gjuhë të ndërmjetme janë të lejuara, të ndaluara, të toleruara apo të preferuara? A është kjo një tendencë, një preferencë apo një detyrim? A është e zakonshme ose e detyrueshme për të treguar se kemi të bëjmë me një përkthim të tërthortë, apo kjo gjë injorohet, fshihet, mohohet, etj.? Në rastin e fundit, a është përmendur gjuha e ndërmjetme?

1.7.2.3. Normat operacionale

⁶⁶Po aty, fq. 58.

Me norma operacionale, Toury kupton normat që drejtojnë vendimet e marra në procesin e përkthimit. Këto janë, në fakt, norma që rregullojnë matricën e tekstit, domethënë, mënyrat e shpërndarjes së elementeve gjuhësore në përkthim, si dhe faturën e saj, në lidhje me sintaksën dhe me formulimin verbal si të tillë. Si rrjedhim, këto norma drejtojnë, gjithashtu, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, marrëdhëniet mes tekstit burimor dhe tekstit të synuar, domethënë çka është e vërtetë dhe çka mbetet e pandryshueshme.

Ndër normat operacionale, Toury dallon normat e matricës (*matricial norms*) dhe normat tekstuale – gjuhësore (*textual-linguistic norms*). Normat e matricës lidhen me tërë tekstin e synuar, bëhet fjalë, në fakt për variacione në lidhje me tekstin origjinal: heqje, shtesa, zhvendosje pasazhesh, ndarje teksti në segmente⁶⁷ (*test segmentation*), shënime në fund të faqes. Disa variante të vëzhguara në përkthim mund të rrjedhin edhe nga struktura e gjuhës së synuar ose nga strategjitë kompensuese ose humbëse.⁶⁸

Përsa u përket normatve tekstuale – gjuhësore, ato u referohen zgjedhjeve gjuhësore, me fjalë tjera, elementeve leksikore, frazave dhe veçorive stilistike të tekstit të synuar. Toury dallon dy lloje normash tekstuale - gjuhësore: normat e përgjithshme dhe ato specifike. Të parat vlejné për përkthimin në përgjithësi, ndërsa të dytat u referohen një mënyre përkthimi të veçantë ose përkthimit të një tipi të veçantë teksti.

1.7.3. Përçapje analize

Toury propozon një model analize të varianteve, me qëllim që të rindërtojë procesin e vendimeve të marra nga përkthyesi dhe të formulojë hipoteza në lidhje me kufizimet, nën të cilat këto vendime kanë qenë marrë. Normat janë mjete për të arritur këtë qëllim. Këto mund të vijnë nga dy burime: 1) nga analiza e një korpusi 2) nga analiza e aktorëve të ndryshëm që ndërhyjnë në përkthim, si praktikantët, teoricienët, rishikuesit, etj. Toury thekson se ndërhyrësit në përkthim mund të fusin preferenca dhe

⁶⁷Toury-i nuk është përkrahës i postulateve sipas të cilave segmentimi i teksteve ndjek modele universale. Ai saktëson se ka modele të ndryshme ose tradita segmentimi të teksteve, dhe secili model ka efekt mbi përkthimit. Ai jep shembullin e Dhiatës së Vjetër, e cila u ndryshua nga përkthyesit e saj në mënyrë që t'u afrohej zakoneve dhe kulturës pranuese dhe, kështu, të rritej pranimi i përkthimit të saj.

⁶⁸J.P. Vinay et J. Darbelnet-i shpjegojnë mirë këtë dukuri në veprën e tyre *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, 1958, fq. 163-168.

perceptime vetjake. Ai, gjithashtu, parapëlqen normat që rrjedhin nga analiza e teksteve.⁶⁹

Siç u përmend në hyrjen e përgjithshme, Toury propozon që të analizohen njësitë e përkthimit - segmentet e tekstit – dhe jo tekstet kryefund. Me njësi përkthimi duhen kuptuar jo njësi të identifikuar nga përkthyesi për përkthimin e vet, por segmente teksti të nxjerra nga studiuesi për qëllime analize. Përzgjedhja e segmenteve duhet të jetë në funksion të krahasimit, të cilave u nënshtrohen këto pjesë.

Metodologjikisht, është gjithashtu e rëndësishme për të vendosur drejtimin e veprimit, domethënë, të tregohet cili është teksti origjinal dhe cili është teksti i synuar, dhe si rrjedhim, cili është teksti që ndryshon në lidhje me tjetrin. Kjo është e vetmja mënyrë për të identifikuar marrëdhënien problem / zgjidhje. Nga pikëpamja konceptuale, vendosja e çifteve të segmenteve të tekstit supozon se dy komponentet e çiftit kanë një farë pandryshueshmërie të caktuar⁷⁰ që lejon identifikimin e njërit si shpërblim i tjetrit. Vendosja e çifteve të segmenteve të tekstit lejon analizën e varianteve përkthimore dhe marrëdhëniet që ekzistojnë mes dy teksteve.

Në vendosjen e marrëdhënieve të përkthimit, të cilat nënkuptojnë jo vetëm ngjashmëri, por edhe dallime, theksi bie mbi nocionin e pandryshueshmërisë, ndryshme mbi atë që mbetet e pandryshuar në përkthim. Por ato çka nuk ndryshojnë, te një çift segmentesh, nuk janë të dukshme dhe duhet t'i nënshtrohen analizës. Në parim, kjo pandryshueshmëri mund të ekzistojë në aspektin e substancës (në nocionin ose konceptin në fjalë) ose të funksionit dhe kjo në planin gjuhësor dhe tekstual. Sipas Toury-së, ashtu si për normat, ai i kthehet anës teorike të përkthimit për të siguruar një pajisje përshkruese për marrëdhëniet formale dhe funksionale të përkthimit, në rrafshet gjuhësore dhe tekstuale, të cilat Toury i emëron përkatësisht plan i *zakonshëm* dhe plan *ad hoc*.⁷¹

Toury pohon se përkthologjia, në saje të traditës së saj të gjatë të studimeve në përkthimin literal (ose ekuivalenca formale) dhe në përkthimin jo literal (ose ekuivalenca

⁶⁹Vëmë re se normat që dalin nga analiza e një korpusi që përmban, gjithashtu, një shkallë të caktuar të relativitetit dhe të përgjithësismit. Siç saktëson Toury në fushën e standardeve dhe të prirjeve, asgjë nuk duhet të merret në shkallë absolute.

⁷⁰Termi *invariance*, i cili vjen prej anglishtes *invariance* do të thotë “Veti e asaj çka është e pandryshueshme, e cila ruhet në një shndërrim të natyrës fizike ose matematikore” (*Termium*, parë më 17 dhjetor 2002). Të dy përbërësit e një çifti segmentesh ruajnë një farë ekuivalence që identifikon si njërin krahas, ashtu edhe tjetrin.

⁷¹Gideon Toury, *Descriptive Translation Studies and Beyond*, 1995, fq. 85.

funkzionale), është në gjendje të sigurojë këtë funksion. Le të saktësojmë se ky postulat i Toury-t përbën objektin e një teme të diskutueshme. Nga njëra anë, Toury nuk jep hollësi për këtë dispozitiv. Ne mund të nxjerrim si përfundim se ai i referohet strategjive të përkthimit, por mbetet i heshtur lidhur me këtë temë. Nga ana tjetër, siç vë në dukje Munday, pjesa teorike e përkthimologjisë është larg së arrituri një konsensus përse i përket imazhit për të krijuar marrëdhënie ndërmjet segmenteve të tekstit⁷².

Duke përcaktuar përkthimin si një veprimtari sociokulturore, të udhëhequr nga norma dhe si një proces vendimmarrjesh, Toury parashtron parimet për rindërtimin e këtij procesi dhe formulimin e hipotezave, në lidhje me kufizimet gjuhësore, tekstuale dhe metodologjike, nën të cilat janë marrë vendimet. Për ta bërë këtë, ai propozon që përkthimi të segmentohet në njësi krahasimore dhe këto njësi të përputhen me segmentet përkuese në tekstin origjinal. Duke përdorur parimet e përkthimit formal ose funksional, të dhëna nga lëmi i studimeve teorike të përkthimologjisë, kërkuesi shkencor mund të përcaktojë drejtimin e segmenteve të analizuara. Drejtimi i përgjithshëm, i vërejtur në segmentet e tekstit, mundëson vendosjen e një drejtimi për përkthimin e plotë. A është ky një përkthim që është orientuar drejt gjuhës dhe tekstit origjinal apo drejt gjuhës dhe kulturës pritëse?

Nocioni i ekuivalencës, nga ana tjetër, nuk duhet të shihet si një marrëdhënie mes tekstit burimor dhe tekstit në gjuhën pritëse, i cili parashkruan se çduhet të jetë ose të mos të jetë përkthimi. Ekuivalenca, siç perceptohet nga Toury, ndihmon në përcaktimin e asaj se çka është e përshtatshme ose e papërshtatshme në traditën gjuhësore dhe tekstuale të kulturës pritëse. I takon lëmit teorik të shkencës së përkthimit që të japë parimet që mundësojnë dallimin e mënyrave të përshtatshme apo të papërshtatshme për një kulturë të caktuar.

⁷²Shih Jeremy Munday, *Introducing Translation Studies*, 2001, fq. 112.

KREU II

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT JURIDIK

2.1. Hyrje

Përkthimi ligjor paraqet problemet e veta. Mund të thuhet me siguri e njëjta gjë për fushat e tjera të përkthimit. Megjithatë, përkthimi në fushën e së drejtës ka karakteristika, që asnjë lëmë tjetër specialiteti nuk paraqet, dhe kjo për shkaqe të

elementeve shoqërorë, gjuhësorë, kulturorë, metodologjikë dhe nocionore që ndërhyjnë në këtë lëmë.

E Drejta, duke qenë një dukuri shoqërore, produkti i një kulture, siç pohon Gémarr-i, përfton në çdo shoqëri një karakter unik. Siç do të shohim më tutje, secila shoqëri e organizon drejtësinë apo sistemin juridik në bazë të botëkuptimit që ajo ka dhe sipas strukturës që ajo dëshiron t'i japë. Kështu, ligjërimi në drejtësi mbart një dimension kulturor, i cili pasqyrohet jo vetëm në fjalë ose terma specifike për një sistem ligjor, por edhe në mënyrën për t'i shprehur ato⁷³.

Sistemi i drejtësisë ka specifikat e gjuhës së vet. Këto specifika e dallojnë përkthimin ligjor nga përkthimi i fushave të tjera të specialitetit. Sigurisht, çdo lëmë specialiteti ka një fjalor të vetin. Megjithatë, drejtësia ka veçantinë e përdorimit të gjuhës si mjet dhe udhë⁷⁴ shprehjeje, tekstet përbëjnë mjetin kryesor dhe qëllimin kryesor. Për më tepër, do të ishte e drejtë të thuhej se drejtësia nuk mund të ekzistonte pa këtë mjet shprehës. Citimi i mëposhtëm, marrë nga juristi anglez Yon Maley, ilustron shumë bukur lidhjen e brendshme që ekziston midis drejtësisë dhe gjuhës që përdoret në drejtësi:

*In all societies, law is formulated, interpreted and enforced : there are codes, courts and constables. And the greater part of these legal processes is realized primarily through language. Language is medium, process and product in the various arenas of the law where legal texts, spoken or written, are generated in the service of regulating social behaviour. Particularly in literate cultures, once norms and proceedings are recorded, standardised and institutionalised, a special language develops, representing predictable process and pattern of functional specialisation**⁷⁵.

Drejtësia është kaq ngushtësisht e lidhur me gjuhën, e cila e mbështet, sa që përbën një nga kriteret për klasifikimin e familjeve të ndryshme të ligjit. Kështu, përkthimi nga anglishtja në frëngjishte ose nga anglishtja në spanjishte, do të thotë që të

⁷³ Shih Jean-Claude Gémarr, *La traduction juridique et son enseignement, Meta*, 1979, fq. 37-45.

⁷⁴ Pankartat dhe posterat, natyrisht, bëjnë përjashtime.

⁷⁵ Yon Maley, *The Language of the Law, Language and the Law*, botuar nga John Gibbons, London, Longman 1994, fq. 11.

*"Në të gjitha shoqëritë ligjet janë të formuluara, interpretuara dhe përforcuara: ekzistojne kode, gjykata dhe zbatues. Pjesa më e madhe e këtyre proceseve juridike realizohet nëpërmjet gjuhës. Gjuha është ndërmjetësues, proces si edhe produkt në fusha të ndryshme ku tekstet juridike, të folura apo të shkruara gjenerohen në shërbim të sjelljeve shoqërore. Vecanërisht në shoqëritë e përparuara pasi normat regjistrohen dhe standardizohen, zhvillohet një gjuhë e vecantë e cila përfaqëson procese të parashikueshme dhe modele funksionale".

përkthesh në kuadrin e dy familjeve juridike, që janë tradita civiliste⁷⁶ dhe tradita anglo-amerikane. Në fakt, gjuha dhe kultura janë elementet më të rëndësishëm që përcaktojnë përmbajtjen dhe formën e këtyre dy familjeve të drejtësisë.

Në fakt, karakteristikat gjuhësore dhe kulturore të drejtësisë janë të tilla që ligjërimi juridik nuk mund të ushtrohet përveçse në një kuadër institucional të përcaktuar mirë. Kjo kornizë institucionale, siç specifikohet nga Groffier-i dhe Reed-i, ka tradita, që do të thotë ide që përcaktojnë ligjshmërinë e drejtësisë. Meqë drejtësia është një fakt i gjuhës, shumë njerëz mbështesin kauzën e tyre mbi parimet thjesht gjuhësore. Groffier-i dhe Reed-i japin dy shembuj të këtij përdorimi. I pari ka të bëjë me vendet totalitare që mburrin barazinë, lirinë dhe tiraninë që shpallin me të madhe të jenë "demokratike". I dyti është ai i betejave juridike dhe vendimet e gjykatave që rrotullohen rreth fjalëve më shumë se rreth fakteve⁷⁷.

Gjuha në drejtësi paraqet, gjithashtu, paradoksin e të qenit e latuar me shumë kujdes, por edhe e të qenit hermetike dhe e paqartë. Siç vë në dukje Gémar-i "*Juristët praktikonin një ligjërim shpesh të errët dhe gjithë dredha, dhe kjo ndodh në të shumtën e gjuhëve të zakonshme, sidomos në Perëndim*"⁷⁸.

Karakteristikat e mësipërme janë kurthe që has përkthyesi. Gjithashtu, përkthyesi i teksteve ligjore duhet të ketë një formim që t'i mundësojë shmangien e këtyre kurtheve dhe të japë një produkt, që mund të përmbushë pritshmëritë e të interesuarit. Sa më shumë të ndërhyjë drejtësia në pothuajse të gjitha aspektet e jetës në shoqëri, aq më i plotë duhet të jetë ky formim.

Le të vëmë re, gjithashtu, se të flasësh për ligjërimin nënkupton të folurit për qëllimin. Drejtësia ë ka një ose disa misione të veçanta. Po kështu, edhe ligjërimi në drejtësi ka një ose disa qëllime po të veçanta. Për shkak të këtyre karakteristikave të

⁷⁶Termet *traditë* juridike dhe *sistem* juridik janë përdorur shpesh si sinonime, ndërkohë që tregojnë dy koncepte shumë të ndryshme. Dallimi midis të dyjave është analizuar në sythin 2.3.

⁷⁷Ethel Groffier, et David Reed, *La lexicographie juridique*, Cowansville (Québec), Les éditions Yvon Blais, fq. 3.

⁷⁸Jean-Claude Gémar, *Les fondements du langage du droit comme langue de spécialité*, Revistë e përgjithshme e së Drejtës, Universiteti i Oktavias, Fakulteti i Drejtësisë, vol. 21, nr. 4, 1990, fq. 719. Le të shënojmë se në botimin e vitit 1995, Gémar-i pranon se kjo dukuri mund të gjendet në krahina të tjera. Shih: Jean-Claude Gémar, *Traduire ou l'art d'interpréter: langue, droit et société: éléments de jurilinguistique, Tome 2: Application*, Vëllimi 2: Zbatime, Kebek, Les Presse de l'Université du Québec, 1995, fq. 84.

veçanta të gjuhës ligjore, përkthyesi, si dhe përdorues të tjerë të ligjit, duhet të angazhohen në procesin e interpretimit të kuptimit dhe qëllimit të tekstit ligjor.

Pragmatika, disiplinë gjuhësore, e cila studion elementet që ndërhyjnë në ligjërim - dhënësi, marrësi, kanali, rrethana ose konteksti, etj. - është shumë e dobishme në përkthimin ligjor. Ajo hedh dritë mbi atë, çka nuk e bën dot gjuhësia, dmth nuk mjafton të njohësh kodin ose të zotërosh kompetenca gjuhësore për të interpretuar një mesazh. Duke përfshirë përdoruesin e gjuhës, pragmatika arrin të analizojë raportet dhe elementet gjuhësore dhe jashtëgjuhësore që hyjnë në lojë në një mesazh.

Ky kre është i strukturuar në dy pjesë. Pjesa e parë - nga sythi 2.2 te sythi 2.5 -, përqendrohet në elementet që janë në origjinën e kompleksitetit të përkthimit ligjor. Ai përfshin një përshkrim të shkurtër të qasjes pragmatike, të analizës së kuptimit dhe një analizë të bazës epistemologjike të përkthimit ligjor. Me këto duhen kuptuar analiza e elementeve strukturore, gjuhësore, socio-politike dhe metodologjike që hyjnë në ligjërimin juridik dhe që e bëjnë përkthimin në këtë fushë një nga përkthimet më të ndërlikuara. Ky themel epistemologjik mbështetet në tipologjinë e vështirësive të përkthimit ligjor, të propozuar nga Gémair-i. Ajo përfshin, gjithashtu, analizën e konceptit të kulturës juridike dhe rëndësinë e saj në përkthim ligjor.

Pjesa e dytë - ose syshet 2.6, 2.7 dhe 2.8, - i kushtohet analizës së mënyrave kryesore për t'u bërë ballë problemeve thelbësore në përkthimin ligjor. Kështu, sythi 2.6 trajton çështjen e formimit ideal të përkthyesit ligjor. Sythi 2.7 përshkruan qasjet për të interpretuar kuptimin e tekstit origjinal. Sythi 2.8 merret me dykuptimësinë e teksteve ligjore dhe ofron mendime se si ta trajtojmë atë. Së fundi, sythi 2.9 përmban një përshkrim të metodave teknike të përkthimit.

2.2. Qasje pragmatike në përkthimin juridik

Siç vërejtëm në kreun e parë, gjuhësia ka përbërë prej kohësh shkencën që studionte dukuritë e përfshira në fushën e përkthimit. Ajo ishte, pra, burimi i udhëzimeve që ne duhej të ndiqnim për të arritur një "përkthim të mirë". Përkthimologjia lindi si një reagim kundër këtyre udhëzimeve të konsideruara si monolitike dhe të pamjaftueshme. Kjo shkencë e re dhe arti i përkthimit janë të bazuara në disa disiplina për të zgjeruar, midis të tjerash, mundësitë e analizës në procesin e përkthimit.

Pragmatika ndihmon për të analizuar komunikimin nga perspektiva e kodit gjuhësor por, gjithashtu, dhe sidomos, në funksion të përdoruesit të gjuhës dhe të përdorimit që ai i bën. Analiza pragmatike mbështetet në parimin që përdoruesit e gjuhës

nuk veprojnë në një boshllëk, por në një situatë ose kontekst të veçantë. Ai që shkruan një tekst, për shembull, e shkruan me një qëllim, por ky qëllim mund të jetë i ndryshëm nga ai që do të shfaqet në tekst. Gjërat që janë thënë, shkruar ose sugjeruar, janë përcaktuar jo vetëm nga konteksti, por edhe nga kultura në të cilën jetojmë.⁷⁹ Një fjalë mund të jetë mbajtëse e ngjyimeve të ndryshme, në varësi të kontekstit kulturor në të cilin është kumtuar ose shkruar.

Analiza e situatës, e propozuar nga House-i⁸⁰, është mbështetur në parimin se disa elemente jo-gjuhësore pasqyrohen në forma gjuhësore. Kjo analizë, siç përmendet më sipër, merr parasysh dy dimensione, përkatësisht: dimensionin që mban parasysh përdoruesin e gjuhës dhe atë që mban parasysh përdorimin e gjuhës si të tillë.

Dimensioni i parë, ose ndryshe analiza e përdoruesit, merr parasysh elemente si: origjina gjeografike e fjalëve, klasa shoqërore e dhënësit si dhe koha kur teksti është shkruar. Analiza e prejardhjes gjeografike mund të zbulojë variacionet e fjalëve brenda një gjuhe. Analiza e klasës shoqërore, nga ana e saj, hedh dritë mbi vendin e përdoruesit të gjuhës në shoqëri dhe, rrjedhimisht, mbi regjistrin e përdorur. Analiza e dimensionit kohor të tekstit bën të mundur identifikimin e prejardhjes kohore.

Lidhur me përdorimin e analizës së gjuhës, mund të themi se ajo mbështetet te nocionet e *mediumit*, të pjesëmarrjes dhe të rolit social apo në qëndrimin ndaj përdorimit të gjuhës. *Mediumi*, në këtë rast, i referohet ligjërit me gojë ose me shkrim; termi *pjesëmarrje* përdoret për të dalluar dialogun nga monologu. Madhësia e rolit social apo e qëndrimit përdoret për të përcaktuar llojin e raportit të synuar, për shembull, një komunikim mes të barabartëve ose komunikimi midis eprorëve dhe vartësve.

Qasja pragmatike zë një vend të madh në përkthimin juridik, sepse elementet që i nënshtrohen studimit të pragmatikës kanë një ndikim të rëndësishëm në mjedisin juridik. Faqet në vijim përmbajnë një përshkrim dhe analizë të elementeve më të rëndësishëm që hyjnë në lojë në përkthimin juridik. Siç u vu re në hyrjen e përgjithshme, diversiteti i të Drejtave, gjuha e së Drejtës, dimensionin kulturor i së Drejtës si dhe korniza në të cilën

⁷⁹Disa teoricienë si Leo Hickey dhe Paul Kussmaul-i njohin kontributin e pragmatikës në procesin e interpretimit apo të kuptimit të teksteve para se të jenë përkthyer. Paul Kussmaul-i u bën një përshkrim të qartë dhe lakonik këtyre kontributeve. Përshkrimi i qasjes pragmatike, i paraqitur këtu, është nxjerrë krejtësisht nga vepra e tij *Training the Translator*, Amsterdam, John Benjamins, 1995, fq. 55-60.

⁸⁰Krahaso Juliane House, *A Model for Translation Quality Assessment*, Tübingen, Narr, 1977, cituar nga Kussmaul në veprën *Training the Translator*, 1995, fq. 56.

praktikohet ligji janë të gjitha elemente që e bëjnë një përkthim juridik një nga përkthimet e specialitetit më të ndërlukuara. Së fundi, ata përbëjnë, gjithashtu, elementet e një analize *par excellence* të pragmatikës, prej nga buron rëndësia e prurjeve të kësaj disipline në përkthimin e përgjithshëm dhe përkthimin ligjor në veçanti.

2.3. Baza epistemologjike e përkthimit juridik

Janë të shumtë teoricienët që kanë ndihmuar në zhvillimin e anës teorike dhe praktike të përkthimit ligjor, duke trajtuar çështje të ndryshme ose aspekte të saj. Midis tyre, ka shumë juristë, përkthyes, gjuhëtarë dhe juristë-gjuhëtarë. Problemet që ata trajtojnë, si edhe metoda e tyre, shpesh pasqyrojnë një shqetësim që ka lidhje të drejtpërdrejtë me formimin e tyre ose me fushën e veprimtarisë së tyre.

Hartimi i anës teorike dhe praktike të përkthimit juridik ka përfituar nga punimet shkencore të kryera, ndër të tjera, në Evropë dhe Kanada. Mes teoricienëve evropianë, vlen të përmendet Gerard-René de Groot, jurist i së drejtës krahasuese në Universitetin e Limburgut, Mاستrihtit, (Holandë), i cili mbështet pikëpamjen e së drejtës krahasuese dhe paralajmëron për vështirësitë dhe sfidat që vijnë nga përkthimi i dokumenteve ligjorë me burim nga tradita të ndryshme juridike; Sacco Rodolfo, profesor në Universitetin e Torinos (Itali), i cili tregon për bashkëpraninë e dy gjuhëve juridike në një gjuhë të vetme, si dhe praninë e figurave retorike në ligjërimin juridik; Gérard Cornu-ja, Profesor në Universitetin e së Drejtës, të Ekonomisë dhe të Shkencave Sociale në Paris II si dhe Jean-Louis Sourieux, profesor në Universitetin e Orleanit (Francë), i cili përqendrohet në gjuhësinë ligjore; Pjer Lerat-i, profesor i asociuar i gramatikës në Universitetin Paris XIII, i interesuar për aspekte të ndryshme të gjuhëve të specialitetit.

Në Kanada, në mes tjerash, Emmanuel Didier-i, avokat në Gjykatën e Lartë në Kebek dhe Nju Jork, që përqendrohet në mënyrat e shprehjes të së Drejtës zakonore dhe të së Drejtës civile, në anglishte dhe frëngjishte; Michel Sparer-i, që përqendrohet, në veçanti, në dimensionin kulturor të përkthimit juridik dhe të të mësuarit të tij, dhe, natyrisht, Jean-Claude Gémar-i, i cili, pasi i ka dedikuar jetën mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore në fushën e përkthimit ligjor në Kanada, ka arritur që të analizojë përkthimin ligjor në aspektet e tij më të ndryshme. Punimet e Gémar-it, sidomos tipologjia e tij lidhur me problemet e përkthimit juridik, udhëheqin këtë studim.

Tipologjia që Gémar-i përpunoi në vitin 1979 dhe shumica e artikujve që ai ka shkruar gjatë gjithë karrierës, u ripunuan dhe u botuan në vitin 1995 në një punim dy-

vëllimësh të titulluar “*Traduire ou l’art d’interpréter*” (Të përkthesh, ose arti i përkthimit me gojë”). Dëshira për të futur referenca të kohëve të fundit kanë sugjeruar zgjedhjen e kësaj vepre. Megjithatë, thelbi është tipologjia e botuar në vitin 1979. Në një korrespondencë personale, Gémar-i thotë se vepra e vitit 1995 është më tepër për juristët dhe juristë-gjuhëtarët sesa për përkthyesët. Përveç kësaj, tipologjia e re përfshin një pikë, në lidhje me pasojat ligjore të ekuivalencës e cila, sipas tij, ka të bëjë më tepër me juristët sesa me përkthyesët. Duhet të theksohet gjithashtu se tipologjia e vitin 1979 është shumë më e hollësishme se ajo e vitit 1995, çka shpjegon se pse ai e zgjodhi për këtë analizë.

Vështirësitë e përkthimit juridik, sipas Gémar-it, lidhen rrënjësisht me karakterin shtrëngues të tekstit juridik. Ky karakter është caktuar nga norma juridike. Jeta në shoqëri udhëhiqet nga norma juridike që imponojnë detyrime, dmth kufizime, dhe, si rrjedhim, sanksione. Të përkthesh tekste juridike do të thotë të njohësh elemente juridike dhe gjuhësore që kanë formuar standardin ligjor dhe t’i “përkthesh” në një gjuhë dhe në një kulturë tjetër⁸¹. Ja, pra, një punë e cila i lë përkthyesit një liri veprimi shumë të kufizuar, përse u përket zgjedhjeve të burimeve gjuhësore.

Elementet e analizës së tipologjisë së Gémar-it janë: karakteri normativ ose detyrues i tekstit juridik, ligjërimi (ose gjuha) në fushën e së Drejtës, diversiteti social dhe politik i sistemeve ligjore, problemi i dokumentacionit juridik dhe qasja shumëdisiplinore e përkthimit ligjor.

Faqet në vijim përmbajnë një analizë të këtyre pesë elementeve. I pari ka të bëjë me natyrën e së drejtës dhe kufizimin e saj. I dyti përmban karakteristikat e përgjithshme dhe të veçanta të gjuhës ligjore. Elementi i tretë ka të bëjë me diversitetin e sistemeve juridike. Analiza e këtij zëri përfshin një përshkrim të dy familjeve të së drejtës, të përdorura në këtë studim, më konkretisht *e drejta romake* dhe *common law*. Elementi i katërt, ndërkohë, përqendrohet në probleme me burime bibliografike që mbështesin përkthimin dhe te përdorimi si dhe shkalla e përdorimit me efikasitet i këtyre burimeve. Elementi i pestë, në fund, ka të bëjë me natyrën shumëdisiplinore të së Drejtës dhe efektin e saj mbi aftësitë e përkthyesit.

2.3.1. Karakteri normativ ose detyrues i tekstit juridik

⁸¹Shih Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique et son enseignement*, Meta, 1979, fq. 38.

Gémar-i është një nga teoricienët e rrallë që i jep një vend të rëndësishëm këtij aspekti të përkthimit që kufizon, në pjesën më të madhe, zgjedhjen e burimeve gjuhësore, të cilat përkthyesi duhet t'i ketë për të kryer detyrën e tij. Ai nënvizon referencën e shkurtër që citojnë Vinay dhe Darbelnet⁸² në rubrikën *servitude et option*. Por këta dy teoricienë i referohen havaleve që gjuha i imponon përkthyesit, për shembull, gjinia e fjalëve, zgjedhimi i foljeve, etj. Karakteri detyrues i tekstit juridik për të cilin flet Gémar-i, i referohet më tepër një vendimi të kthyer nga ligjvënësi, i cili është pasqyruar te rregulli i vendosur nga ligji, kushtetuta, etj. Përkthyesi nuk mund të zëvendësojë, për shembull, një term me një tjetër, madje edhe nëse e konsideron më të përshtatshme, pa rrezikuar të shkelë atë që ka qenë e vendosur nga drejtësia. Ja se si e përshkruan Gémar-i këtë tipar të veçantë të gjuhës ligjore.

Karakterit normativ i së Drejtës buron kryesisht nga legjislacioni dhe nga jurisprudenca, të cilat i japin ligjit vlefshmërinë e tij, pra efikasitetin dhe natyrën e domosdoshme të tij, kushte pa të cilat ne nuk mund të flasim për normë juridike.⁸³

Në këtë pikë, Michel Sparer-i kujton se "*teksti ligjor është hartuar kryesisht për të detyruar apo nxitur sjellje. Ligji, për shembull, vëren ai, është menduar para së gjithash për të dhënë të drejta ose detyrime*"⁸⁴.

Le të marrim për shembull termat 'konventë', 'marrëveshje' dhe 'traktat'. Konventa e Vjenës për Ligjin e traktateve (nënshkruar në Vjenë më 23 maj 1969 dhe hyrë në fuqi në 27 janar 1987) parashikon në Nenin 2 (1) (a), se termi "traktat" do të thotë "një marrëveshje ndërkombëtare në formë të shkruar, mes shteteve dhe e udhëhequr nga e drejta ndërkombëtare, që është përcaktuar për një mjet të vetëm ose për dy ose më shumë mjete të lidhura, dhe çfarëdo qoftë emërtimi i saj i veçantë." ⁸⁵. Neni 2 (1) (a), në anglishte, lexohet si vijon: "« 'treaty' means an international agreement concluded between States in written form and governed by international law, whether embodied in a single instrument or in two or more related instruments and whatever its particular designation »." ^{86*}

⁸²Krahaso J. P. Vinay, et J. Darbelnet, *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, 1958, fq. 31.

⁸³Jean-Claude Gémar, *Le traducteur et la documentation juridique*, Meta, vol. 25, nr 1, mars 1980, fq. 137.

⁸⁴Komunikimi mbi karakteristikat dhe sfidat e përkthimit ligjor dhe mbi mjetet për ta mësuar në mënyrë ideale. Ky komunikim është bërë nga Sparer-i në mars 1999 pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Gjuhësisë dhe Përkthimit në Universitetin Laval, Fletor gjuhësore fq. 7.

⁸⁵Confederatio Helvetica, *La Convention de Vienne du 23 mai 1960 sur la loi des Traités*: <http://www.admin.ch/ch/f/rs/c0_111.html>.

⁸⁶Treaties and International Law, Internet Law Library, *The Vienna Convention on the Law of Treaties*: <gopher://gopher.law.cornell.edu/00/foreign/fletcher/treaties.txt>.

Vëmë re se në rastin e ALENA-s flitet për “accord” në frëngjishte, për “tratado” në spanjishte dhe për “agreement” në anglishte (‘marrëveshje’ në shqipe). Alonso Gómez-Robledo Verduzco, jurist meksikan, saktëson se zgjedhja e termit në Shtetet e Bashkuara dhe në Meksikë varet nga procesi juridik i këtyre vendeve, përse i përket përfundimit të këtij tipi negociatash. Në Shtetet e Bashkuara, sipas tij, Kushtetuta Federale e vitit 1787, parashikon në nenin II, Sythi 2, paragrafi 2, që presidenti ka fuqinë për të nënshkruar traktate në qoftë se ai ka njoftimin dhe pëlqimin e dy të tretave të Senatit. Me kalimin e kohës, shton ai, pushteti ekzekutiv, nga vetë Presidenti, ka fituar të drejta më të rëndësishme nga sa i dha Kushtetuta. Marrëveshjet e arritura nga Presidenti tani quhen *Executive Agreements*. Gómez-Robledo Verduzco dallon tri lloje marrëveshjesh: marrëveshje të përfunduara mbi bazën e një marrëveshjeje ekzistuese, *Congressional Executive Agreements*, përfundimi i të cilave duhet të miratohet nga Kongresi; dhe *Sole Executive Agreements*, të nënshkruara nga Presidenti duke u bazuar mbi të drejtat që u jep Kushtetuta. ALENA është një *Congressional Executive Agreements*. Në Meksikë, termi *tratado* është i përcaktuar në nenin 133 të Kushtetutës së këtij vendi. *Tratados internacionales* zënë në këtë shtet vendin e tretë përse u përket ligjeve që mund të drejtojnë këtë vend, apo *leyes supremes de la Federación*.⁸⁷

Siç do vërejmë në paragrafët vijues, gjuha e drejtësisë u nënshtrohet disa kushteve të caktuara, në mënyrë që të arrijë qëllimin e duhur nëpërmjet normës së të drejtës.

2.3.2. Gjuha e së Drejtës

Për të shmangur një debat përtej qëllimit të këtij studimi, le të saktësojmë fillimisht se termi *gjuhë e së Drejtës* është përdorur këtu në kuptimin që i kanë dhënë Sourieux-i dhe Lerat-i⁸⁸, në kuptimin e gjuhës ose *mënyrës së veçantë të të shprehurit*. Ne e dimë se hollë – hollë nuk ka gjuhë të së Drejtës, të paktën në gjuhën e përditshme.

*“Traktati përfaqëson një marrëveshje ndërkombëtare midis vendeve në formë të shkruar dhe të udhëhequr nga ligjet ndërkombëtare i përfshirë në një apo dy instrumente apo edhe në më shumë, pavarësisht emërimit të tij”.

⁸⁷Alonso Gómez-Robledo Verduzco, *Aproximaciones al marco jurídico internacional del Tratado de Libre Comercio. El Tratado de Libre Comercio de América del Norte. Análisis, Diagnóstico y propuestas jurídicas*, bërë nën përgjegjësinë e Jorge Witker, vol. 1, México, Universidad Autónoma de México, 1993, fq. 55-78.

⁸⁸J.-L. Sourieux et Pierre Lerat, *Le langage du droit*, Paris, P.U.F., 1975, Introduction.

Megjithatë, juristët, si dhe specialistë të tjerë, si fizikantët ose matematicinët, shpesh flasin për një gjuhë të ligjërimit, për dialekte sociale, madje edhe për "teknolekte"⁸⁹.

Përcaktimi i gjuhës së të Drejtës, si një mënyrë e veçantë e të shprehurit, nënkupton se ajo përmban elemente të gjuhës së përditshme dhe elementet që janë të huaja për të. Ky kombinim i elementëve është ajo që Souriouxi dhe Lerati quajnë *karakter heterogjen* i gjuhës ligjore. Dhe, siç thonë ata, " është pikërisht ky karakter heterogjen që shpjegon pjesërisht këtë paradoks: E Drejta është një dukuri sociale, si edhe gjuha në vetvete, dhe që ngjall një ndjenjë të çuditshme të shumica"⁹⁰.

Gjuha është mjeti nëpërmjet të cilit e Drejta shpreh normën juridike. Për të shprehur normën, në mënyrë që ajo të respektohet dhe ndiqet, e Drejta i dorëzon mjetin e vet të të shprehurit në një seri masash, si në planin e brendshëm (sintaksë, semantikë, stilistikë dhe leksik) ashtu edhe në të jashtëm (organizimi dhe struktura e gjuhës).

2.3.2.1. Karakteristika të përgjithshme

Në këtë studim, termi *gjuhë e së Drejtës* pëlqehet më shumë se sa *dialekt social* dhe *teknolekt*, sepse gjuha e së Drejtës përmban në vetvete më shumë se një bateri termash teknike, të përdorura për të përshkruar objekte ose nocione. E Drejta përdor një ligjërimit, elemente sintaksorë, leksikorë, stilistikorë dhe semantikë, të cilët duhen përdorur në rrethana mjaft të sakta. Këto janë elemente gjuhësorë që janë të vështirë për t'u ndarë në njësi, por që shkenca gjuhësore i ndan vetëm për qëllime analize.

Le të saktësojmë, gjithashtu, se termi gjuhë e së Drejtës është përdorur këtu si një term përmbledhës, sepse nën-fusha të ndryshme, degë të së Drejtës, kanë karakteristika leksikore, sintaksore, semantike dhe stilistike të tyre. Një nen i ligjit, për shembull, ka karakteristika të ndryshme gjuhësore nga ato të një kontrate ose traktati ndërkombëtar. Megjithatë, teksti ligjor ka veçori që e dallojnë nga tekstet e disiplinave apo degëve të tjera të dijes.

Një nga karakteristikat e spikatura të përkthimit ligjor buron nga marrëdhëniet e ngushta që e Drejta mban me gjuhën që e drejton. Shumë teoricienë që njohin gjuhën e së Drejtës i japin kësaj lidhjeje një karakter mjaft të veçantë. Gémar-i, për shembull, e

⁸⁹Claude Hagège, *L'homme de parole*, 1985, fq. 191, cituar nga Gémar në *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995, fq. 84.

⁹⁰J-L Souriouxi et Pierre Lerat, *Le langage du droit*, 1975, Introduction.

përshkruan këtë marrëdhënie të paqartë dhe kaotike⁹¹. Mbiemri “kaotike” nuk cilëson gjuhën e së Drejtës, por natyrën ambivalente (të dyfishtë) të marrëdhënieve mes së Drejtës dhe mjetit të saj shprehës. Ai i referohet faktit se e Drejta “laton” me kujdes ligjërimin për të shprehur normën, dhe vështirësia është shpesh rezultat i interpretimit të kuptimit të mbartur nga kjo.

David Mellinkoff-i, jurist amerikan, analizon njëzet e dy karakteristikat e gjuhës ligjore në gjuhën angleze, dhe e percepton si një gjuhë që është e mbushur me plot pasaktësi. Mellinkoff-i e cilëson gjuhën e së Drejtës si *wordy* (e gjatë), *unclear* (e paqartë), *pompous* (enfatike) dhe *dull* (e mërzitshme)⁹². Rezultati, vëren ai, është një gjuhë e vështirë për t’i kapur kuptimin, jo vetëm për profanin, por gjithashtu edhe për ithtarin.

Nëse gjuha ligjore, siç sapo u përshkrua, ka mbrojtësit e vet, ajo ka gjithashtu edhe rebelët e saj, të cilët propozojnë thjeshtëzimin e saj. Mbështetësit e teorisë së thjeshtëzimit të së Drejtës, nisën edhe një lëvizje të quajtur *Plain Langage* ose *Plain English*.⁹³

2.3.2.2. Karakteristika leksikore

Plani leksikor i gjuhës së të Drejtës paraqet një shkallë të lartë vështirësie për përkthyesin. Nomenklatura e së Drejtës dallohet nga karakteri i pasigurtë që buron, sipas Gémer-it⁹⁴, nga karakteri i paqartë i koncepteve të saj.

Terminologjia juridike karakterizohet gjithashtu edhe nga një polisemi (shumëkuptimësi) e gjerë. Ky tipar i gjuhës ligjore u bindet arsyeve historike, domethënë, zhvillimit të së Drejtës në kohë, institucioneve dhe individëve të cilët kanë ndihmuar për

⁹¹Jean-Claude Gémar, *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995, fq. 10. Mbiemri *kaotik* duket sikur tregon çrregull, çka nuk është aspak rasti në lëmin juridik.

⁹²Shih David Mellinkoff, *The Language of the Law*, Boston, Little, Brown and Company 1963, fq. 3-29.

⁹³Shih Lawrence M. Solan, *The Language of Judges*, Chicago, University of Chicago Press, 1993, 218 fq.; Clark D. Cunningham, Judith N. Levi et al, *Plain Meaning and Hard Cases*, The Yale Law Journal, vol. 103, nr. 1533, 1994, fq. 1561-1625; dhe Judith N. Levi and Anne Graffam Walker (ed.), *Language in the Judicial Process*, New York, Plenum Press, 1990, 373 fq. Këshilli kanadez i dokumentacionit ligjor vendosi në vitin 1990 Plain Language Center, misioni i së cilës është pikërisht për t’u përqendruar te çështja *Plain English*. Një lëvizje e ngjashme u ndërrmor në Kebek me qëllimin për të thjeshtuar gjuhën në lëmin e së Drejtës në gjuhën frënge duke kufizuar, mes të tjerash, numrin e shprehjeve me origjinë latine. Banka terminologjike *Termium* identifikon termin *gjuhë e qartë* si barasvlerës të termit *plain language*.

⁹⁴Veçoritë leksikore, stilistike dhe sintaksore të paraqitura këtu janë marrë, në pjesën më të madhe, nga vepra e Gémar-it *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995 b, fq. 95-115.

ta modeluar. E Drejta pasqyron nevojat e një shoqërie në kohë, si rrjedhim, kuptimi i termave mund të ndryshojë sipas kontekstit dhe epokave.

Studimi diakronik i gjuhës ligjore tregon se pasuria dhe diversiteti i saj pasqyrojnë nevojat e një epoke dhe burimet e shumta të përdorura për të përmbushur këto nevoja. Gjuha e së Drejtës është një dukuri sociale, ajo është e shënuar nga ngjarje që kanë ndikuar shoqërinë në një kohë të veçantë të historisë së saj.

Gjuha ligjore është gjuhë shumë e lashtë dhe ajo ende mban trashëgiminë e gjuhëve terminologjike si të latinishtes dhe greqishtes së vjetër. Shprehjet dhe termat latine, për shembull, janë pjesë e gjuhës ligjore në shumë prej gjuhëve të sotme moderne: *constitution* (fr.), *costituzione* (it.), *costitucion* (sp.); *législature* (fr.), *legislatura* (it.), *legislatura* (sp.); *régime* (fr.), *regime* (it.), *regime* (sp.); *acte* (fr.), *atto* (it.), *acto* (sp.) etj.

Është e rëndësishme të theksohet, megjithatë, se fjalët evoluojnë në kontekstin e tyre të ri dhe se këto ndryshime mund të sjellin ndryshime kuptimore në lidhje me gjuhën e origjinës. Kështu, termi latin *statum* ka evoluar në gjuhën angleze në formë të termit *status*, si në formën e tij më të thjeshtë edhe në shprehjen *status quo*, ndërsa në frëngjishte, i njëjti term nga *statut* është bërë në formën e tij më të thjeshtë *statu* (pa " t ") në shprehjen *statu quo*. Lidhur me evolucionin e fjalëve, Didier-i thekson se "*Kur fjalët u ç'rrënjosen dhe u transferuan nga një gjuhë në një tjetër, nga një vend në tjetrin, ato u vendosën në një strukturë gjuhësore dhe sociale të re, duke i bërë ato autonome në raport me gjuhët - nëna nga të cilat vijnë*".⁹⁵

Gjuha ligjore merr shumë fjalë e terma nga gjuha e përgjithshme. Dhe kjo është një nga vështirësitë kryesore të kësaj gjuhe të specializuar: termat e gjuhës së përditshme mund të kenë një kuptim të ndryshëm në një kontekst të veçantë. Ky diversitet paraqet vështirësi të mëdha për të mos u regjistruar në tërësinë e tij në leksikun e ndryshëm dhe në fjalorë të specializuar. Këto vepra nuk përfshijnë shpesh nomenklaturën e së Drejtës ose termat e fushës së vet, dhe përjashtojnë termat e gjuhës së përditshme të cilat, duke fituar një kuptim të veçantë, i shpëtojnë rishtarit.

Darbelnet-i dallon nomenklaturën e së Drejtës dhe fjalorin mbështetës të së Drejtës. Nomenklatura përfshin termat që i përkasin një teme. Kjo është ajo që Souriou-x-i dhe Lerat-i i quajnë fjalët - bazë. Fjalori mbështetës përfshin fjalë me kuptime teknike të ulëta ose zero, të cilat shërbejnë për të aktualizuar fjalët e specializuara dhe për t'i dhënë

⁹⁵Emmanuel Didier, *Langues et langages du droit*, Montréal, Wilson et Lafleur, 1990, fq. 3.

tekstit një organizim. Me pak fjalë, ata janë fjalët e zakonshme ose të gjuhës së përbashkët që kanë një kuptimin teknik dhe që Darbelnet-i i quan edhe *fjalor para- teknik*. Ai shpreh keqardhjen që këto terma nuk janë të përfshira në përgjithësi në leksikon juridik. Ja se ç'vërejtje bën ai lidhur me këtë temë: Nëse duhet këmbëngulur për ekzistencën e një fjalori mbështetës, kjo duhet bërë për shkak se rëndësia e tij është e dukshme në inventarët e specializuar për termat teknikë. Duke shfletuar repertorët e gjuhës ligjore, si për shembull *le Lexis de termes juridiques* (*Leksiku i termave juridikë*), konstatojmë se numri i termave të përdorura në hartimin e teksteve ligjore dhe administrative, [...] nuk janë mbajtur parasys. Është e vërtetë se në përgjithësi repertorët synojnë më tepër të kuptuarit se sa hartimin e tyre. Kjo është arsyeja pse ka fjalë të tilla si *syndic* (*këshilltar ligjor*), *réclusion* (*burgim*), *parafiscalité* (*kuotizacion, kontribut i detyruar*), apo edhe *défendeur* (*i pandehur*), *inculpé* (*i paditur*), *prévenu* (*i pandehur*), dhe *accusé* (*i akuzuar*), por, le ta themi kalimthi, përkthyesit e betuar nuk tregojnë marrëdhëniet që kanë mes tyre këto katër terma. Kuptimi i këtyre fjalëve është i lehtë për t'u identifikuar dhe vendi që u jepet atyre shpjegon padyshim përfshirjen e tyre. Megjithatë ne nuk mund ndeshim te të njëjtët repertorë fjalë mbështetëse, të tilla si *intenter* (*padis*), *entendre* (*dëgjoj një dëshmitar*), *exorbiter* (*dal*), *dépérir* (*vdes*), *supporter* (*mbështet në kuptimin tatimor, fiskal*).⁹⁶

Darbelnet-i sugjeron që fjalori mbështetës në gjuhën ligjore duhet të regjistrohej në fjalorët e specializuar, ashtu si termat teknike. Atë që ai e quan fjalor mbështetës është analizuar nga teoricienë të tjerë si bashkësi elementesh në gjuhën ligjore ose ndryshe si organizim i tekstit ligjor. Këto bashkësi elementesh nxjerrin si problem faktin që nuk mund të identifikohen në ndonjë vepër, cilado qoftë ajo. Darbelnet-i tregon, gjithashtu, se vështirësia e gjuhës ligjore nuk është vetëm çështje terminologjie, por edhe lidhje e organizim fjalësh, sipas një skeme të paracaktuar. Terminologjia dhe lidhja e fjalëve përbëjnë pra dy pjesët e ligjërit me rëndësi të barabartë për kuptimin e mesazhit. Kuptimi që përcjellin fjalët e tekstit, sado të zgjedhura qofshin, nuk do të ndodhë në qoftë se ato fjalë nuk janë të rregulluara në njëfarë mënyre.

2.3.2.3. Karakteristikat stilistikore

Stili ose mënyra për të shprehur një fjalim ka gjithashtu një qëllim apo arsye për të qenë. Ligjëruesi përzgjedh mënyrën e të thënit, në varësi të llojit të mesazhit që do të përcjellë ose sipas efektit që kërkon të prodhojë te bashkëbiseduesi i tij. Qëllimi është,

⁹⁶Jean Darbelnet, *Réflexions sur le discours juridique*, Meta, vol. 24, nr. 1, mars 1979, fq. 27.

natyrisht, për të përcjellë një mesazh, por ky mesazh do të ketë një efekt pak a shumë të rëndësishëm në varësi të stilit që përshtatet pak a shumë mirë me llojin e mesazhit që do të përçohet.

Tekstet normative, për shembull, kanë ton solemn. Në këtë lloj teksti, është Shteti ai që flet, dhe qëllimi është që të respektohet norma që organizon jetën shoqërore. Sigurisht, poshtë normës, gjenden parimet e legjitimitetit që justifikojnë sistemin juridik dhe që e bëjnë atë të përshtatshëm për bindje. Kjo është ajo që Friedman⁹⁷ e quan *tipar kulturor*, domethënë, qëndrimi dhe opinionimi i individëve kundrejt sistemit juridik në fuqi.

2.3.2.4. Karakteristikat sintaksore

Gjuha juridike paraqet karakteristika sintaksore që e dallojnë lehtë nga gjuha e fushave të tjera. Ajo përdor të njëjtat rregulla sintaksore⁹⁸ si gjuha e zakonshme. Nuk ka sintaksë të veçantë ose një gramatikë të gjuhës juridike. Megjithatë, kjo gjuhë, ashtu si poezia, ka struktura sintaksore që e bëjnë të dallohet lehtë nga gjuha e zakonshme dhe nga gjuhët e tjera të specialitetit. Karakteristikat në vijim⁹⁹ zbatohen sidomos për tekstet normative si për nenet e ligjit, rregulloret, aktet dhe vendimet gjyqësore.

2.3.2.5. Vendi i foljes

Në gjuhën angleze, përgjithësisht, folja vendoset pas kryefjalës, pra kemi strukturën Kryefjalë – Kallëzues – Kundrinor, pasi anglishtja është gjuhë me rend të ngulitur:

- a. John is very nice.
- b. John is over there.
- c. John is at home.

⁹⁷Krahaso Lawrence Friedman, *Is there a Modern Legal Culture?*, Ratio Juris, vol. 7, nr. 2, Korrik, 1994, fq. 123.

⁹⁸Ashtu si Gémar-i, termat *gramatikë* dhe *sintaksë* janë konsideruar këtu si diçka që është e detyrueshme në komunikim me gojë ose me shkrim, dhe besojmë se përmbajnë njëri - tjetri. Kjo shpjegon se vetëm karakteristikat sintaksore të ligjit janë analizuar.

⁹⁹Siç vërehet më sipër, karakteristikat specifike të gjuhës së të Drejtës të paraqitura këtu janë marrë nga Gémar-i. Shembujt që paraqiten në katër paragrafët vijues gjenden në faqet 112-114 të veprës së tij *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995b.

- c. *John works hard.*
- d. *Jim had a bad cold last week.*
- dh. *Jim is watching TV with his mother.*
- e. *I will cook the dinner for you.*
- ë. *She sent a letter to John.*
- f. *He hit the ball with his hand.*
- g. *They finished their homework quickly.*

Me foljet e përbëra, shpesh ndajfolja pozicionohet midis foljes ndihmëse dhe foljes kryesore:

- a. *She is still typing the letter.*
- b. *They will never get there on time.*
- c. *They have always been punctual.*

Folja i paravendoset kryefjalës, në fjalitë pyetëse:

- a. *Are they sure?*
- b. *Is she at home?*

Kur folja është e përbërë, kryefjala pozicionohet midis foljes ndihmëse dhe foljes kryesore:

- a. *What are you doing now?*
- b. *Is she watching TV?*

Në gjuhën frënge folja mund të paravendoset - si në shembullin : *est décrété bien public* (është dekretuar një e mirë publike) [...] apo edhe të pasvendoset - si në shembullin: *le conseil, statuant à l'unanimité, sur proposition [...] adopto...* (Këshilli, duke vepruar njëzëri, me propozimin e ... miraton .

Gjuha shqipe, që njihet si gjuhë me rend më të lirë krahasuar me anglishten, pozicioni i foljes mund të ndryshojë, duke u vendosur në fillim, në mes apo edhe në fund të fjalisë, edhe pse shqipja, ashtu si pjesa më e madhe e gjuhëve ka strukturën Kryefjalë – Kallëzues – Kundrinorë.

- a. *Djali shikon televizor.*
- b. *Lodhet babai tërë ditën në punë.*
- c. *Gjithë natën kanë ecur.*

2.3.2.6. Rendi i fjalive

Në anglishte, rendi i fjalive me nënrenditje mund të ndjekë skemën fjali kryesore – fjali të varuara, si për shembull: *The conditions of service of local government employees shall be such as to permit the recruitment of high-quality staff on the basis of merit and competence*; (Tekst 2, kapitulli IV). Por, ka raste, kur fjalia mund të fillojë jo me fjalinë kryesore, si për shembull: *...to this end adequate training opportunities, remuneration and career prospects shall be provided* (Tekst 2, kapitulli IV). Në frëngjishte, në gjykimet, për shembull, është e zakonshme të gjenden fjali që fillojnë me lokucione lidhëzore të tilla si *Vu que (duke parë që/se), entendu que (Duke qenë se...)* dhe ndiqen nga një fjali lidhore që i paraprin fjalisë kryesore.

2.3.2.7. Gjatësia e fjalive

Në shumicën e gjuhëve, gjatësia e fjalive të teksteve ligjore dhe të kontratave është e konsiderueshme. Siç vëren Gémar-i, nuk bëhet fjalë për një tipar stilistikor të redaktorit, por për rezultatin e një numërimi (renditje faktesh). Gjatësia e fjalive kontribuon në masë të madhe në fjalëteprinë, tepriçë që karakterizon gjuhën juridike. Edhe një herë, nuk bëhet fjalë për një proces stili, por për rezultatin e shqetësimit shterues.

2.3.2.8. Përdorimi i fjalive në diatezën pësore

Diateza pësore është përdorur gjerësisht, si në anglishte, në frëngjishte edhe në spanjishte. Përdorimi i fjalive në pësore në tekstet juridike si në rregulloret, aktet dhe gjykimet, u jep këtyre të fundit një ton asnjës, objektiv dhe formal, madje solemn. Qëllimi, siç deklaroi Gémar-i, është dinjiteti i tekstit normativ, ku ne shmangim me kujdes përdorimin e një gjuhë banale apo të shprehjeve familjare. Për shembull: *On the basis of what and by whom is it decided whether a case is an urgent case qualifying for direct contact between local authorities* (Tekst 6, kapitulli IV); *Videolink testimony is provided in Article 20* (Tekst 8, kapitulli IV). Në frëngjishte, përemri *il (ai)* parapëlqehet më shumë nga përemri vetor i pacaktuar *on*. Prandaj, fjalia *Il est convenu / décidé (Është rënë dakord / vendosur)* është më e pëlqyer nga fjalia *On a convenu / décidé (U ra dakord / vendos)*.

2.3.2.9. Karakteristikat semantike

Çdo element që përbën gjuhën e së Drejtës ka qenë analizuar me kujdes para përdorimit të tij, madje kuptimi i tij është ngulitur në një fushë ose nën-fushë të së Drejtës dhe është i lidhur me një rast të veçantë.

Në të vërtetë, një term mund të përdoret nga të gjithë përdoruesit e së Drejtës në një kuptim, që gjithkush e kupton ose beson se e kupton. Megjithatë, kuptimi i termit aktualizohet nga gjyqtarët të cilët fiksojnë kuptimin e termave në një kontekst specifik dhe në një rast të veçantë. Siç u përmend më sipër, kjo është ajo që Gémar-i e quan *karakteri normativ* i gjuhës ligjore. Pjesa e mëposhtme ilustron se si kuptimi i një termi është i nevojshëm në kontekstit në të cilin punon përkthyesi dhe për konsideratat e tij gjuhësore.

Ligji është jashtë kontekstit dhe konsideratave gjuhësore [të përkthyesit]. Mund të kundërshtojmë përdorimin e termit "*corporation (korporatë)*" dhe në vend të tij të parapëlqejmë termin "*société commerciale (shoqëri tregtare)*". Megjithatë, termi i përcaktuar në ligj është ai që gjykatësi, nga respekti për unitetin dhe stabilitetin semantik të nevojshme për funksionimin e duhur të makinës gjyqësore, duhet mbajtur parasys, në fund të fundit.¹⁰⁰

Në citimin e mësipërm, bëhet fjalë për ekuivalencën franceze të termit *business corporation*. Ekuivalenca e tij në Kebek dhe Ontario është *compagnie (kompani)*, në legjislacionin federal, ekuivalenca është *société par actions (shoqëri aksionare)* dhe në New Brunswick, ekuivalenca është *corporation commerciale (korporatë tregtare)*.¹⁰¹

Dhënia e një një kuptimi një fjale të veçantë, në një rast apo në një kontekst të veçantë, i jep shkas një polisemie, e cila mund të çojë në keqpërdorim ose keqinterpretim të termave. Problemi i polisemisë së gjuhës ligjore është një nga sfidat më të vështira për t'u kapërcyer. Ajo është edhe më e vështira për t'u zgjidhur, nëse nuk merret parasys burimi i së drejtës, siç thotë Gémar-i, për të njohur kuptimin e saktë të tekstit juridik në fjalë. Në kuadrin e ALENA-s, për shembull, është e vështirë për të pyetur redaktorët e teksteve juridike, për rishikimin dhe zgjidhjen e konflikteve që kanë një karakter konfidencial. Për më tepër, përdorimi i fjalorit nuk është gjithmonë zgjidhja e problemit, sepse fjalorët nuk identifikojnë të gjitha rastet ose të gjitha kontekstet, ku një term ligjor mund të shfaqen dhe, si rrjedhim, të ketë të gjitha kuptimet e këtij termi.

¹⁰⁰Jean-Claude Gémar, *Le traducteur et la documentation juridique*, Meta, vol. 25, nr 1, mars 1980, fq. 137.

¹⁰¹Ethel Groffier et David Reed, *La lexicographie juridique*, 1990, fq. 79.

Gjuha juridike, si gjuhë specialiteti, ka karakteristika që e bëjnë atë një gjuhë unike dhe të ndërlikuar. Fjalori i tij përfshin shumë terma që vijnë nga gjuha e përditshme dhe terma që nuk mund të ekzistojnë jashtë kuadrit juridik, si dhe një numër të madh termash të huazuara nga gjuhë të tjera apo të trashëguara nga gjuhë të tjera, si latinishtja, për shembull. Gjuha juridike mund të organizojë përbërësit e fjalisë së ligjërimit në një mënyrë të dallueshme (një folje vendoset në fillim apo në fund të një fjalie, fjali të nisura me lokucione parafjalore, të ndjekura nga fjali të varura). Ajo përdor, gjithashtu, një ton solemn që shmang çdo përdorim familjar. Së fundi, gjuha e së Drejtës është njëra nga gjuhët më polisemike, pasi kuptimi i termave të ligjërimit është vendosur në një kontekst të veçantë, në lidhje me një rast të veçantë. Terminologjia për këtë arsye ka një karakter të veçantë, por të pasaktë.

Gémar-i i mvesh gjuhës juridike një karakter ezoterik (i pakuptueshëm) dhe solemn, për shkak të elementeve të tillë si "*naissance en assemblée législative (lindje në asamblenë legjislative); sanction publique, par la justice, de l'infraction commise (sanksion publik, nga gjykata, për shkelje ligjore); celebration du Droit par les ministres du culte que sont les avocats et notares (Kremtimi i së Drejtës nga priftërinj që janë avokatë dhe noterë)*"¹⁰². Për më tepër, ai i mvesh gjuhës së të Drejtës një karakter nismëtar. Profanët e kuptojnë një tekst juridik vetëm kur i janë futur këtij kulti që është Drejtësia, gjuhës së saj, njohjes së institucioneve të saj, mekanizmave dhe mënyrave të funksionimit të saj. Polisemia që karakterizon gjuhën ligjore kontribuon, sipas Gémar-t, për të theksuar misterin që rrethon këtë gjuhë.

2.3.3. Diversiteti i sistemeve juridike

Diversiteti i sistemeve të sotme juridike përbën për Gémar-in "të vetmen vështirësi me të vërtetë të madhe"¹⁰³ të përkthimit ligjor. Drejtësia është zhvilluar nga një shoqëri e veçantë, për vetë atë shoqëri, dhe plotëson kërkesat e njëjta të saj. Përveç kësaj, çdo shoqëri përcakton të drejtën e saj sipas perceptimit që ajo ka dhe sipas tipit të organizimit që dëshiron të ketë. Kjo, është sipas Gémar-it, ajo çka shpjegon ekzistencën e sistemeve të ndryshme juridike.

¹⁰²Jean-Claude Gémar, *Les fondements du droit comme langue de spécialité: Du sens et de la forme du texte juridique*, në *Revue générale du droit*, 1990, fq. 737.

¹⁰³Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique et son enseignement: aspects théoriques et pratiques*, Meta, 1979, fq. 44.

Siç dëftuam në “hyrjen e përgjithshme”, sistemet juridike që na interesojnë këtu janë *common law*-i dhe *le droit civil*. Paragrafët në vijim paraqisin një përshkrim të këtyre dy sistemeve juridike, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e përkthimit. Prandaj, përkthyesi duhet të veprojë si krahasues i së drejtës.

Gerard-René de Groot-i thotë se e Drejta krahasuese është baza e përkthimit ligjor; po kështu, Gémar-i thekson se vështirësia e parë e përkthimit nuk është përcaktuar nga dallimet gjuhësore, por më tepër nga afria e sistemeve ose e traditave juridike ¹⁰⁴.

Në të vërtetë, e Drejta krahasuese analizon sistemet e ndryshme juridike dhe i grupon në familje. Në përgjithësi, grupimi ose klasifikimi i të drejtave në familje kryhet sipas kriterëve të qëllimit dhe ngjashmërisë në substancë dhe në formë të këtyre trupave juridikë. Siç është nënvizuar më herët, gjuha është një kriter i rëndësishëm për klasifikimin e të drejtave sipas famijeve. Kështu, de Groot-i ¹⁰⁵, sipas shembullit të Gémar-it dhe të teoricienëve të tjerë, pohon se përkthimi ligjor është një veprimtari relativisht e lehtë, në qoftë se sistemet juridike dhe gjuhët e përfshira në përkthim janë të afërta. Ky do të jetë rasti për vende të tilla si Danimarka dhe Norvegjia, apo Franca dhe Spanja, të cilat kanë miratuar të drejtën civile si sistem juridik.

Përveç kësaj, përkthimi i teksteve që u përkasin një vendi me gjuhën e një vendi tjetër, sistemi juridik i të cilëve është i ngjashëm, nuk do të duhej të shkaktonte probleme serioze, madje edhe në qoftë se gjuhët në fjalë ngjasojnë pak. Ky do të ishte rasti i përkthimit të dokumenteve nga frëngjishtja në hollandishte. Përkthimi i termave që i përkasin sistemeve të ngjashme juridikë, thotë de Groot-i, nuk paraqet vërtetë problem, sepse ngjyrimet janë paralele. Ky do të ishte rasti i vendeve me më shumë se një gjuhë zyrtare, të tilla si Kanadaja, Belgjika, Zvicra apo Finlanda. Vështirësitë e përkthimit janë më të mëdha, kur përkthehen tekste të sistemeve shumë të ndryshme në gjuhët që janë shumë të ndryshme nga gjuha origjinale.

Së fundi, përkthimi është gjithashtu i vështirë kur bëhet midis sistemeve ligjore jo konverguese, edhe në qoftë se gjuhët janë të afërta. Përkthimi i teksteve nga gjermanishtja në hollandishte është një shembull i kësaj vështirësie. Kurth në të cilin bie përkthyesi, në këtë rast, është ekzistenca e *miqve të rremë* juridikë. Prandaj, mund të arrijmë në përfundimin se sa më shumë sisteme të ndryshme juridike do të hasen, aq më

¹⁰⁴Gérard-René de Groot, *La traduction juridique: The Point of View of a Comparative Lawyer*, Les Cahiers de Droit, vol. 28, nr. 4, dhjetor 1987, fq. 798.

¹⁰⁵Po aty, fq. 798-800.

shumë vështirësi do të kemi gjat përkthimit. Vështirësia e përkthimit në organizatat shumëkombëshe, ose në vende me disa gjuhë zyrtare, është edhe më e lartë.

Common law-i dhe *le droit civil* paraqesin dallime në substancë dhe në formë. Substanca lidhet me atë që ne nuk e shohim, domethënë, me aspektet kulturore të së Drejtës, me rrethanat në të cilat ajo u farkëtua, me individët dhe ngjarjet që kanë kontribuar në zhvillimin e saj. Këto të gjitha janë elemente që e bëjnë unike të Drejtën dhe që janë në origjinën e ndërlikueshmërisë së përkthimit ligjor.

Përshkrimi i karakteristikave kryesore të sistemeve juridike nuk do të ishte i mundur pa ndihmesën e së drejtës krahasuese, shkencë kjo që kontribuon kryesisht në njohjen e sfondit historik dhe filozofik të të drejtave të ndryshme, në të kuptuarit e popujve të huaj dhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.¹⁰⁶

E Drejta është përcaktuar këtu si "tërësia e rregullave të shkruara, zakonore ose jurisprudenciale që organizojnë jetën shoqërore".¹⁰⁷ Kjo do të thotë se e Drejta synon të krijojë një kuadër të kufizuar marrëdhëniesh dhe sjelljesh midis anëtarëve të shoqërisë. Diversiteti i këtyre raporteve bën që e Drejta të ketë shumë forma shprehëse. Siç është raportuar nga juristi kebekas A. Georges Legault, këto marrëdhënie midis individëve mund të jenë "*vis-à-vis*" (*ballë për ballë*) objekte: blerje, shitje, marrje me qira, martesë, prejardhje, ose *vis-à-vis* institucione gjyqësore, legjislativë apo gjithçka që përfshijnë e grupojnë këto institucione.¹⁰⁸

Këto manifestime të ndryshme të së Drejtës kanë një organizim dhe një strukturë të tyren. Megjithatë, ata formojnë një grup që ka edhe tipare të veta të identitetit. Juristi i të drejtës krahasuese René David¹⁰⁹-i thekson se çdo e Drejtë është një sistem që përdor një farë fjalori që u përkon disa koncepteve dhe që rigrupon rregullat në kategori të caktuara, e që përfshin përdorimin e teknikave të caktuara për të formuluar disa rregulla dhe metoda për t'i interpretuar dhe që lidhet me një konceptim të caktuar të rendit

¹⁰⁶E Drejta krahasuese nuk është një metodë e thjeshtë krahasuese e zbatuar në shkencën juridike, është një shkencë që ka një objekt, natyrën dhe interesin e vet. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me historinë e së drejtës krahasuese, teorinë e përgjithshme të së drejtës apo me sociologjinë juridike. Shih, për këtë temë, René Davidin, *Les grands systèmes de droit contemporains*, edicioni 10, Paris, Dalloz 1996, fq. 1-3.

¹⁰⁷Ky përkufizim i së Drejtës është marrë nga parathënia e veprës bashkëautoriale *Langage du droit et traduction*, drejtuar nga Jean- Claude Gémard-i. Përcaktimi i të drejtës mund të ndryshojnë nga një fjalor në një tjetër; prandaj u gjykua me vend për të përdorur veprat e doktrinës të së drejtës për të gjetur një përkufizim që është i besueshëm. Duhet vënë në dukje se përkufizimi që jepet këtu korrespondon me përkufizimin e të drejtës së shoqërive shtetërore.

¹⁰⁸Georges A. Legault, *Fonctions et structure du langage juridique, Meta*, vol. 24, nr.1, mars 1979, fq. 19.

¹⁰⁹René Davidin, *Les grands systèmes de droit contemporains*, edicioni 10, Paris, Dalloz 1996, fq. 1-3.

shoqëror, i cili përcakton mënyrën e zbatimit dhe madje edhe funksionin e vetë së Drejtës. Gjithashtu, edhe korrespondenca ndërmjet koncepteve përbën një nga vështirësitë më të mëdha të krahasimit mes të drejtave të ndryshme.

David-i thotë, gjithashtu, se rregullat e së Drejtës japin një përgjigje ndaj një nevoje të pranishme, në një çast të caktuar në historinë e një shoqërie dhe, si rrjedhim, ato ndryshojnë me shndërrimin apo zhvillimin e shoqërisë. Gjithashtu, e Drejta ka nevojë për një kornizë për ta mbajtur dhe për të siguruar vazhdimësinë. Kuadri i këtyre përbërësve përbën tipare të identitetit të së Drejtës dhe sistemit përreth të cilit ajo është artikuluar. Në saje të këtyre veçorive, të cilat David-i i quan *éléments constants* (*elemente konstante*) të së Drejtës dhe pohon se e Drejta mund të ndahet në familje. Klasifikimi i të drejtave në familje ka përparësinë e reduktimit të numrit dhe të lehtësimit të të kuptuarit. Numri i të drejtave, thotë David-i, do të ishte i pafund në qoftë se do kihej parasysh përmbajtja e tyre. Ky numër bëhet më i vogël, nëse kihen parasysh teknikat e përdorura për t'i shprehur, mënyrat për t'i klasifikuar, mënyrat e përdurura të arsytimit për t'i interpretuar, etj.

Kriteret e përdorura për rigrupimin e të drejtave në familje nuk janë gjithnjë të njëjtësuar mes sistemeve të së Drejtës krahasuese. Megjithatë, të gjithë bien dakord për t'i klasifikuar si të drejtat romake-gjermanike, prej të cilave lindi sistemi civilist ose e Drejta civile, dhe e drejta angleze, prej së cilës lindi Common Law-i.

2.3.3.1. E Drejta civile

E Drejta civile bën pjesë në familjen romako-gjermanike dhe përfshin të drejtat që burojnë nga amalgama e së Drejtës romake, e së Drejtës gjermanike, e së Drejtës kanonike (zakonore) dhe e së Drejtës tregtare¹¹⁰. E Drejta e romakëve ishte e drejta mbizotëruese në këtë amalgamë, përndryshe e drejta civile është e njohur me emrin e së drejtës romake.

Romakët u konsideruan si juristët më të mëdhenj të antikitetit. Sipas Gilissen-it, juristët¹¹¹ romakë do të ishin "të parët në historinë e njerëzimit që arritën të hartonin një teknikë juridike dhe një shkencë të së Drejtës, në saje të një analize të thelluar të

¹¹⁰Shih John Henry Merryman, *The Civil Law Tradition*, Stanford (California), Stanford University Press, 1969, fq. 7.

¹¹¹Juristët janë quajtur si avokatët e parë profesionalë.

institucioneve dhe formulimit të saktë të rregullave juridike"¹¹². E Drejta romake nuk është vetëm një e Drejtë shumë e vjetër¹¹³, shumë më e vjetër sesa Common Law-i, - siç do ta shohim në vijim - por gjithashtu një e Drejtë e mbrujtur me një teknicitet që e karakterizon ende edhe në ditët tona.

E drejta romake, siç e njohim ne sot, është rezultat i një seri shndërrimesh në të cilat përkthimi ka luajtur një rol të rëndësishëm. Komparatistët (Juristët e të Drejtës krahasuese) si Gillisen-i dhe Merryman-i thonë se e drejta e shteteve romaniste bashkëkohore nuk është e Perandorisë Romake, por ajo që është studiuar dhe mësuar në universitete mesjetare. Me rënien e Perandorisë Romake në Perëndim në shekullin e V-të, *Corpus Juris Civilis*-i është vjetëruar, por ajo u bë një temë me interes për studiuesit dhe profesorët e rinj të universiteteve evropiane në fund të shekullit të XI-të. Në fillim, rindërtimi dhe shpjegimi i këtyre teksteve çoi në përdorimin e glosave (shënime sqaruese), në tekste të shkruara në gjuhën e përdorimit të gjerë. Pas kësaj, *Corpus Juris Civilis*-i iu përshtat problemeve të kohës. Studentët morën me vete jo vetëm të drejtën e *Corpus Juris Civilis*-it, por edhe metodat dhe idetë e profesorëve të tyre. E Drejta romake, dhe vëllimi i madh i letërsisë që rrodhi nga glosat dhe përshtatja e së Drejtës me problemet e kohës, u bë *Jus Commune*, ose e Drejta e përbashkët e një pjese të madhe të Evropës kontinentale¹¹⁴.

2.3.3.1.1. Ndarjet dhe konceptet

Rregullat e së Drejtës romake formuan dy kategori të gjera: të drejtën publike dhe të drejtën private. Ky dallim nisët nga parimi sipas të cilit marrëdhëniet ndërmjet sunduesve dhe të sunduarëve kanë problemet e tyre dhe kërkojnë rregulla të ndryshme, që rregullojnë marrëdhëniet midis individëve.

René David-i thotë se brenda këtyre dy kategorive të mëdha të rregullave gjenden, në të gjitha vendet e sistemeve të së drejtës romake, të njëjtat degë apo ndryshe e drejta kushtetuese, administrative, e drejta ndërkombëtare publike, e drejta e procedurës, e drejta civile, e drejta tregtare, e drejta e punës, etj. Ky fakt do të shpjegonte, sipas René Davidit, se "nuk është hasur asnjë problem madhor, në përgjithësi, për të përkthyer nga frëngjishtja në gjermanishte, spanjishte, italishte, hollandishte, greqishte ose portugalishte

¹¹²John Gilissen, *Introduction historique du droit*, Bruxelles, Bruylant, 1979, fq. 16.

¹¹³Prodhimi i materialeve juridike nga ana e romakëve do të zgjasë nga 450 p.k . tek grumbullimi i Justinianit I – apo të *Corpus Juris Civilis* - botuar në mes 529 dhe 534. Shih Glendon e tj. *Comparative Legal Traditions*, Saint Paul (Minnesota.), West Publishing Co., 1985, fq. 40.

¹¹⁴Po aty, fq. 44-45.

fjalët e fjalorit juridik "¹¹⁵. Sipas tij, kjo varet edhe nga fakti se, për shekuj me radhë, shkenca e së Drejtës ka qenë mësuar në bazë të ligjit romak dhe të së drejtës kanonike, dhe se gjuha e përdorur ishte e njëjtë dhe ka shprehur të njëjtat ide, pavarësisht nga metodat e ndryshme të përdorura për të njohur këtë shkencë.

2.3.3.1.2. Nocioni i rregullit të së Drejtës

Një tjetër element që e bën unitetin e të drejtave të traditës romake njerëzore është mënyra sesi është hartuar rregulli i kësaj të drejte. Për më tepër, ky konceptim i rregullit të së Drejtës dallon në mënyrë të qartë të drejtat romake nga Common Law-i. Të drejtat romake, siç do t'i shohim më poshtë, i kushtojnë një rëndësi të madhe doktrinës ¹¹⁶ që përlligj, sipas Davidit, që rregulli i së Drejtës nuk është konsideruar si rregull i thjeshtë i hartuar për zgjidhjen e problemeve; kjo e Drejtë shihet më tepër si një rregull i rëndësishëm që ka karakter të përgjithshëm, që është mbi zbatimet që gjykatat apo praktikuesit mund të bëjnë. Pjesa që vijon ilustron mënyrën se si rregulli i së Drejtës është parë në traditën romake.

Rregulli i së Drejtës qartëson dhe pastron praktikën, duke hedhur poshtë elemente kontradiktorë ose të panevojshëm. Ajo thjeshton njohuritë e ligjit, duke pakësuar në masë elementet që duhen marrë në konsideratë. Ai u jep kuptim këtyre elementeve, duke treguar se si ato ndihmojnë për të siguruar një drejtësi sociale më të mirë, një rend ekonomik apo moral më të sigurtë. Kjo i lejon opinionit publik, legjislativit, të ndërhyjnë në mënyrë më efektive për të korigjuar disa sjellje të caktuara, apo edhe për të orientuar shoqërinë drejt qëllimesh të caktuara. ¹¹⁷

Ky citat tregon, gjithashtu, se e Drejta në traditën romake është konsideruar si një model i organizimit shoqëror. Ajo përmban parimet e sjelljes dhe të moralit, që duhet të ndjekin anëtarët e një shoqërie.

Në traditën romake, roli i kodit nuk është që të gjendet një zgjidhje për të gjitha problemet, por më tepër për të përcaktuar rregulla të përgjithshme, në bazë të cilave gjyqtarët dhe qytetarët të mund të nxjerrin lehtë përfundimin se si mund të zgjidhet një

¹¹⁵René David, *Les grands systèmes du droit contemporain*, 1996, fq. 64.

¹¹⁶Doktrina përbëhet nga shënime të teoricienëve të së Drejtës. Ajo është një burim i rëndësishëm i parimeve që udhëheqin dhe të zhvillojnë të Drejtën. Davidi vuri në dukje se doktrina ka qenë prej kohësh burimi kryesor i të drejtave romake .

¹¹⁷ René David, vepër e cituar, fq. 73.

problem i caktuar. Vështirësia, siç u përmend më herët, vjen nga interpretimi që i duhet bërë rregullit ligjor, i cili është shprehur në një gjuhë të veçantë.

2.3.3.1.3. *Burimet e së Drejtës*

Edhe pse është i vështirë krijimi i një liste të njëtrajtshme të burimeve të të drejtave romake dhe organizimi i këtyre burimeve sipas një rregulli të veçantë, ne e njohim përgjithësisht ligjin, zakonet, jurisprudencën, doktrinën dhe parimet e larta si burimet kryesore të këtyre të drejtave. Midis këtyre burimeve të së Drejtës, vendi dhe roli që u jepen ligjit dhe jurisprudencës përbëjnë dy elementet kryesore që e dallojnë të Drejtën romake nga Common Law-i.

Ligji, siç u tha më sipër, duket si burimi *par excellence* i së Drejtës romake. David-i saktëson se në vendet e familjes romano-gjermanike, zbatimi i dispozitave të ligjit është parë si mënyra më e mirë për të bërë drejtësi. Ky perceptim ka sjellë në shekullin e XIX-të, për shumicën e shteteve anëtare të familjes romano-gjermanike, kodifikimin e ligjeve dhe pajisjen me kushtetuta të shkruara.

Ligji, i cili ka një sintaksë, stil dhe terminologji të paracaktuar në mënyrë rigorozë, shfaqet si teknika më e mirë për të siguruar rregulla të qarta që çojnë në një zgjidhje të drejtë. David-i thotë se qartësia është një nga paradokset e të Drejtave të traditës romake: është dëshira për të "shprehur në mënyrën më të kuptueshme të mundur vulgaren dhe, anasjelltas, një tendencë për të shprehur rregullat e së Drejtës, duke përdorur një teknikë sa më të saktë që të jetë e mundur, duke rrezikuar shndërrime të së Drejtës në një shkencë disi ezoterike (të pakuptueshme)" ¹¹⁸. Ky paradoks kontribuon në masë të madhe për faktin se gjuha ligjore është një nga gjuhët e specialiteteve më të ndërlikuara.

Ky burim kryesor i së Drejtës përfshin, gjithashtu, traktate, kode, rregullore dhe dekrete si dhe qarkore administrative.

Zakoni, thotë David-i, parë nga këndvështrimi sociologjike i së Drejtës, luan një rol shumë të rëndësishëm. Ai do të përbënte infrastrukturën mbi të cilën është ndërtuar Drejtësia. Ai do të udhëheqte parimet relative për zbatimin dhe zhvillimin e ligjit. Sipas

¹¹⁸ Po aty, fq. 91.

tij, është zakoni që do të përcaktojë, për shembull, nocione si *sjellje e keqe*, *afate të arsyeshme*, *pamundësi morale*, etj.

Burimi i tretë i së Drejtës së familjes romako-gjermanike, i cili është në kohën tonë më i rëndësishëm se në të kaluarën, është jurisprudenca, domethënë, vendimet e gjykatave. David-i vuri në dukje se ekzistojnë në të Drejtën romako-gjermanike përmbledhje ose repertorë të jurisprudencës dhe se këto koleksione janë zhvilluar për avokatët në praktikë. Ai nuk e shpjegon rolin e jurisprudencës në këtë familje të së Drejtës, përveçse në raport me ligjin. Në vendet e qeverisura nga e Drejta e traditës romako-gjermanike, thotë ai, juristët heqin dorë me vështirësi nga ligji. Rëndësia relative e legjislacionit gjyqësor në vendet e së Drejtës romako-gjermanike dhe në vendet e *Common Law*-it përbën një rën nga dallimet e mëdha midis këtyre dy familjeve. Rëndësia e së Drejtës jurisprudenciale është e kufizuar në të parat, ndërkohë që është pikërisht e kundërta në të dytat.

Doktrina, nga ana tjetër, është një burim që ka ndihmësuar ndjeshëm, nëpërmjet së shkuarës, në zhvillimin e së Drejtës, veçanërisht në universitetet evropiane të shekujve XIII-të – XIX-të. David-i thotë se, vetëm kohët e fundit, ligji merr përparësi mbi doktrinën. Sipas tij, është doktrina ajo që farkëton termat dhe konceptet e ligjit që përdor ligjvënësi. Gjithashtu, do të ishte doktrina ajo që do të vendoste metodat e interpretimit të ligjeve. Ai, gjithashtu, nuk nënvlerëson ndikimin që doktrina mund të ketë mbi ligjvënësin gjatë hartimit të ligjeve. Sipas tij, hartuesi i ligjeve gjatë punës së vet ka parasysh prirjet që kanë qenë përgatitur dhe zhvilluar nga doktrina.

Burimi i fundit i zhvillimit dhe i përtëritjes të së Drejtës, që do të analizojmë këtu, do të përqëndrohet në parime të përgjithshme. Për të lehtësuar se çfarë janë këto parime, le të themi se janë rrugët ligjore që huazojnë juristët kur kufijtë e ligjit janë plotësuar. Këto parime të përgjithshme mund të rrjedhin nga vetë ligji ose të sugjerohen nga hartuesit e ligjeve, në rastet kur ligji është i pamjaftueshëm. David-i shprehet, lidhur me këtë temë, se " asnjë sistem legjislativ nuk mund të bëjë pa këto plotësime ose pa këto mangësi, pa të cilat një divorc i papranueshëm mund të rrezikonte të ndodhte mes së drejtës dhe drejtësisë".¹¹⁹

2.3.3.2. *Common Law*-i

¹¹⁹Po aty, fq. 119.

Nëse tradita romake dëshmon për rëndësinë e postulatit të Didier-it se fjalori juridik ka të njëjtën histori si institucionet dhe individët që e krijojnë dhe përdorin, këtë e konfirmon *common-law*-i. David-i është krejt në një mendje kur deklaron se "common-law-i është një sistem i shënuar nga historia e vet, dhe kjo histori është ekskluzive, deri në shekullin e XVIII-të, historia e së Drejtës angleze"¹²⁰. Kjo justifikon faktin se ndarjet e mëdha, institucionet, struktura dhe veçanërisht terminologjia e *common-law*-it janë aq të ndryshme nga ato të traditës romake.

Origjina e *common law*-it vjeton qysh nga 1066, viti i pushtimit të Anglisë nga Guillaume, Duka i Normandisë, i quajtur *Guillaume Pushtuesi*. Normanët mbretërojnë si trashëgimtarë dhe jo si pushues-fitimtarë, dhe ata ruajnë të drejtën anglo-saksone, tashmë në fuqi në Angli, një e drejtë lokale dhe zakonore e pashkruar. Guillaume, Duka i Normandisë, vendosi në Westminster gjykatat mbretërore, të cilat merreshin vetëm me çështjet që lidheshin me pushtetin mbretëror. Guillaume krijoi një sistem, i cili kërkonte kryesisht të sigurote pushtetin mbretëror dhe të zhvillonte një strukturë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidheshin me mbledhjen e taksave¹²¹. Çështjet në lidhje me interesat e individëve duheshin të sillleshin në gjykatat vendore të quajtura *County Court ose Hundred Court*. Vetëm për çështje të një rëndësie të jashtëzakonshme vihej në dijeni mbreti, i cili luante rolin e kryetarit të jurisë.

Kjo e Drejtë anglo-saksone pak nga pak u zëvendësua nga *common law*-i, të cilin normanët e quajtën *Comune Ley*, e cila u bë e Drejta e përbashkët në të gjithë Anglinë. Gjuha e folur e së Drejtës ishte frëngjishtja dhe gjuha e shkruar, latinishtja. Latinishtja si gjuhë e së Drejtës ka qenë ngulitur në Angli nga normanët, dhe jo nga romakët.

Për t'u gjykuar në oborrin mbretëror, çka nuk ishte një e drejtë, por një privilegj, duhej të ndiqej një procedurë e veçantë. Kjo procedurë kishte të bënte me të kërkuarin e një *writ*-i (mandati në formë urdhëri) - apo dokumenti¹²²- kancelarit. *Writ*-i jepej nga mbreti ose zyrtarë të tij, të cilët urdhëronin të pandehurin për të vepruar në përputhje me ligjin, dhe kështu të zgjidhej racionalisht kërkesa e paditësit. René David-i pohon se, në bazë të kësaj procedure, kërkuesi duhej të paraqiste një akt hyrës gjyqësor (deklaratë), në të cilin ai do të përcaktonte faktet e çështjes (objektin) dhe t'u kërkonte gjykatësve mbretërore të njiheshin me mosmarrëveshjen. Veprimet e reja nëpërmjet të cilave gjyqtarët njihnin kompetencën e tyre quheshin veprime *super casum (actions on the case)*.

¹²⁰Po aty, fq. 251

¹²¹Shih Mary Ann Glendon et al., *Comparative Legal Traditions*, 1985, fq. 270.

¹²²Sipas Gémar-it dhe Vo Ho-Thuy-it termi *bref* duhet shmangur. Këta autorë parapëlqejnë thirrje (në gjyq), fletëthirrje, ftesë, në varësi të kontekstit. Shih Jean- Claude Gémar-in dhe Vo Thuy Ho-n, në veprën *Difficultés du langage du droit au Canada*, Montréal, Les Éditions Yvon Blais inc. 1990, fq.41.

Me kalimin e kohës, shton David-i, këto veprime u diversifikuan dhe iu dhanë emra që ishin zgjedhur në funksion të faktit që motivonte dhënien e tyre. Kështu, lindën veprime me emra të tillë si *assumpsit* (hipotekë), *deceit* (mashttrim), *trover* (përvetësim i një objekti të gjetur); terma pa ekuivalentë në sisteme të tjera juridike.

David-i pohon, gjithashtu, se çdo *writ-i* i korrespondon një procedurë që përcakton vazhdimin e veprimeve. Për shembull, mundësitë e përfaqësimit të palëve, kushtet në të cilat duhet të paraqiten provat, mjetet e zbatimit të vendimit dhe, sidomos, terminologjia që duhej përdorur. Kjo është procedura që do ta kishte bërë *common law*-in një të drejtë procedurale bazuar në *stare decisis*, parimi sipas të cilit raste të ngjashme duhet të rregullohen në mënyrë të ngjashme. Një tjetër karakteristikë e së Drejtës angleze është krijimi i një jurie, në të cilën juristët duhet të shqyrtojnë mosmarrëveshjet dhe të bëjnë mbrojtje.¹²³

Rrethanat në të cilat *common law*-i u zhvillua i kanë dhënë të Drejtës angleze një karakter të rëndësishëm. Kjo shpjegon, sipas David-it, përparësinë e procedurës, ekzistencën e një numri të madh të koncepteve të veçanta për këtë traditë të së Drejtës, mos-dallimin mes të drejtës publike dhe asaj private dhe moszbatimin në Angli të së Drejtës romake.

Procedurat e vjetra të përdorura për të hyrë në gjykatat mbretërore kanë latuar terminologjinë e *common law*-it dhe kanë përcaktuar kategoritë e identifikuar të rasteve përballë të cilave gjykata njih kompetencat e veta. David-i jep, si shembull, fushën e përgjegjësisë kur shkelet ligji, në të cilën *common law*-i "njuh vetëm raste të veçanta të krimeve civile të quajtura: *deceit* (mashttrim), *nuisance* (ngacmim, fyerje), *trespass* (shkelje abuzive e pronës së dikujt), *conversion* (shndërrim), *libel* (deklaratë e rreme), and *slander* (gënjeshtëri)". Disa prej këtyre shkeljeve, thotë ai, përfaqësojnë *writ*-et e vjetra¹²⁴.

Përsa i përket jo-dallimit ndërmjet së Drejtës private dhe publike, kjo shpjegohet, sipas David-it, nga fakti se gjykatat mbretërore u shërbenin kryesisht interesave mbretërore. Megjithatë, David-i pranon se teknika e *writ*-it që shqyrtonin gjykatat mbretërore, shfaqet edhe si një aspekt i së drejtës publike.

¹²³Kjo procedurë karakteristike për të Drejtën angleze u fut në të Drejtën meksikane nëpërmjet të drejtës tregtare. Përveç kësaj, ajo përbën gjithashtu një nga elementët e mekanizmit të përdorur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas Kapitullit nëntëmbëdhjetë të ALENA-s, risi kjo për juristët meksikanë. Në kontekstin e kreu XIX, NAFTA (MSHLAV-a), lutjet para një jurie paraqesin vështirësi të mëdha në komunikimin mes palëve.

¹²⁴René David, *Les grands systèmes du droit contemporain*, 1996, fq. 263.

Mosmarrja parasysh e së drejtës romake, sipas David-it, shpjegohet nga kompleksiteti dhe ana teknike e procedurës së të drejtës angleze. Ndryshe nga juristët e Evropës kontinentale që studionin të drejtën romake në universitetet mesjetare, *common lawyers*-ët nuk ishin trajnuar përmes praktikës, dhe ajo vazhdoi kështu deri në shekullin e XIX-të.

2.3.3.2.1. *Struktura e Common Law-it*

Edhe pse nuk ka në të Drejtën romake një dallim të qartë ndërmjet së drejtës publike dhe asaj private, ka një dallim midis *common law-it* dhe *equity-s*. *Common law-i* është e Drejta e hartuar në gjykatat mbretërore të Westminster-it, *Equity-a* është e drejta e hartuar nga Gjykata e Kancelarisë.

2.3.3.2.2. *Equity*

Equity-a, thotë René David-i, është një grup mjetesh “shëruese” juridike¹²⁵ që zëvendësohen me *common law-in*, kur ky i fundit nuk mjafton për të zgjidhur një problem. Mbyllja e gjykatave vendore në favor të *common law-it* ka çuar në zhvillimin e një sistemi paralel të administrimit të drejtësisë në Anglinë e shekullit të XIV-të: në atë të *equity-së*. Gjykatat lokale të mbyllura dhe individët nuk mund të zgjidhnin një çështje kur *common law-i* i gjykatave mbretërore nuk mund të jepte drejtësi apo të merrte vendime jo të drejta. E vetmja zgjidhje që ekzistonte ishte prerogativa mbretërore. Mbreti ia delegonte pushtetin e tij kancelarit të vet, i cili jepte drejtësi në emër të tij. Kjo zgjidhje u institucionalizua dhe Kancelari zhvilloi sistemin e vet të rregullave juridike. Ai zbatonte doktrina të drejta të frymëzuara nga e drejta kanonike¹²⁶ dhe nga e drejta romake.

2.3.3.2.3. *Burimet e së Drejtës*

¹²⁵ René David saktëson se termi *remède* (bar, ilaç), i përdorur si barasvlerës francez i termit anglez *remedies*, nuk është një përkthim i kënaqshëm, edhe pse është term i përdorur.

¹²⁶ Gjykatat kishtarë u krijuan në Angli pas pushtimit norman dhe e Drejta kanonike është e drejta e përbashkët për të gjithë krishtërimin. Kisha urdhëronte dhe vendoste mbi moralin e besimtarëve dhe të disiplinës së klerit. Ajo, gjithashtu, ndërhynte në çështjet civile në familje, si në martesë dhe trashëgimitë. Kisha e ruajti këtë juridiksion deri në gjysmën e parë të shekullit XIX. Shiko lidhur me këtë temë Glendon dhe tj. *Comparative Legal Traditions*, 1985, fq. 272.

Zhvillimi i *common law*-it ka qenë shumë i ndryshëm nga ai i së drejtës civile, burimet në të cilat ai kërkon për t'u zhvilluar ose rinovuar nuk luajnë të njëjtin rol si në të drejtat romako-gjermanike.

Duke pasur parasysh natyrën juridike të *common law*-it, Davidi e konsideron çështjen¹²⁷ si burim parësor të së drejtës, ndjekur nga ligji, zakoni, doktrina dhe arsyjeja.

Jurisprudenca, siç u tha më sipër, i referohet vendimeve të gjykatave. Në vendet e qeverisura nga *common law*-i, roli i jurisprudencës është që të zbatohen dhe shfaqen ligjet e së drejtës. Ajo ka, pra, një autoritet kryesor në këtë sistem të së drejtës.

Parimi udhëheqës, pas hartimit të rregullave të së drejtës, nisur nga vendimet e gjyqtarëve është rregulli i precedentit. Kjo do të thotë se raste të ngjashme duhet të zgjidhen në një mënyrë të ngjashme. Si thotë David-i, logjika, e cila nënkupton një sistem të jurisprudencës, imponon detyrimin për t'iu përmbajtur rregullave që janë të përcaktuara nga ana e gjyqtarëve (*stare decisis*) dhe të respektojë parimin e precedentit gjyqësor. *Common law*-i është, pra, një e drejtë që imponon rregulla për të zgjidhur rastet në bazë të ngjashmërisë së tyre, nga ku del dhe emri *case law*. E Drejta civile, ndërkohë, imponon rregulla të cilat janë të vlefshme për parimet e sjelljes dhe moralit.

Common Law-i ka si burim të dytë ligjin, i njohur me emrin *legjislacion i deleguar ose legjislacion mbështetës*. David-i saktëson se në *common law*-in, ligji nuk përmban parime të së drejtës, por përdoret më tepër si një korrigjues i parimeve, të përcaktuara nga jurisprudenca.

Burime të tjera, si zakoni, doktrina dhe arsyjeja, do të luanin vetëm një rol dytësor në zhvillimin e mirëfilltë të *common law*-it. Ashtu si në vendet e të drejtës romako-gjermanike, zakoni udhëheq disa mënyra të caktuara për t'u sjellë në shoqëri, që askush nuk mund t'i vërë në dyshim. Doktrina dhe arsyjeja do të përdoren për të mbushur boshllëqet në rregullat e jurisprudencës.

Për ta përmbledhur, mund të themi se kjo është struktura që do të shënonte dallimin kryesor në mes *common law*-it dhe së drejtës civile. Kjo është, gjithashtu, edhe struktura që do të ishte në origjinë të mospërputhjes mes disa nocioneve të caktuara nga një sistem në tjetrin. David-i thotë, në lidhje me këtë, se "duke mos i përkuar asnjë

¹²⁷Termi *jurisprudence* në frëngjishte i referohet vendimeve gjyqësore, çka në anglishte i korrespondon *decision of the courts*, e cila është në vendimin e gjykatave angleze. Termi anglez *jurisprudence*, në frëngjishte do t'i korrespondonte teorisë së përgjithshme dhe filozofisë së të Drejtës.

koncept i njohur nga ne, termat e së drejtës angleze janë të papërkthyeshme në gjuhët tona, siç janë termat e florës dhe faunës të një klime tjetër. Shtrembërohet kuptimi, në të shumtën e rasteve, kur duam me çdo kusht t'i përkthejmë ".¹²⁸

Kur zakoni nuk ofron zgjidhje ose ai bëhet i padrejtë, për të vendosur dy çështje në të njëjtën mënyrë sipas të vetmit kriter të karakteristikave të ngjashme, Sovrani (Mbreti), burimi i çdo drejtësie, do të ngarkonte Kancelarin, qysh nga fundi i shekullit të XV-të, për të vendosur nëse përfundimet, duke qenë në pajtueshmëri me *law-in*, u përgjigjeshin *equity-së*, funksion që i besohej më pas *Court of Chancery-së* ose *Court of Equity-së*, e cila u bë një ndarje e *High Court-it*, kur riorganizimi i vitit 1873 shfuqizoi këtë dyzim gjyqësor. Kjo është arsyeja pse *High Court-i* i sotëm zbaton edhe *law-in* dhe *equity-në*, dhe nëse ata bien në konflikt, mbizotëron *equity-ja*.¹²⁹

Ky pasazh dëshmon për natyrën e së drejtës romake dhe të *common law-it*, si në planin historik, ashtu edhe në atë nocionor. Në planin historik, ai përcakton rolin që monarkia angleze ka luajtur në përcaktimin e strukturës së *common law-it*; në plan nocionor, kjo tregon se në Kanada, pamvarësisht bashkëjetesës së gjatë të këtyre dy traditave, nuk janë gjetur barasvlerës frëngjisht për një numër të nocioneve të së drejtës angleze.

Kjo histori e shkurtër e të drejtave na mëson se *common law-i* ndryshon nga e drejta romake, nga origjinat, burimet e së drejtës, nga ndarjet dhe konceptet që ajo pranon. Ndarjet e *common law-it*, si dhe roli që luan procedura në traditën e së drejtës janë në fillësën e një numri të madh të koncepteve të panjohura në të drejtën civile, dhe që përbëjnë, edhe sot, edhe në Kanada ku bashkekzistojnë këto dy sisteme për më shumë se dy shekuj, një nga vështirësitë më të mëdha të përkthimit. Për shembull, në Kanada, është hequr dorë nga përkthimi i termave të tilla si 'common law'. Në Kebek, ky term nuk shkruhet më me shkronja të pjerrëta dhe praktika më e zakonshme është të shkruhet në gjininë femërore.^{130*}

Lidhur me problemet e formës, duhet ditur se çdo gjuhë ka modelin e vet të të shkruarit. E drejta civile në gjuhën frënge, për shembull, është rezultat i studimeve që

¹²⁸René David, *Les grands systèmes du droit contemporain*, 1996, fq. 273.

¹²⁹Jean-Claude Gémard et Vo Ho Thuy, *Difficultés du langage du droit au Canada*, Cowansville (Québec.), Les éditions Yvon Blais, 1990, fq. 81-82.

¹³⁰Është përdorur mashkullorja, por rekomandohet të përdoret gjinia femërore.

*Në frëngjishten e Kebek-ut *common law* përshtatet me gjininë femërore, pasi fjala 'loi' është në gjininë femërore.

janë bërë në universitetet evropiane të iluminizmit. Kjo kërkon që përkthyesi të njohë stilet dhe metodat e përgatitjes së sistemeve të ndryshme ligjore.

Si përfundim, duhet theksuar se, megjithë dallimet e tyre, të dy traditat ndajnë një koncept të përbashkët të së drejtës apo, ndryshe, kërkimit të drejtësisë.

2.3.4. Dokumentacioni mbështetës në përkthim

Meqë e Drejta është një shkencë shoqërore, dukuritë që ajo përshkruan janë vështirësisht të kalueshme nga një gjuhë në një tjetër ose nga një sistem në tjetrin. Për më tepër, prania e sistemeve të ndryshme juridike shkakton problemin e mospërputhjes të nocioneve ose të termave. Në një kornizë, ku përkthimi duhet të kapërcejë pengesat gjuhësore dhe ligjore të shkaktuara nga prania e sistemeve të ndryshme juridike, përkthyesi përdor mjete ose mënyra për të mundësuar që ta kryejë detyrën. Çështa qëndron se ku duhet t'i gjejë këto burime, dhe nga duhet të fillojë kërkimin dokumentar.

Gémar-i sugjeron një kërkim dokumentar në tri faza. Hapi i parë është leximi dhe analiza e tekstit; hapi i dytë është evidentimi dhe paraqitja e termave dhe nocioneve të panjohura, dhe hapi i tretë është kërkimi i barasvlerësve. Problemi që shtrihet në Gémar-i, në procesin e kërkimit të barasvlerësve, është rendja fillimisht pas fjalorit ndërkohë që, duhej të përdorej si një mjet i fundit. Problemi, thotë Gémar-i është i kriterit metodologjik, sepse "bëhet fjalë për një zgjedhje në një fushë që karakterizohet nga një shumësi termash, një polisemi kronike dhe një sinonimi jo më pak të rëndësishme. Përveç kësaj, kjo terminologji është e vështirë të "eksportohet", meqë realiteti juridik i një vendi nuk mund të kalkohet krejt pa pësuar ndonjë dëm për shkak të dallimeve socio-kulturore dhe socio-ekonomike që pasqyrohen në institucione¹³¹.

Një tjetër problem që krijojnë fjalorët, thotë Gémar-i, vjen, nga njëra anë, sepse ata sugjerojnë zgjidhje të tipit "receta kuzhine" dhe nga ana tjetër, shembujt që na ofrojnë janë shpesh përkthime dhe jo tekste origjinale. Për më tepër, fjalorët, edhe për arsye metodologjike, nuk mund të sigurojnë të gjitha kontekstet në të cilat mund të përdoret një term. De Groot-i, si Gémar-i, shpreh keqardhjen për faktin se fjalorët nuk ofrojnë kontekstin në të cilin termat që ata sugjerojnë mund të shfaqen si në gjuhën origjinale edhe në gjuhën e synuar: "*Ideally, dictionaries should also give the context of the concepts that have to be translated as well as the context of the suggestions for*

¹³¹ Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique et son enseignement: aspects théoriques et pratiques, Meta*, 1979, fq. 49.

translations. [...] most dictionaries give some suggestions for translating a concept and usually only one of these suggestions is correct, depending on context" ^{132*}. De Groot-i beson, gjithashtu, se fjalorët duhet të përmbajnë vetëm sugjerime për përkthimin e termave nga një sistem juridik në një sistem tjetër juridik, çdo përkthim u përket dy sistemeve në të njëjtën kohë.

Për shkak të besueshmërisë së ulët të fjalorëve, sidomos të fjalorëve shumëgjuhësh, Gemar-i rekomandon, së pari, përdorimin e fjalorëve apo enciklopedive juridike njëgjuhëshe, si në gjuhën origjinale edhe në gjuhën e synuar. Një fjalor i mirë duhet t'u përgjigjet kriterëve të besueshmërisë, dobisë dhe të jetë sa më shterues. Besueshmëria përcaktohet nga cilësia gjuhësore e fjalëve, nga përkufizimet, nga barasvlerësit e propozuar dhe nga shkalla e vjetërimit të terminologjisë. Nuk duhet harruar se e Drejta është një shkencë shoqërore dhe, për këtë arsye, ajo ndjek zhvillimin e shoqërisë. Besueshmëria varet, gjithashtu, nga mënyra e paraqitjes, nga qartësia e formulimit, nga thuktësia dhe nga saktësia e përkufizimeve. Dobia e një fjalori varet, në një masë të madhe, nga kriteret e plotësisë dhe të besueshmërinë. Së fundi, me kriteret shteruese, Gemar-i nënkupton seriozitetin e autorëve në kërkimin dhe në përdorimin e terminologjisë në fushën përkatëse. Fjalori sistematik i terminologjisë i Rachel Boutin-Quesnel-it etj. tregon se një fjalor terminologjik, që merret vetëm me një fushë të së Drejtës, përfshin në përgjithësi një shkallë të lartë të të qenit shterues.

Shqetësimi i Gémar-it, në lidhje me dokumentacionin juridik, nuk justifikohet me mungesën e besimit që u jep fjalorëve të përkthimit, por para së gjithash nga fakti se në përzgjedhjen e fjalorëve, përkthyesi duhet të jetë besnik ndaj sistemeve të përfshira në përkthim. Gémar-i rekomandon që përkthyesi duhet t'i përshtatet realitetit të sistemeve ligjore të tekstit që do të përkthejë. Ky mosbesim mund të provohet, gjithashtu, për fjalorë të përkthimit në spanjishte në kontekstin latino - amerikan. Fjalorët e mirë janë të rrallë. Për më tepër, nuk duket se ka përpjekje të bashkërenduara për hartime të mundshme leksikografike në të drejtën krahasuese.

¹³²De Groot, La traduction juridique: *The Point of View of a Comparative Lawyer*, Les Cahiers de Droit, 1987, fq. 806.

*"Në rastin më të mirë të mundshëm fjalorët duhet të japin edhe kontekstin e koncepteve të cilat duhet të përkthehen si edhe kontekstin e sugjerimeve për përkthim. [...] Shumica e fjalorëve japin disa sugjerime për përkthimin e koncepteve dhe zakonisht njëri prej tyre është i sakte në varësi të kontekstit".

Përkthyesi nuk duhet të kënaqet thjesht duke kërkuar në disa fjalorë. Ai, gjithashtu, duhet të kërkojë edhe në burime të besueshme. Burimet e hulumtimeve të tilla kërkojnë që përkthyesi të njohë të drejtat e pranishme në substancë dhe formë.

Gémar-i përcakton tri kategori burimesh: të ashtuquajturat burime normative, burime dytësore dhe burime të ndryshme. Burimet normative përfshijnë tekste që burojnë nga legjislati - burim i shkëlqyer si për common law-in edhe për të drejtën civile (ligjet, rregulloret, dekretet, etj). Ato përfshijnë, gjithashtu, edhe tekstet e jurisprudencës - burimi kryesor i së Drejtës në common law – të cilët përbëjnë një burim të besueshëm të dokumentacionit për përkthyesin. Ndër burimet dytësore, dmth., burimet e së Drejtës më pak kufizuese, Gémar-i përmend dokumente që burojnë nga zakoni dhe doktrina, repertorët, leksikët, fjalorët njëgjuhësh, dygjuhësh ose shumëgjuhësh, kontratat model, etj. Përkthyesi duhet, gjithashtu, të hulumtojë një shumëllojshmëri burimesh si akte noteriale, kontrata, formularë standardë, procesverbale seancash, etj.

Diversiteti dhe sasia e çështjeve juridike janë një tjetër problem i kërkimit të informacionit. Meqë e Drejta prek të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, është e vështirë të dallohen kufijtë mes degëve të ndryshme të së Drejtës. Përhapja e bankës së të dhënave të kompjuterizuara mundëson përdorimin e cunuar të informacionit, por problem është identifikimi i degëve të së Drejtës dhe i termave bashkangjitur tyre dhe kostoja e lartë që lidhet me shfletimin e këtyre bankave (të dhëna të informatizuara).

2.3.5. Qasja shumëdisiplinare e përkthimit ligjor

Shpalosja e katër pikave të Tipologjisë së Gémar-it nxjerr në pah diversitetin e aftësive që përkthyesi ligjor duhet të ketë për të kryer si duhet punën e tij dhe rolin që luan si ndërmjetës i komunikimit. E Drejta prek, pothuajse, të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore. Të përkthesh tekste të së Drejtës tregtare ndërkombëtare, për shembull, do të thotë të përkthesh terma dhe shprehje të fushave të ndryshme si: të ekonomisë së biznesit, taksave dhe, natyrisht, ekonomisë politike.

Nuk ka asnjë dyshim se kjo tipologji mund të përfshijë edhe elemente të tjerë. Siç u tha më herët, ajo nuk është shteruese, por paraqet edhe kategori të tjera vështirësish që e bëjnë përkthimin juridik një nga veprimtaritë më të ndërlikuara. Në njerën mund të përfshijmë, për shembull në pikën e dytë të kësaj tipologjie, vështirësitë e përkthimit të

identifikuara nga Sacco-ja. Ky autor¹³³ pohon bashkëpraninë e dy gjuhëve ligjore në një gjuhë, si dhe praninë e figurave retorike. Në rastin e parë, është fjala për gjuhë të zakonshme në disa vende, për shembull, frëngjishtja që është gjuha e folur në Francë, Belgjikë, Kebek, Zvicër, etj. Pra, do të kishte nga një gjuhë ligjore në frëngjisht për secilin nga këto vende frankofone. I njëjti parim do të duhej zbatuar edhe në rastin e gjuhës spanjolle, do të duhej të kishte një gjuhë ligjore për Spanjën, si dhe për çdo vend spanjisht-folës në Amerikën Latine. Sa për praninë e figurave të retorikës, Sacco-ja vë në dukje se ajo mund të shkaktojë një mospërputhje midis formulimit verbal të folësit dhe rregullit të zbatuar. Ky ndryshim, sipas Sacco-s, ekziston në të gjitha sistemet juridike. E Drejta krahasuese është disiplinë e qenësishme që mund t'i ofrojë përkthyesit mjete teknike që i ka të nevojshme për të kapërcyer këto vështirësi.

Le të saktësojmë, për të përfunduar këtë syth, se Tipologjia e Gémar-it nuk zbatohet përjashtimisht për përkthimin ligjor nga anglishtja në frëngjishte, por në përkthimin ligjor perëndimor në përgjithësi. Përkthimi në spanjishte i një vepre mbi të drejtën amerikane, lidhur me tregtinë dhe investimet¹³⁴, dëshmon problematikën juridike të ngritur nga Gémar-i.

Në veprën *Nota a la version en español*, botuesit meksikanë nënvizojnë si vështirësi të parë dallimin midis sistemeve juridike të dy vendeve, dallimet midis traditës civiliste dhe common law-it. Ata theksojnë se, për të kapërcyer këtë vështirësi, nuk është e mjaftueshme bërja e një përkthim të thjeshtë, është e nevojshme që të kesh njohuri të gjerë të të dy sistemeve juridike për të identifikuar equivalencat që janë të afërta. Ky dallim i traditave juridike, theksojnë ata, ngjiz si vështirësi ekzistencën e koncepteve për të cilat nuk ka asnjë përkthim në spanjishte, thjesht sepse institucioni i së drejtës amerikane nuk ekziston në traditën e "Romano-kanonica"¹³⁵. Termat *subpoena* dhe *discovery* janë dy nga shembujt e shumë.

Ata, gjithashtu, tregojnë për problemet gjuhësore. Për shembull, termat që në dukje, janë ekuivalente në spanjishte, por, pas analizave, janë vetëm ekuivalente të pjesëshme. Përdorimi i këtyre barasvlerësve do të rezultonte, siç vënë në dukje ata, përfitim të një versioni të pjesshëm i cili mund të çonte lehtë në pështjellim. Disa nga

¹³³Shih Rodolfo Sacco, *La traduction juridique: Un point de vue italien*, Les Cahiers de Droit, vol. 28, nr. 4, dhjetor 1987, fq. 845-859.

¹³⁴*El derecho de Estados Unidos en torno al comercio y a la inversión*, vol. 1, National Law Center for Inter-American Free-Trade dhe Universidad Nacional Autónoma de México, 1999. Përkthimi në spanjishte u krye nga një ekip përkthyesësh dhe juristësh të Universidad Nacional Autónoma, México.

¹³⁵Po aty, LXIV.

këto terma janë, *municipality*, *statute*, *tort*, përkthimi i të cilave me *municipio*, *ley* ose *responsabilidad* është i paplotë. Probleme të tjera janë fjalët në gjuhën angleze me nuanca të ndryshme, të cilat nuk mund të kthehen në spanjishte. Për shembull, termat *property - ownership* kthyer në spanjishte me *propiedad* dhe *procedure / proceeding* kthyer në *procedimiento*. Këtu bëhet fjalë për një rast humbjeje të përmbajtjes në raport me origjinalin. Botuesit theksojnë, gjithashtu, problemet e shkaktuara nga termat angleze që do të kishin disa kuptime në spanjishte, në varësi të kontekstit. Për shembull, termi *enforcement*, i cili mund të kthehet në spanjishte me *aplicación*, *ejecución* ose *cumplimiento de la ley*, dhe *authority* që mund të përkthehen me *autoridad* ose *fuentes*. Një çështje e fundit që u ngrit nga botuesit është besnikëria në stilin e versionit origjinal duke respektuar traditat dhe zakonet e gjuhës spanjolle. Kur bëhet fjalë për një tekst të doktrinës ku përkthimi, sipas Gëmar-it, është i krahasueshëm me përkthimin e një teksti letrar, botuesit shqetësohen në lidhje me stilin e origjinalit, edhe kur e përkthejnë tekstin në përputhje me frymën e gjuhës spanjolle.

Equivalencat e përshtatshme janë ato që bordi botues ka gjykuar si më të përshtatshme. Për shembull, në disa raste, termi ka qenë ruajtur në gjuhën origjinale dhe në raste të tjera, atij i kanë gjetur një ekuivalent në spanjishte, dhe termi anglez është vendosur në kllapa. Si përfundim, mund të themi se e rëndësishme është, në këtë rast të veçantë, që të jepej përmbajtja, dmth., e drejta për tregti dhe investime në Shtetet e Bashkuara, të arritshme për një lexues hispanofon spanjoll, i cili do të kishte disa njohuri të gjuhës angleze.

Ja, pra, një shembull që ilustron mirë nocionin e barasvlerës, siç e përshkruam në kapitullin e mëparshëm: barasvlera vendoset në funksion të asaj që është negociuar midis përkthyesit dhe porositësit. Konsumatori është, në këtë rast të veçantë, bordi botues. Në të ardhmen, në qoftë se konteksti do të ndryshojë, zgjidhjet e përshtatshme nga bordi botues mund të ndryshojnë. Për shembull, me kalimin e kohës, ekuivalencat e propozuara në versionin spanjoll të veprës në fjalë mund të hiqen si terma të gjuhës origjinale që kanë qenë midis kllapave. Me fjalë të tjera, kjo do të varej nga leksikalizimi në kohë i barasvlerësve të propozuar.

2.4. Kultura juridike dhe rëndësia e saj në përkthim

Në qoftë se vazhdojmë të ndërtojmë një kornizë, e cila përbën ligjërimin juridik, në të do të duhej përfshirë nocioni i kulturës, e pandarë në çdo sistem të së drejtës.

Antropologia Sally Engle Merry e përkufizon kulturën si vlera, institucione dhe ndërveprime shoqërore që ndajnë një grup individësh¹³⁶. Ajo, gjithashtu, thekson se e Drejta bën pjesë të institucionet ose sistemet normative që kanë ndihmuar në ruajtjen e rendit në shoqëri, dhe se struktura e së Drejtës është e lidhur ngushtë me atë të grupit. Prandaj, studimi i së Drejtës nuk mund të ndahet nga studimi i kulturës së grupit që e ka formësuar të Drejtën në fjalë.

E Drejta, si kulturë e përgjithshme, është një proces hermeneutik (semiologjik), që ka gjuhën dhe njohuritë e veta. Prandaj, e Drejta është njëkohësisht gjenerator i kulturës dhe produkt i një kulture: ajo ndihmon për të formësuar një kulturë, por ka gjithashtu një kulturë të vetën, kulturën juridike.

Studimet mbi konceptin e kulturës juridike janë të pakta dhe, edhe më të pakta, janë ato që krahasojnë kulturat e ndryshme juridike. Përveç kësaj, përkufizimet e këtij koncepti shpesh janë të kundërshtuara, sepse kultura juridike është quajtur një nocion i përgjithshëm për të shpjeguar disa procese të së Drejtës dhe të sistemeve juridike. Lawrence M. Friedman-i, profesor dhe studiues në Universitetin e Stanfordit, është një nga juristët që është interesuar shumë për këtë nocion.

Friedman-i e përkufizon kulturën juridike si një tërësi idesh, vlerash, qëndrimesh që anëtarët e një shoqërie shfaqin për të Drejtën dhe për sistemin juridik. Ai thekson, gjithashtu, se këta individë si pjesë e një bashkësie, e një entiteti shoqëror marrin pjesë në idetë dhe qëndrimet e grupit. Prandaj, kultura juridike është tërësia e ideve, vlerave, qëndrimeve të mbajtura nga një komunitet individësh karshi së Drejtës dhe sistemit të së Drejtës, i cili rregullon jetën e tyre në shoqëri.¹³⁷ Sipas Friedman-it, kultura juridike e një shoqërie do të ishte në origjinë të së Drejtës: normat e saj do të diktonin normat juridike. Ajo është, gjithashtu, kultura juridike që do të përcaktonte efektin e normave juridike mbi shoqërinë. Le të mendojmë, për shembull, për dënimin me vdekje në botën perëndimore. Sanksioni për një dënim të tillë është përballur, gjithashtu, me kundërshtimin e shumicës së njerëzve, madje edhe në vendet ku ky dënim zbatohet.

¹³⁶Sally Engle Merry, *Law, Culture, and Cultural Appropriation*, Yale Journal of Law and Humanities, vol. 10, nr. 575, 1998, fq. 575-588.

¹³⁷Lawrence Friedman, *Is There a Modern Legal Culture?*, Ratio Juris, 1994, fq. 118.

Në paragrafin e mësipërm, i referohemi kulturës juridike të jashtme, d.m.th., kultura e anëtarëve të një shoqërie. Kultura juridike,¹³⁸ është ajo e trajtuar nga juristët, ajo që Friedman-i e quan *kulturë e brendshme juridike*.

Para se të vazhdojmë analizën e nocionit të kulturës juridike, duhet bërë një dallim tjetër: ai mes traditës juridike dhe sistemit juridik. Këto dy terma, shpesh të përdorur si sinonime, bartin në vetvete nocione shumë të ndryshme.

Punimet shkencore të Merryman-it i kemi shfrytëzuar në këtë studim për të përcaktuar sistemin juridik si tërësinë e institucioneve, procedurave dhe rregullave rreth të cilave artikullohet një sistem i së Drejtës. Ja përkufizimi që na jep Merryman-i:
... a set of deeply rooted, historically conditioned attitudes about the nature of law, about the role of law in the society and the polity, about the proper organization and operation of a legal system, and about the way law is or should be made, applied, studied, perfected and taught. The legal tradition relates the legal system to the culture of which it is a partial expression. It puts legal system into cultural perspective^{139*}.

Çdo shtet apo provincë ka sistemin e vet juridik, edhe kur bazohen në të njëjtën traditë të së Drejtës. Tradita juridike, siç thotë Merryman-i, është vendi që bashkon sistemin juridik me kulturën në të cilën bën pjesë. Le të nënvizojmë se termi *traditë juridike* lidhet me sistemin juridik si një e tërë, kurse kultura juridike - kultura e brendshme juridike - i referohet individëve që punojnë brenda një sistemi të së Drejtës. Tradita juridike lidhet, në mënyrë më specifike, me atë çka kanë të përbashkët sistemet juridike që burojnë nga e njëjta familje.

Nocioni i kulturës juridike është analizuar me hollësi në këtë punim, sepse ai prek komunikimin dhe, si rrjedhim, përkthimin në fushën e së drejtës.

Fix Fierro-i dhe López Ayllón-i kanë kryer një studim mbi komunikimin ndërkulturor brenda grupeve të veçanta dykombëshe¹⁴⁰, ku tregojnë se kultura juridike

¹³⁸Për shënime shtesë për nocionin e kulturës ligjore, shih Volkmar Gessner, *Global Legal Interaction and Legal Cultures*, 1994, Ratio Juris, vol. 7, nr. 2, fq. 132 -145, si edhe revistën *Social & Legal Studies*, vol. 4, no 4, dhjetor 1995, e cila përmban katër artikuj lidhur me këtë temë.

¹³⁹ John Henry Merryman, *The Civil Law Tradition*, 1969, fq. 2.

*“Një sërë rregullash dhe qëndrimesh të kushtëzuara historikisht për vetë natyrën e ligjeve, për rolin e tyre në shoqëri, për organizimin dhe veprimin e saktëtë sistemit ligjor, si edhe për mënyrën që ligji është ose duhet të ishte i aplikuar, studiuar, perfeksionuar dhe i mesuar. Tradita juridikelidh sistemin juridik me kulturën në të cilin ai bën pjesë. Ai vendos sistemin juridik në një këndvështrim kulturor”.

¹⁴⁰Krahaso Héctor Fix Fierro et Sergio López Ayllón, *Comunicación entre culturas jurídicas: los paneles binacionales del Capítulo XIX del TLCAN*, 1997, fq. 19-57.

ka ndikim në funksionimin e këtyre grupeve. Studimi ishte fokusuar më konkretisht te kultura juridike e arbitrave amerikanë dhe meksikanë, apo ndryshe te juristët e formuar respektivisht sipas traditës së common law-it dhe të traditës romake. Dallimet në kulturën juridike, të identifikuar nga autorët, janë të natyrave të ndryshme dhe kanë efekte, ndër të tjera, mbi komunikimin¹⁴¹ mes palëve të interesuara.

Midis problemeve të komunikimit, që lidhen me dallimin ndërmejt kulturave juridike, autorët kanë vënë në dukje dallimet në lidhje me sistemet juridike dhe dallimet që lidhen me vetë individët. Kështu, në kategorinë e parë, ata gjetën dallime në qasjen ndaj çështjeve juridike: juristët meksikanë vonohen në aspektet formale të gjykimit, ndërsa ata amerikanë vonohen në aspektet praktike. Ky është një tipar kulturor, që autorët e quajnë formalizëm meksikan dhe pragmatizëm amerikan¹⁴². Fix Fierro-i dhe Lopez Ayllon-i besojnë se, për shkak të formimit të tyre, të mendësisë së tyre dhe të praktikës së tyre lidhur me të Drejtën, juristët meksikanë i japin procedurës një rëndësi të madhe. Në Meksikë, shumë procese do të shtyreshin, madje të anuloheshin, për arsye thjesht formale. Ky tipar kulturor pasqyrohet në arsyetimin dhe stilin e analizës së juristëve. Juristët meksikanë kanë prirje për t'i privilegjuar konceptet dhe parimet e përgjithshme, ndërsa homologët e tyre amerikanë do të përqëndrohen në çështje specifike dhe konkrete.

Një tjetër vështirësi e ngritur nga autorët është përdorimi i *audiencias públicas* për të paraqitur dhe sqaruar argumentet e palëve në konflikt me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të një grupi të veçantë dykombësh. *Audiencias*-at, sipas ligjit meksikan, nuk janë, në parim, ngjarje publike me qëllim shkëmbimet verbale, por më tepër një hap në procesin gjyqësor për prezantimin e dokumenteve të një dosjeje. Kjo procedurë e shkëmbimit verbal u prezantua në sistemin juridik meksikan në vitin 1993 nga *Ley de Comercio Exterior*. Mungesa e familjaritetit me këtë procedurë do të kishte si efekt shtimin e strategjive ligjërimore të palëve për të arritur rezultatin e dëshiruar. Ky rezultat, nënvizojnë autorët e studimit, është një ligjërimit me shumë fjalë të tepërta, i pështjelluar dhe i ngathët, dhe në fund askush nuk ka një ide të qartë të rezultatit të *audiencia publica*.

Sa për kategorinë e dytë të dallimeve, domethënë ato që lidhen me vetë individin, Fix Fierro-i dhe Lopez Ayllon-i vënë në dijeni për pengesën e gjuhës dhe shkallën e

¹⁴¹ Autorët thonë se studimi i tyre paraqet përfundime paraprake. Objektivi i studimit të tyre ishte të analizohej efekti i mekanizmit të zgjidhjes së konflikteve në kapitullin XIX të ALENA-s për të drejtën meksikane. Për sa u përket elementeve të kulturës juridike, të cilat kanë efekt në komunikimin ndërmjet anëtarëve të një paneli dykombësh, ata përmendin vetëm disa.

¹⁴² Héctor Fix Fierro et Sergio López Ayllón, vepër e cituar, fq. 34.

njohjes së sistemeve juridike të përfshira. Këto dy elemente janë probleme të komunikimit tërësisht rrethanas, që do të thotë, se ndryshojnë në përputhje me përbërjen e grupit special dykombësh dhe prejardhjen e anëtarëve të tij. ALENA nuk parashikon rregulla në lidhje me gjuhën e punës së grupit special dykombësh. Juristët mund të flasin në gjuhën e tyre të zgjedhur, sipas zotërimit të gjuhëve të ndryshme.

Edhe pse studimet mbi kulturën juridike nuk janë të shumta, ka teoricienë të cilët janë të shqetësuar për vendosjen e masave që kërkojnë të sfidojnë vështirësitë që dalin nga diversiteti i kulturave juridike. Gloria M. Sánchez-i, profesore në Western State University College of Law, sugjeron që shkollat e së Drejtës e universiteteve amerikane të përfshijnë në programin e tyre të mësimdhënies sisteme dhe kultura juridike të partnerëve kryesorë tregtarë të Shteteve të Bashkuara, dhe këtë e kryejnë në gjuhët përkatëse kombëtare. Sipas mendimit të saj, kjo do të shmangte pështjellimin, përçarjen dhe paqartësinë në ligjërimin juridik, në një kontekst ku bashkëjetojnë sisteme të ndryshme juridike. Ajo supozon, gjithashtu, se sistemi juridik, kultura e lidhur me një sistem të së drejtës dhe gjuhës që përdor e drejta në fjalë, rregullojnë mënyrën e të menduarit të juristit. Lidhur me këtë temë, ajo thekson se:

Linguistic thought will not correspond in the minds of individuals of different cultural and linguistic backgrounds because different methods of legal reasoning and different values underlie the different legal systems in which they operate. Unless the parties become aware of the differences in their linguistic and cultural assumptions, the likelihood of misunderstandings and miscommunications in legal discourse between parties of different legal systems and cultures is great^{143*}

Pa komentuar mbi anët pozitive dhe negative të një propozimi të tillë, duhet bërë e ditur se ajo përbën një paralajmërim bindës kundër efekteve që dallimet kulturore juridike mund të kenë mbi ligjërimin në lëmin e së Drejtës. Ky paralajmërim vlen për të dy: si për juristët, ashtu edhe për përkthyesët. Në të vërtetë, përkthyesi ligjor duhet të jetë i vetëdijshëm për efektin që këto dallime mund të kenë jo vetëm në ligjërimin juridik, por edhe mbi vetë procesin e përkthimit.

¹⁴³Gloria M. A. Sánchez, *Paradigm Shift in Legal Education : Preparing Law Students for the Twenty-First Century: Teaching Foreign Law, Culture, and Legal Language of the Major U.S. American Trading Partners*, San Diego Law Review, vol. 34, nr. 635, 1997, fq. 668.

*"Mendimi gjuhësor nuk do të korrespondojë në mendjen e personave të ndryshëm që vinë nga kultura të ndryshme sepse ekzistojnë formime të ndryshme të arsytimit juridik në të cilat ata veprojnë. Për aq kohë sa individët nuk bëhen të përgjegjshëm për ndryshimet e tyre gjuhësore dhe kulturore mundësitë për të pasur keqkuptime në bashkëbisedimet e fushës juridike, janë shumë të mëdha".

KREU III

ANALIZA E TEKSTIT DHE METODAT E PËRKTHIMIT

3.1. Tipologjia e teksteve juridike dhe përgjegjësia e përkthyesit

Siç është cekur në sythin 2.3.3, është e drejtë mënyra që shoqëritë adoptojnë për të rregulluar marrëdhëniet midis individëve. Rregullimi i këtyre marrëdhënieve prodhon tekste të tilla si ligje, gjykime, marrëveshje, kontrata, testamente e të tjera. Megjithëse të gjithë këto tekste i përkasin fushës juridike, ata kanë karakteristika shumë të ndryshme, si përsa i përket formës, ashtu edhe përmbajtjes.

Këto tipare të vecanta i imponojnë përkthyesit disa kufizime të rëndësishme, të cilat lidhen me interpretimin e kuptimit të originalit dhe me zgjedhjen e burimeve

gjuhësore të rishprehjes së këtij kuptimi. Në themel të këtij kufizimi është nocioni i përgjegjësisë së përkthyesit.

Nuk po flasim këtu për përgjegjësinë e përkthyesit karshi parimeve urdhëruese që diktojnë se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të bëjë. Siç vë në dukje Anthony Pym-i, "në qoftë se përkthyesi ndjek vetëm receta, ai nuk do të jetë përgjegjës për asgjë që të jetë e tij".¹⁴⁴ Përgjegjësia në fjalë, këtu, ka të bëjë me vendimet që përkthyesi duhet të marrë gjatë procesit të përkthimit, si dhe përdorimit të burimeve gjuhësore, konceptuale dhe nocionore të fushës së tij të specialitetit dhe, si rrjedhim, me besueshmërinë e tekstit që ai duhet t'i dorëzojë porositësit.

Gémar-i ndan tekstet ligjore në tri kategori, domethënë: 1) aktet me interes publik të tilla si rregulloret, gjykimet dhe aktet procedurale, 2) aktet me interes privat të tilla si kontratat, formulat administrative ose tregtare, testamentet dhe marrëveshjet kolektive dhe 3) tekstet e doktrinës. Ai, gjithashtu, njeh edhe tri lloje të përgjegjësisë për përkthyesit, përkatësisht detyrimin e mjeteve, detyrimin e rezultatit dhe detyrimin e garancisë¹⁴⁵ [184]. Në rastin e parë, kjo do të thotë detyrimin që përkthyesi ka për të përdorur në maksimum jo vetëm një pjesë të burimeve pothuajse të pakufishëm të gjuhës. Në rastin e dytë, ai i referohet rishprehjes së përmbajtjes juridike të tekstit origjinal, ndërsa në rastin e tretë, bëhet fjalë për nivelin më të lartë të besueshmërisë¹⁴⁶ së një përkthimi. Gémar-i e ngarkon përkthyesin me një nivel të ndryshëm përgjegjësie, sipas asaj që ky i fundit përkthen: një dokument të grupit të parë, të dytë apo të tretë. Kështu, përgjegjësia e përkthyesit, për akte me interes publik, nuk do të vendosej në nivel të njëjtë (në planin profesional, shoqëror, politik dhe etik), me atë të dokumenteve me përdorim të brendshëm apo privat, të tilla si teste etj.

Duke qenë se pasojat e gabimeve janë të paparashikueshme, Gémar-i përcakton një detyrim të trefishtë – të mjeteve, rezultatit dhe të garancisë – për përkthyesin e teksteve të grupit të parë dhe të tretë¹⁴⁷. Gémar-i propozon që përkthimi të bëhet në përputhje me rregullat që kërkon redaktimi me shkrim. Tekstet e doktrinës së Drejtës,

¹⁴⁴Shih Anthony Pym, *Pour une éthique du traducteur*, 1997, fq. 68.

¹⁴⁵Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique: art ou technique d'interprétation*, *Meta*, vol. 33, nr 2, qershor 1998, fq. 308.

¹⁴⁶Në këtë kategori të tretë të përgjegjësisë apo detyrimit Gémar-i përfshin cilësi që përkthyesi duhet t'i sigurojë dhënësit të veprës.

¹⁴⁷Jean-Claude Gémar, cituar më lart.

ndërkohë, janë perceptuar nga Gémar-i si tekste letrare, për të cilat përkthimi kërkon aftësi të veçanta.¹⁴⁸

Në përkthimin e dokumenteve të grupit të dytë, apo dokumenteve me interes privat, detyrimi i përkthyesit në raport me mjetet, rezultatet dhe garancinë është më i vogël se në rastin e grupit të parë. Gémar-i vë në dukje, me të drejtë, se porositi rrallë pret që përkthyesi të përçojë gjithë përmbajtjen juridike të origjinalit. Në fakt, porositi që nuk studion për 'drejtësi' injoron shpesh domethënien juridike të dokumentit dhe mënyrën me të cilën do të bëhet ky përkthim. Detyrimi i mjeteve, në këtë rast, kalon në planin e dytë, i cili, sipas Gémar-it, nuk do të ishte pa pasoja. Ja, sipas Gémar-it, çfarë pasojash mund të kenë tekste që heqin detyrimin e mjeteve në planin e dytë.

Kjo kërkesë (ose hendek, në varësi të pikëpamjeve [...]) është kryesisht përgjegjëse për cilësinë e dobët të teksteve juridike aktuale, që njerëzit e zakonshëm kanë pasur ose do të kenë rastin të lexojnë një ditë prej ditësh te juristi i tyre, te siguruesi, shitësi i makinave apo te makinat larëse. Prej këtej buron përshtypja, shpesh e përligjur, se tekstet juridike janë të redaktuara keq, të mbushura me pasaktësi dhe gabime të të gjitha llojeve, pa përmendur këtu, pastaj, stilin që lë shumë për të dëshiruar. Duke vepruar kështu, duke injoruar pyetjen se si të përfitojnë nga një rezultat, ky grup "ndihmon" për të diskredituar gjuhën e së Drejtës në sytë e publikut.¹⁴⁹

Ndodh shpesh që porositi, që nuk njeh mirë përmbajtjen juridike të një dokumenti origjinal, ia beson përkthimin dikujt që nuk ka formimin e duhur për të kryer këtë detyrë. Kjo injorancë e dyfishtë në fushën juridike përsëritet më shpesh se sa ne e mendojmë, duke çuar në rezultate të padëshiruara. Të përkthesh tekste juridike është, pra, një çështje gjenialiteti dhe kjo në shumë plane.

3.2. Formimi i përkthyesit ligjor

¹⁴⁸Gabimet në përkthimin ligjor mund të jenë nga më të larmishmet, dhe pasojat e gabimit mund të ndryshojnë në varësi të llojit të dokumentit dhe të kontekstit. Mohammed Didaoui ofron një përshkrim interesant të gabimeve në përkthim, në kontekstin e veçantë të Kombeve të Bashkuara. Shih *Les conséquences politiques, juridiques et commerciales de l'erreur en traduction*, Parallèles, nr. 19, 1997, fq. 45-62. Héctor Fix Fierro-i theksonte gjatë një takimi me të në Meksikë, në vitin 1997, se versioni spanjoll i rregullave të grupeve të veçanta ishte ribërë javët e mëvonshme, çka kishte çuar në hyrjen në fuqi të ALENA-s. Si pasojë e një rishikimi më të thellë, ajo u gjykua si jo e kënaqshme. Një version i ri u bë dhe u botua në Fletoren Zyrtare të qeverisë meksikane *El Diario Oficial de la Federación*. Pasoja politike, juridike, tregtare ose të tjera nuk janë njohur.

¹⁴⁹Jean-Claude Gémar, vepër e cituar, p. 309.

Studimi i elementeve që formojnë bazën nocionore të përkthyesit apo të aftësive të tij thelbësore na çon në përfundime nga më të ndryshmet. Specialistët e çështjes evokojnë shpesh kompetencat në lidhje me zotërimin e njohurive gjuhësore dhe me njohuri të ndryshme të fushave të specializimit. Në polin e kundërt gjejmë, madje, edhe në mesin e njerëzve të specialitetit, ata të cilët argumentojnë se kompetencat gjuhësore dhe njohja e aspekteve teorike të fushës nuk e ndihmojnë për asgjë përkthyesin në ushtrimin e përditshëm të profesionit të tij. Përkrahësit e një postulati të tillë argumentojnë se për të përkthyer, mjaftojnë vetëm disa njohuri të gjuhëve të huaja dhe të kemi disa fjalorë të mirë në dorë. Të tjerë sugjerojnë, gjithashtu, se përkthimi është një proces intuitiv që mbështetet në aftësinë krijuese të përkthyesit, ashtu si intuita mund t'u transmetohet përkthyesve në të ardhmen. Përballë tyre, janë ata që argumentojnë se vetëm ata që kanë një formim juridik mund të përkthejnë dokumente juridike.¹⁵⁰

Analiza e formimit ose e aftësive të përkthyesit ligjor kërkon krijimin e një baze paraprake aksiomatike. Kështu, konsiderojmë faktin që përkthimi ligjor është i mundur. Gjithashtu, jemi të mendimit se të flasësh për formimin ose kompetencat e përkthyesit juridik nënkupton një refuzim të parimeve sipas të cilave pretendohet se vetëm juristët mund të përkthejnë dhe se për të përkthyer është e mjaftueshme që të kihen disa njohuri dhe të përdoren disa fjalorë, ose se përkthimi është një proces intuitiv i drejtuar nga aftësitë krijuese të përkthyesit. Mospranimi i këtyre parimeve, nga ana tjetër, sugjeron se përkthyesi duhet të ketë një bazë të larmishme nocionesh. Mendojmë, gjithashtu, se mësimi i kësaj baze nocionore kërkon disa përgjithësime, dmth., formulimin e parimeve që mund të zbatohen në situata të shumta. Së fundi, e Drejta është e lidhur ngushtë me gjuhën dhe disiplinat e tjera, prandaj edhe studimi i gjuhës ligjore duhet të ketë një vend të rëndësishëm në formimin e përkthyesve ligjorë.

Qëllimi këtu nuk është të sugjerojmë përmbajtje për kurset e formimit; kjo do të ishte përtej fushëveprimit të këtij studimi. Qëllimi është për të sugjeruar aftësitë që do të udhëzojnë përkthyesin e ri dhe përkthyesin profesional, në interpretimin e kuptimit të tekstit burimor dhe rishprehjen e këtij kuptimi në gjuhën e synuar.

Analiza e kompetencave të përkthyesit kërkon, gjithashtu, përcaktimin paraprakisht të kuptimit të nocionit të përkthimit. Në këtë studim, ne do t'i përmbahemi teorisë interpretuese, e cila ndan procesin e përkthimit në dy faza: kapja e kuptimit nëpërmjet interpretimit të tekstit burimor dhe rishprehja e këtij kuptimi në tekstin mbërritës. Gjithashtu, do t'i përmbahemi teorisë funksionaliste se përkthimi mund të ketë

¹⁵⁰ Shih Paul Kussmaul, *Training the Translator*, 1995, fq. 1-3

një qëllim të ndryshëm nga ai i tekstit origjinal. E konsiderojmë përkthimin si një proces, në të cilin përkthyesi duhet të marrë një seri vendimesh, si në interpretimin e tekstit ashtu edhe në gjetjen e burimeve dhe proceseve që përdoren në rishprehjen e kuptimit në gjuhën mbëritëse.

Të përkthesh është, pra, procesi i zgjidhjes së problemeve, të cilat kërkojnë që përkthyesi të njohë parimet teorike dhe praktike të përkthimit. Në kreun e parë sollëm reflektime të përgjithshme mbi kontributin e teorive të ndryshme të përkthimit, duke u përqendruar në çështje të ndryshme si ato pragmatike, semantike, të gjuhësisë krahasuese, leksikografisë, strategjive të komunikimit, jurilinguistikës, të Drejtës krahasuese dhe disiplinave të tjera. Kontributi i këtyre teorive të ndryshme përbën, në fakt, parimet mbi të cilat përkthyesi mbështetet në marrjen e vendimeve. Përkthimi është një art dhe një shkencë që po ndryshon dhe përkthyesi duhet të ndjekë këtë evolucion.

Siç vë në dukje Kussmaul-i, ata që mburren se, për të përkthyer, janë të njohur disa njohuri të lëmit tekstor, si dhe gjuhët e përfshira në përkthim, nuk e bëjnë dallimin mes njohjes faktike dhe njohjes teknike. Me këtë ai nënkupton njohjen e gjuhëve dhe të terminologjisë së specializuar, njohjen e mënyrave, metodave dhe teknikave të përkthimit.¹⁵¹

Teksti ligjor është produkt i një kulture, i shkruar për një qëllim të veçantë në një kontekst të caktuar kohor dhe hapësinor. Nisur nga kjo, përkthimi ligjor nuk mund të jetë zbatimi i parimeve të përcaktuara në mënyrë universale. E Drejta, le ta themi sërish, është edhe produkt i një kulture edhe pasqyrimi i saj. Studentët e drejtësisë nuk janë të detyruar të mësojnë, për shembull, të gjitha ligjet e vendit të tyre. Përkundrazi, ata inkurajohen të mësojnë metodat dhe procedurat e interpretimit juridik, duke u lejuar që të zbatojnë të njëjtat parime për raste të ngjashme. Për të mësuar se si përkthehet, studenti-përkthyes (praktikanti) nuk është e nevojshme të njohë të gjitha problemet e natyrshme në fushën e përkthimit, por duhet të mësojë të njohë problemet e përgjithshme të fushës së tij të specializimit dhe të përdorë burimet, si edhe të bëjë zgjedhjen e saktë.

Elementet që hyjnë në përbërjen e kompetencës së përkthyesit, ose në *kompetencën përkthimore*, kanë qenë dhe janë gjithnjë objekte debatesh të forta. Në Kanada, Roda Roberts-i, profesore e përkthimit në Universitetin e Otavës, e cila mbështet teorinë interpretuese, ofron pesë aftësi që përbëjnë bazën themelore të kompetencës përkthimore për përkthyesët e ardhshëm. Këto aftësi janë: 1) aftësitë gjuhësore, aftësia

¹⁵¹Krahaso. *factual knowledge and procedural knowledge* .

për të kuptuar gjuhët e përfshira në përkthim, 2) kompetenca përkthimore, thënë ndryshe aftësia për të kuptuar artikulin e kuptimit të tekstit origjinal dhe përcjelljen e tij në gjuhën e synuar, pa shtrembëruar kuptimin e kompetencës dhe duke shmangur interferencat, 3) kompetenca metodologjike, ndryshe aftësia për të mbledhur informacion mbi një temë të veçantë dhe për të zotëruar terminologjinë e saj, 4) kompetenca disiplinare, ndryshe, aftësia për të përkthyer tekste që i përkasin një fushe të specialitetit. 5) kompetenca teknike apo aftësia për të përdorur mjete mbështetëse për përkthim të tilla si trajtimi, analizimi i tekstit.¹⁵²

Jean Vienne-i, profesor në Universitetin e Turku-t (Finlandë), mendon se modeli i Roberts-it redukton kompetencën përkthimore karshi aspekteve thjesht gjuhësore, përveç, pikës 5. Vienne parapëlqen qasjen funksionaliste të Reiss-it dhe Vermeer-it dhe huazon shumë nga elementet e tyre për të plotësuar propozimin e Roberts-it.

Pesë kompetencave të propozuara nga Roberts, Vienne u shton edhe katër, të cilat i quan "bërthamë e fortë" e kompetencës përkthimore. Duke u bazuar në teorinë e *Skopos-it*¹⁵³ Vienne propozon si kompetenca bazë: 1) aftësinë për të analizuar situatat e ndryshme të përkthimit, apo ndryshe aftësinë për të vendosur se çfarë masash u përgjigjen më mirë kërkesave dhe pritshmërive të porositësit, 2) aftësinë për të administruar dhe trajtuar informacionin, 3) aftësinë për të argumentuar me dhënësin e veprës për zgjidhje të përshtatshme në përkthim dhe 4) aftësinë për të bashkëpunuar me ekspertë në fushën me të cilën përkthimi lidhet¹⁵⁴.

Vienne thotë se përkthyesi, përveç në raste të rralla, nuk merr nga donatori mjaftueshëm informacion në lidhje me tekstin origjinal. Teoria e *Skopos-it* nënkupton parimin, sipas të cilit, përkthimi mund të ketë një qëllim të ndryshëm nga ai i tekstit origjinal. Përkthyesi duhet të përcaktojë me porositësin situatën e re të përkthimit. Ai duhet të shtrojë pyetje në lidhje me marrësin (për kë?), me kontekstin e përdorimit (cili është objektivi?) dhe për formën e përkthimit (cila formë?). Në shumicën e rasteve, ky dialog midis përkthyesit dhe porositësit nuk ndodh. Ne besojmë se ky dialog ndihmon, jo vetëm në marrjen e vendimeve mbi strategjitë e përkthimit që duhen adoptuar por, gjithashtu, lejon përkthyesin të fitojë besueshmëri në sytë e porositësit.

¹⁵²Roda P. Roberts, *Compétences du nouveau diplômé en traduction*, cituar nga Jean Vienne në *Vous avez dit compétence traductionnelle?*, Meta électronique, vol. XLIII, nr. 2, 1998.

¹⁵³Teoritë funksionaliste janë përshkruar në pikat 1.3.1 dhe 1.3.2.

¹⁵⁴Jean Vienne, *Vous avez dit compétence traductionnelle?*, Meta électronique, vol. XLIII, nr 2, 1998.

Kompetenca e dytë e propozuar nga Vienne, përqendrohet në njohuritë dhe përdorimin e burimeve më të përshtatshme. Në Kanada, përkthimi shoqërohet me burime dhe mjete që mundësojnë përkthimin. Këto burime përfshijnë programet universitare, qendrat kërkimore të së Drejtën krahasuese, si në atë të Universitetit të Moncton-it, programet qeveritare të tilla si Programi për administrimin e drejtësisë në të dy gjuhët zyrtare, Zyrën e përkthimit të qeverisë federale dhe bazat e të dhënave të terminologjisë. Kanadaja ka një common law në frëngjisht (CLEF) dhe një të drejtë civile në gjuhën angleze. Kjo u jep një ndihmë të madhe përkthyesve frankofonë. Në epokën e telekomunikacionit dhe internetit, një numër i madh i ligjeve dhe vendimeve të gjykatave janë në dispozicion dhe mund të shkarkohen falas. Në vitet e fundit, revista Meta boton artikuj shumë interesantë.

Një burim ndihme për një përkthim të shkëlqyer është edhe *Termium*-i, banka e të dhënave të terminologjisë e Zyrës së përkthimit të qeverisë federale, e cila me siguri është një nga bazat më të dhëna më të mëdha gjuhësore në botë. Ajo aktualisht përmban rreth tre milionë terma anglisht dhe frëngjisht, nga të gjitha fushat ¹⁵⁵. Një komponent në spanjishte është shtuar disa vjet më parë, por ai ka vetëm njëqind mijë terma, termat juridike zënë vetëm një përqindje të vogël. *Termium*-i është një bazë të dhënash me pagesë, por burimet që ajo ofron për ata që punojnë në kontekstin e industrive gjuhësore janë aq të mëdha sa që ia vlen pajtimi në të.

Sa për përdorimin e burimeve të përshtatshme, është e rekomandueshme që përkthyesi ligjor të shfrytëzojë burimet e shkruara në gjuhën e tij amtare. Për shembull, gjatë përkthimit të një teksti me përmbledhje ligjesh, rekomandohet që përkthyesi të njohë mirë paraprakisht dhe të lexojë ligjet e sistemit juridik të kulturës pritëse. Gémar-i thekson rëndësinë e përdorimit të fjalorëve njëgjuhësh dhe të atyre dygjuhësh vetëm si mjet i fundit. Siç vë në dukje Vienne-s, leximi " i teksteve të hartuar nga juristë në gjuhën amtare është [...] e vetmja rrugë e vërtetë për të mos bërë gabime interferenciale [...] kurth i madh për çdo përkthyes, si profesional, si rishtar ".¹⁵⁶

Kompetenca e tretë e Vienne-s justifikohet me nevojën për sqarim apo shpjegim të zgjedhjes, sidomos të asaj terminologjike, bërë gjatë përkthimit. Aftësia e katërt është propozuar për shkak të shkallës në rritje të specializimit të teksteve të prodhuara në fusha të ndryshme. Përkthyesi duhet të bashkëveprojë me specialistë për të kuptuar e shpjeguar, në gjuhën e burimit, jo fjalë, por koncepte, nocione dhe mekanizma para se të përkthehen në gjuhën e synuar. Përkthyesit duhet të kuptojnë mirë në mënyrë që të përkthejnë mirë.

¹⁵⁵*Termium*, Po aty, fq. 4.

¹⁵⁶Po aty, fq. 4.

Keto kompetenca përbëjnë një bazë nocionore dhe teknike mjaft të fortë. Megjithatë, këtyre kompetencave u duhet shtuar zotërimi i mjeteve të cilat, në më pak se dy dhjetvjeçarë, kanë ndryshuar përgjithmonë mënyrën tonë të të punuarit, dhe kjo ka ndodhur në pothuajse në të gjitha fushat. Në të vërtetë, përkthyesi bashkëkohor duhet të ketë njohuri teorike dhe praktike në lëndën e teknologjisë së informacionit. Konsultimi me specialistë, megjithëse i dëshiruar, nuk është gjithmonë i mundur, ata rrallë janë të interesuar ose në dispozicion. Teknologjitë e informacionit, sidomos interneti, u japin të gjithëve burime të paimagjinueshme. Megjithatë, duhet ditur se si të përdoren këto burime dhe të bëhet dallimi mes burimeve të besueshme dhe të atyre që nuk janë të tilla.

Burimet gjuhësore në internet, banka e të dhënave e terminologjisë, glosarët e specializuar, leksikët dhe artikujt e gazetave të specializuara nuk mungojnë. Megjithatë, mungon në shumicën e burimeve terminologjike, riprodhimi i kontekstit dhe treguesi i fushës në të cilën shfaqen termat e trajtuara¹⁵⁷. Një nga burimet më revolucionare të internetit janë grupet e diskutimeve, ku njerëzit mund të shkëmbejnë informacion dhe të bëjnë pyetje. Ky forum i ri për shkëmbime thyen izolimin e përkthyesit, kudo që ai gjendet¹⁵⁸. Për shkak të numrit të tyre në rritje dhe të natyrës gjithnjë e më të larmishme, këto burime meritojnë të analizohen në leksionet e formimit të përkthyesve.

Një tjetër kompetencë që duhet të arrijë përkthyesi i ardhshëm është përdorimi i softuerëve ndihmës në përkthim.

Duhet të theksohet se në ditët e sotme, njohuritë dhe aftësia për të përdorur një mjet për përkthim si Trados ose SDLX janë gjithnjë e më të kërkueshme kur punësohesh si përkthyes. Programet e përkthimit, me përjashtime të rralla, nuk e ofrojnë këtë lloj të trajnimit. Përkthyesët duhet të ndjekin evolucionin e teknologjise se informacionit, pasi gara e tyre kushtëzohet, në masë të madhe, nga njohuritë e mjeteve elektronike mbështetëse të përkthimit.

¹⁵⁷*Euridicautom* banka e të dhënave terminologjike të Komisionit Evropian, Fjalor i madh terminologjik i Zyrës së gjuhës frënge në Kebek dhe *Termium*, banka e të dhënave gjuhësore të Qeverisë së Kanadasë, janë banka terminologjike. Zërat e tyre përfshijnë informacione mbi kontekstin dhe fushën e përdorimit të fjalëve që ata identifikojnë. Megjithatë duhet pasur kujdes për sa i përket përdorimit të tyre në kulturën pritëse të përkthimit.

¹⁵⁸Lidhja <http://groups.yahoo.com/group/jobs-translators/> i korrespondon një grupi diskutimi përkthyesësh të specializuar në përkthimin spanjisht / anglisht. Anëtarët e këtij grupi shkëmbejnë informacione të të gjitha llojeve, tregojnë mundësitë e punësimit sidomos kërkojnë ndihmën e kolegëve. Përgjigjet e këtyre pyetjeve përbëjnë shpesh objekt debatesh frytdhënëse në internet.

Le të shtojmë, më në fund, rëndësinë që ka për përkthyesin profesional dhe përkthyesin rishtar njohja e bazave historike, filozofike dhe sociologjike të përkthimit të përgjithshëm dhe të përkthimit ligjor në veçanti. Në këtë studim, e filluam diskutimin tonë me një historik të përgjithshëm të përkthimit. E kemi quajtur me vend për të treguar evolucionin e kësaj disipline, sepse besojmë se është e rëndësishme të njohim të kaluarën për të kuptuar të tashmen dhe të kemi një ide të saktë të prirjeve të së ardhmes.

3.3. Kuptimi nëpërmjet interpretimit të tekstit

Reflektimi për kapjen e kuptimit të tekstit ligjor synon të plotësojë analizën tonë mbi aftësitë e përkthyesit. Për shkak të karakteristikave gjuhësore të teksteve me përmbajtja juridike, dhe sidomos të legjislacionit, shpesh është i vështirë kuptimi i këtyre teksteve. Kjo mund të shpjegojë arsyen pse shumë përkthyes i ngjisin tekstit origjinal atë që na dhuron si rezultat një tekst shprehja e të cilit është mjaft e kufizuar dhe burimet e gjuhës së synuar nuk janë shfrytëzuar plotësisht. Shqetësimi për besnikëri ndaj tekstit origjinal është përdorur shpesh për të justifikuar përkthyesët që i qëndrojnë besnikë fjalëve.

Duke e konsideruar barasvlerën si përcaktuese të përkthimit, jemi të mendimit se përkthyesi duhet të kërkojë një tekst, i cili të pasqyrojë kuptimin e origjinalit, duke përdorur deri në maksimum burimet e gjuhës dhe të kulturës përftuese. Me fjalë të tjera, procesi i përkthimit është një proces ku duhet të kihet parasysh kuptimin i mirë i tij në gjuhën zanafillore, për të prodhuar një tekst të përkthyer që plotëson një funksion të dhënë në një kulturë pranuese, ku ky funksion, gjithashtu, mund të jenë i ndryshëm nga ai i tekstit origjinal.

Lidhur me analizën e kuptimit të tekstit origjinal dhe rishprehjes së tij në gjuhën e synuar, studimi do të ndërtohet mbi punën e Danica Seleskovitch-it, të Marianne Lederer-it dhe asaj të Gémar-it. Seleskovitch-i dhe Lederer-i mendojnë se të përkthesh nuk do të thotë të transkodosh, por të kuptosh dhe shprehësh kuptimin, atë çka ato e quajnë si *dëshira për të thënë e autorit*. Gémar-i, ndërkohë, sugjeron se teksti i përkthyer duhet të pasqyrojë saktësisht letrën, d.m.th., përmbajtjen dhe shpirtin e tekstit origjinal, që do të thotë, mbajtësen (gjuha që shpreh atë).

Vlen të theksohet, gjithashtu, se koncepti i besnikërisë, sipas Gémar-it, është krejt i shkëputur nga nocioni i vjetër i besnikërisë, i cili lidhej me tekstin origjinal dhe që e çonte përkthyesin në atë pikë sa teksti i synuar të mbante shenjën e tij. Seleskovitch-i dhe

Lederer-i shpjegojnë se çfarë kuptojnë me besnikëri përkthimi dhe përqëndrohen në atë që ka rëndësi në përkthim dhe në hapat që duhen ndjekur për t'ia dalë mbanë.

Për të përkthyer nuk është e mjaftueshme vetëm të kuptosh atë që duhet përkthyer. Duhet që, atë që kuptoni, ta bëni të kuptueshme për të tjerët. Procesi i përkthimit është i ndarë në dy pjesë, në kapjen e kuptimit dhe në shprehjen e tij. Në këtë fazë të dytë përkthyesi shprehet, flet si autori para tij, si dhe të gjithë ata që flasin gjuhën e tyre. Por *të shprehesh* nuk do të thotë gjithmonë *të jesh apo të bëhesh i kuptueshëm*. Të përkthesh ndershmërisht, të përkthesh besnikërisht do të thotë, nga ana tjetër, të kërkosht të bëhesh i kuptueshëm dhe të bëhesh i kuptueshëm nënkupton të gjesh shprehjen e duhur.¹⁵⁹

Për ta përmbledhur, sipas këtyre autorëve, të përkthesh do të thotë të riprodhosh kuptimin ose atë çka dashur të thotë autori, dhe për të bërë këtë duhet, së pari, të kuptojmë dhe pastaj të kërkojmë mënyrat për t'u bërë të kuptueshëm. Por të kapësh kuptimin është një proces i ndërlikuar, sepse përkthyesi, përveç përjashtimesh të rralla, nuk ka asnjë kontakt me autorin e tekstit. Atij i duhet, pra, ta kapë vetë kuptimin nisur nga vetë teksti, që do të thotë se vetë ai duhet të interpretojë tekstin. Në fushën juridike, George A. Legault-i saktëson se "meqë burimi i së drejtës nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt për të ditur kuptimin e saktë të këtij neni apo të kësaj klauzole, arti i interpretimit juridik është për të përcaktuar kuptimin e ligjit, dhe qëllimi i supozuar i ligjvënësit për të analizuar formën e shkruar"¹⁶⁰.

Të gjesh se çka dashur të thotë autori është një ushtrim që kërkon kompetencat e përkthyesit në rrafshet gjuhësore, juridike dhe jashtë-gjuhësore. Ashtu si studentët e Drejtësisë, të cilët mësojnë për të interpretuar tekste juridike qysh në vitet e para të formimit të tyre, edhe përkthyesi i ardhshëm duhet të marrë, gjithashtu, një formim në interpretimin e teksteve. Shqetësimi i përkthyesit është t'i gjejë kuptimin tekstit origjinal për t'i dhënë atij, në formulimin e gjuhës së synuar, barasvlerësin gjuhësor më të saktë. Juristi, nga ana tjetër, e interpreton tekstin për t'i kapur kuptimin dhe rëndësinë juridike. Edhe pse objektivat e të dyve janë të ndryshme, të dy kanë një qëllim të përbashkët, gjetjen e kuptimit të vërtetë të tekstit ligjor.

Mbi interpretimin e tekstit, si një proces që çon në kapjen e kuptimit, do t'u referohemi punimeve të Seleskovitch-it dhe Lederer-it si dhe metodave të propozuara nga Gémar-i. Seleskovitch-i dhe Lederer-i, siç u përmend më sipër, vërejnë se përkthimi

¹⁵⁹ Danica Seleskovitch et Marianne Lederer, *Interpréter pour traduire*, Paris, Didier Erudition, 1986, fq. 31.

¹⁶⁰ Georges A. Legault, *Fonctions et structure du langage juridique, Meta*, 1979, fq.19.

është një përçapje në dy hapa: Kapja e kuptimit të tekstit origjinal dhe rishprehja në gjuhën e synuar. Gémar-i, ndërkohë, ndan vizionin e Seleskovitch-it dhe Lederer-it përsa u përket dy fazave të përkthimit, por bën një dallim midis kuptimit dhe domethënies. Për të, kuptimi kapet gjatë fazës së parë nëpërmjet interpretimit të tekstit. Kapja e domethënies arrihet edhe nëpërmjet interpretimit¹⁶¹ të tekstit, por ajo është më e lartë se niveli i kuptimit, dhe sqarohet përfundimisht vetëm në fund të procesit.

Le të saktësojmë se qasja e propozuar nga Gémar-i kërkon një mënyrë interpretimi të përgjithshme të tekstit, por edhe një mënyrë të të mësuarit autodidakt dhe të vetëzhvillimit. Kjo qasje ka si qëllim t'i japë tekstit përfundimtar kuptimin dhe domethënien e tekstit origjinal, në një mënyrë të kënaqshme dhe të ofrojë një estetikë të caktuar. Duhet theksuar se, ndryshe nga fusha letrare, ku estetika e tekstit është e lidhur me dykuptimësinë që përkthyesi duhet të riprodhojë¹⁶², estetika e tekstit ligjor është më tepër e pasqyruar nga qartësia dhe thjeshtësia e saj. Gémar-i, për shembull, është partizan i thjeshtësisë dhe i së natyrshmes, çka nënkupton tekste të menuara mirë dhe të hartuara e redaktuara mirë¹⁶³.

Siç u vu në dukje më sipër, analiza e Seleskovitch-it dhe Lederer-it ka si bosht kryesor faktin se ne nuk përkthejmë një gjuhë, por një ligjërim. Ata janë të mendimit se ashtu siç nuk flasim pa pasur si qëllim komunikimin, ne nuk mund të dëgjojmë apo lexojmë pa kuptuar diçka, d.m.th, pa interpretuar¹⁶⁴. Ata, pra, e perceptojnë përkthimin si një seksion të ndërmjetëm midis asaj çka ka dashur të thotë autori dhe asaj që interpreton lexuesi, në këtë rast përkthyesi. Por ajo çka dëshiron të thotë autori dhe interpretimi që i bën përkthyesi leximit të tekstit duhet të jenë në thelb të njëjta. Me qëllim që përkthyesi të mund të arrijë një interpretim korrekt të kuptimit të tekstit, Seleskovitch-i dhe Lederer-

¹⁶¹Kur Seleskoviçi dhe Ledereri flasin për *signification* (domethënie), ata e kanë fjalën për *signification linguistique* (kuptim gjuhësor), çka është kuptimi i fjalëve jashtë përdorimit që është fakt në të folur apo në ligjërim. Për këto autorë, termi *sens* (kuptim), siç kuptohet në këtë hulumtim është kuptimi që gjendet te e folura, mbështetur te *domethënia gjuhësore*, por shkon përtej tij, është tërësi e teksti që zbulon kuptimin e plotë të tekstit.

¹⁶²Shih Louis Jolicoeur, *La sirène et le pendule*, 1995, fq. 24-27.

¹⁶³Me *tekste të menuara mirë dhe të hartuara mirë*, Gémar-i referohet tekstit juridik ideal ose përkthimit që shkon përtej kufijve të pranueshmërisë. Ai flet, në fakt, për përkthimin e zhveshur nga çdo gjurmë e gjuhës origjinale. Në shtojcën F të vëllimit të dytë të veprës *Traduire ou l'art d'interpréter*, Gémar-i përfshin një tekst fillestar, versionin frëngjisht të tij dhe versionin e rishikuar. Versioni i rishikuar, më i shkurtër se përkthimi, i ngjan më tepër një ushtrimi për t'u rishikuar. Gémar-i duket se tregon dallimin në mes kuptimit dhe domethënies.

¹⁶⁴Seleskovitch-i dhe Lederer-i me *discours* (ligjërim) ose *parole* (fjalë) kuptojnë "lidhjen e fjalëve të veçuara, njërën me gjendjen në të cilën është shqiptuar, dhe tjetrën gjatë tekstit prej të cilit ajo është nxjerrë, " vepër e cituar, fq. 16.

i propozojnë një qasje që mbështetet mbi njohuritë thelbësore që ai duhet të ketë, me fjalë të tjera përkthyesi duhet të njohë temën, të ketë njohuri gjuhësore dhe jashtë-gjuhësore.

Kjo qasje, për të kapur kuptimin, përfshin një proces të pavetëdijshëm apo perceptim të tekstit, dhe një proces të vetëdijshëm, që do të thotë, përpjekje për të rrokur kuptimin e tekstit. Dy autorët e përcaktojnë kuptimin si "takim në frymën e formulimit gjuhësor që ne shohim në letër, dhe njohuritë që kemi për të lexuar¹⁶⁵." Seleskovitch-i dhe Lederer-i e perceptojnë fjalorin si një mjet ndihmës të vlefshëm, por si Gémar-i, ata janë të kujdesshëm ndaj propozimeve që janë ofruar.

Ata sugjerojnë qasjen interpretuese, e cili bazohet në parimin se nuk ka asnjë përkthim jashtë kuptimit, dhe se ky nuk mund të arrihet vetëm nga njohuritë e gjuhës, dhe njohuritë e fushës, si edhe nga elementet e përfshira në transformimin e gjuhës në ligjërim, d.m.th., të situatës¹⁶⁶ dhe kontekstit, ky i fundit i ndarë në kontekst gojor (verbal) dhe kontekst njohës (konjitiv). Kjo pjesë e dytë interpretuese e metodës së Seleskovitch-it dhe Lederer-it nuk do të jetë objekt i studimit tonë, sepse ajo është më e zbatueshme për llojet e tjera të përkthimeve, duke përfshirë edhe përkthimin simuluan (të aty-për-atyshëm).

Qasja interpretuese e tekstit e propozuar nga Gémar-i është e bazuar në parimin, sipas të cilit përkthyesi duhet të rishprehë në gjuhën dhe sistemin juridik pritës, kuptimin që ka në gjuhën dhe sistemin juridik nga gjuha që përkthehet. Që përkthyesi t'ia dalë mbanë për të shprehur kuptimin sa më saktë që të jetë e mundur, Gémar-i sugjeron një analizë tekstuale për pesë nivelet e mëposhtme: semantike, sintaksore, gramatikore, leksikore dhe stilistike.

3.3.1. Analiza semantike

Analiza semantike e propozuar nga Gémar-i është një proces në tre hapa. Hapi i parë është zbatimi i dijes universale, apo i njohurive që ka çdo njeri. Hapi i dytë përdor njohuri paraprake të lexuesit, apo ndryshe bagazhin e tij njohës. Hapi i tretë është kuptimi i përfshirë në fjalorët, kuptim të cilin Gémar-i e quan *kallëzues të lirë (prédicat libre)* (dmth kuptimi që kanë të gjitha gjuhët në barasvlerës më shumë ose më pak të

¹⁶⁵Po aty, fq. 22.

¹⁶⁶Elementi *situation* (rrethanë), për shembull, i referohet elementeve të perceptimit ndijor jo-gjuhësor të cilët ndërhyjnë në të njëjtën kohë me ligjërimin (gjestet e oratorit ...); ai i referohet, gjithashtu, hapësirës fizike ku zhvillohet ligjërimi.

përafërt), dhe kuptimi i kallëzuesit (predikatit) të lidhur, i cili është ai i kontekstit të dhënë¹⁶⁷. Hapi i dytë është gjuhësor, i pari dhe i treti lidhem me mekanizma jashtë-gjuhësorë.

Gémar-i propozon se, për të rrokur si kuptimin sipërfaqësor ashtu edhe atë të thellë të një teksti, ne duhet të largohemi nga konteksti gjuhësor i fjalëve dhe të shkojmë drejt gjërave, drejt atyre që ato përfaqësojnë. Për këtë, duhet që lexuesi të përdorë fillimisht pesë shqisat e tij për të dalluar kuptimet të cilat janë universale, njësoj si faktin se nëse gjethet e një peme lëvizin, kjo ndodh për shkak të erës. Në qasjen e Gémar-it, ky nivel kuptimi vendoset në nivelin e informacionit. Pastaj vjen niveli i dijes. Në këtë nivel, kuptimi është i qartë nga njohuritë më të thella, duke përdorur analizën sistematike apo mjete të tilla si kompjuter, fjalor, etj.

Interpretimi i kuptimit është një proces që shkon nga e përgjithshmja tek e veçanta. Sa më shumë përparon procesi i interpretimit drejt domethënies, aq më shumë shkojmë drejt specifikes, apo fushës së specialistit. Gémar-i krahason rritjen e kapjes së kuptimit drejt kapjes së domethënies me një kënd që do të ishte i sheshtë në fillim (kuptimi), dhe i ngushtë në fund (domethënia).

Si përfundim, niveli i domethënies së një teksti kushtëzohet nga shkalla e aftësisë ose e njohurive të lexuesit, kështu që ajo ndryshon nga një lexues te një tjetër. Të rrokurit e kuptimit dhe të domethënies është, pra, një çështje e leximit dhe e aftësisë për të kuptuar atë që lexojmë, në mënyrë që të interpretojmë atë që është thënë dhe për ta rishprehur, më pas, në gjuhën e synuar.

3.3.2. *Analiza sintaksore*

Ashtu si de Groot-i, Gémar-i thotë se në interpretimin e kuptimit të tekstit, përkthyesi vepron si komparatist (krahasues)¹⁶⁸. Në kapjen e kuptimit të tekstit, përkthyesi duhet të krahasojë si aspektet sintaksore ose makrostrukturën e tekstit, ashtu edhe aspektet gramatikore, d.m.th, mikrostrukturën e tekstit. Duke analizuar marrëdhëniet midis fjalëve ose grupeve të fjalëve (sintaksën) dhe strukturat e fjalive ose grupet e fjalive (gramatikën) të gjuhës burimore dhe të gjuhës së synuar, përkthyesi është në gjendje të krahasojë organizimin e përgjithshëm të secilës prej gjuhëve të përfshira në përkthim.

¹⁶⁷Shih Jean-Claude Gémar, *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995, fq. 188-190.

¹⁶⁸Shih pikën 2.3.3.

Në këtë analizë, vepra të tilla si ajo e J.P.Vinay-t dhe J.Darbelnet-it¹⁶⁹ janë shumë të dobishme për përkthyesët rishtarë në profesion. Gémar-i sugjeron se përkthyesi duhet, gjithashtu, të njohë metodat e analizës që ofron gjuhësia, si për shembull analizën e ligjërimin. Praktika e këtij lloji të analizës, edhe pse kjo merr shumë kohë, ndihmon përkthyesin që të gjejë më lehtë kuptimin e përgjithshëm të tekstit; në afat më të gjatë, sipas Gémar-it, përkthyesi fiton siguri dhe efikasitet.

3.3.3. Analiza gramatikore

Gémar-i pohon se gramatika jep informacion për funksionet e ndryshme të përbërësve të fjalisë si: folje, emra, nyje, etj., dhe se ky informacion lejon përkthyesin për të kapur çdo hollësi të tekstit. Kur përkthyesi e ka kuptuar tekstin, ai mund të rishprehë kuptimin duke ditur se duhet t'u nënshtrohet, në pothuajse të gjitha gjuhët, rregullave të gramatikës. Në gjuhën frënge, në varësi të rrethanave, ai mund të përdorë, për shembull, të tashmen e narracionit në vend të së kryerës së thjeshtë ose të së kryerës, por ai duhet të dijë gjithashtu se forma e thjeshtë e së kryerës në një gjuhë nuk i përkon domosdoshmërsht formës së thjeshtë të së kryerës në një gjuhë tjetër (siç ndodh me frëngjishten dhe spanjishten).

3.3.4. Analiza leksikore

Para përkthimit të një teksti të paraqitur, përkthyesi duhet të kryejë analizën leksikore. Kjo analizë, e cila *a priori* mund të duket e qartë, kërkon të menduar të thelluar. Duhet theksuar se çdo gjuhë ka mënyrën e vet të të përshkruarit të objekteve, realiteteteve ose koncepteve. Mjetet për të bërë këtë janë, gjithashtu, shpesh të ndryshme nga njëra gjuhë në tjetrën. Në fakt, analiza leksikore është baza e kërkimit të barasvlerësve gjuhësorë.

3.3.5. Analiza stilistikore

Këtu preket një pikë e rëndësishme e procesit të përkthimit, e cila është thelbësore për përkthimin ligjor.

¹⁶⁹Krahaso *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, 1958.

Frymëzuar nga përkufizimi që jep Grevisse-i në gramatikën frënge “Le bon usage”, Gémar-i tregon se stilistika trajton mënyrën e përdorimit të mjeteve të ndryshme të shprehjes, d.m.th. të burimeve të gjuhës. Kur analizohen elementet e ndryshëm të një teksti, stilistika lejon për të kuptuar më mirë nuancat kuptimore të fjalëve, frazave, apo edhe një libër.

Ajo që kërkojmë të bëjmë, duke përdorur mjete stilistike, është prodhimi i një efekti. Kujtojmë se teksti juridik, siç është shprehur Sparer-i, është projektuar për të detyruar ose për të provokuar sjellje. Për të arritur këtë qëllim, e Drejta përdor metoda stilistikore. Nëse teksti është dhënë me një stil të veçantë, për të arritur një qëllim të veçantë, mund të arrijmë në përfundimin se stili është mbajtësi i kuptimit dhe është e rëndësishme për ta vënë në dukje.

Analiza stilistikore i lejon përkthyesit të identifikojë regjistrat e ndryshëm të shprehjes dhe të identifikojë tonin e përdorur nga autori i tekstit origjinal; më pas ai do të mund të riprodhjë një tekst të ri, në përputhje me përdorimet e gjuhës së synuar dhe me fushën në fjalë.

3.4. Paqartësia (Dykuptimësia) në tekstet ligjorë

Gjuha e së Drejtës është plot me paqartësi, kjo nuk ka dyshim. Në pranverën e vitit 1995, në Evanstons në Shtetin e Uashingtonit, Shtetet e Bashkuara, gjuhëtarë dhe juristë u takuan për të dialoguar lidhur me temën e kuptimit në tekstet ligjore¹⁷⁰. Në vitin 1985, një takim tjetër i rëndësishëm, që bashkoi antropologë, poliglotë, profesorë anglishteje, psikologë, sociolingustë, gjuhëtarë dhe juristë u zhvillua në Universitetin Georgetown për të diskutuar për temën e vetme të gjuhës në kontekstin juridik¹⁷¹. Nga këto takime lindi lëvizja për thjeshtimin apo zhveshjen nga dykuptimësia e gjuhës së të Drejtës, e njohur në anglishte si *plain meaning movement*.

Po kjo natyrë e njëjtë e paqartë e teksteve juridike udhëhoqi Lawrence M. Solan-in të analizonte vendimet e Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara. Kërkimet e tij, që kishin të bënin me cilësinë e analizës gjuhësore të ligjeve të bëra nga gjyqtarët për të dhënë vendimin e tyre për rastet që kishin trajtuar, zbuluan fakte tronditëse.

¹⁷⁰ Shih Judith N. Levi, *What is Meaning in a Legal Text?: A First Dialogue for Law and Linguistics*, Washington University Law Quarterly, 1995.

¹⁷¹ Shih Judith N. Levi and Anne Graffan Walker (ed.), *Language in the Judicial Process*, 1990.

Solan-i vuri në dukje se gjyqtarët, shpesh, përdornin argumente gjuhësore për të justifikuar vendimet e tyre dhe se, këto argumente, nuk mbështeten në asgjë logjike, ata janë mjaft kontradiktore dhe pështjelluese. Analizat e tyre zbuluan, gjithashtu, se gjyqtarët dhe avokatët zbatojnë ose shmangen së zbatuari parime të së Drejtës, sipas asaj që këto parime mund të çojnë në padrejtësi ose në një fitore të çështjes.¹⁷² Prandaj, është e ligjshme të besojmë se fati i të pandehurit, shpesh, varet nga takti apo etika e juristëve.

Në sistemet juridike të traditës romake, ligji - burimi kryesor i së Drejtës - nuk mund të bëjë parashikime për të gjitha rastet e mundshme të shkeljes së ligjit. Në këto sisteme, drejtësia vepron sipas parimit filozofik të deduksionit, d.m.th., përpjekja për të mbuluar situata sa më shumta të jetë e mundur duke u nisur nga një *corpus* specifik i ligjeve. Zbatimi i këtyre ligjeve mund të çojë në rezultate të ndryshme, në varësi të strategjive të interpretimeve të përdorura. Sistemet juridike të traditës britanike nuk janë të imunizuara ndaj këtij parimi. Edhe pse zbatimi i ligjit është bërë kryesisht me induksion, d.m.th, duke u bërë rekurs disa gjykimeve paraprake të ngjashme ose jurisprudencës, kapja e kuptimit të këtyre teksteve udhëhiqet nga parimet e interpretimit.

David G. Reed-i vë në dukje se përkthimet juridike janë plot me pasaktësi. Megjithatë, ai nënvizon se këto pasaktësi, të cilat çojnë në dykuptimësinë e teksteve, shpesh përbëjnë gabime të perspektivës në lidhje me tekstin origjinal, sidomos në një lexim jashtë kuptimit të përgjithshëm të origjinalit¹⁷³. Nida thotë se paqartësia e teksteve është e lidhur shpesh me mungesën e njohjes së kontekstit kulturor dhe historik të këtyre¹⁷⁴. Edhe pse konsideratat e Nida-s lidhen me përkthimin e Biblës, ato gjejnë zbatimin e tyre të plotë në mjedisin juridik. Gjuha ligjore ka si karakteristikë kryesore të pasurit e një terminologjie të përcaktuar me kujdes. Dhe ky është paradoksi i madh: duke u shqetesuar për saktësinë, ajo (gjuha ligjore) përcaktohet kujdesshem ndaj një nevoje dhe rrethane të caktuar, por kjo i vlen nga njëra anë për të pasur një polisemi të bollshme dhe, nga ana tjetër, përshtypja se termat e përdorura mund të thonë diçka tjetër përveç asaj që ata duket se shprehin. Këto mund të çojnë në gabime të perspektivës për të cilat flet Reed-i.

Reed-i, gjithashtu, vuri në dukje se përkthimet e teksteve ligjorë nuk janë bërë në përgjithësi nga juristë, dhe se edhe kur ka ndodhur kjo, atyre shpesh u mungojnë

¹⁷²Shih Lawrence M. Solan, *The Language of Judges*, 1993.

¹⁷³Shih David Reed, *Problèmes de la traduction juridique au Québec*, Meta, vol. 24, n1 1, mars 1979, fq. 95.

¹⁷⁴Shih Eugene A. Nida et Jean de Waard, *From One Language to Another*, 1986, fq. 36.

njohuritë teknike në fushën e përkthimit. Juristi mëson, qysh në vitet e para të shkollimit, rregullat që drejtojnë interpretimin e teksteve ligjore, së pari në lidhje me kuptimin dhe pastaj krahasuar me efektet e së Drejtës.¹⁷⁵ Këto rregulla drejtojnë, për shembull: mënyrën se si të analizohet imtësisht një listë, që do të thotë se çfarë përfshin ose përjashton ajo, kuptimin e një fjale në raport me fjalë të tjera në kontekstin e menjëhershëm apo edhe ekskluzivitetin e mënyrës së ekzekutimit të diçkaje¹⁷⁶. Nëse këto rregulla janë të dobishme për juristin, ato duhet të jenë gjithashtu të dobishme edhe për përkthyesin.

Themi, megjithatë, se një tekst mund të jetë i paqartë në mënyrë vullnetare dhe kjo mund të ndodhë për shumë arsye. Paqartësia mund të jetë leksikore apo sintaksore. Dykuptimësia leksikore është futur në përgjithësi nga përdorimi i termave të cilat ndryshon kuptimi, d.m.th. nga përdorimi i termave shumëkuptimëshe. Didier-i analizon në mënyrë shumë interesante paqartësinë e shkaktuar nga polisemia. Ai njeh tri lloje termash, të cilët i rigrupon në dy kategori që janë: A) termat, kuptimi juridik i të cilave ndryshon dhe B) termat që kanë një kuptim juridik dhe një kuptim të zakonshëm.

Në grupi A, Didier-i dallon dy kategori termash: 1) terma njëkuptimëshe dhe 2) terma polisemike, me shumë kuptime. Në kategorinë 1), ai vuri në dukje: a) termat me një kuptim juridik të vetëm që janë specifike për një juridiksion (gjykatë), b) terma që janë të përbashkëta për disa juridiksione - ose sinonime - qoftë në të njëjtën familje të së Drejtës apo në më shumë. Në kategorinë 2) ai vuri në dukje: a) termat me një kuptim të veçantë në të njëjtin juridiksion, b) termat me një kuptim të veçantë në disa juridiksione dhe disa familje të së Drejtës dhe c) termat me një kuptim relativ në një ose disa juridiksione; në rastin e fundit, bëhet fjalë për hiperonime ose hiponime.

Në Grupin B, ose te termat që kanë një kuptim juridik dhe një të zakonshëm, Didier-i dallon dy kategori termash: 1) termat me një kuptim në gjuhën e përditshme dhe 2) termat që mund të ndryshojnë kuptimin në varësi të faktit nëse ato janë bartës ose jo të një dimensionit juridik. Në kategorinë 2) ai vë në dukje: a) termat e gjuhës së përditshme që kanë një kuptim juridik universal, që do të thotë në një gjykatë ose në një familje të Drejte të dhënë, b) termat me një kuptim universal të përbashkët ose me një kuptim juridik të kufizuar, qoftë në një gjykatë, qoftë në një familje të së Drejtës dhe c) termat me një kuptim relativ. Mund të bëhet fjalë për një term me një kuptim juridik, i cili

¹⁷⁵ Anglishtja dallon foljet *to construe* dhe *to interpret*. Në rastin e parë, bëhet fjalë për analizën e kuptimit gjuhësor dhe në të dytin, për analizën e efekteve ose pasojave juridike.

¹⁷⁶ Krahaso: Rregulla *Ejusdem generi*, që u përkasin radhës së termave. Shih: Leo Hickey, *Equivalence, Certainly. But is it Legal?*, Turjuman, vol. 2, nr. 2, Tetor1993, fq. 69-73.

përafron me kuptimin e përbashkët (p.sh. termi "*aliments* (ushqime)" ose një term i zakonshëm që i afrohet kuptimit juridik (p.sh. fjala "*amélioratin* (përmirësim)").¹⁷⁷

Didier-i, me këtë renditje, dëshmon për diversitetin e burimeve të dykuptimësisë leksikore të gjuhës së të Drejtës. Duhet vënë re se për të arritur një renditje, që përfshin nuanca të tilla delikate, kërkohen njohuri të një jete të dedikuar studimit të gjuhës së të Drejtës.

Sa për dykuptimësinë sintaksore, që do të thotë, për atë që del nga struktura e fjalisë apo paragrafit - jo nga krejt vepra siç pohon Jolicoeur-i - përkthyesi nuk mund të mbështetet përveçse në aftësitë e tij. Për ta¹⁷⁸ përçuar atë në tekstin përfundimtar, ai mund të kërkojë, natyrisht, ndihmë nga kolegët, por ajo vetëm mund të identifikojë apo ta imagjinojë, sepse, siç ka deklaruar Reed-i, përkthimet janë plot pasaktësi, të cilat janë futur shpesh nga një perceptim i rremë i përkthyesit.

Por çfarë duhet bërë me dykuptimësinë? Prirja aktuale, ndryshe nga e kaluara¹⁷⁹, është që dykuptimësinë ta kalojmë edhe në tekstin e synuar. Për ta bërë këtë duhet, së pari, të jemi në gjendje ta identifikojmë. Leo Hickey, për shembull, argumenton se përkthyesi nuk duhet të jetë i paaftë në atë masë që të mos mund ta zbulojë, apo ta shpërfillë deri në atë masë që të mos e përçojë në gjuhën pritëse. Për të kaluar atë çka nuk është e qartë, duke përkthyer një tekst nga anglishtja në spanjishte, Hickey sugjeron që të përkthehet fjalia duke e nisur nga fundi. Kështu, fjalia *charitable associations and schools...* duhet të përkthehen kështu: *escuelas o instituciones de Caridad ...*¹⁸⁰. Kjo është një fjali që pasqyron dykuptimësinë e tekstit origjinal. Në këtë rast të veçantë, paqartësia në versionin spanjoll është bërë nga lidhëza "o", e cila mund të shënojë kufizim dhe përfshirje në të njëjtën kohë. Ndërkohë, *Caridad* mund të lidhet me njëren ose me tjetrën nga këto dy institucione, ose me të dy institucionet në të njëjtën kohë.

¹⁷⁷Shih Emmanuel Didier, *Langues et langages du droit*, 1990, fq. 113-114.

¹⁷⁸Krahaso Louis Jolicoeur, *La sirène et le pendule*, 1995, fq. 51-55.

¹⁷⁹Nida dhe Waard-i, për shembull, kundërshtojnë riprodhimin e paqartësisë në tekstin e synuar. Ata sugjerojnë që përkthyesi duhet të bëjë interpretimin më të mirë të tekstit origjinal dhe të tregojë poshtë faqes me shënime mundësitë e ndryshme. Shih: Eugene A. Nida dhe Jean de Waard, *From One Language to Another*, 1986, fq. 39.

¹⁸⁰Leo Hickey, *Aproximación didáctica a la traducción jurídica, La enseñanza de la traducción*, nën përgjegjësinë e d'Amparo Hurtado Albir, Publicacions de la Universitat Jaume I (Castellón, España), Campus de la Penyeta Roja, 1996, fq. 127-139, kolana « Estudios sobre la traducción », nr 3.

Zgjidhja, e propozuar nga Hickey, është vetëm një nga shumë rastet dhe nuk është marrë në mënyrë përshkruese ose normative. Një zgjidhje që leksikografët rekomandojnë gjithnjë e më tepër janë fjalorët, fjalët e të cilëve janë ekstrakte tekstesh të marra nga gjuha origjinale sesa tekste të përkthyer. Glosarët juridikë të Komunitetit Europian, për shembull, shpesh përfshijnë një fjali të plotë në tekstit ku shfaqet termi i listuar. Kjo lejon për të vëzhguar njësinë e kuptimit - termin në fjalë, i cila ka efektin e rritjes së besueshmërisë së përdorimit të termit, ashtu siç është propozuar nga glosari apo fjalori.

Takimet e grupeve për të lehtësuar gjuhën e së Drejtës do të vazhdojnë të zhvillohen, ndoshta, për të arritur qëllimin e tyre. A do të kenë sukses? Vështirë të parashikohet, sepse traditat dhe zakonet janë të rrënjësura tek njerëzit dhe, për këtë arsye, është më e vështirë për t'i ndryshuar. Ndërkohë, gjuha ligjore vazhdon të përdoret me të gjitha tiparet e zhvillimit që ka njohur gjatë mijëvjeçarit. Vetëm një formim i rreptë u lejon të gjithë përdoruesve për ta përdorur në mënyrën më të mirë të mundshme.

3.5. Metodatat e përkthimit

Metodat e përkthimit janë me interes themelor, sipas pikëpamjes së paraqitur këtu. Duke ndjekur qasjen interpretuese të kuptimit të teksteve juridike, jemi të mendimit se metodatat e përkthimit janë një nga rrugët për të kuptuar domethënien e tekstit origjinal dhe mënyra me të cilën përkthyesi rishpreh këtë kuptim në gjuhën e synuar, duke pasur parasysh marrësin dhe funksionin që ky tekst do të ketë në kulturën pritëse. Njohja dhe zotërimi i këtyre metodave të përkthimit do t'u lejojnë përkthyesëve përdorimin maksimal të burimeve të gjuhës synuese dhe t'u garantojnë porositësve rezultate, në përputhje me pritshmëritë e tyre. Propozimi i mësipërm nënkupton se disa metoda të përkthimit janë më të përshtatshme se të tjerat për një përkthim.

Metodat e përkthimit ¹⁸¹ përgjithësisht klasifikohen në dy grupe: metodatat e përkthimit të drejtpërdrejtë (literal) dhe metodatat e përkthimit të zhdrejtë (jo fjalë për fjalë). Metodatat e përkthimit të drejtpërdrejtë janë përdorur në pjesët ku gjuha origjinale dhe gjuha e synuar ndajnë kategori paralele, në aspektin e strukturës apo në atë konceptual. Prandaj, mesazhi i nisjes transpozohet lehtë në gjuhën e caktuar. Metodatat e përkthimit të zhdrejtë, ndërkohë, janë të nevojshme kur gjuha burimore dhe gjuha e synuar (pritëse) nuk ndajnë elemente në aspektin e strukturës apo në atë konceptual – janë ato që Vinay

¹⁸¹Metodat e përkthimit të sjella këtu janë të J.P. Vinay dhe J. Darbelnet-it, që i analizojnë në veprën e tyre *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, edhe pse janë përmendur teoricienë të tjerë. Shembujt e huazuar këtu nga këta dy teoricienë gjenden në faqet 46-54, 88-90 dhe 235-240.

dhe Darbelnet-i i quajjnë *paralelizëm strukturor dhe paralelizëm metagjuhësor*. Siç ka pohuar Didier-i, metodat e grupit të dytë shërbejnë për të zëvendësuar, në shkallë të ndryshme, pjesët e ligjëratës¹⁸².

Kjo renditje shënon drejtimin që përkthyesi mund t'i japë përkthimit të tij. Metodatat e përkthimit të drejtpërdrejtë, me përjashtim të përkthimit literal, i ashtuquajtur idiomatik, krijojnë tekste të orientuara drejt gjuhës dhe kulturës fillestare, ndërsa metodatat e përkthimit të zhdrejtë mund të prodhojnë tekste të orientuara drejt gjuhës dhe kulturës pritëse.

Vinay dhe Darbelnet-i ofrojnë shtatë metoda për përkthimin e përgjithshëm. Të vjetëruara dhe shpesh të kontestuara, këto metoda janë, edhe sot, një lloj kuadri metodologjik i përshtatshëm në substancë, pothuajse për çdo kombinim gjuhësh – të paktën për gjuhët kryesore të botës perëndimore. Në renditje rritëse, sipas shkallës së vështirësisë, këto metoda janë: huazimi, kalku, përkthim i fjalëpërfjalshëm, transpozimi (zhvendosja) (duke përfshirë edhe këmbimet), modulimi, barasvlera dhe përshtatja. Radha e vështirësisë është përcaktuar, sipas faktit, nëse metodatat e përkthimit janë të drejtpërdrejta apo të zhdrejta.

Disa prej këtyre metodave janë rimarrë nga teoricienët e përkthimit ligjor, me nuanca përsa i përket emrit të tyre dhe nganjëherë edhe natyrës që kanë. Le të përmendim, midis të tjerëve, Gémar-in, Didier-in, Pigeon-in dhe Sarçeviç-in. Kjo nënkupton se metodatat teknike të përkthimit të përgjithshëm janë të vlefshme edhe për përkthimin ligjor.

Në këtë pikë, Gémar-i pohon se parimet që drejtojnë përkthimin juridik janë të njëjta me ato që drejtojnë përkthimin e përgjithshëm, se mekanizmat luajnë të njëjtin rol dhe se, pavarësisht nga lloji i tekstit që do të përkthehet, qëllimi është gjithmonë kalimi i mesazhit të kuptueshëm për marrësin. Ai kujton, megjithatë, se në fund të fundit, përkthimi ligjor shmanget nga metodatat teknike dhe nga shqetësimet e formave të tjera të përkthimit dhe është "një disiplinë krejt më vete, origjinale në objektin e vet, shumë e ndërlikuar në diversitetin e të dhënave dhe në shumëllojshmërinë e gjerë të fushave që përfshin"¹⁸³.

¹⁸² Emmanuel Didier, *Langues et langages du droit*, 1990, fq. 250.

¹⁸³ Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique et son enseignement: aspects théoriques et pratiques*, 1979, fq. 37.

Në veprën *Traduire ou l'art d'interpréter*, Gémard-i fokusohet në katër metoda: përkthimi literal (ose ekuivalenca formale), përkthimi jo literal (ose ekuivalenca funksionale), huazimi dhe neologjizmi. Didier-i frymëzohet nga refleksionet e Vinay-t dhe Darbelnet-it, duke siguruar saktësi interesante për cilësitë dhe karakteristikat e mënyrave të përkthimit. Ai analizon metodat e përkthimit të drejtpërdrejtë, apo huazimit, kalkut dhe përkthimit të fjalëpërfjalshëm dhe metodat e tërthorta të përkthimit ose modulacionin, barasvlerën dhe përshtatjen¹⁸⁴. Pigeon-i fokusohet, kryesisht, në ekuivalencën funksionale. Sarçeviçi, ndërkohë, njih po të njëjta metoda të përkthimit, por përfshin, përveç metodave të përkthimit të drejtpërdrejtë, edhe transkriptimin dhe përkthimin fonologjike dhe grafik, të cilat janë në fakt lloje huazimesh të përdorura përgjithësisht midis thonjzave ose me shkronja të pjerrëta. Ajo specifikon se termat e futura kështu në gjuhën dhe kulturën pritëse janë të pranueshme, me kusht që ato të jenë atje tashmë të natyralizuara¹⁸⁵.

Barasvlera, e propozuar nga Vinay dhe Darbelnet-i, ndryshon nga ajo që analizon Gémard-i apo gjykatësi Pigeon¹⁸⁶. Ekuivalenca që propozojnë ata përkon me atë që ka gjuha mbërritëse, si një shprehje e ngurosur nga përdorimi. Bëhet fjalë, në fakt, për zgjedhjen e proverbave, shprehjeve, klisheve dhe shprehjeve të tjera të një natyre të ngjashme të cilat ushtrojnë, në gjuhën e synuar, të njëjtin funksion si shprehja e tekstit origjinal. Gémard-i, ndërkohë, e sheh ekuivalencën, sidomos ekuivalencën funksionale, si mënyrë të tërthortë në procesin e përkthimit *par excellence*, mënyrë e cila mundëson, pas një të ushtruarit interpretues të kuptimit të fjalëve, të rrokurit e domethënies së tyre.

Vinay dhe Darbelnet thjesht përcaktojnë shtatë mënyrat e përkthimit. Ata analizojnë, përveç, siç do ta shohim më poshtë, modulacionit, të cilit i mveshin virtyte. Gémard-i, i përshkruan kufizimet e teksteve të prodhuara nga metodat e drejtpërdrejta të përkthimit. Në veprën e cituar, Gémard-i krahason përkthimin e një paragrafi të bërë nga mënyrat e përkthimit të drejtpërdrejtë dhe përkthimit të po atij paragrafi të bërë duke përdorur metodat e përkthimit të tërthortë. Ai vuri në dukje se përkthimet literale shpesh janë "të papranueshme edhe nga ana e një makine përkthimi¹⁸⁷," pasi ato janë të kufizuara në të gjitha pikëpamjet. Për Gémard-in, ekuivalenca funksionale është metoda e përkthimit

¹⁸⁴Emmanuel Didier, vepër e cituar, fq. 248-251.

¹⁸⁵Susan Šar evi, *Translation of Culture-Bond Terms in Laws*, Multilingua, vol 4, nr. 3, 1985, fq. 127-133.

¹⁸⁶Krahaso, Louis-Philippe Pigeon, avokat dhe profesor i së drejtës kushtetuese, Universiti Laval (Kebek), artizan i projektit të përmirësimit të cilësisë së frëngjishtes juridike në Kebek.

¹⁸⁷Jean-Claude Gémard, *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995b, fq. 164.

që e kthen shkronjën dhe frymën e tekstit origjinal. Për Vinay-n dhe Darbelnet-in, është më tepër modulacioni që lejon për t'ia dalë me sukses.

3.5.1. *Huazimi*

Huazimi konsiderohet si metoda më e thjeshtë e të gjitha metodave të përkthimit. Ai mund të jetë leksikor, sintaksor ose semantik. Huazimi leksikor është i lehtë për t'u njohur. Siç e tregon vetë emri, ky ka të bëjë me huazimin ose përdorimin në gjuhën e synuar, të një termi që është i huaj për të. Huazimi sintaksor është gjithashtu i lehtë për t'u njohur. Bëhet fjalë në fakt për një formë të veçantë sintaksore, karakteristike për një gjuhë të huaj. Didier-i jep një shembull shprehjeje që përdoret nganjëherë në Kebek: *la personne que je sors avec (njeriu që dal me (të))*, në vend të *la personne avec laquelle je sors (njeriu me të cilin dal)*. Huazimi semantik, ndërkohë, ka të bëjë me dhënien e një kuptimi të ri një fjale që ekziston tashmë në një gjuhë. Në kontekstin e grupeve speciale dykombëshe të ALENA-s, termi spanjoll *panel*, i cili i referohet një tablele druri apo materialesh të tjera, ka marrë kuptimin e fjalës angleze *panel* që i referohet një grupi njerëzish që mbledhen për një qëllim të veçantë.

3.5.2. *Kalku*

Kalku është një rast i huazimit që përfshin kalkimin në gjuhë të huaj të planit leksikor ose sintaksor. Në rastin e parë, ne ruajmë sintagmën e gjuhës së origjinës duke përkthyer fjalë për fjalë. Rezultati është krijimi i një shprehjeje të re, apo ndryshe i një kalku shprehjeje. Vinay dhe Darbelnet-i na japin si shembull *Compliments de la saison*, përkthimin nga anglishtja të *Season's Greeting*.

Në planin sintaksor, kalku prezanton një ndërtim të ri. Shembulli i dhënë nga Vinay dhe Darbelnet-i është *science – fiction* nga anglishtja *science fiction* (fantashkencë). Ashtu si huazimi, kalku arrin shpesh të futet në gjuhën e synuar. Është, për shembull rasti i termit *thérapie occupationnelle (terapi profesionale)*, nga termi anglez *occupational therapy*. Ky term është përdorur shpesh në vend të termave *ergothérapie (ergoterapi)* dhe *réadaptation par le travail (ripërshtatje nëpërmjet punës)* të cilat janë ekuivalente të miratuara nga Komiteti për standardizimin e terminologjisë së shërbimeve sociale. Kalku është një nga mjetet për krijimin leksikor, një detyrë që nxjerr në pah punën e leksikografëve dhe jo të përkthyesve.

3.5.3. Përkthimi i fjalëpërfjalshëm

Përkthimi i fjalëpërfjalshëm, që Gémar-i e quan ekuivalencë formale, është rishprehja e tekstit fjalë për fjalë në gjuhën e synuar. Përmes kësaj metode, përkthyesi duhet të shqetësohet vetëm për shtrëngimet dhe detyrimet gjuhësore. Versionet që mund të përftohen fjalë për fjalë mund të jenë të pranueshme ose të papranueshme. Vinay dhe Darbelnet-i saktësojnë se përkthimi i fjalëpërfjalshëm është i pranueshëm, kur na jep një tekst të saktë dhe idiomatik. Ata e përshkruajnë atë si të papranueshëm kur përdorimi i tij na jep një tekst që nuk ka kuptim, apo që ndryshon kuptimin, me strukturë të huaj nga ajo e gjuhës së synuar, që nuk përkon me asgjë në gjuhën e mbëritur ose që është diçka e një niveli tjetër të gjuhës.

Seleskovitch-i dhe Lederer-i specifikojnë se përkthimi fjalë për fjalë, ose transkodimi mund të bëhet vetëm në rastet kur termat kanë të njëjtin kuptim, qoftë në aspektin e gjuhës, qoftë në atë të ligjërit. Termat që mund të transkodohen janë terma që kanë ekuivalentë të përhershëm, si shifrat, për shembull, kur shënojnë sasi, emrat e përveçëm dhe termat teknike. Kur transkodimi nuk është i mundur, ne duhet të kërkojmë mjete të tjera. Analizua më parë, që Seleskovitch-i dhe Lederer-i u përmbahen qasjes interpretuese të kuptimit të tekstit. Kjo do të thotë se ata e perceptojnë përkthimin si një proces me të cilin përkthyesi kërkon t'i japë frymën më tepër sesa shkronjën (formën) tekstit origjinal. Në fakt, ata theksojnë se përkthimi fjalë për fjalë është një term nënçmues në kohën tonë.¹⁸⁸

Ashtu si Seleskovitch-i dhe Lederer-i, Gémar-i pranon se përkthimi i fjalëpërfjalshëm është i mundur kur ka një përkitje fjalë për fjalë në të dy gjuhët e përfshira. Por ai, gjithashtu, vë në dukje se përkthimi literal mund të japë edhe rezultate që janë të pranueshme, megjithëse të kufizuara. Problemi i përkthimit të fjalëpërfjalshëm, shton ai, është se ai bashkon "njëkohësisht gabimet fjalë pas fjale, ato të kalkut dhe të huazimit, dhe se kjo shtrihet në disa nivele: sintaksore (struktura e fjalive), stilistikore (organizimin e fjalëve), leksikore (kalk fjalësh)"¹⁸⁹. Ai kujton një të vërtetë të madhe, e cila është tundimi konstant te përkthyesi për të përkthyer fjalë për fjalë, një prirje që i duhet rezistuar për shkak të të metave të lartpërmendura.

3.5.4. Zëvendësimi (transpozicioni)

¹⁸⁸Danica Seleskovitch et Marianne Lederer, *Interpréter pour traduire*, 1986, fq. 28.

¹⁸⁹Jean-Claude Gémar, *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995b, fq. 164.

Transpozicioni është zëvendësimi i një pjesë të ligjërit me një tjetër, duke u kujdesur që të mos ndryshojë kuptimi. Ky zëvendësim zakonisht prek llojet gramatikore të ligjërit. Ai përdoret si në përkthim, ashtu edhe brenda së njëjtës gjuhë. Vinay dhe Darbelnet-i japin si shembull : *Il a annoncé qu'il reviendrait (Ai njoftoi se do të kthehej)* që mund të rishprehet me *Il a annoncé son retour (Ai njoftoi kthimin)*. Këto dy fjali kanë të njëjtin kuptim, edhe pse ata janë të ndryshme nga ana sintaksore dhe stilistike. Transpozicioni mund të jetë i padetyrueshëm ose i detyrueshëm. Karakteri detyrues imponohet nga struktura e gjuhës së synuar ose nga mënyra se si shprehemi në atë gjuhë. Siç e tregojnë këta dy teoricienë, përkthyesi nuk mund të kthejë "*as soon as he gets up*" përveç se me shprehjen "*dès son lever* (me t'u ngritur)." Sigurisht, mund të thuhet edhe *dès qu'il se lève (sapo ngrihet, çohet)*, por kjo nuk do të ishte mënyra spontane dhe e përbashkët për ta thënë në frëngjishte.

Të dy autorë i japin kësaj metode përkthimi karakteristikën e një metode që operon në fushën gramatikore. Kjo e dallon atë nga modulacioni, i cili vepron në nivelin e mendimit. Për të treguar rolin e disa veprimeve të caktuara në gramatikën frënge, Vinay dhe Darbelnet-i ofrojnë transpozimin e përmbytur (transposition inversée). Me këtë metodë, është e mundur të përkthejmë një folje, në tekstin origjinal, me një emër, i cili shpreh, në përgjithësi, një veprim dhe jo një gjendje. Ja një shembull i përkthimit i arritur nëpërmjet zëvendësimit (transpozimit) të përmbytur:

"Canada has publicly demonstrated its inevitable involvement in the problem of Asia by accepting membership on the Indochine truce commission". Ja, versioni frëngjisht, nëpërmjet transpozicionit të përmbytur: *"Le Canada a démontré publiquement, en acceptant de faire partie de la commission d'armistice en Indochine, qu'il ne pouvait rester en dehors des affaires d'Asie"* ¹⁹⁰.

Zëvendësimi ndan disa karakteristika me modulacionin. Prandaj, ndonjëherë është e vështirë për të dalluar njërin nga tjetri.

3.5.5. Modulimi

¹⁹⁰J.P. Vinay et J. Darbelnet, *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, 1958, fq. 107-108.

Modulimi ka të bëjë me futjen në mesazh të një varianti në pikëpamje. Ky variacion është futur duke zëvendësuar një pjesë të ligjërit me një tjetër. Modulimi është përdorur në mënyrë që mesazhi i përkthyer të jetë në përputhje me frymën dhe praktikën e gjuhës së synuar.

Ashtu si transpozimi, ai mund të jetë i padetyrueshëm ose i detyrueshëm. Dallimi mes ë këtyre dy llojeve të modulimit, saktësojnë autorët, është çështje e shkallës. Nocioni i detyrimit përcaktohet nga frekuenca në përdorim, nga shkalla e pranimi të përdorimit, dhe nga leksikalizimi, pra ka të bëjë me përfshirjen e termit në fjalorë. Këto janë elemente që i njeh kushdo që zotëron dy gjuhë pune. Vinay dhe Darbelnet-i specifikojnë, nëpërmjet shembullit të mëposhtëm, se “*the time when*” nuk mund të përkthehet në frëngjishte përveç se me “*le moment où*” (çasti ku(r)). Në rastin e modulimit të padetyrueshëm, mungesa e ngulitjes së kategorive mendore apo atyre gramatikore mund të vendosë kur mund të përdoret kjo metodë.

Sipas autorëve, modulimi ka për funksion kryesor të veprjës në kategoritë e mendimit. Megjithatë, ata pranojnë se një ndryshim në kategoritë e mendimit mund të çojë në një ndryshim në kategoritë gramatikore. Prandaj, shpesh është e vështirë për të dalluar modulimin nga transpozimi.

Vinay dhe Darbelnet na japin njëmbëdhjetë lloje modulimesh të përshkruar në tabelën e mëposhtme. Emri i llojeve të ndryshme të modulimit shpjegon vetë variantin e përfutur. Shembujt e mëposhtëm tregojnë ndryshimin (variantin) në fjalë.

Tabela nr. 1. Tipat e Modulimit

	Tipi i modulimit	Teksti burimor (ang.)	Teksti mbërritës (fr.)
1	Abstraktja për konkréten (nga e përgjithshmja tek e veçanta)	... and I don't mean maybe (shq. ...dhe nuk dua të them ndoshta)	...et je ne plaisante pas (shq.... dhe nuk bëj shaka)
2.	Modulimi shpjegues (që mund të jetë i tipit shkak për pasojë, mjet për rezultat, ose substancë për objekt)	This baffles analysis (shq. Kjo i shpëton analizës)	Ceci échappe à l'analyse (shq. Kjo i shpëton analizës)

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

3.	Pjesa për të tërën	The Islands had been the scene of several attacks (shq. <i>Këta ishuj kishin qënë skena e shumë sulmeve</i>)	Ces îles avaient été le théâtre de plusieurs attaques (shq. <i>Këta ishuj kishin qënë arena e shumë sulmeve</i>)
4.	Një pjesë për një tjetër	He cleared his throat (shq. <i>Ai pastroi zërin</i>)	il s'éclaircit la voix (shq. <i>Ai kruajti (pastroi) zërin</i>)
5.	Përmbysja e termave	His clothes hung loosely around him (shq. <i>Veshjet i rrinin shumë të gjëra</i>)	Il flottait dans ces vêtements (shq. <i>Veshjet i rrinin shumë të gjëra</i>)
6.	I kundërti i mohuar (refuzuar)	Don't make me laugh (shq. <i>Mos më bëj të qesh</i>)	Laissez-moi rire (shq. <i>Lërmëni të qesh</i>)
7.	Kalimi nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë (ose e anasjellta)	Only a miracle saved the world (shq. <i>Bota shpëtoi veç nga një mrekulli</i>)	Le monde n'a été sauvé que par un miracle (shq. <i>Bota ka shpëtuar vetëm nga një mrekulli</i>)
8.	Hapësira për kohën	When my generation was writing poetry ... these youngsters are studying radio scripts (shq. <i>Kur brezi im thurte vargje...të rinjtë e sotëm shkruajnë vargje për radio</i>)	Alors que ma génération faisait des vers ... les jeunes d'aujourd'hui travaillent des textes pour la radio (shq. <i>Në kohën që brezi im thurte vargje... të rinjtë e sotëm krijojnë tekste për radion</i>)
9.	Çastet (Intervalet) dhe kufijtë (limitet) (në kohë ose në hapësirë)	a) For the period under review (shq. <i>Për periudhen në fjale</i>) b) No parking between signs (shq. <i>Nuk lejohet parkimi midis tabelave</i>)	a) Depuis notre dernier numéro (shq. <i>Qysh nga numri unë i fundit</i>) b) Limite de stationnement (shq. <i>Kufizim parkimi</i>)
10	Ndryshim simboli	He earns an honest dollar (shq. <i>I fiton lekët me djersë</i>)	Il gagne honnêtement sa vie (shq. <i>Ai e fiton jetën ndershmërisht</i>)

11	Modulimi i ngurosur nga përdorimi. Bëhet fjalë në fakt për barasvlerën) ekuivalencën, shprehje të ngurosur, klishe		

Është e rëndësishme të theksohet se përdorimi i modulimit, sidomos i modulimit shpjegues, shpesh kërkon të shtohet ose pasurohet. Siç sugjeron edhe emri i tyre, këto dy strategji të përkthimit kanë të bëjnë me shtim të elementeve që kontribuojnë në qartësimin ose saktësimin e një teksti të përkthyer.

3.5.6. Përshtatja

Përshtatja është metoda që ka të bëjë me të përshtaturit e një situatë me një situatë tjetër, kur ajo që është e përshkruar në tekstin origjinal nuk ekziston në gjuhën e synuar, ose kur ajo nuk përputhet me doket dhe zakonet e përftuesëve të përkthimit. Ky është rasti i shembullit: *Hi kissed his daughter on the mouth (Ai e puthi të bijën në buzë)*, që përkon me një gjest të zakonshëm, të lirë nga çdo prapamendim. Nëse ky veprim do të perceptohej keq në kulturën pritëse, fjalia mund të përkthehej *Ai e shtrëngoi të bijën gjithë dashuri me krahët e tij*. Përshtatja përdoret kur mundësia e përkthimit arrin kufijtë e saj.

Fusha juridike është një fushë ku përkthimi shpesh arrin kufirin e aktualizimit. Karakteri socio-kulturor i së drejtës, mes tjerash, bën që situatat që përshkruhen të mos jenë të barasvlershme ose të mos ekzistojnë në kulturën pritëse. Ekuivalenca, sidomos ajo funksionale, është një nga mënyrat e përdorura për të kthyer nocione ose realitete që nuk përputhen me gjuhën e tjetrit.

Njohja e metodave të ndryshme të përkthimit është baza e kompetencës teknike të përkthyesit. Në përkthimin juridik, kjo aftësi është e dyfishtë, madje e trefishtë në dimensionin e saj. E Drejta është një disiplinë e lidhur pazgjidhshmërisht me gjuhën, një gjuhë që i nënshtrohet normave që rregullojnë formën dhe përmbajtjen. Çdo sistem juridik ka një organizim të brendshëm dhe një gjuhë të vetën. Përkthyesi duhet, pra, të

njohë metodat që e lejojnë fillimisht të rrokë rëndësinë juridike të tekstit, të kapë kuptimin dhe domethënien e tekstit dhe, së fundi, të rishprehë rëndësinë dhe kuptimin e këtij teksti në gjuhën pritëse, sipas normave dhe përdorimeve të gjuhës dhe të sistemit juridik të kulturës pritëse.

KREU IV

ANALIZË KRAHASUESE E TEKSTEVE LIGJORË

4.1. Rëndësia e përkthimit ligjor

Përkthimi juridik është ndoshta një nga sfidat më të mëdha me të cilat ndeshet një përkthyes. Ashtu si dhe vetë ligji, që është një fushë në varësi të kulturës së një shoqërie, dhe përkthimi ligjor nuk është detyrë e lehtë.

Vetëm përkthyesit profesionistë, të specializuar në përkthim juridik, mund të përkthejnë dokumenta dhe shkrime ligjore. Përkthimi jo i saktë i një neni në një kontratë, për shembull, mund të sjellë probleme të mëvonshme.

Kur përkthehet një tekst brenda fushës së ligjit, përkthyesi duhet të ketë parasysh: nëse sistemi ligjor i gjuhës burimore është ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i përshtatet asaj kulture dhe të reflektohet në gjuhën juridike; në të njëjtën mënyrë, teksti në gjuhën mbërritëse do të lexohet nga dikush që është i njohur me një tjetër sistem ligjor dhe gjuhën e tij. Shumica e formave të shkrimit ligjor dhe kontratave në veçanti kërkojnë të vendosin qartë të drejta dhe detyrime të përcaktuara për individë të caktuar. Është e rëndësishme të sigurohet korrespondenca e saktë e këtyre të drejtave dhe detyrave, si në gjuhën e burimit ashtu dhe në atë të mbërritjes.

Përveç mungesave në terminologji apo leksik, përkthyesi duhet të fokusohet në disa aspekte si: konvencionet kontekstuale në gjuhën burimore janë shpesh në varësi të kulturës dhe mund të mos përkojnë me traditën e gjuhës në të cilën përkthehet. Strukturat gjuhësore, që gjenden shpesh në gjuhën burimore, nuk kanë struktura ekuivalente në gjuhën e përkthimit. Atëherë, përkthyesit i duhet të gjejë struktura në gjuhën e përkthimit me të njëjtat funksione si të gjuhës burimore.

Gjuha teknike në përgjithësi, dhe ajo ekonomiko-juridike në veçanti, është produkt i vetë zhvillimeve ekonomiko-shoqërore, nëpër të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare me të mirat dhe të metat e saj.

Kjo gjuhë lindi si nevojë e kohës për t'iu përgjigjur kërkesave, kryesisht të specialistëve për të komunikuar në një gjuhë teknike të përbashkët, për të përkthyer nga gjuhët e huaja dhe në gjuhë të huaja termat bashkëkohorë, pra, për të ecur me hapin e zhvillimeve të kohës.

4.2. Pak histori e përkthimit ligjor

Për historinë e Ilirëve, jepen disa të dhëna nga historianë e gjeografë grekë, romakë e bizantinë. Kështu, historiani i Romës së vjetër Tit Livi jep pak njohuri për organizimin shtetëror të ilirëve (shek IV-II para erës së re), por për të drejtën dhe gjuhën e saj në veçanti nuk janë të mjaftueshme burimet arkivore e bibliografike. Mund të përmendim kushtetutën e shtetit të Epirit (2977-262 para erës së re).

Pikëpamjet juridike u shfaqën në vendosjen e normave të së drejtës zakonore të pashkruar. Mendimi juridik në shtetin ilir e kishte bazën filozofike në mënjurinë popullore, bazuar në botëkuptime pagane, fetare, empirike, idealiste.

Në zhvillimin e juridiksionit shqiptar, gjatë këtyre shekujve, ka vepruar e ndikuar fuqishëm qytetërimi greko-romak e bizantin, ligjet si dhe kultura e tyre, që kishte nivele të larta. Ky proces filloi me pushtimin e Ilirisë nga Roma (167 para erës së re), kur dihet, që shteti dhe e drejta romake ishin mbi baza të forta filozofike e juridike.

Pas pushtimit bizantin që zgjati rreth 1000 vjet, ndikimet e legjislacionit (Kodit të Justinianit) u thelluan më tej.

Nga periudha e shkurtër e principatave të Arbërit kemi dëshminë se Dhimitri i Arbërit (fillimi i shek. XIII), bashkë me vasalët, lidhi me Raguzën një marrëveshje tregtare, e cila ishte akti i parë ndërkombëtar që njihet nga administrata e një sundimtari shqiptar. Pas shtetit të Skënderbeut, në administratën e të cilit figura kryesore ishte Pal Engjëlli, për shumë shekuj veprimtaria shtetërore në trojet tona është ushtruar nga administrata osmane. Njëkohësisht, në disa krahina kanë vepruar ligjet e pashkruara, kanunet.

Ndonëse kanunet janë mbledhur e rregjistruar vonë, nga kanunet lokale, më 1891 u botua ai i Kastratit, më 1890 u botua marrëveshja e Shalës me Nikajn, kurse Kanuni i Lekë Dukagjinit përgatitur nga Gjeçovi doli më 1935. Standardizimi gjuhësor, sado gojor, ndihej që ishte arritur.

Nga shek. XVII njihen kodikët ose kanonizmat e esnafëve: një e argjendarëve 1662-1900, e gëzoftarëve 1669-1884, e bojaxhinjve 1689-1895, që nisin në gjuhë të huaj e më pas përfshinin dhe shqipen. Për shek. XVIII dokumentohet që shkrimi ishte shtrirë në defterët e reshperëve; alfabeti i Todhrit përdorej nga tregtarët elbasanas në llogaritë e tyre.

Anëshkrime shqip ka mbi dokumentet turqisht; shqip janë radhonjtë e N. Sumës, letrat tregtare të A. Sumës dhe A. Muzanit, një aktdorëzim i 1845-ës; dokumentacioni i firmës tregtare Bianki - Çoba 1860 - 1915 është në fillim italisht e më pas shqip.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878) luftoi për një shtet shqiptar dhe prandaj problemi i gjuhës për këtë shtet doli që në hapat e para të saj. Në programin e botuar më 1878 thuhej:

"Gjuha osmane të mbetet si gjuhë zyrtare në korrespondencën dhe letërkëmbimin e vilajetit me Portën e Lartë. Megjithëkëtë në këshillat e gjykatave të përdoret gjuha shqipe dhe diskutimet të zhvillohen në këtë gjuhë."

Një nga kërkesat e Lidhjes së Prizrenit ishte krijimi i gjykatave të reja me gjykatës vëndës, që të gëzonin besimin e popullit, të mbështeteshin në praktikën e tyre, në normat e së drejtës zakonore shqiptare dhe jo në kodet e vështira turke. Rilindasit ia nënshtuan kritikës legjislacionin osman, i cili nuk i përgjigjej idealeve të tyre dhe nevojave të popullit shqiptar.

Pas reformave të Tanzimatit, sheriatit, i cili përmblihte ligjet myslimane fetare, civile, familjare, penale etj, të përpunuara në bazë të kuranit në fushën penale ishin zëvendësuar nga ligjet pozitive (Kodi Penal i vitit 1858), sipas modelit të shteteve kapitaliste.

Mendimet e rilindasve, për probleme të shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, kanë rëndësi të madhe për shkencën juridike shqiptare. Por faktet tregojnë se në pjesën më të madhe të vendit, në gjysmën e dytë të shekullit XX, vepronin me forcë zakonet dhe normat e pashkruara në të drejtën zakonore, të shprehura në vendimet e kuvendeve të malësorëve të viteve 1860, 1873, 1883, 1884, 1891 e deri në vitet 1907 e 1912.

Në maj 1879, Lidhja e Prizrenit hapi në Kosovë një gjykatore shqiptare, që u pranua nga autoritetet e Stambollit. "Radhuashkronja" e J. Vretos, 1889, ka dhe mënyën e mbajtjes së kontabilitetit. Kërkesat për ta futur shqipen në administratë e gjyqe tingellojnë me forcë në gjithë shtypin shqiptar në prag të Pavaresisë. F. Konica me 1901 botoi fjalë të reja, me qëllim që të krijonte të gjitha fjalët administrative dhe politike në gjuhën shqipe.

Rilindasit i kushtuan një rëndësi të madhe pastërtisë së gjuhës, ruajtjes së saj nga huazimet e panevojshme. Dokumentat e qeverisë së I. Qemalit, në nëntor 1912 në Vlorë, shënojnë hyrjen në fuqi të këtij stili në funksionin e vet kryesor. Shqipja u shpall gjuhë zyrtare më 23 shtator 1913.

Akti i parë legjislativ në fushën e organizimit gjyqësor kombëtar është Kanuni i Zhurisë 1913, ndërsa akti më i rëndësishëm ishte Kanuni i Përtashëm i administratës civile të Shqipërisë, nëntor 1913.

Bazat e gjuhësisë teknike moderne u hodhën me konsolidimin e shtetit të parë shqiptar në vitet '20 të shekullit të kaluar. Edhe pse gjuha shqipe, asokohe, qe ende e panjehsuar, ngritja e një sistemi modern ekonomiko-juridik kërkonte pranimin, përshtatjen dhe shqipërimin e ligjeve dhe termave të Evropës Perëndimore.

Në këtë kontekst, vlejnjë për t'u përmendur fuqizimi i një sërë ligjeve bazë, si p.sh. Kodi Civil, Kodi Tregtar etj. (të ashtuquajturat kodet e Zogut), bazë e së cilëve vërtet qenë kodet angleze, frënge dhe italiane por, megjithatë, ligjbërësit jepnin në pasqyrën e lëndës së kodeve lidhjet, madje edhe numrat e neneve korresponduese në kodet e disa vendeve të rëndësishme perëndimore.

Në këtë mënyrë bëhej i mundur një komunikim më i shpejtë dhe racional i juristëve shqiptarë, të cilët kishin studiuar në vende të ndryshme evropiane apo amerikane. Themelimi i Bankës së Shqipërisë, edhe pse me kapital italian, solli nevojën e përdorimit të një gjuhe ekonomike bankare, ndërsa futja e sistemit tatimor ndikoi në futjen e terminologjisë së tatimeve, si dhe në të kontabilitetit.

Është e qartë se, duke mos pasur traditë në këtë fushë, shqipja ekonomiko-juridike u ndikua shumë nga gjuhët perëndimore. Ndoshta lexuesi i sotëm do të haste vështirësi përdorimi me kodin civil të Zogut, jo vetëm për shkak të përpilimit të tij në dialektin geg, por sepse një mori fjalësh të huazuara nga ky kod e të përdorura në kodin civil të sotëm, përdoren në gjininë femërore ose gabimisht. Në këtë kontekst, po jap disa shembuj: "enfiteoza" (Kodi Civil), "enfiteusi" (italisht), "emfiteusis" (latinisht), "emfiteozi" (Kodi i Zogut); "testament ollograf" (Kodi Civil), "testament holograf" (Kodi i Zogut); "enviksioni" (Kodi Civil), "eviksioni" (Kodi i Zogut) "evictio" (latinisht). Terma të tjerë, si p.sh. "Gjykata e Diktimit", "diktimon" janë zëvendësuar sot respektivisht me "Gjykata e Lartë/Gjykata e Kasacionit" dhe "ankohet/ankimon" ose "ushtron rekurs në Gjykatën e Lartë".

Ende pa zënë mirë rrënjë terminologjia e monarkisë shqiptare, pas Luftës së II Botërore, gjuhësia, e sidomos ajo teknike, u përball me sfida të reja, këtë herë nga gjuhët sllave. Ristrukturimi i shoqërisë dhe ekonomisë sipas modelit socialist, solli një terminologji të re, e cila zuri vend kryesisht në fusha, deri atëherë të panjohura ose të pazhvilluara, si në ushtri, industrinë e rëndë dhe tekstile. Në fushën ekonomike dhe

juridike, duke e lënë mënjanë përmbajtjen, terminologjia nuk pësoi ndonjë ndryshim rrënjësor. Fjalë të tilla, si p.sh. "bilanci", "zërat e bilancit" (italisht "voci di bilancio"), "fatura" (italisht "fattura"), "llogaria" (greqisht "logarismos"), "konto" (italisht "conto"), "debiton", "krediton", "rakordon", "revizion", "revizor" (italisht "addebitare", "accreditare", "raccordare", "revisione", "revisore") etj., të cilat përdoren edhe sot si terma të kontabilitetit, mbetën të pandryshuara.

Madje, njësimi i shqipes në vitin 1974, si dhe përdorimi "de jure" i një shqipeje standarde në të gjithë hapësirën shqipfolëse, solli një përparim të madh në fushat që flasim.

Në kuadrin e standardizimit gjuhësor, u bënë arritje edhe në fushën e leksikologjisë. Botimi i parë i Fjalori i Shqipes së Sotme (1981), e më pas fjalorët disagjuhësh teknikë, juridikë, ekonomikë, tregtarë etj., edhe pse me kufizime, e madje duke e mënjanuar anglishten, qenë megjithatë frut i një pune të madhe të Institutit të Gjuhësisë. Përdorimi i detyruar i shqipes standarde në media ushtroi, nga ana e vet, një ndikim të dukshëm në konsolidimin e terminologjisë së atëhershme.

Një kthesë rrënjësore mori jo vetëm gjithë shoqëria shqiptare në përgjithësi, në periudhën paskomuniste por, bashkë me të, edhe gjuha shqipe. Në vazhden e një transformimi të shpejtë të ekonomisë kombëtare nga një ekonomi e planifikuar në ekonomi tregu, terminologjia e kësaj fushe pësoi ndryshime të ndjeshme e, fatkeqësisht, shumë herë duke iu shmangur jo vetëm traditës gjuhësore të deriatëhershme, por edhe duke thyer normat më elementare sintaksore, morfologjike e drejtshkrimore.

Marrja e sistemit të kontabilitetit frëng në fillimin e viteve '90 solli në terminologjinë dhe gjuhën ekonomiko-juridike shqipe, së paku për një kohë shkurtër, një farë puritanzmi karakteristik për gjuhën frënge. Kështu p.sh., duke iu referuar ligjit për kontabilitetit (1993), termi "mjetet kryesore të ndërmarrjes" zëvendësohet me "aktive të qëndrueshme" (të trupëzuara dhe jo të trupëzuara), në një kohë që në të folmen e qeveritarëve përdoret rëndom anglicizma "asetet fikse" (anglisht "asset"). Zëri i pasivit të bilancit "shuma të parashikuara për rreziqe" përdoret edhe në formën "provigjon" apo edhe "provixhon" (anglisht "provision"). Termi "ekspert kontabël" (frëngjisht "expert comptable") dhe "audit/auditor" (anglisht "auditor") mund të zëvendësoheshin me terma me brumë të shqipes.

Teksa në ligjet e Zogut përkthyesi ose specialisti jepte, për terma të rinj specifikë, në kllapa, shënimin në gjuhën e origjinës dhe në pasqyrën e lëndës edhe nenet në kodin e origjinës, kur lexon ligjet ekonomike shqiptare të sotme, duhet shumë herë ose të

hamendësosh ose të gjesh "originalin" në gjuhë të huaj për të kuptuar se për çfarë bëhet fjalë.

Përballë vërshimit pa kriter të termave të huaj në shqipe, vërehen fatkeqësisht, nga njëra anë, një tërheqje e plotë e shtetit shqiptar nga detyrimi i tij kushtetues për mbrojtjen e gjuhës kombëtare, një apati e institucioneve gjuhësore e, nga ana tjetër, një zhvillim të gjuhësisë terminologjike.

Një përkthyes i mirë i teksteve ligjore duhet të zotërojë jo vetëm zhargonin ligjor, por duhet të njohë dhe historinë e Evropës dhe të Anglisë, në rastin e përkthimit nga anglishtja. "Common Law" dhe "Civil Law" janë dy sistemet ligjore kryesore të botës perëndimore. Asnjë përkthim fjalë për fjalë i këtyre termave nuk do ishte i kuptueshem, pasi është e pamundur t'i kapësh të gjitha kuptimet, konceptet dhe trashëgimitë kulturore me thjesht dy fjalë. Për këtë arsye, këto terma njihen si sistemet ligjore "common law" e "civil law".

Teksti ligjor është ndryshe nga e folura e zakonshme. Kjo është e vërtetë më tepër për tekstet me fuqi ligjore, të cilat krijojnë, modifikojnë ose përfundojnë të drejtat dhe detyrimet e individëve dhe institucioneve. Tekstet me fuqi ligjore janë të llojeve të ndryshme. Ato përfshijnë dokumenta të tilla si: Kushtetuta, Procese Gjyqësore, Ligje, Akte normative të Këshillit të Ministrave, Marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara, Kontrata, Akte shitblerjeje, Urdhra, Vendime/dekrete etj.

Secili nga keto zhanre ka tendencën të ketë formatin e tij stereotip, shkruhet zakonisht në gjuhë ligjore ose e ashtuquajtura "legalese" dhe përmban, zakonisht, akte ligjore që kryejnë funksionet për të cilat janë shkruar. Kështu, një kontratë përmban një ose disa premtime dhe një akt dhurimi ose një akt shitblerjeje tregon transferimin e pasurisë gjatë kohës së jetës së atij që e bën.

4.3. Huazimet

Sikurse edhe gjuhët e tjera, shqipja ka huazuar fjalë nga gjuhët e popujve me të cilët ka pasur kontakte gjatë historisë së saj. Shqipja nuk është më pak "e pasur" se anglishtja dhe gjuhë të tjera. Por tani, sikundër edhe shumë gjuhë të tjera të botës, shqipja përballë me një "mësymje" të anglishtes. Si mund të përballohet kjo situatë dhe çfarë qëndrimi duhet mbajtur ndaj huazimeve leksikore të kohës më të re?

Edhe pse me plot fjalë “të huaja”, anglishtja, jo vetëm që gjallon edhe sot e kësaj dite, por është më me ndikim se kurrë më parë. Anglishtja, posaçërisht varianti i saj amerikan, është bërë një gjuhë që shumë më tepër jep sesa merr. Anglishtja është duke krijuar fjalë të reja me një ritëm që vështirë e kanë ta ndjekin gjuhët e tjera, ndaj duhet të marrim mjaft fjalë nga ajo nëse dëshirojmë të jemi në hap me shkencën, teknikën, teknologjinë e ekonominë e përparuar të botës.

Faktorët që ndikojnë në ”pushtimin” gjuhësor të një gjuhe ndaj një apo më shumë gjuhëve janë të shumtë. Faktori i parë është ai gjuhësor, ku prirja për të përdorur një gjuhë që merr statusin e ”lingua franca”, siç është rasti i anglishtes sot, është një prirje e pashmangshme, pasi kjo shkon paralel me zhvillimin e ekonomisë dhe epërsinë ekonomike të SHBA-së. Gjithashtu, nisur nga prirja ekonomike, edhe marrëdhëniet që lidhen midis shtetesh, janë pjesë e politikave dhe të strategjivbe ndërkombëtare. Shteti shqiptar, sot, sheh tek SHBA-ja aleatin e vet strategjik më të ngushtë. Kjo e forcon edhe më shumë prirjen e mësimit të anglishtes dhe të përdorimit të termave në anglishte. Faktorë të tjerë mund të jenë demografikë dhe psiko-sociologjikë.

Pas viteve '90-të, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës e re, u hartuan me qindra ligje, kode e konventa të reja, ku paraqiten dhe nocione të reja juridike, që nuk përfshiheshin në ligjet e viteve para '90-tës. Kjo, sigurisht, ka sjellë dhe përdorim termash të reja që emërtojnë këto dukuri e nocione. Por ka munguar një strategji e caktuar për përdorimin e terminologjisë juridike. Kjo ka sjellë një numër të madh huazimesh; në rastin më të mirë, këto huazime kanë qenë të nevojshme për vete faktin se mungonte terminologjia dhe në rastin me të keq termat ekzistojnë në gjuhën shqipe por hartuesve të ligjeve iu duket më e lehtë të përdorin termat e huaj. Ja disa shembuj të përdorimit të termave, të huazuara nga gjuhë të huaja, por që, fortmirë, mund të zëvendësoheshin nga termat me brumë të shqipes.

legal - ligjor, i ligjshëm

elektoral - zgjedhor

tentativë - orvatje

apeloj - bëj thirrje

legjislativ - ligjvënës

atribut - cilësi

kontestoj - kundërshtoj

bilateral - dypalësh

multilateral - shumëpalësh

Parlamenti - Kuvendi

kryeparlamentari - kryetar kuvendi

Implementoj - Zbatoj

konstitucionale - kushtetuese

artikull - nen

negocioj - ndërmjetësoj

negociata – ndërmjetësime

aplikoj - vë në jetë

inicion - fillon

rezident - vendas

rekrutim – marr në punë

divorcoj - zgjidh martesën

abort - deshtim

abrogoj - shfuqizoj

adoptoj - birësoj

aprovoj - miratoj

azhurnoj - përditesoj

difeze - mbrojtje

divergjence - mosmarrëveshje

draft - skicë

bipartisan - dypalësh,

supremacy - epërsi

precedent - paraprijës,

Në realitetin e sotëm, konceptet e rilindasve mbeten mjaft aktuale. Politika e tyre gjuhësore u mbështet në këto parime kryesore:

- a. mbështetja tek gjuha e folur e popullit dhe tradita shkrimore paraardhëse;
- b. mësimi i shqipes me alfabet të njëjtë, për të krijuar një gjuhë me aftësi shprehëse të vlerave dhe interesave të kombit;
- c. nxjerrja nga gjuha letrare e fjalëve të huaja të panevojshme dhe zëvendësimi i tyre me fjalë të marra nga gjuha e gjallë e shqipes;
- d. ruajtja e strukture së gjuhës në të gjitha rrafshet e saj, për një qartësi strukturore semantike të shqipes në tërësi.

U bie për detyrë gjuhëtarëve, leksikografëve dhe studjuesve të fushave juridike që të hartojnë fjalorë gjuhësorë dhe specifikë, dhe të përditësojnë vazhdimisht terminologjinë juridike, për të ruajtur, kësisoj, pastërtinë e gjuhës shqipe, e cila i ka të gjitha potencialet burimore për të mbuluar edhe nocionet e konceptete e reja që ngërthen zhvillimi i sotëm i ekonomisë botërore.

4.4. Analizë krahasuese

Në vijim do të bëjmë analiza krahasuese të teksteve në anglisht dhe shqip. Qëllimi i analizës është të identifikojmë atë ç'ka parashtruar në kapitujt më sipër, duke sjellë dy tipe analizash : tipi i parë ka të bëjë me strategjitë e përkthimit dhe analiza e dytë rrok rrafshin sintaksor, leksikor e semantik.

Tekst 1

(Raport i Këshillit të Evropës për Demokracinë Lokale dhe Rajonale në Shqipëri)

(**seg.1**) The present report on local and regional democracy in Albania follows upon Recommendation 201 (2006). (**seg.2**) The report notes with satisfaction that decentralisation of the state power has been a major component of democratisation in Albania and that the legislative framework is in line with the Charter. (**seg.3**) It also notes, however, that regional authorities appear to be very weak, the local government associations appear fragmented and without a unified voice, and that there are no clear

regulations for the process of consultation between the local and central governments. **(seg.4)** It draws attention to the fact that a territorial reform as well as a comprehensive and intensive fiscal reform could promote local economy.

(seg.5) The report recommends that the Albanian Government elaborate a territorial policy which can offer small communes and municipalities the possibility of performing their tasks and benefiting from economies of scale, to enhance local authority competences, to ensure concomitant financing of delegated competences and to clarify and increase regional competences. **(seg.6)** It encourages the government to develop legislation that will set up clear requirements for the central authorities to consult with local authorities on matters which concern them directly. **(seg.7)** It also invites the government to work with all the existing associations to achieve the establishment of a body that could represent all local authorities. **(seg.8)** It invites the authorities to sign and ratify the Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority.

(seg.1) Ky raport për demokracinë vendore dhe rajonale në Shqipëri bëhet mbi bazën e Rekomandimit 201 (2006). **(seg.2)** Raporti vëren me kënaqësi që decentralizimi i kompetencave shtetërore ka qenë një komponent kryesor i demokratizimit në Shqipëri dhe se kuadri legjislativ është në përputhje me Kartën. **(seg.3)** Gjithsesi, ai vëren po ashtu se organet rajonale duken shumë të dobëta, shoqatat e qeverisjes vendore janë të fragmentarizuara dhe pa një zë të unifikuar, dhe se nuk ka rregulla të qarta lidhur me procesin e konsultimit ndërmjet qeverive vendore dhe qeverisë qendrore. **(seg.4)** Raporti tërheq vëmendjen në faktin se reforma territoriale dhe një reformë gjithëpërfshirëse dhe intensive fiskale mund të nxisin ekonominë lokale.

(seg.5) Raporti i rekomandon Qeverisë së Shqipërisë të hartojë një politikë territoriale që mund t'u ofrojë komunave dhe bashkive të vogla mundësinë të kryejnë detyrat e tyre, duke përfituar nga ekonomitë e shkallës, të rrisin kompetencat e autoriteteve lokale, të sigurojnë financim të njëkohshëm të kompetencave të deleguara dhe të qartësojnë dhe të rrisin kompetencat rajonale. **(seg.6)** Ai e inkurajon Qeverinë të zhvillojë një legjislacion që përcakton kërkesa të qarta për organet e qeverisë qendrore për t'u konsultuar me organet vendore për çështje që lidhen drejtpërsëdrejti me qeverisjen vendore. **(seg.7)** Raporti e fton po ashtu Qeverinë të punojë me të gjitha shoqatat ekzistuese për të arritur krijimin e një strukture që mund të përfaqësojë të gjitha organet vendore. **(seg.8)** Raporti i fton organet përgjegjëse të nënshkruajnë dhe të ratifikojnë Protokollin Shtesë të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore për të drejtën për të marrë pjesë në çështjet e një organi vendor.

Grila 1 (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

Gjuha burimore (Gjuha angleze)		A
Gjuha mbërritëse (Gjuha shqipe)		SH
Numri i segmenteve (numri i fjalive)		8/8
Strategji të përkthimit	1.Kalke leksikorë	3
	2.Kalke sintaksorë	8
	3.Kryqëzime (këmbime reciproke)	-
	4.Ekuivalenca (Barasvlera)	
	5.Modulime	-
	6.Parafrazime	7
	7.Përkthime të fjalëpërfjalshme	Seg.2 Seg.3 Seg.4 Seg.7 Seg.8
	8.Përkthime pothuajse të fjalëpërfjalshme	Seg.1 Seg.5 Seg.6
	9.Zëvendësime	1

Strategji të përkthimit

1.Kalke leksikorë

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
1.notes with satisfaction	vëren me kënaqësi
2.is in line with	është në përputhje me
3.draw attention	tërheq vëmendjen

2.Kalke sintaksorë

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
1.it notes with satisfaction	raporti vëren me kënaqësi
2.appear to be very weak	duken shumë të dobëta
3.process of consultation	procesin e konsultimit
4.draw attention	tërheq vëmendjen
5.report recommends	raporti rekomandon
6.benefiting from economies of scale	duke përfituar nga ekonomitë e shkallës
7.to clarify and increase	të qartësojnë dhe te rrisin

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

8.to develop a legislation	të zhvillojë një legjislacion
----------------------------	-------------------------------

3. Nuk ka

4. Ekuivalenca

Përkthimi i terminologjisë me karakter juridik është ruajtur edhe në gjuhën mbërritëse, duke sjellë gjegjëset e sakta të shqipes si:

Recommendation – rekomandim; benefiting – duke përfituar; to consult – për t'u konsultuar e mjaft shembuj të tjerë.

5. Nuk ka

6. Parafrazime

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
1. however	po ashtu
2. which concern them directly	që lidhen drejtpërdrejt me qeverisjen vendore
3. also	po ashtu
4. all	me të gjitha
5. authorities	organe përgjegjëse
6. to participate	për të marrë pjesë

7. Përkthime të fjalpërfjalshme

Seg.2, Seg.3, Seg.4, Seg.7, Seg.8

8. Përkthime pothuaj të fjalpërfjalshme

Seg 1, Seg 5, Seg 6

9. Zëvendësime

1. follows upon	bëhet mbi bazën e ...
-----------------	-----------------------

Grila 2 Analiza e teskteve (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

		Teksti origjinal (A)	Teksti mbërritës (Sh)
Aspekti sintaksor	(a) përdorimi i fjalive me nënrenditje	6	6
	(b) përdorimi i formave të pashjtelluara	-	-
	(c) kohët e foljeve		
	(ç) raporti i përdorimit të diatezës pësore dhe	Veprorë (Active)	Veprorë

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

	<i>veprorë</i>		
	(d) <i>rendi i fjalëve</i>		
	(e) <i>përdorimi apo mungesa e nyjes shquese</i>	1(1), 2(3), 3(6), 4(2), 5(3), 6(2), 7(4), 8(6)	1(3), 2(4), 3(4), 4(2), 5(3), 6(2), 7(4), 8(4)
Aspekti semantik	(a) <i>kuptimet semantike të fjalëve dhe shprehjeve</i>		
	(b) <i>përdorimi i elementëve deiktikë dhe anaforikë</i>	The present report	Ky raport
	(c) <i>konektorët</i>	Në tekstin origjinal ndeshim 12 herë përdorimin e konektorëve.	Në tekstin mbërritës e ndeshim po ashtu 12 herë.
	(d) <i>familjet semantike</i>	Democracy-democratisation Legislative-legislation Clear-clarify Government-self government	Demokraci-demokratizimi Legjislativ-legjislacion I qarte – qartësoj Qeverisje-qeveri-vetë qeverisje
	(e) <i>dykuptimësia (ambiguiteti)</i>	Nuk ka ambiguitet	-
Aspekti leksikor	(a) <i>përdorimi i teknikizmave</i>	-	-
	(b) <i>përdorimi i latinizmave (nëse ka)</i>	-	-
	(c) <i>përdorimi i formave apo fjalëve arkaike (nëse ka)</i>	-	-

Aspekti sintaksor

(a) 6 fjali me nënrenditje (Seg 2, Seg 3, Seg 5, Seg 6, Seg 7, Seg 8)

(b) Nuk kemi përdorim të formave të pashtjelluara.

(c) Foljet në tekstin origjinal janë kryesisht në kohën e tashme siç janë edhe në tekstin mbërritës:

Follows upon – bëhet mbi bazën e

Report notes – vëren

Appear – duken

It draws attention – tërheq vëmendjen

(c) Foljet e përdorura në tekstin 1, si në gjuhën origjinale edhe në gjuhën mbërritëse janë në formën veprare.

(d) Vërejmë së në të gjithë tekstin hasim ndryshime të rendit të fjalëve sidomos kur bëhet fjalë për mbiemrat. Në anglisht mbiemrat, si rregull, u paravendosen emrave, pasi rendi i fjalëve në anglisht është i ngulitur. Në gjuhën shqipe, përsa i përket shembullit tonë mbiemrat janë vendosur pas emrit duke qenë se në shqip rendi i fjalëve është i lire, pra mbiemrat mund të vendosen para ose pas emrit. (local and regional democracy-demokracinë vendore dhe rajonale, regional competences- kompetencat rajonale, clear requirements- kërkesa të qarta

(e) Gjuha shqipe është gjuhë sintetike-analitike. Në segmentin 1 në tekstin origjinal kemi vetëm 1 nyje shqese (the), ndërsa në tekstin mbërritës kemi 3(ky raport, rekomand-i-mit). Në segmentin 2 kemi 3(the, a, the) në gjuhën origjinale dhe 3 në gjuhën mbërritëse(qe, i, i). Seg 3 (it, the, a, that, the, the)(se, e) Seg 4 (it, the, a, a) (raport-i-, se)Seg 5(the, the, a, the) (raport-i-, qever-i-se, t-u-) Seg 6 (it, the, the, a, that, the) (Ai e, e qever-i-se, per t-u-)Seg 7 (it, the, the, a) (raport-i-) Seg 8 (it, the, the, the, the, a) (Raport-i-, organi-i-)

Aspekti semantik

(a) (b) Në tekstin 1 ndeshim zinxhirë anaforikë si psh:

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
Report seg(1)	Raport (seg 1)
Report (seg2)	Ai (seg2)
It (seg3)	Raporti (seg 3)
It (seg4)	Raporti (seg4)
Report (seg5)	Ai (seg 5)
It (seg 6)	Raporti (seg 6)
It (seg 6 dhe 7)	Raporti (seg 7 dhe 8)

(c) 12 konektorë në tekstin origjinal dhe po aq në tekstin mbërritës(and, with, it also, and, as well as, and, also, and, with) (dhe, me, dhe, po ashtu, dhe, po ashtu edhe, me, dhe)

(d) 4 familje semantike

Democracy-democratisation

Legislative-legislation

Clear-clarify

Government-self government

Demokraci-demokratizimi

Legjislativ-legjislacion

I qarte – qartësoj

Qeverisje-qeveri-vetë qeverisje

(e) Nuk ka

Aspekti leksikor

(a) Nuk ka

(b) Nuk ka

(c) Nuk ka

Tekst 2

(Karta e Qeverisjes Vendore)

Article 6 – Appropriate administrative structures and resources for the tasks of local authorities

- 1 (seg.1) Without prejudice to more general statutory provisions, local authorities shall be able to determine their own internal administrative structures in order to adapt them to local needs and ensure effective management.
- 2 (seg.2) The conditions of service of local government employees shall be such as to permit the recruitment of high-quality staff on the basis of merit and competence; to this end adequate training opportunities, remuneration and career prospects shall be provided.

Neni 6 – Strukturat dhe burimet e përshtatshme administrative për detyrat e organeve vendore

- 1 (seg.1) Pa cenuar dispozitat më të përgjithshme statusore, organet vendore duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë strukturat e tyre të brendshme administrative në mënyrë që t'i përshtatin ato me nevojat vendore dhe të sigurojnë menaxhim efektiv.

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

- 2 (seg.2) Kushtet e shërbimit të punonjësve të qeverisjes vendore do të jenë të tilla që të lejojnë rekrutimin e stafit me cilësi të lartë, bazuar në meritë dhe në kompetencë; për të arritur këtë rezultat do të ofrohen mundësi trajnimi, paga dhe mundësi të përshtatshme për karrierë.

Grila 1 (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

Gjuha burimore (Gjuha angleze)		A
Gjuha mbërritëse (Gjuha shqipe)		SH
Numri i segmenteve (numri i fjalive)		2
Strategji të përkthimit	1.Kalke leksikorë	1
	2.Kalke sintaksorë	4
	3.Kryqëzime (këmbime reciproke)	-
	4.Ekuivalenca (Barasvlera)*	
	5.Modulime	
	6.Parafrazime	1
	7.Përkthime të fjalëpërfjalshme	
	8.Përkthime pothuajse të fjalëpërfjalshme	Seg 1 Seg 2
	9.Zëvendësime	1

Strategji të përkthimit

1.Kalke leksikorë

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
shall be able	duhet të jenë në gjendje

2.Kalke sintaksorë

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
local authorities	organet vendore
local needs	nevoja vendore
effective management	menaxhim efektive
on the basis of merit and competence	bazuar në meritë dhe kompetencë

3.Kryqëzime

Nuk ka

4. Ekuivalenca

Përkthimi i terminologjisë me karakter juridik është ruajtur edhe në gjuhën mbërritëse, duke sjellë gjegjëset e sakta të shqipes si:

Prejudice – cënuar; provisions – dispozitat; recruitment – rekrutim e mjaft shembuj të tjerë

5. Modulime

Nuk ka

6. Parafrazime

Teksti original	Teksti mbërritës
to this end	për të arritur këtë rezultat

7. Përkthime të fjalëpërfjalshme

Dy segmentet janë përkthime pothuaj të fjalëpërfjalshme

8. Përkthime pothuajse të fjalëpërfjalshme

Seg 1, Seg 2

9. Zëvendësime

Teksti original	Teksti mbërritës
to this end	për të arritur këtë rezultat

Grila 2 Analiza e teksteve (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

		Teksti original (A)	Teksti mbërritës (Sh)
Aspekti sintaksor	(a) <i>përdorimi i fjalive me nënrenditje</i>	2 seg	2 seg
	(b) <i>përdorimi i formave të pashtjelluara</i>	2	2
	(c) <i>kohët e foljeve</i>		
	(ç) <i>raporti i përdorimit të diatezës pësore dhe veprorë</i>	Veprorë (Active)	Veprorë
	(d) <i>rendi i fjalëve</i>		
	(e) <i>përdorimi apo mungesa e nyjës shquese</i>	Seg 1 (-) Seg 2 (3)	Seg 1 (1) Seg 2 (4)
	(a) <i>kuptimet semantike të fjalëve dhe shprehjeve</i>		
	(b) <i>përdorimi i elementëve</i>	-	-

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

Aspekti semantik	<i>deiktikë dhe anaforikë</i>		
	(c) <i>konektorët</i>	Seg 1 dhe 2 (3)	Seg 1 dhe 2 (3)
	(d) <i>familjet semantike</i>	Nuk ka	Nuk ka
	(e) <i>dykuptimësia (ambiguiteti)</i>	-	-
Aspekti leksikor	(a) <i>përdorimi i teknikizmave</i>	-	-
	(b) <i>përdorimi i latinizmave (nëse ka)</i>	-	-
	(c) <i>përdorimi i formave apo fjalëve arkaike (nëse ka)</i>	-	-

Aspekti sintaksor

(a) 2 fjali me nënrenditje (Seg 1 dhe Seg 2)

(b) Kemi përdorim të formave të pashtjelluara dhe përkatësisht:

-pa cënuar dispozitat (formë e pashtjelluar mohore, Seg 1)

-për të arritur këtë rezultat (formë e pashtjelluar paskajore me funksion qëllimor, Seg 2)

(c) Kohët e foljeve:

Shall be able to determine – duhet të jenë në gjendje (e tashme, lidhore)

Adapt – përshtatin (pakryer)

Ensure – të sigurojnë (e tashme, lidhore)

Shall be such – do të jenë të tilla (e ardhme)

Te permit – të lejojnë (e tashme, lidhore)

(ç) Foljet e përdorura në tekst 2 si në gjuhën origjinale edhe në gjuhën mbërritëse janë në formën veprorë.

(d) Vërejmë se në të gjithë tekstin hasim ndryshime të rendit të fjalëve sidomos kur bëhet fjale për mbiemrat. Në anglisht mbiemrat si rregull u paravendosen emrave, pasi rendi i fjalëve në anglisht është i ngulitur. Në gjuhën shqipe, përta i përket shembullit tonë mbiemrat janë vendosur pas emrit duke qenë se në shqip rendi i fjalëve është i lire, pra mbiemrat mund të vendosen para ose pas emrit psh (local authorities - autoritete vendore, effective management - menaxhim efektiv)

(e) Gjuha shqipe është gjuhë sintetike-analitike. Në segmentin 1 në tekstin origjinal nuk kemi përdorim të nyjës shquese, ndërsa në tekstin mbërritës kemi 1. Në segmentin 2 kemi 3 në gjuhën origjinale dhe 4 në gjuhën mbërritëse. (the, the - të, që, të)

Aspekti semantik

(a) (b) Nuk ka

(c) 3 në tekstin original dhe po aq në tekstin mbërritës (and, and, and - dhe, dhe)

(d) Nuk ka

(e) Nuk ka

Aspekti leksikor

(a) Nuk ka

(b) Nuk ka

(c) Nuk ka

Tekst 3

(Çështje e Gjykatës së Strasburgut)

PROCEDURE

1.(**seg.1**) The case originated in an application (no. 34806/04) against the Republic of Finland lodged with the Court under Article 34 of the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms (“the Convention”) by a Finnish national, X (“the applicant”), on 30 September 2004. (**seg.2**) The President of the Fourth Section of the Court decided of his own motion that the applicant’s name should not be disclosed (Rule 47 § 3 of the Rules of Court).2. (**seg.3**) The applicant was represented by Ms Helena Molander, a lawyer practising in Helsinki. The Finnish Government (“the Government”) were represented by their Agent, Mr Arto Kosonen of the Ministry for Foreign Affairs.

3.(**seg.4**) The applicant alleged in particular under Article 6 of the Convention that she had not received a fair hearing in the criminal proceedings against her, in that she had not been given an opportunity to be heard at an oral hearing on the need to appoint a guardian for her for the purpose of those proceedings, and that she had not been given an opportunity to examine witnesses appearing on her behalf. (**seg.5**) She also alleged, under Articles 5 and 8 of the Convention, that she had been unnecessarily and unlawfully subjected to involuntary admission to a mental institution and forcible administering of medication. (**seg.6**) She further claimed, under Article 13 of the Convention, that she had not had an effective remedy to challenge the forcible administering of medication.

PROCEDURA

1.(**seg.1**) Çështja ka filluar me një kërkesë (nr. 34806/04) kundër Republikës së Finlandës, e depozituar në Gjykatë në përputhje me nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më poshtë “Konventa”) nga një nënshtetas finlandez, X (“kërkuesja”) më 30 shtator 2004. (**seg.2**) Kryetari i Seksionit të Katërt të Gjykatës vendosi me mocionin e tij të mos bënte të ditur emrin e kërkueses (neni 47 § 3 i Rregullores së Gjykatës).2.(**seg.3**) Kërkuesja u përfaqësua nga Znj. Helena Molander Huttunen, avokate që e ushtron aktivitetin e saj në Helsinki. Qeveria finlandeze (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjenti i saj, Z. Arto Kosonen, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

(**seg.15**) Article 42 brings together several assurances that may be requested from the requesting state. (**seg.16**) However, it mingles speciality guarantees (under a and b) with other conditions (under c, ç and d). (**seg.17**) This may lead to confusion in the

international relations, as the general understanding is that the rule of speciality is what has been stipulated in art. 14 of ETS 24. **(seg.18)** It is to be recommended to separate these or at least to give the article a different name (e.g. guarantees to be given by the requesting state). **(seg.19)** The consequences of the reference in Art. 44 to the principle of speciality in simplified procedure are severe (also art. 51 refers to art. 42). **(seg.20)** As it refers to the principle as a whole as defined under national law, it would also apply to conditions (under c, ç and d). **(seg.21)** There is, to my knowledge, no international convention that allows for a waiver of more than speciality. **(seg.22)** How does this relate to Albania's obligations under the European Convention on Extradition?

Ekstradimi

(seg.1) Nenet 31-52 të ligjit shqiptar rregullojnë çështjen e ekstradimit. **(seg.2)** A duhet të interpretohet Neni 31 sikur kërkon një traktat si bazë për ekstradim? **(seg.3)** Si interpretohet Neni 32, germa dh? **(seg.4)** Sipas këtij Neni një personi të kërkuar për ekstradim mund t'i miratohet ekstradimi vetëm për shkak të kërkesës për azil?

(seg.5) Ngrihen pyetjet e përmendura më sipër lidhur me autoritetin që mund japë shkaqet për refuzim (Neni 33).

(seg.6) A parashikon ligji ekstradim të përshpejtuar? **(seg.7)** Neni 37 të jep përshtypjen se ky ligj nuk e lejon këtë gjë.

(seg.8) Ligji e ndalon ekstradimin e nënshtetasve (Neni 38, paragrafi 5). **(seg.9)** Gjithsesi, ligji shqiptar i ofron tre alternativa shtetit kërkues: a) transferimin e proceseve penale; b) njohjen e vendimit të gjykatës së huaj; ose c) dërgimin e akteve dhe të provave nëpërmjet letërporosive.

(seg.10) A ka Shqipëria ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që lejon ekstradimin e nënshtetasve siç parashikohet në Nenin 38, paragrafi 9? **(seg.11)** Nga mënyra sesi është hartuar ligji, duket se vendimi për ekstradim merret në një procedurë me dy hapa.

(seg.12) Së pari, Gjykata merr vendimin (Neni 39); në rast se ajo vendos për ekstradim, atëherë çështja i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë. **(seg.13)** Mbi bazën e cilit kriter e merr vendimin për refuzim ose shtyrje ministri? **(seg.14)** Çfarë lloj shtate mund të çojë në zbatimin e Nenit 46?

(seg.15) Neni 42 sjell sëbashku shumë siguri që mund të kërkohen nga shteti kërkues.

(seg.16) Gjithsesi, ai i përzier garancitë e specialitetit (në germën a dhe b) me kushte të tjera (në germën c, ç dhe d). **(seg.17)** Kjo mund të çojë në paqartësi në marrëdhëniet ndërkombëtare, pasi kuptimi i përgjithshëm është që rregulli i specialitetit është ai që parashikohet në nenin 14 i ETS-së 24. **(seg.18)** Rekomandohet që këto dy pika të ndahen, ose të paktën nenit t'i jepet një emërtim tjetër (p.sh. garancitë që duhet të jepen nga shteti kërkues). **(seg.19)** Pasojat e përmendjes së parimit të specialitetit në procedurën e thjeshtësuar në Nenin 44 janë të ashpra (po ashtu, Neni 51 i referohet Nenit 42). **(seg.20)**

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

Për shkak se ai i drejtohet parimit në tërësi, siç parashikohet në legjislacionin kombëtar, ai i duhet referuar edhe kushteve (në pikën c, ç dhe d). (seg.21) Me aq sa di unë nuk ka një konventë ndërkombëtare që lejon për përjashtim tjetër përveç specialitetit? (seg.22) Si lidhet kjo pikë me detyrimet e Shqipërisë sipas Konventës Evropiane për Ekstradim?

Grila 1 (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

Gjuha burimore (Gjuha angleze)		A
Gjuha mbërritëse (Gjuha shqipe)		SH
Numri i segmenteve (numri i fjalive)		22
Strategji të përkthimit	1.Kalke leksikorë	4
	2.Kalke sintaksorë	8
	3.Kryqëzime (këmbime reciproke)	-
	4.Ekuivalenca (Barasvlera)*	
	5.Modulime	
	6.Parafrazime	4
	7.Përkthime të fjalëpërfjalshme	Seg 1, Seg 2, Seg 6, Seg 7, Seg 8, Seg 9, Seg 10, Seg 11, Seg 12, Seg 14, Seg 15, Seg 16, Seg 18, Seg 19, Seg 20, Seg 22.
	8.Përkthime pothuajse të fjalëpërfjalshme	Seg 3, Seg 4, Seg 5, Seg 13, Seg 17, Seg 21
	9.Zëvendësime	-

1.Kalke leksikorë

Tekst origjinal	Teksti mbërritës
As requiring	Sikur kërkon

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

As referred to	Siç parashikohet ne
It appears that	Duket se
On the basis of	Mbi bazën e

2.Kalke sintaksorë

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
Grounds for refusal	Shkaqe për refuzim
Offers there alternatives	Ofron tre alternativa
Acts and evidence	Akteve dhe provave
Decision to extradite	Vendimi për ekstradim
Bring together	Sjell sebashku
Several assurance	Shume siguri
Consequences of reference	Pasojat e përmendjes

3.Kryqëzime

Nuk ka

4.Ekuivalenca

Termet juridikë janë sjellë saktësisht me gjegjëset e tyre në shqipe:

Extradition – ekstradim, foreign criminal decision - njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, simplified procedure- procedure e thjeshtëzuar e shumë shembuj të tjerë

5.Modulime

Nuk ka

6.Parafrazime

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
Does this mean....	Sipas këtij neni parashikohet qe...
Earlier question	Pyetje te përmendura me sipër
It does not....	Ky ligj nuk e lejon këtë gjë
From the construction of.....	Nga mënyra sesi është hartuar....

6.Përkthime të fjalëpërfjalshme

Seg 1, Seg 2, Seg 6, Seg 7, Seg 8, Seg 9, Seg 10, Seg 11, Seg 12, Seg 14, Seg 15, Seg 16, Seg 18, Seg 19, Seg 20, Seg 22.

7.Perkthime pothuaj te fjaleperfjalshme

Seg 3, Seg 4, Seg 5, Seg 13, Seg 17, Seg 21

8.Zevendesime

Nuk ka

Grila 2 Analiza e teskteve (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

		Teksti original (A)	Teksti mbërritës (Sh)
Aspekti sintaksor	<i>(a) përdorimi i fjalive me nënrenditje</i>		7
	<i>(b) përdorimi i formave të pashjtelluara</i>	-	-
	<i>(c) kohët e foljeve</i>		
	<i>(ç) raporti i përdorimit të diatezës pësore dhe veprare</i>	Veprare (Active)/Passive	Veprare/Joveprare
	<i>(d) rendi i fjalëve</i>		
	<i>(e) përdorimi apo mungesa e nyjes shquese</i>	Seg.1 (1) Seg.2 (1) Seg.3 (0) Seg.4 (1) Seg.5 (1) Seg.6 (1) Seg.7 (2) Seg.8 (0) Seg.9 (5) Seg.10 (1) Seg.11 (4) Seg.12 (4) Seg.13 (2) Seg.14 (0) Seg.15 (1) Seg.16 (0) Seg.17 (3) Seg.18 (2) Seg.19 (3) Seg.20 (2) Seg.21 (1) Seg.22 (1)	Seg.1 (1) Seg.2 (2) Seg.3 (0) Seg.4 (4) Seg.5 (1) Seg.6 (1) Seg.7 (1) Seg.8 (1) Seg.9 (6) Seg.10 (2) Seg.11 (2) Seg.12 (4) Seg.13 (2) Seg.14 (1) Seg.15 (2) Seg.16 (1) Seg.17 (4) Seg.18 (2) Seg.19 (1) Seg.20 (2) Seg.21 (0) Seg.22 (1)
Aspekti semantik	<i>(a) kuptimet semantike të fjalëve dhe shprehjeve</i>		
	<i>(b) përdorimi i elementëve deiktikë dhe anaforikë</i>	-	-
	<i>(c) konektorët</i>	Ne te gjithë tekstin i ndeshim 6 here	Ne te gjithë tekstin i ndeshim 16 here
	<i>(d) familjet semantike</i>	Requiring Requested Requesting	Kërkon Te kërkuar Kërkues

		Extradition Extradite	Ekstradim Vendim për ekstradim
	(e) <i>dykuptimësia (ambiguiteti)</i>		
Aspekti leksikor	(a) <i>përdorimi i teknicizmave</i>		
	(b) <i>përdorimi i latinizmave (nëse ka)</i>		
	(c) <i>përdorimi i formave apo fjalëve arkaike (nëse ka)</i>		

Aspekti sintaksor

(a) 7 segmente me nënrenditje (Seg 9, Seg 10, Seg 12, Seg 17, Seg 18, Seg 19, Seg 20)

(b) Nuk kemi përdorim të formave të pashtjelluara.

(c) Kohet e foljeve

- Regulate – rregullojnë (e tashme)
- Be interpreted – të interpretohet (e tashme, joveprore)
- Apply – ngrihen (e tashme, joveprore)
- Gives – jep (e tashme)
- Is prohibited – e ndalon (e tashme)
- Offers – ofron (e tashme)
- As referred – siç parashikohet (e tashme, joveprore)
- Is taken – merret (e tashme, joveprore)
- Could amount – mund të çojë (e tashme, lidhore)
- Brings – sjell (e tashme)
- May be requested – mund të kërkohen (e tashme, lidhore)
- May lead to – mund të çojë (e tashme)
- Be recommended – Rekomandohet (e tashme, joveprore)

(c) Foljet e përdorura në tekst 8 i ndeshim si në formën veprorë edhe në atë jo-veprorë

(d) Vërejmë se në të gjithë tekstin hasim ndryshime të rendit të fjalëve sidomos kur bëhet fjalë për mbiemrat. Në anglisht mbiemrat si rregull u paravendosen emrave, pasi rendi i fjalëve në anglisht është i ngulitur. Në gjuhën shqipe, persa i përket shembullit tonë

mbiemrat janë vendosur pas emrit duke qenë se në shqip rendi i fjalëve është i lire, pra mbiemrat mund të vendosen para ose pas emrit.

(e) Përdorimi i nyjës shqese: Në gjuhën origjinale në të gjithë tekstin i ndeshim: Seg.1 (1), Seg.2 (1), Seg.3 (0), Seg.4 (1), Seg.5 (1), Seg.6 (1), Seg.7 (2), Seg.8 (0), Seg.9 (5), Seg.10 (1), Seg.11 (4), Seg.12 (4), Seg.13 (2), Seg.14 (0), Seg.15 (1), Seg.16 (0), Seg.17 (3), Seg.18 (2), Seg.19 (3), Seg.20 (2), Seg.21 (1), Seg.22 (1). Ndërsa në gjuhën mbërritëse: Seg.1 (1) Seg.2 (2), Seg.3 (0), Seg.4 (4), Seg.5 (1), Seg.6 (1), Seg.7 (1), Seg.8 (1), Seg.9 (6), Seg.10 (2), Seg.11 (2), Seg.12 (4), Seg.13 (2), Seg.14 (1), Seg.15 (2), Seg.16 (1), Seg.17 (4), Seg.18 (2), Seg.19 (1) Seg.20 (2), Seg.21 (0), Seg.22 (1)

Aspekti semantik

(a)

(b) Elemente deiktike:

(c) Në të gjithë tekstin në gjuhën origjinale e ndeshim përdorimin e konektoreve 6 herë ndërsa në gjuhën mbërritëse 16 herë (with regard, however, with, also – lidhur me, gjithsesi, dhe, se pari, ose, per shkak se)

(d) Familje semantike:

Requiring – Requested – Requesting / Kërkon – Te kërkuar - Kërkues

Extradition – Extradite / Ekstradim – Vendim për Ekstradim

(e) Nuk ka

Aspekti leksikor

(a) Nuk ka

(b) Nuk ka

(c) Nuk ka

Tekst 10

(Procedura e Transferimit të Proceseve Gjyqësore)

Transfer of proceedings

(seg.1) This is provided in MLAAAlbania, articles 66-75. (seg.2) How does the defendant learn from the decision to transfer, as mentioned in Art. 68? (seg.3) What are the experiences with this form of cooperation?

Transferimi i procedimeve penale

(**seg.1**) Transferimi i procedimeve penale parashikohet në ligjin shqiptar në Nenet 66-75.

(**seg.2**) Si i bëhet me dije të pandehurit vendimi për transferim, i përmendur në Nenin 68?

(**seg.3**) Çfarë eksperiencash keni me këtë lloj bashkëpunimi?

(Procedura e Ekzekutimit të Vendimeve Gjyqësore)

Transfer of the execution of judgments

(**seg.1**) This is provided in MLAAAlbania, articles 53-65. (**seg.2**) I found reference to Art. 505-511 and 514 CCP. (**seg.3**) As I have no access to the Code of Criminal procedure I am unable to check what has been regulated there. (**seg.4**) Is a translation available?

(**seg.5**) Is the procedure provided in article 57, par. 4 to set the sentence, a procedure of continued enforcement or of conversion of the foreign sentence? (**seg.6**) How does art. 57 relate to art. 60?

(**seg.7**) In a declaration to ETS 112 Albania stated: "In accordance with Article 3, paragraph 3, the Republic of Albania declares that it intends to exclude the application of the procedures provided for in Article 9, paragraph 1, letter "a" of the Convention."

(**seg.8**) This would mean that Albania would apply conversion proceedings only. (**seg.9**) The impression of Art. 60 MLAAAlbania is the opposite: namely that it applies continued enforcement only. (**seg.10**) What is the situation under Albanian law?

(**seg.11**) It appears that the Albanian legislation is applicable to the transfer of unconditional sentences only. (**seg.12**) Is it a correct understanding that conditional and alternative sentences have been ruled out?

Transferimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

(**seg.1**) Kjo çështje parashikohet në ligjin shqiptar në Nenet 53-65. (**seg.2**) Po ashtu, thuhet se kjo çështje trajtohet dhe nga Neni 505-511 dhe 514 i KPP-së. (**seg.3**) Për shkak se nuk kam kopje të Kodit të Procedurës Penale, e kam të mundur të kontrolloj se çfarë parashikohet në këto nene. (**seg.4**) A ekziston një version i përkthyer i Kodit?

(**seg.5**) **Cila është procedura e parashikuar në Nenin 57, paragrafi 4 për përcaktimin e dënimit, procedurë për vazhdim zbatimi, apo konvertim i dënimit të gjykatës së huaj?**

(**seg.6**) Si lidhet Neni 57 me Nenin 60?

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

(**seg.7**) Në një deklaratë për ETS-në 112 Shqipëria u shpreh se: “Në përputhje me Nenin 3, paragrafi 3, Republika e Shqipërisë deklaroi se synon të përjashtojë zbatimin e procedurave të parashikuara në Nenin 9, paragrafi 1, germa “a” të Konventës.” (**seg.8**) Kjo do të thotë që Shqipëria do të zbatojë vetëm procedurat e konvertimit. (**seg.9**) Ndërkohë, përshtypja që të lë Neni 60 i ligjit shqiptar është tërësisht e kundërta: pra, që ligji nënkupton vetëm vazhdim zbatimi të vendimit. (**seg.10**) Cila situatë parashikohet në ligjin shqiptar?

(**seg.11**) Duket se legjislacioni shqiptar është i zbatueshëm vetëm për transferimin e dënimeve të pakushtëzuara. (**seg.12**) A është i saktë konstatimi që dënimet e kushtëzuara dhe alternative nuk janë të përfshira?

Grila 1 (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

Gjuha burimore (Gjuha angleze)		A
Gjuha mbërritëse (Gjuha shqipe)		SH
Numri i segmenteve (numri i fjalive)		12/12
Strategji të përkthimit	1.Kalke leksikorë	1
	2.Kalke sintaksorë	2
	3.Kryqëzime (këmbime reciproke)	-
	4.Ekuivalenca (Barasvlera)*	
	5.Modulime	1
	6.Parafrazime	
	7.Përkthime të fjalëpërfjalshme	Seg 6, Seg 7, Seg 8, Seg 10, Seg 11 Seg 12,
	8.Përkthime pothuajse të fjalëpërfjalshme	Seg 1, Seg 2, Seg 3, Seg 4, Seg 5, Seg 9
	9.Zëvendësime	-

1.Kalke leksikorë

Teksti origjinal	Teksti mbërritës
In accordance with	Ne përputhje me

2.Kalke sintaksorë

Teksti original	Teksti mbërritës
Intends to exclude	Synon te përjashtoje
It appears that	Duket se

3.Kryqëzime

Nuk ka

4. Ekuivalenca

Termet juridikë janë përkthyer korrektësisht me gjegjëset e tyre në shqipe:

Code of Criminal procedure – Kodi i Procedurës penale, transfer of unconditional sentences – transferim i vendimeve të pakushtëzuara e shumë shembuj të tjerë.

5.Modulim

Teksti original	Teksti mbërritës
I found reference....	Thuhet se.....

6.Parafrazime

Nuk ka

7.Perkthime te fjaleperfjalshme

Seg 6, Seg 7, Seg 8, Seg 10, Seg 11, Seg 12

8.Perkthime pothuaj te fjaleperfjalshme

Seg 1, Seg 2, Seg 3, Seg 4, Seg 5, Seg 9

9.Zevendesime

Nuk ka

Grila 2 Analiza e teskteve (për secilin çift tekstesh anglisht-shqip)

		Teksti original (A)	Teksti mbërritës (Sh)
Aspekti sintaksor	(a)përdorimi i fjalive me nënrenditje	-	-
	(b)përdorimi i formave të pashjtelluara	-	-
	(c)kohët e foljeve		
	(ç)raporti i përdorimit të diatezës pësore dhe veprare	Active/Passive	Veprare/Joveprare
	(d)rendi i fjalëve		

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË PËRKTHIMIT LIGJOR

	<i>(e) përdorimi apo mungesa e nyjes shquese</i>	Seg.1 (0) Seg.2 (2) Seg.3 (1) Seg.1 (0) Seg.2 (0) Seg.3 (1) Seg.4 (1) Seg.5 (3) Seg.6 (0) Seg.7 (4) Seg.8 (0) Seg.9 (2) Seg.10 (1) Seg.11 (2) Seg.12 (1)	Seg.1 (2) Seg.2 (2) Seg.3 (1) Seg.1 (1) Seg.2 (2) Seg.3 (2) Seg.4 (2) Seg.5 (4) Seg.6 (1) Seg.7 (5) Seg.8 (1) Seg.9 (2) Seg.10 (1) Seg.11 (2) Seg.12 (1)
Aspekti semantik	<i>(a) kuptimet semantike të fjalëve dhe shprehjeve</i>		
	<i>(b) përdorimi i elementëve deiktikë dhe anaforikë</i>	This is provided..	Transferimi i procedimeve..
	<i>(c) konektorët</i>	Ne te gjithë tekstin i ndeshim 6 here	Ne te gjithë tekstin i ndeshim 6 here
	<i>(d) familjet semantike</i>	Application Applicable Applies	Zbatim i zbatueshëm Zbatim vendimi
	<i>(e) dykuptimësia (ambiguiteti)</i>	-	-
Aspekti leksikor	<i>(a) përdorimi i teknikizmave</i>	-	-
	<i>(b) përdorimi i latinizmave (nëse ka)</i>	-	-
	<i>(c) përdorimi i formave apo fjalëve arkaike (nëse ka)</i>	-	-

Aspekti sintaksor

- (a) Nuk kemi fjali me nënrenditje
- (b) Nuk kemi përdorim të formave të pashtjelluara

(c) Kohet e foljeve

- Learn from – i behet me dije (e tashme, joveprore)
- Provided – parashikohet (e tashme, joveprore)
- Regulated – parashikohet (e tashme, joveprore)
- Relate – lidhet (e tashme, joveprore)
- Stated – u shpreh (e kryer e thjeshte, joveprore)
- Declares – deklaron (e tashme)
- To exclude – të përjashtojë (e pakryer, lidhore)
- Would mean – do të thotë që (e ardhme)

(c) Foljet e përdorura në tekst i ndeshim si në formën veprorë edhe në atë jo-veprorë

(d) Vërejmë se në të gjithë tekstin hasim ndryshime të rendit të fjalëve sidomos kur bëhet fjalë për mbiemrat. Në anglisht mbiemrat si rregull u paravendosen emrave, pasi rendi i fjalëve në anglisht është i ngulitur. Në gjuhën shqipe, persa i përket shembullit tone mbiemrat janë vendosur pas emrit duke qenë se në shqip rendi i fjalëve është i lire, pra mbiemrat mund të vendosen para ose pas emrit (Albanian legislation – Legjislacioni shqiptar, unconditional sentences – dënime të pakushtëzuara)

(e) Përdorimi i nyjës shqese: Në gjuhën origjinale në të gjithë tekstin i ndeshim: Seg.1 (0), Seg.2 (2), Seg.3 (1), Seg.1 (0), Seg.2 (0), Seg.3 (1), Seg.4 (1), Seg.5 (3), Seg.6 (0), Seg.7 (4), Seg.8 (0), Seg.9 (2), Seg.10 (1), Seg.11 (2), Seg.12 (1). Ndërsa në gjuhën mbërritëse: Seg.1 (2), Seg.2 (2), Seg.3 (1), Seg.1 (1), Seg.2 (2), Seg.3 (2), Seg.4 (2), Seg.5 (4), Seg.6 (1), Seg.7 (5), Seg.8 (1), Seg.9 (2), Seg.10 (1), Seg.11 (2), Seg.12 (1)

Aspekti semantik

(a) Nuk kemi shmangje të kuptimeve të termave juridikë.

(b) Elemente deiktike:

This is provided.../ Kjo parashikohet në...

(c) Në të gjithë tekstin në gjuhën origjinale e ndeshim përdorimin e konektoreve 6 herë dhe po aq në gjuhën mbërritëse (with, as, or, with regard to – po ashtu, dhe, për shkak se, apo, me)

(d) Familje semantike

Application – Applicable – Applies / Zbatim – I zbatueshëm – Zbatim vendimi

(e) Ambiguitet - Nuk ka

Aspekti leksikor

- (a) Nuk ka
- (b) Nuk ka
- (c) Nuk ka

Analizat e teksteve, të sjella pak më sipër, synojnë të kuptojmë të përbashktat dhe dallimet që anglishtja dhe shqipja kanë në përkthimin e teksteve juridikë. Përzgjedhja e dy grilave të analizës jep më qartë strategjitë e përkthimit në përgjithësi dhe ato të përdorura nga përkthyesi i shqipes. Siç edhe vihet re, në të gjitha tekstet e analizuar, jo të gjitha llojet e strategjive mund të jenë të pranishme në një tekst të përkthyer. Kjo ka të bëjë me llojin e tekstit dhe zgjedhjet individuale të përkthyesit. Ajo që vlen të theksohet është se përkthyesi i teksteve ligjore përpiqet të mbetet besnik i tekstit origjinal në përmbajtje dhe herë herë edhe në formë. Referuar përkthimit të terminologjisë juridike, përkthyesi përpiqet të gjejë gjegjësen përkatëse në shqipe, duke e kapërcyer me sukses këtë vështirësi. Në aspektin formal, përkthyesi i nënshtrohet rregullave të strukturimit të shqipes

PERFUNDIME

Në këtë studim synuam të sjellim një panoramë, sigurisht jo shteruese, të disa prej aspekteve teorike dhe praktike të përkthimit në përgjithësi dhe atij juridik në veçanti.

Pyetjet që parashtruam në hyrje të këtij punimi, jemi të mendimit se u kemi dhënë përgjigje përgjatë kapitujve, duke u përpjekur të sjellim interpretime dhe analiza të disa prej studiuesve më në zë të fushës së përkthimiologjisë në përgjithësi dhe të asaj juridike në veçanti.

Studimi është i sjellë në këndvështrimin teorik dhe atë praktik. Kemi parapëlqyer këtë qasje, pasi jemi të mendimit se trajtesa teorike, e sjellë në mënyrë të përmbledhur, na ndihmon të kemi një panoramë të gjerë të studimeve dhe studjuesve më në zë të këtij lëmi. Qasja praktike, aq e domosdoshme në punime të tilla, na ndihmon të kuptojmë më mirë çka parashtrësit teorike na dëshmojnë dhe, sigurisht, analizat do të shërbejnë si modele që për çdokënd që merret apo dëshëron të merret me përkthimin e teksteve juridike.

Kështu, në kreun e parë, duke trajtuar disa koncepte teorike që kanë lidhje me nocionin e 'Ekuivalencës', si dhe teorinë e modelet më domethënëse të analizave përkthimore, kemi synuar të përmbledhim qasje të shkollave të ndryshme dhe që u takojnë periudhave të ndryshme. Kjo për të vlerësuar edhe zhvillimin e nocioneve dhe të modeleve në kohë. Duke sjellë, kështu, qëndrimet dhe debatet mbi përkthimin të përfaqësuar nga shkolla e Lajpcigut me Kade, Jäguer, Neubert, Eills, Reiss, Koller si dhe të studjuesve të tjerë evropianë si Viany, Darbelnet, Gentzler, Munday, Pym, Caminade, Hornby e duke u kundërvënë këtyre frymëzuesit e teorisë së pavarur të përkthimit të përfaqësuar nga amerikanët Lefevere, Holmes, Van der Broek, Catford, kemi synuar të japim një tablo sa më mirë të përfaqësuar të shkollave kryesore përkthimore të Evropës dhe të Amerikës. Vend të veçantë në kreun e parë zënë disa teori: teorinë funksionaliste e përkthimit si ajo për tipat e teksteve me përfaqësuese kryesore teoricienen gjermane Katarina Reiss. Në punimet e saj. Reiss-i analizon shkallën sipas së cilës përkthimi arrin të vendosë komunikimin dhe pikën tek e cila duhet kërkuar ekuivalenca. Ajo çka ajo kërkonte të ndiqte ishte vendosja e një procesi sistematik për vlerësimin e përkthimit. Për këtë, ajo propozoi një tipologji tekstesh dhe çdo tipi i dha një funksion të veçantë. Mjaft interes, në kuadër të teorisë funksionaliste të përkthimit, është edhe teoria e Skopos-it e studjuesit gjerman Vermmer. Teoria e Skopos-it përqëndrohet, para së gjithash, tek qëllimi i përkthimit, i cili përcakton metodat e përkthimit dhe strategjitë që përdoren për të mbërritur tek një rezultat funksionalisht i përshtatshëm. Studjuesi saktëson se procesi duhet të paraprihet nga një proces marrëveshjeje, sipas të cilit ai që komandon përkthimin i shpjegon përkthyesit qëllimin e përkthimit dhe kushtet në të cilat duhet të kryhet përkthimi. Sipas Vermeer-it, përkthyesi është ekspert në veprimin përkthimor; ai është i vetmi përgjegjës i realizimit të punës që i është besuar dhe i rezultatit të pritshëm. Qasja funksionaliste dhe, sidomos tepria e Skopos-it, i ka mundësuar përkthimologjisë të fitojë një dimension të ri. Sot janë kaluar parashkrimet e vjetra të cilat e shikonin tekstin burimor si normë që përcakton funksionin e tekstit mbërritës. Kjo teori ia njeh tekstit të përkthyer identitetin e vet dhe rrethanat e veta. Siç pohon Munday, ajo njeh mundësinë për të pasur përkthime të ndryshme të të njëjtit tekst sipas funksionit të tekstit mbërritës. Në praktikë, ndodh shpesh që të përkthehen tekste për qëllime të ndryshme nga ato që

kanë motivuar krijimin e tekstit burimor. Kjo është e vërtetë, para së gjithash, në botën e biznesit dhe në fushën juridike.

Teoritë funksionaliste revolucionarizuan përkthimologjinë duke e analizuar përkthimin si një proces komunikimi pragmatik, tek i cili tekstet burimore dhe tekstet mbërritëse mund të kenë qëllime ose funksione të ndryshme. Sot, gjuhësia bashkëkohore largohet nga debati i përkthyesve të vjetër që e shikonin përkthimin si veprimtari të mundshme ase të pamundur, të plotë ose të paplotë. Duke u mbështetur te qasjet e komunikimit pragmatik, gjuhësia bashkëkohore njeh relativitetin e rezultateve të veprimtarisë përkthimore duke e përcaktuar si një operacion, relativ në suksesin e tij, të ndryshueshëm në nivelet e komunikimit që arrin. Teoricienët që përcaktojnë përkthimin me ndihmën e nocionit të barazvlerësisë janë të shumtë. Aettinger e quan përkthimin “zëvendësim të elementëve të një gjuhe me elementë ekuivalentë të një gjuhe tjetër”. Catford pohon se përkthimi do mund të përcaktohej si “zëvendësimi i materialeve tekstuale të një gjuhe me materiale barazvlerëse në një gjuhë tjetër”. Nida propozon se “përkthimi ka të bëjë me prodhimin në gjuhën mbërritëse të brasvlerësit më të afërt të mesazhit të gjuhës burimore, fillimisht të përmbajtjes, pastaj të stilit”. Për studjuesin tjetër Pym, barasvlera përkthimore është një krijim dhe se ky krijim kërkon që vlera e elementëve të ngarkohet në hapësirën semantike të gjuhëve. Duke analizuar në hollësi nocioni e ‘ekuivalencës’, kemi paraplëqyer ta shohim atë në shfaqjet e ndryshme të saj, për ta kuptuar më saktë këtë nocion. Edhe pse, ndoshta, studiusit kanë identifikuar një numër të madh ekuivalencash, në punimin tonë jemi ndalur tek ato tipa ekuivalencash që analizohen më shpesh: ekuivalenca gjuhësore, paradigmatiske, stilistike, semantike, formale, referenciale, pragmatike, dinamike, funksionale, të cilat vendosen në rrafsh të ndryshme, si në atë semantik (ekuivalenca gjuhësore), në rrafshin gramatikor (ekuivalenca paradigmatiske) apo në rrafshin jashtëgjuhësor (ekuivalenca pragmatike).

Sjellja e analizës së Gideon Toury-së është bërë, pasi punimet e Toury-së janë një dëshmi e kontributeve të përkthimit letrar në zhvillimin e studimeve të përkthimologjisë. Duke përcaktuar përkthimin si një veprimtari sociokulturore, të udhëhequr nga norma dhe si një proces vendimmarrjesh, Toury parashtron parimet për rindërtimin e këtij procesi dhe formulimin e hipotezave, në lidhje me kufizimet gjuhësore, tekstuale dhe metodologjike, nën të cilat janë marrë vendimet. Për ta bërë këtë, ai propozon që përkthimi të segmentohet në njësi krahasimore dhe këto njësi të përputhen me segmentet përkuese në tekstin origjinal. Duke përdorur parimet e përkthimit formal ose funksional, të dhëna nga lëmi i studimeve teorike të përkthimologjisë, kërkuesi shkencor mund të përcaktojë drejtimin e segmenteve të analizuara. Drejtimi i përgjithshëm, i vërejtur në segmentet e tekstit, mundëson vendosjen e një drejtimi për përkthimin e plotë. A është ky

një përkthim që është orientuar drejt gjuhës dhe tekstit original apo drejt gjuhës dhe kulturës pritëse?

Në kreun e dytë trajtuam disa aspekte teorike dhe praktike të përkthimit juridik, duke nisur me një qasje pragmatike në këtë lloj përkthimi. Pragmatika, si disiplinë gjuhësore, na ndihmon të analizojmë komunikimin nga perspektiva e kodit gjuhësor por, dhe në funksion të përdoruesit të gjuhës dhe të përdorimit që ai i bën gjuhës. Qasja pragmatike zë vend të rëndësishëm në përkthimin juridik, pasi elementët që i nënshtrohen studimit të pragmatikës kanë ndikim të rëndësishëm në mjedisin juridik. Për të kuptuar më mirë gjuhën juridike dhe përkthimin e saj, na u duk me vend që të trajtojmë karakteristikat e përgjithshme të gjuhës së të Drejtës, kjo e fundit me karakter të gjerë heterogjen. Pikërisht ky karakter heterogjen i gjuhës të së drejtës e bën përkthimin e teksteve ligjore një proces të vështirë. Nëse do të niseshim nga leksiku, terminologjia juridike karakterizohet nga një shkallë e lartë vështirësie për përkthyesin si dhe shumëkuptimësi të gjerë. Duke qenë se e Drejta pasqyron nevojat e një shoqërie në kohë, kuptimi i termave mund të ndryshojë sipas kontekstit dhe epokave. Kjo bën që përkthyesi i sotëm të hasë vështirësi në përkthim të teksteve të vjetra juridike, pikërisht për shkak të ndryshimeve që shoqëria pëson. Gjithashtu, gjuha ligjore ka specifikat e saja stilistike, sintaksore, semantike që e bëjnë të ndryshme nga gjuha e zakonshme.

Na u duke me vend që, po në këtë kapitull, të sjellim edhe dy sistemet kryesore juridike *common loë* dhe *le droit civil*. Dy sistemet paraqesin dallime në substancë dhe në formë. E Drejta civile bën pjesë në familjen romako-gjermanike dhe përfshin të drejtat që burojnë nga amalgamat e së drejtës romake, gjermanike, zakonore dhe tregtare. E Drejta romake është mbizotëruese në këtë sistem, ndryshe e drejta civile njihet edhe si e drejtë romake. Nëse tradita romake dëshmon për rëndësinë e postulatit të Didier-it se fjalori juridik ka të njëjtën histori si institucionet dhe individët që e krijojnë dhe e përdorin, këtë e konfirmon *common loë*-i. Ky i fundit është një sistem i shënuar nga historia e vet, dhe kjo histori është ekskluzive, deri në shekullin e XVIII, historia e së drejtës angleze. Kjo justifikon faktin se ndarjet e mëdha, institucionet, struktura dhe veçanërisht terminologjia e *common loë*-it janë aq të ndryshme nga ato të traditës romake. Duke qenë se e Drejta është një shkencë shoqërore, dukuritë që ajo përshkruan janë vështirësisht të kalueshme nga një gjuhë në një tjetër ose nga një sistem në një tjetër. Për më tepër, prania e simeve të ndryshme juridike shkakton problemin e mospërputhjes të nocioneve dhe termave. Jean-Claude Gémard sugjeron një kërkim dokumentar në tre faza. Hapi i parë është leximi dhe analiza e tekstit; hapi i dytë është evidentimi dhe paraqitja e termave dhe nocioneve të panjohura dhe hapi i tretë është kërkimi i barasvlerës. Përkthyesi i teksteve ligjore nuk duhet të kufizohet në konsultimin e fjalorëve. Përkundraz, fjalorët janë të fundit që duhet

shfletuar. Fusha e së drejtës rrok shumë disiplina dhe pikërisht kjo e bën përkthimin juridik një proces të vështirë. Pra, lind pyetja: çfarë kulture juridike duhet të ketë një përkthyes i gjuhës ligjore? Kultura juridike rrok një kuptim të gjerë. Përkthyesi, nëse nuk është i fushës juridike, duhet të njohë mirë terminologjinë juridike dhe sistemin juridik të vendit të vet, për të mundur të kuptojë terminologjinë apo konceptet e një teksti, i cili i takon një sistemi tjetër të së drejtës.

Në kreun e tretë bëjmë një klasifikim të teksteve juridike, të cilat u përkasin tipologjive të ndryshme. Kështu, Géemar i ndan tekstet ligjore në tri kategori: aktet me interes publik si rregulloret, gjykimet dhe aktet procedurale; aktet me interes privat si kontratat, testamentet, marrëveshjet etj; tekstet e doktrinës. Duke u nisur nga ky klasifikim, në rastin e teksteve të kategorisë së parë, përkthyesi ka detyrim të përdorë në maksimum jo vetëm një pjesë të burimeve pothuajse të pakufishëm të gjuhës. Për kategorinë e dytë, përkthyesi duhet të dijë të rishprehë përmbajtjen juridike të tekstit origjinal dhe në kategorinë e tretë kërkohet niveli më i lartë i besueshmërisë së përkthimit nga ana e përkthyesit. Atëherë, cili do duhej të ishte formimi i përkthyesit ligjor? Roberts, profesor i përkthimit në Universitetin e Otavës (Kanada), është i mendimit se përkthyesi ligjor duhet të ketë këto aftësi: aftësi gjuhësore, kompetencë përkthimore, kompetencë metodologjike, kompetencë disiplinare, kompetencë teknike. Pesë kompetencave të Roberts, Vienne, profesor në Universitetin e Turku-së (Finlandë), u shton edhe katër aftësi apo kompetenca të tjera: aftësia për të vendosur se çfarë masash u përgjigjen më mirë kërkesave dhe pritshmërive të porositesit, aftësia për të trajtuar dhe administruar më mirë informacionin, aftësia për të komunikuar dhe rënë në ujdin me porositesin mbi përkthimin, aftësia për të bashkëpunuar me ekspertë të fushës me të cilën përkthimi lidhet. Megjithatë, mos të harrojmë se sot teknologjia e informacionit nëpërmejt inetrnetit na ofron burime të paimagjinueshme. Por, duhet ditur si t'i përdorim duke bërë dallimin midis burimeve të besueshme dhe atyre më pak të besueshme. Shtojmë këtu dhe domosdoshmërinë e pajisjes së përkthyesit ligjor më një njohje të mirë të bazave historike, filozofike dhe sociologjike të përkthimit të përgjithshëm dhe të përkthimit ligjor në veçanti.

Qasja interpretuese e tekstit gjatë procesit të përkthimit, sipas Géemar-it, është e bazuar në parimin sipas të cilit përkthyesi duhet të rishprehë në gjuhën dhe sistemin juridik pritës, kuptimin që ka në gjuhën dhe sistemin juridik nga gjuha që përkthehet. Që përkthyesi t'ia dalë mbanë, Géamr-i sugjeron një analizë tekstuale në pesë nivele: semanti, sintaksor, gramatikor, leksikor, stilistikor.

Lidhur me metodat apo mënyrat e përkthimit, Vinay dhe Darbnet kanë qenë më të plotë. Kështu, ata propozojnë shtatë mënyra të përkthimit: huazimi, kalku, përkthimi i fjalëpërfjashëm, përkthimi pothuajse i fjalëpërfjashëm zëvendësimi (transpozicioni), modulimi, përshtatja.

Në kapitullin e katërt, pas një përmbledhjeje të shkurtër të historisë së përkthimit të teksteve juridike në vendin tonë, kemi sjellë disa tekste anglisht të përkthyer në shqip, duke u bërë analizën përkatëse. Në këtë analizë jemi mbështetur në trajtesën teorike të parashtruar në kapitujt e mëparshëm, duke përgatitur edhe dy modele grilash për analizë. Modeli i grilës së parë është hartuar duke pasur parasysh të përmbledhim të gjithë informacionin që lidhet me strategjitë e ndryshme të përkthimit. Grila e dytë ngërthen analizën në tre plane: plani sintaksor, semantik dhe leksikor.

BIBLIOGRAFIA

- Alonso Gómez-Robledo Verduzc, *Aproximaciones al marco jurídico internacional del Tratado de Libre Comercio. El Tratado de Libre Comercio de América del Norte. Análisis, Diagnóstico y propuestas jurídicas*, bërë nën përgjegjësinë e Jorge Witker, vol., México, Universidad Autónoma de México, 1993
- Andre Lefevere *Translation of Poetry: Seven Strategies and a Blue Print*, Assen, Van Gorcum, 1975

- Andre Lefevere *Translation, Rewriting & the Manipulation of Literary Frame*, London, Routledge, 1992
- Anthony Pym *European Translation Studies, Une Science qui dérange, and why Equivalence Needn't Be a Dirty Word*, 1995
- Anthony Pym *Translation and Text Transfer*, New York, Peter Lang, 1992
- Anthony Pym, *Pour une éthique du traducteur*, 1997
- Clark D. Cunningham, Judith N. Levi et al, *Plain Meaning and Hard Cases*, The Yale Law Journal , vol. 103, nr. 1533, 1994
- Claude Hagège, *L'homme de parole*, 1985, fq. 191, cituar nga Gémar në *Traduire ou l'art d'interpréter*, 1995
- Danica Seleskovitch et Marianne Lederer, *Interpréter pour traduire*, Paris, Didier Erudition, 1986
- David Mellinkoff, *The Language of the Law*, Boston, Little, BroWn and Company 1963
- David Reed, *Problèmes de la traduction juridique au Québec*, Meta, vol. 24, n1 1, mars 1979
- Edmond Cary, *Les grands traducteurs français: Etienne Dolet, Amyot, Mme Dacier, Houdar de la Motte et les traducteurs d'Homère, Galland et les traducteurs des Mille et une nuits, Gérard de Nerval, Valery Larbau.* , Genève, Georg, 1963
- Edwin Gentzler, *Contemporary Translation Theories*, 1993
- *El derecho de Estados Unidos en torno al comercio y a la inversión*, vol. 1, National Law Center for Inter-American Free-Trade dhe Universidad Nacional Autónoma de México, 1999
- Emmanuel Didier, *Langues et langages du droit*, Montréal, Wilson et Lafleur, 1990

- Ethel Groffier, et David Reed, *La lexicographie juridique*, Cowansville (Québec), Les éditions Yvon Blais, 1990
- Eugene A. Nida, *Toward a Science of Translating*, 1964
- Eugene A. Nida et Jean de Waard, *From One Language to Another*, 1986
- *From One Language to Another. Functional Equivalence in Bible Translation*, Nashville, Thomas Nelson Publishers, 1986
- Gentzler *Contemporary Translation Theories*, 1993
- Georges A. Legault, *Fonctions et structure du langage juridique, Meta* , vol. 24, nr.1, mars 1979
- Georges Mounin, *Les problèmes théoriques de la traduction*, Paris, Gallimard, 1986
- Gérard-René de Groot, *La traduction juridique: The Point of View of a Comparative Lawyer*, Les Cahiers de Droit , vol. 28, nr. 4, dhjetor 1987
- Gideon Toury, *Descriptive Translation Studies and Beyond*, 1995
- Gloria M. A. Sánchez, *Paradigm Shift in Legal Education : Preparing Law Students for the Twenty-First Century: Teaching Foreign Law, Culture, and Legal Language of the Major U.S. American Trading Partners*, San Diego Law Review, vol. 34, nr. 635, 1997
- H. G. Höning, *Positions, Power and Practice: Functionalist Approaches and Translation Quality Assessment*, në *Translation and Quality*, edited by C. Schäffner, Clevedon, Multilingual Matters, 1998
- Hans J. Vermeer, *Skopos and Commission in Translational Action*, botuar nga Lawrence Venuti, London, Routledge, 2000
- Héctor Fix Fierro et Sergio López Ayllón, *Comunicación entre culturas jurídicas: los paneles binacionales del Capítulo XIX del TLCAN*, 1997
- James Holmes *The Name and Nature of Translation Studies*, 1972

- Ichiro Kitamura, *La traduction juridique: Un point de vue japonais*, Les Cahiers de Droit, vol. 28, nr. 4, dhjetor 1987
- J.C. Catford, *A Linguistic Theory of Translation: an essay in applied linguistics*, London, Oxford University Press, 1965.
- J. P. Vinay, et J. Darbelnet, *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, 1958
- J.L. Sourieux et Pierre Lerat, *Le langage du droit*, Paris, P.U.F., 1975, Introduction
- James Holmes «*The Name and Nature of Translation Studies*», The Translation Studies Reader, botuar nga Lawrence Venuti, London, Routledge, 2000
- Jean- Claude Gémar, Vo Thuy Ho-n, *Difficultés du langage du droit au Canada*, Montréal, Les Éditions Yvon Blais 1990
- Jean Darbelnet, *Réflexions sur le discours juridique*, Meta, vol. 24, nr. 1, mars 1979
- Jean Delisle et al., Amsterdam, John Benjamins *Terminologie de la traduction*, 1999
- Jean Vienne, *Vous avez dit compétence traductionnelle?*, Meta électronique, vol. XLIII, nr 2, 1998
- Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique et son enseignement: aspects théoriques et pratiques*, Meta, 1979
- Jean-Claude Gémar, *La traduction juridique: art ou technique d'interprétation*, Meta, vol. 33, nr 2, qershor 1998
- Jean-Claude Gémar, *Le traducteur et la documentation juridique*, Meta, vol. 25, nr 1, mars 1980
- Jean-Claude Gémar, *Les fondements du droit comme langue de spécialité: Du sens et de la forme du texte juridique*, në Revue générale du droit, 1990

- Jean-Claude G mar, *Les fondements du langage du droit comme langue de sp cialit *, Revist  e p rgjithshme e s  Drejt s, Universiteti i Oktavias, Fakulteti i Drejt sis , vol. 21, nr. 4, 1990
- Jean-Claude G mar, *Traduire ou l'art d'interpr ter: langue, droit et soci t  :  l ments de jurilinguistique, Tome 2 : Application*, V llimi 2: Zbatime, Kebek, Les Presse de l'Universit  du Qu bec, 1995
- Jeremy Munday, *Introducing Translation Studies*, 2001
- John Benjamins *Training the Translator* , Amsterdam , 1995
- John Gilissen, *Introduction historique du droit*, Bruxelles, Bruyland, 1979
- John Henry Merryman, *The Civil Law Tradition* , Stanford (California), Stanford University Press, 1969
- John Henry Merryman, *The Civil Law Tradition*, 1969
- Judith N. Levi and Anne Graffam Walker (ed.), *Language in the Judicial Process*, New York, Plenum Press, 1990
- Judith N. Levi, *What is Meaning in a Legal Text?: A First Dialogue for Law and Linguistics*, Washington University Law Quarterly, 1995
- Juliane House, *A Model for Translation Quality Assessment*, T bingen, Narr, 1977
- Katharina Reiss, *Type, Kind and Individuality of Text. Decision Making in Translation*, n  *The Translation Studies Reader*, edited by Lawrence Venuti, London, Routledge, 2000
- Kussmaul, *Training the Translator*, 1995
- Lawrence Friedman, *Is there a Modern Legal Culture?*, Ratio Juris, vol. 7, nr. 2, Korrik, 1994
- Lawrence M. Solan, *The Language of Judges* , Chicago, University of Chicago Press, 1993

- Lawrence Venuti-t , *The Translation Studies Readers*, 2000
- Lefevere “*The Focus of Growth of Literary Knowledge*”
- Leiden E. H. Brill, *The Theory and Practice of Translation*, 1969
- Leiden E. H. Brill, *Toward a Science of Translating*, 1964
- Leo Hickey, «*Equivalencia pragmática y traducción jurídica*, *Perspectivas Pragmáticas en Lingüística Aplicada*, 1998
- Leo Hickey, *Aproximación didáctica a la traducción jurídica, La enseñanza de la traducción*, nën përgjegjësinë e d’Amparo Hurtado Albir, Publicacions de la Universitat Jaume I (Castellón, España), Campus de la Penyeta Roja, 1996
- Leo Hickey, *Equivalence, Certainly. But is it Legal?*, *Turjuman*, vol. 2, nr. 2, Tetor1993
- Leo Hickey, *Equivalencia pragmática y traducción jurídica*, 1998
- Louis Jolicoeur, *La sirène et le pendule*, Kebek, L’instant même, 1995
- Louis-Philippe Pigeon, *La traduction juridique: L’équivalence fonctionnelle, Langage du droit et traduction: Essais de jurilinguistique*, punim kolektiv, realizuar nën drejtimin e Jean-Claude Gémard, Montréal, Linguatex, 1982
- Mary Ann Glendon et al., . *Comparative Legal Traditions*, Saint Paul (Minnesota.), West Publishing Co., 1985
- Mary Snell-Hornby, *Translation Studies: An Integrated Approach*, 1995
- Paul Kussmaul, *Training the Translator*, 1995
- Peter Newmark, *A Textbook of Translation*, New York, Prentice Hall 1988
- René David, *Les grands systèmes de droit contemporains*, edicioni 10, Paris, Dalloz 1996

- Roda P. Roberts, *Compétences du nouveau diplômé en traduction*, cituar nga Jean Vienne në *Vous avez dit compétence traductionnelle?*, Meta électronique, vol. XLIII, nr. 2, 1998
- Rodolfo Sacco, *La traduction juridique: Un point de vue italien*, Les Cahiers de Droit , vol. 28, nr. 4, dhjetor 1987
- Roman Jakobson, *On Linguistic Aspects of Translation*, The Translation Studies Reader, botuar nga Lawrence Venuti, Routledge, London, 2000
- Sally Engle Merry, *Law, Culture, and Cultural Appropriation*, Yale Journal of Law and Humanities, vol. 10, nr. 575, 1998
- Snell-Hornby, *Translation Studies: An Integrated Approach*, Amsterdam, John Benjamins, 1988, Rishikuar 1995
- Susan Bassnett, *Translation Studies*, London, Routledge 1991
- Susan Šar evi , *Bilingual and Multilingual Legal Dictionaries: New Standards for the Future*, Revue générale de droit, 1988
- Susan Šar evi , *New Approaches to Legal Translation*, The Hague, Kluwer Law International 1997
- Susan Šar evi , *Translation of Culture-Bond Terms in Laws*, Multilingua , vol 4, nr. 3, 1985
- Susan Šar evi , *New Approach to Legal Translation*, 1997
- Virginia Cano Mora, Leo Hickey et al., « *¿Qué hace, exactamente, el traductor jurídico?* », Livius , 1994
- Volkmar Gessner, *Global Legal Interaction and Legal Cultures*, 1994, Ratio Juris, vol. 7, nr. 2
- Yon Maley, *The Language of the Law, Language and the Law*, botuar nga John Gibbons, London, Longman 1994

➤ Revista *Social & Legal Studies*, vol. 4, no 4, dhjetor 1995